



**REPUBLIKA E KOSOVËS
INSTITUCIONI I AVOKATIT TË POPULLIT**

RAPORTI I DHJETË VJETOR 2010

**drejtuar
Kuvendit të Kosovës**

**Telefoni: ++381 38 545 303
Telefaksi: ++381 38 545 302
e-mail: ombudspersonkosovo@ombudspersonkosovo.org
ueb-faqja: www.ombudspersonkosovo.org**

Publikuar nga:

Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës

Përpunimi kompjuterik:

Linodesign

Shtypi:

Shtypshkronja “ORIENT” Prishtinë

2011, Prishtinë

Z. Jakup Krasniqi
Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës
Prishtinë

I nderuar zoti Kryetar

Bazuar në nenin 135 paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në nenin 27 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Ju paraqes raportin e dhjetë vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës.

Njëkohësisht, Ju lutem të pranoni edhe kërkesën për paraqitjen e këtij raporti në seancë plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe hapjen e diskutimit në lidhje me këtë raport.

Me nderime,
Sami Kurteshi



Avokat i Popullit i Republikës së Kosovës

Prishtinë, më 10 korrik 2011

Përmbajtja

Fjala e Avokatit të Popullit	7
1. Hyrje	9
1.1. Aspektet e përgjithshme	11
2. Institucioni i Avokatit të Popullit	13
2.1. Misioni i Institucionit të Avokatit të Popullit	13
2.2. Masat e përkohshme dhe raportet	15
2.3. Institucioni i Avokatit të Popullit i hapur për qytetarët	15
3. Gjendja e të drejtave dhe lirive themelore në Kosovë	17
4. Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës	25
4.1. Zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare	25
4.2. Dinjiteti i njeriut	27
4.3. Barazia para ligjit	28
4.3.1. Mungesa e ligjit për bashkësitë fetare	29
4.3.2. Diskriminimi i gjyqësorit dhe nga gjyqësori	30
4.3.3. Pabarazia e grup-moshave në sferën e punësimit	31
4.3.4. Diskriminimi i personave me aftësi të kufizuara	32
4.3.5. Trajtimi diskriminues nga Agjencia Kosovare e Pronës	33
4.3.6. Barazia gjinore	33
4.4. E drejta për jetën	36
4.5. Ndalimi i torturës, trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues	38
4.6. Të drejtat e të akuzuarit	41
4.7. E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm	43
4.8. E drejta për mjete juridike	46
4.9. Parimi i ligjshmërisë dhe proporcionalitetit në rastet penale	48
4.10. Liria e lëvizjes	49
4.10.1. Liria e lëvizjes së pjesëtarëve të komuniteteve pakicë	49
4.10.2. Liria e lëvizjes për popullatën shqiptare	51
4.10.3. Transporti publik i udhëtarëve	52
4.11. E drejta e privatësisë	53
4.11.1. Sigurimi i dokumenteve lidhur me marrjen e shtetësisë	53
4.11.2. Mënjanimi i zhurmës në vendet publike	54
4.11.3. Pacenueshmëria e banesës dhe e vendbanimit	54
4.11.4. Kontrolli dhe përgjimi i mjeteve të komunikimit-telefonisë	55
4.12. E drejta e martesës dhe familjes	55
4.13. Liria e besimit, ndërgjegjes dhe fesë	58
4.13.1. Analiza e gjendjes në Kosovë	58
4.13.2. Bashkësitë fetare në Kosovë	59
4.14. Liria e shprehjes	61
4.15. E drejta e qasjes në dokumente publike	62
4.16. Liria e mediave	64
4.17. Liria e tubimit	65
4.18. Liria e asociimit	67
4.19. E drejta e zgjedhjes dhe e pjesëmarrjes	68
4.20. E drejta e pronës	70
4.21. E drejta për arsimin	73
4.22. Liria e artit dhe e shkencës	76
4.23. E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit	77
4.24. Të drejtat e fëmijëve në Kosovë	79
4.24.1. Zbatimi i Strategjisë dhe Planit Nacional të Veprimit për të drejtat e fëmijëve	80
4.24.2. Mangësitë në fushën e arsimimit të fëmijëve	80
4.24.3. Dukuria e dhunës në shkollë	80
4.24.4. Braktisja e shkollimit	81
4.24.5. Puna e fëmijëve	81
4.24.6. Mungesa e mirëqenies sociale për fëmijët	82

4.24.7.	<i>Diskriminimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara</i>	82
4.24.8.	<i>Trafikimi me genie njerëzore- fëmijët viktime</i>	83
4.25.	Mbrojtja shëndetësore dhe sociale	83
4.25.1.	<i>Problemet sociale dhe mungesa e legjislacionit</i>	84
4.25.2.	<i>Diskriminimi i fëmijëve me aftësi të kufizuar</i>	84
4.25.3.	<i>Problemi i skemave pensionale</i>	85
4.25.4.	<i>Problemet në shëndetësinë e Kosovës</i>	86
4.26.	Përgjegjësia për mjedis	88
4.27.	Mbrojtja gjyqësore e të drejtave	91
4.27.1.	<i>Gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it</i>	93
4.27.2.	<i>Kompetencat e Avokatit të Popullit në raport me gjyqësorin</i>	94
4.27.3.	<i>Ankesat e qytetarëve ndaj gjyqësorit</i>	94
4.27.4.	<i>Ankesat e qytetarëve ndaj prokurorisë</i>	96
4.27.5.	<i>Rekomandime</i>	97
4.28.	Të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre	99
4.28.1.	<i>Përbërja e popullsisë në Republikën e Kosovës</i>	99
4.28.2.	<i>Kultivimi i identitetit politik, kulturor dhe kombëtar</i>	99
4.28.3.	<i>Sfidat dhe mundësitë e arsimit të komuniteteve pakicë</i>	100
4.28.4.	<i>Kultivimi i gjuhës së komuniteteve dhe sfidat praktike</i>	102
4.28.5.	<i>Komunitetet pakicë dhe mediat</i>	103
4.28.6.	<i>Përfundim</i>	105
4.29.	Përdorimi i gjuhëve	105
5.	Rekomandimet e Avokatit të Popullit	109
6.	Aktivitetet e Institucionit të Avokatit të Popullit	115
6.1.	Aktivitetet e Njësisë për Barazi Gjinore	115
6.2.	Aktivitetet e Grupit për të Drejtat e Fëmijëve	115
7.	Bashkëpunimi i IAP-së	117
7.1.	Bashkëpunimi me institucionet vendore	117
7.2.	Bashkëpunimi me OJQ-të vendore	117
7.3.	Bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare në Kosovë	118
7.4.	Bashkëpunimi me institucionet simotra	118
7.5.	Ndërtimi i kapaciteteve, konferencat, punëtoritë dhe trajnimet	119
8.	Buxheti i Institucionit të Avokatit të Popullit	123
9.	Përmbledhja statistikore e ankesave dhe rasteve për vitin 2010	125
10.	Struktura e personelit	135
11.	Shkurtesat	139
12.	Shtojca 1: Kërkesat për Gjykatën Kushtetuese	143
12.1.	Vendimi i Gjykatës Kushtetuese	151
13.	Shtojca 2: Baza ligjore dhe kompetencat e Avokatit të Popullit	155
13.1.	Ligji për Avokatin e Popullit,	157
13.2.	Kompetencat e Avokatit të Popullit në ligjet e tjera	170

Fjala e Avokatit të Popullit



Republika e Kosovës ballafaqohet me dy kundërshti që përbëjnë realitetin që e shohim dhe e prekim të gjithë: kërkesat e mëdha dhe mundësitë e vogla! Gjetja e baraspeshës midis kërkesave dhe mundësive shoqërore është pikërisht qëllimi i organizimit dhe i veprimit të shtetit.

Dy sfidat kryesore, më të mëdhatë, që vazhdojnë të lëkundin themelet e baraspeshës politike në Republikën e Kosovës, janë shteti ligjor dhe ai social.

Për ndërtimin e një sistemi shoqëror të drejtë, human dhe demokratik, baraspesha midis këtyre kundërshtive të pashmangshme, duhet të jetë shoqërisht e pranueshme, ligjërisht e drejtë dhe institucionalisht e zbatueshme. E kjo baraspeshë do të jetë e pranueshme kur bëhet normë e përgjithshme shoqërore, e cila kodifikohet ligjërisht. Kjo mund të arrihet dhe ka kuptim vetëm kur në procesin e krijimit të

ligjeve të vendit garantohet një pjesëmarrje e gjerë, që mundëson përfshirjen e interesave të sa më shumë shtresave dhe grupeve shoqërore, mundësisht të të gjithave. Kjo paraqet sfida jashtëzakonisht të rëndë, por është e domosdoshme për të qenë njëkohësisht drejtësi shoqërore dhe drejtësi ligjore.

Një drejtësi ligjore, e pranueshme dhe e zbatueshme në jetën praktike, për të gjithë individët pa asnjë dallim, në të gjithë territorin e shtetit, përbën bazën e shtetit ligjor.

A ekziston shteti ligjor? Është pyetja që secili mund ta shtrojë sa herë përballet me shkelje të natyrave të ndryshme. A besojmë si shoqëri në atë që quhet drejtësi e ndërhyrje e drejtë e shtetit?

Koncepti “shtet ligjor” në Kosovë është tjetërsuar deri në shkallën e një shprehje ironike, e shpeshherë edhe termi me konotacion negativ. Humbja e besimit në shtetin ligjor shtrihet nga shtresat dhe grupet më të varfra dhe më të pafuqishme të shoqërisë, deri tek individët që gjenden në krye të shtetit. Edhe kur duket se ekziston, drejtësia e shtetit e bazuar në ligj është përzgjedhëse! Ekziston dhe vlen vetëm për ata që kanë para dhe pushtet. Duke qenë përzgjedhës, hap sytë diku; mbyll diku tjetër, e ka humbur besimin e shoqërisë si tërësi.

Në Institucionin e Avokati i Popullit gjatë vitit 2010 janë 1233 raste të proceduara. Numri më i madh prej tyre ishin ankesa kundër gjyqësorit, në të gjitha nivelet. Ankesat bëhen për shkak të zvarritjes së proceseve gjyqësore – vonimit të drejtësisë; moszbatimit të vendimeve të plotfuqishme të gjykatave të rregullta – pafuqishmërisë së shtetit për të vënë drejtësinë në vend, apo edhe për shkak të vendimeve të padrejta, me elemente të korrupsionit dhe falsifikimeve, që nënkupton padrejtësi nga ata që pritet të vënë drejtësinë në vend! Kurse në pjesën veriore të Mitrovicës si dhe në komunat Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan, vlen vetëm ligji i të fortit. Këtu as ka dhe as ndahet drejtësia ligjore. Republika e Kosovës nuk ushtron fare pushtetin në këtë pjesë të territorit të vet.

Shumë nga ankesat e qytetarëve kanë të bëjnë edhe me moszbatimin e vendimeve të plotfuqishme të institucioneve të pavarura shtetërore nga vetë institucionet e shtetërore, apo edhe vendime të paligjshme të institucioneve shtetërore. Raporti i nëntë i Avokatit të Popullit, së bashku me rekomandimet, është miratuar nga të gjithë deputetë/ët e pranishëm në seancën e datës 26 korrik

2010 të Kuvendit të Republikës së Kosovës, pa asnjë votë kundër. Mirëpo, deri më tani, Avokatit të Popullit nuk ka asnjë informatë apo njoftim nga ndonjë institucion nëse ato janë zbatuar.

Gjithashtu nga analiza e vendimeve dhe akteve të tjera gjyqësore dhe të institucioneve të tjera shtetërore, të cilat i ofrohen si dëshmi Avokatit të Popullit, vërehen shumë lëshime e mangësi, shkelje e padrejtësi të natyrës materiale dhe procedurale. Avokati i Popullit nuk ndërhyr në punën e gjyqësorit në asnjë fazë të zhvillimit të procedurës, as në marrjen e vendimeve dhe as në interpretimin apo ndryshimin e vendimeve gjyqësore.

Humbja e besimit në zbatimin e ligjit e vë Avokatin e Popullit në pozicionin drejt të cilit shtrohen kërkesa për të vënë drejtësi në vend. Rrjedhimisht, edhe presioni mbi Avokatin e Popullit është në rritje dhe vjen nga të gjitha anët: nga individët, nga politika, nga shoqëria civile, nga mediat dhe nga grupet e ndryshme të interesit. Disa e kanë nga halli i madh, disa e bëjnë të shtyrë nga interesi material, të tretët kanë synime politike, të katërtit duan të shtyjnë përpara agjendën e tyre, kurse të n-tët duan thjesht të kenë ndikimin e tyre mbi Institucionin e Avokatit të Popullit. Pothuajse të gjithë e harrojnë, qëllimshëm ose jo, se Avokati i Popullit është institucion i pavarur kushtetues, me mision dhe kompetenca të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj. Agjenda, veprimet dhe vendimet e Avokatit të Popullit janë të pavarura dhe të tilla do të mbeten, përderisa Kushtetuta dhe Ligji e përcaktojnë këtë gjë.

Avokati i Popullit nuk ndan drejtësi, por do të vazhdojë të evidentojë dhe të nxjerrë në pah veprimet apo mos veprimet e parregullta e të paligjshme të autoriteteve publike, pikërisht për të luajtur rolin që ka në ndërtimin e një shoqërie të bazuar në parimin se të gjithë janë të barabartë para ligjit.

Nëse shteti shkel mbi parimet e drejtësisë ligjore, ka prekur në besimin e domosdoshëm për funksionimin e një shoqërie demokratike. Humbja e besimit në shtetin prish shtyllat mbajtëse të funksionimit të baraspeshuar e të bazuar në drejtësi për të gjithë. Kjo nuk duhet të ndodh! Barazinë para ligjit duhet ta sigurojnë dhe ta garantojnë në radhë të parë mekanizmat shtetërorë.

Sado të forta dhembjet e lindjes së shtetit të ri, shpresa për një të ardhme më të mirë, edhe pse e nëpërkëmbur, nuk ka humbur. Përpjekjet për vendosjen e rendit dhe të ligjit janë evidente. Për këtë duhet më shumë përkushtim dhe përgjegjësi individuale, shoqërore dhe sidomos institucionale të autoriteteve publike për veprimet apo mos veprimet e tyre.



1. Hyrje

Mbrojtja, mbikëqyrja dhe promovimi i të drejtave dhe lirive themelore të personave fizikë dhe juridikë nga veprimet e paligjshme ose nga mosveprimet e autoriteteve publike në Republikën e Kosovës janë segmentet kryesorë veprues, nëpërmjet të cilëve synohet realizimi i misionit kushtetues dhe ligjor i Avokatit të Popullit.

Edhe pse Republika e Kosovës tashmë ka krijuar një traditë në angazhimin e mekanizmave ligjorë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, nga çfarëdo aspekti dhe segmenti shkelës, qytetarët e saj, të cilët në të kaluarën janë ballafaquar me masat më të egra shtypëse, individualisht dhe kolektivisht, ndonëse në forma të tjera dhe jo me po atë brutalitet të dhunës fizike, edhe sot e kësaj dite përballen, me shkeljet nga më të ndryshmet të lirive dhe të të drejtave të tyre.

Dhe, këto shkelje, të ndryshme e të shumta, janë pikërisht pasojë e pamjaftueshmërisë së angazhimit të institucioneve publike në zbatimin e ligjeve. Prandaj, nisur nga kjo pamjaftueshmëri e angazhimit të institucioneve publike për zbatimin e ligjeve, që si pasojë ka shkeljen e të drejtave dhe të lirive të njeriut, Avokati i Popullit me veprimin e tij të vazhdueshëm, tashmë është shndërruar një dalzotës të qytetarëve të Kosovës, jo vetëm duke i mbrojtur, por edhe duke i mbikëqyruar dhe promovuar të drejtat dhe liritë themelore të tyre.

Pasqyrimi i mbrojtjes, mbikëqyrjes dhe promovimit të të drejtave dhe lirive të qytetarëve të Republikës së Kosovës, nëpërmjet mekanizmave veprues ligjorë, i sublimuar në veprimtarinë e përcaktuar kushtetuese dhe ligjore, është raporti vjetor, tashti i dhjeti me radhë i Avokatit të Popullit.

Meqenëse raporti i punës i Avokatit të Popullit paraqet njëkohësisht gjendjen e të drejtave të njeriut, por edhe pasqyrën e angazhimit të Avokatit të Popullit për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut nga institucionet publike, e tërë veprimtaria e Avokatit të Popullit përcillet me një ndjeshmëri të theksuar, që nga pranimi i ankesës së qytetarit e deri te zgjidhja përfundimtare e rastit. Ndjeshmëria e veprimtarisë së Avokatit të Popullit qëndron posaçërisht në faktin se, duke qenë se shoqëria jonë ende është në një fazë tranzicioni, institucionet tona shtetërore ende nuk kanë arritur të krijojnë mekanizma të duhur të cilët do të reagonin me efikasitet në përmirësimin e gjendjes së të drejtave dhe të lirive të njeriut në Republikën e Kosovës. Përkatësisht për të kuptuar drejt sugjerimet dhe rekomandimet ligjore të cilat vazhdimisht i përcjellë Avokati i Popullit dhe për të vepëruar ligjërisht sipas tyre.

Rastet e shkeljeve të të drejtave dhe të lirive të njeriut, nga institucionet publike në Republikën e Kosovës, as gjatë kësaj periudhe raportuese nuk kanë rezultuar me ndonjë zvogëlim të numrit për t'u theksuar, ashtu siç ka mbetur e njëjtë natyra e shkeljeve. Ndërkaq, zgjidhja e tyre vazhdon të jetë e koklavitur, qoftë për shkak të shpërfilljes së kërkesave të Avokatit të Popullit, qoftë për shkak të zvarritjes për zgjidhjen e problemeve me të cilat vazhdimisht ballafaqohen qytetarët e Republikës së Kosovës.

Raporti i dhjetë vjetor i Avokatit të Popullit, sikurse edhe raportet e mëparshme, duke qenë dokument zyrtar, paraqet në mënyrën më të përafërt gjendjen reale të të drejtave dhe të lirive të njeriut, përkatësisht anën a pakëndshme të realizimit të tyre, në njërën anë, si dhe angazhimin e vazhdueshëm të Avokatit të Popullit për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe për promovimin e tyre.

Puna e bërë gjatë një viti, përkatësisht gjatë periudhës mbi bazën e së cilës është hartuar ky raport, është një dëshmi për seriozitetin veprues të Avokatit të Popullit, përkatësisht të punonjësve të Institucionit të Avokatit të Popullit. Pavarësisht përballjeve të shumta dhe të ndryshme, pavarësisht ngecjeve dhe vështirësive, pavarësisht situatave, nganjëherë të pakëndshme, në të cilat janë gjendur, për shkak të ndjeshmërisë së rasteve dhe krijimit të raporteve ndërmjet qytetarit që ka konsideruar se i është shkëlur akëcila e drejtë ligjore dhe institucionit që është supozuar se ka bërë shkëljen, Avokati i Popullit dhe bashkëpunëtorët e tij kanë arritur të përbushin misionin e tyre themelor, të mbrojnë me sukses të drejtat e njeriut, madje duke e shtuar efikasitetin e punës së tyre. Në këtë dritë, gjatë kësaj periudhe raportuese, në krahasim me periudhën e kaluar raportuese, ka pasur një ngritje prej 11 për qind të numrit të rasteve të zgjidhura, sipas kërkesave të ankuesve. Kjo ngritje, pos si rezultat i efikasitetit, është edhe rezultat i cilësisë së dëshmuar të punës.

Ky raport vjetor i Avokatit të Popullit është strukturuar sipas parimeve, kriterëve dhe aspekteve, jo vetëm përmbajtësore, por edhe formale. Parimet, kriteret dhe aspektet kryesore për hartimin i këtij raporti qëndrojnë në shpërfaqjen e punës njëvjeçare të Avokatit të Popullit, përfshirë të gjitha hallkat vepruese të tij dhe të paraqitura sipas një renditjeje logjike të bazuar në misionin kushtetues të Avokatit të Popullit: mbrojtja, mbikëqyrja dhe promovimi i të drejtave dhe lirive të njeriut.

Në këtë frymë, raporti është i strukturuar si një tërësi e përbërë nga tri pjesë. E para, gjendja e të drejtave dhe lirive të njeriut në Kosovë, e cila në raport është paraqitur në përputhshmëri me përmbajtjen e kapitullit të dytë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, çka do të thotë se merendimi i të drejtave të njeriut, sikurse edhe i çështjeve të ngritura është sipas renditjes që e kanë bërë ligjvënësit në Kushtetutë e Republikës së Kosovës. Në këtë pjesë janë përfshirë edhe aktivitetet e tri grupeve caktuara që veprojnë brenda Institucionit të Avokatit të Popullit (Grupi për të drejtat e Fëmijëve, Grupi për mosdiskriminim dhe Njësia për barazi gjinore), si dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit, për raste të ndryshme.

E dyta, veprimtaria e përditshme në Institucionin e Avokatit të Popullit, që nga takimet e Avokatit të Popullit e deri te shërbimet mbështetëse profesionale dhe teknike (informimi, përkthimi, teknologjia informative, financat, logjistika, mirëmbajtja), si elemente qenësore për mbarëvajtjen e punëve brenda institucionit, ku janë përfshirë edhe statistikat e ndryshme.

E treta, paraqitja e shtojcave si një pasqyrë mbështetëse e strukturës së raportit, ku janë përfshirë: dokumente të ndryshme, që ilustronë punën e Avokatit të Popullit.

Paraqitja e punës së Avokatit të Popullit për një periudhë njëvjeçare, pos që është një detyrim ligjor, është edhe një dëshmi për të vërtetuar gjithë punën dhe angazhimin e Institucionit të Avokatit të Popullit në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Pra, është dëshmi e përpjekjeve për zgjidhjen e problemeve me të cilat ballafaqohen qytetarët tanë, kur atyre u shkelen apo nëpërkëmben të drejtat e tyre dhe kur ata shtrojnë kërkesat për realizimin e të drejtave të tyre të garantuara me kushtetutë e me ligj.

Avokati i Popullit, duke qenë një mbikëqyrës i zbatimit kushtetues dhe ligjor i të drejtave dhe lirive të qytetarëve të Republikës së Kosovës, ai njëkohësisht është edhe një ndriçues i rasteve kur qytetarët privohen nga ndonjë e drejtë e tyre, si dhe qortues i institucioneve publike kur ato shprehen mospërfillëse në zbatimin kushtetues dhe ligjor të të drejtave dhe lirive të tyre. Ky është njëri prej postulateve kryesore që shpërfaq ky raport, me një synim sublim: paraqitjen reale të gjendjes së të drejtave dhe lirive të njeriut në Kosovë dhe kahet e zhvillimeve të kësaj gjendjeje.

1.1. Aspektet e përgjithshme

Kushtetuta e Republikës së Kosovës tashmë i ka siguruar Kosovës një bazë solide normative, në pajtim të plotë me shumicën e standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Si e tillë ajo paraqet një sintezë, edhe pse jo të plotë, të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, duke qenë një arbitër suprem për interpretimin e dispozitave kushtetuese, si dhe për shqyrtimin dhe zbatimin e ligjshmërisë së veprimeve të autoriteteve publike në Kosovë, ka shënuar një hap vendimtar për vlerësimin dhe zbatimin e ligjshmërisë së veprimeve institucioneve shtetërore.

Ligji për Avokatin e Popullit, duke qenë një mekanizëm ligjor i cili sanksionon mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, kur ato nuk respektohen nga institucionet publike, ka arritur të fuqizojë zërin e Avokatit të Popullit, si dhe të krijojë një frymë të re në trekëndëshin ndërlidhës të të drejtave dhe lirive të njeriut: *Institucioni i Avokatit të Popullit - institucionet publike - qytetarët*.

Me gjithë ekzistimin tashmë të një baze të mirë normative, si dhe të mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, autoritetet publike të Republikës së Kosovës, në të gjitha nivelet, ende më tutje vazhdojnë të tregohen indolente, neglizhente dhe jorrallë mospërfillëse ndaj zbatimit të të drejtave dhe lirive të qytetarëve, që janë pasojë e zbatimit jopërkates të ligjeve.

Ndërkaq, zbatimi efektiv i standardeve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, konsolidimi i sistemit gjyqësor dhe i prokurorisë, si dhe luftimi i krimit të organizuar dhe i korrupsionit, edhe më tutje vazhdojnë të jenë sfida kryesore me të cilat po përballet, në të shumtën e rasteve pa ndonjë sukses të shënuar, shteti i ri Kosovës.

Për ligjvënësit e Kosovës dhe autoritetet e tjera shtetërore, sfida më e madhe mbeten nxjerrja dhe miratimi i disa ligjeve, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë prekin të drejtat e njeriut, të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, si *Ligji për sigurim invalidor dhe pensional* dhe *Ligji për sigurim shëndetësor*. Çdo ditë e humbur pa këto ligje, përbën jo vetëm humbje të madhe për shoqërinë kosovare, por edhe shkelje drastike të të drejtave themelore të njeriut në Republikën e Kosovës.

Po ashtu, edhe vonesat në nxjerrjen e akteve nënligjore paraqesin vështirësi të theksuara në zbatimin e ligjeve. Madje, çështja e vonesave të tilla, është theksuar edhe në raportet e mëhershme të Avokatit të Popullit dhe vazhdon të mbetet ndër rekomandimet themelore të tij. Ky mosveprim i institucioneve bie ndesh me standardet ndërkombëtare, por njëkohësisht është një sfidë shtesë për institucionet tona shtetërore.

Gjithnjë në kontekst të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve tanë, duhet theksuar çështjen e shtruar edhe në raportin e mëparshëm, përkatësisht mungesën e një gjykate administrative. Funkcionimi i saj do të ndikonte në përmirësimin e gjendjes së të drejtave të njeriut në vend. Ndonëse me ligjin në fuqi, vendosja për çështjet e konflikteve administrative, është kompetencë e Gjykatës Supreme të Kosovës, duke parë vështirësitë me të cilat ballafaqohet kjo gjykatë dhe dobësitë në funksionimin e saj, një zgjidhje tjetër është domosdoshmëri. Prandaj, themelimi i një gjykate administrative funksionale dhe me kompetenca të caktuara, do të përmirësonte standardet për mjete juridike efektive për zgjidhjen e konflikteve administrative. Mirëpo, deri tash ende nuk është marrë ndonjë nisim për themelimin e një gjykate të tillë.

Funksionimi i sistemit gjyqësor dhe i prokurorisë në Kosovë, që reflekton edhe në ndjeshmërinë, përkatësisht qëndrueshmërinë e gjithë mekanizmave shtetërore dhe bazën e shtetit të së drejtës, edhe më tutje vazhdon të jetë njëfarë Thembre e Akilit për Republikën e Kosovës. Gjyqësori, si njëra prej tri shtyllave themelore të pushtetit, vazhdon të jetë fusha e identifikuar me numrin më të madh të ankesave të paraqitura nga qytetarët e Kosovës, në institucionin e Avokatit të Popullit.

Joefikasiteti i sistemit gjyqësor në Kosovë është tejet shqetësues për Avokatin e Popullit. Avokati i Popullit ka identifikuar dhe afishuar tri mangësi, të cilat cenojnë rëndë bazat e shtetit të së drejtës, si: mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore; zvarritja pothuajse e pakufishme e procedurave gjyqësore dhe korrupsioni i cili ka kapluar sistemin gjyqësor.

Një problem tjetër, i cili vazhdimisht po e përcjellë gjithë sistemin e drejtësisë në Kosovë, që i ka rrënjët në sistemin arsimor të juristëve në Kosovë, është njohuria e pamjaftueshme në lëmin e standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Sidomos mangësi të patolerueshme vërehen në interpretimin e normave ligjore vendëse, sipas praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të Konventës Evropiane për të Drejtave Njeriut, ashtu siç është sanksionuar në nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Edhe pse Republika e Kosovës nuk është palë nënshkruese e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Kushtetuta e saj, në nenin 53 obligon shprehimisht që, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara, *“të interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*. Kështu, edhe neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës e qartëson detyrimin dhe kërkon që të drejtat dhe liritë e njeriut, të parapara me marrëveshjet dhe me instrumentet ndërkombëtare të *“zbatohen drejtpërdrejt”* dhe *“në rast konflikti”*, të kenë përparësi *“ndaj dispozitave ligjore dhe akteve të tjera të institucioneve publike”* në Republikën e Kosovës.

2. Institucioni i Avokatit të Popullit

Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë është themeluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/38 për themelimin e institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, si institucion i pavarur për shqyrtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut ose me keqpërdorim të autoritetit nga administrata ndërkombëtare dhe ajo vendore, që vepron në Kosovë. Zyrtarisht institucioni e ka filluar punën më 21 nëntor 2000. Deri në dhjetor të vitit 2005 institucioni është udhëhequr nga një Ombudsperson ndërkombëtar.

Pas largimit të Ombudspersonit ndërkombëtar, deri në zgjedhjen e Avokatit të Popullit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës Institucioni është udhëhequr nga ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit.

Me miratimin e Kushtetutës së Kosovës, Institucioni i Avokatit të Popullit u përcaktua si kategori kushtetuese.¹ Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 4 qershor 2009, zgjodhi z. Sami Kurteshi Avokat të Popullit të Republikës së Kosovës, me një mandat pesëvjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje.²

Me miratimin e Ligjit për Avokatin e Popullit u ndryshua edhe struktura organizative e institucionit. Udhëheqja e institucionit përbëhet nga Avokati i Popullit dhe pesë zëvendës.³

Që nga fillimi IAP rëndësi të veçantë i ka kushtuar dhe i kushton përbërjes shumetnike dhe strukturës gjinore të punonjësve.

2.1. Misioni i Institucionit të Avokatit të Popullit

Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe rregulloret e mëhershme të UNMIK-ut nr. 2000/38, nr. 2006/06 dhe nr. 2007/15, kanë përcaktuar misionin e Avokatit të Popullit, për të marrë dhe për të hetuar ankesa nga çdo person në Kosovë, që pretendon se i janë shkelur të drejtat nga autoritetet publike në Kosovë.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton rolin dhe kompetencat e Avokatit të Popullit, për të mbikëqyrur dhe mbrojtur të drejtat dhe liritë e personave fizikë dhe juridikë nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike. Avokati i Popullit zhvillon hetime, jep rekomandime, publikon raporte, ofron shërbime juridike falas, si dhe avokim publik, për të gjithë qytetarët e Kosovës. Në rastet kur hetimet e këshilltarëve ligjorë të IAP-së rezultojnë me gjetje të shkeljeve të të drejtave të njeriut, institucioni mund të kërkojë njoftime plotësuese nga autoritetet publike, të bëjë rekomandime për autoritetet përkatëse dhe të publikojë raporte për çështje të ndryshme. Në raste të veçanta, Avokati i Popullit mund ta bëjë këtë edhe nëpërmjet mediave.

IAP mund të ofrojë shërbime juridike edhe për ankesa të qytetarëve të saj, që drejtohen kundër autoriteteve publike jashtë Kosovës, që i përcjellë ato tek institucioni relevant (në shumicën e

¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kapitulli XII, nenet 132 – 135.

² Po aty, neni 134.

³ Ligji për Avokatin e Popullit, nr. 03/L-195, neni .

rasteve tek institucionet homologe - Ombudsman) në vendin tjetër ose tek ndonjë institucion tjetër simotër.

IAP është i pavarur në ushtrimin e detyrave dhe nuk pranon udhëzime ose ndërhyrje nga organet, institucionet ose nga autoritetet e tjera, të cilat ushtrojnë pushtet në Republikën e Kosovës. Ajo ka mundësi të hapë hetime për dyshimet e shkeljeve të të drejtave të njeriut edhe pa ankesë individuale (hetime ex officio). Po ashtu ka për mision t'i vëzhgojë politikatat dhe ligjet e miratuara nga autoritetet vendore, për të siguruar që ato të jenë në pajtim me standardet e të drejtave të njeriut dhe me kërkesat e qeverisjes së mirë.

Në rastet kur Avokati i Popullit konsideron se një praktikë ose situatë e përgjithshme nuk është në pajtim me standardet vendore a ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ndikon te një individ apo më gjerë, bën raporte speciale, të cilat përfshijnë edhe rekomandime të drejtuara Kuvendit të Kosovës, me qëllim të përmirësimit të gjendjes së krijuar dhe të harmonizimit të saj me standardet vendore dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Me qëllim të identifikimit të problemeve dhe me qëllim të sigurimit të të dhënave për shkeljet e supozuara, Avokati i Popullit kërkon nga çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, t'i përgjigjen kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'ia paraqesin atij të gjitha dokumentet dhe të dhënat e kërkuara, në pajtim me Kushtetutën dhe me ligjin.⁴

Me qëllim të mbulimit të fushave, që përfshijnë çështje të veçanta të disa grupeve të njerëzve, të drejtat e të cilëve konsiderohen më të cenueshme në Kosovë, siç janë fëmijët, gratë, pakicat etnike dhe të tjera, IAP ka themeluar tri grupe të posaçme me juristë të specializuar për fushat përkatëse, siç janë: Grupi për të Drejtat e Fëmijëve (GDF), Njësia për Barazi Gjinore (NJBGJ) dhe Grupi për Mosdiskriminim (GMD).

Edhe pse IAP merret me hetime dhe e mbikëqyr papajtueshmërinë e gjyqësorit me standardet e të drejtave të njeriut, nuk e zëvendëson gjykatën dhe nuk mund t'i hetojë krimet në mënyrë të drejtpërdrejtë, t'i ndryshojë aktvendimet e gjykatës ose të japë vendime detyruese. IAP, po ashtu, nuk merret me hetimin e çështjeve, që kanë të bëjnë me kontestet që zhvillohen ndërmjet personave privatë.

Gjatë periudhës nëntëvjeçare të ekzistimit IAP, gjithnjë i ka proklamuar vlerat dhe parimet më të rëndësishme, në bazë të të cilave funksionon. Në këtë drejtim IAP nuk do ta arrinte efektin e duhur në fushën e veprimit të vet, nëse nuk do t'u përmbahej vlerave dhe parimeve, siç janë: pavarësia, paanshmëria, profesionalizmi dhe konfidencialiteti.

Sfidë dhe objektiv kryesor i IAP-së mbeten krijimi dhe zhvillimi i asaj, që quhet kulturë e qeverisjes së mirë, e cila nënkupton administrim të mirë, transparencë dhe llogaridhënie të administratës publike para qytetarëve të Kosovës, si dhe forcim të përgjithshëm të sundimit të ligjit. Edhe angazhimi i IAP-së për balancim të raporteve në mes administratës publike dhe qytetarëve, të cilëve kjo administratë mëton t'u shërbejë, ka po këtë qëllim. Zgjidhjet e arritura nga Avokati i Popullit synojnë të sjellin përmirësime në standardet dhe në cilësinë e shërbimeve të administratës publike ndaj qytetarëve.

Synim i veprimtarisë efikase të Avokatit të Popullit është shtimi i besimit të njerëzve te institucioni, edhe tek administrata, duke siguruar relacion koherent ndërmjet qytetarit dhe administratës publike.

⁴ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 133, pika 1.

Kjo është e domosdoshme për funksionimin e demokracisë normale. Për këtë arsye Avokati i Popullit është pjesë e atyre institucioneve që konsiderohen si “*garantë të demokracisë, të shtetit ligjor dhe të të drejtave të njeriut*”

Angazhimi dhe insistimi i IAP-së për përmirësimin e imazhit të administratës publike dhe të sistemit gjyqësor, bën që qytetarët të kuptojnë se ata mund të llogarisin në këtë institucion dhe se mund t’i parashtrorjnë ankesat e tyre kundër administratës, sipas një procedure të thjeshtë dhe pa pagesë. Ankesat e drejtuara në IAP mund t’u referohen veprimeve, mosveprimeve ose vendimeve të administratës publike, që nga ankuesit mund të konsiderohen të padrejta ose të pafavorshme. Në shqyrtimet e ankesave të tilla, veprimet e juristëve përkatës kanë të bëjnë me dhënien e këshillave juridike, me kërkim të të dhënave dhe informatave nga administrata publike, nga gjykatat dhe nga institucionet e tjera të rëndësishme, lidhur me ankesat e paraqitura, si dhe me mbikëqyrjen e procedurave të caktuara gjyqësore. Në rastet që kërkojnë veprime të menjëhershme, IAP paraqet kërkesa për masa të përkohshme. Lidhur me këtë, mënyra e veprimit ndryshon, varësisht nga natyra e rasteve individuale.

2.2. Masat e përkohshme dhe raportet

Në qoftë se Avokati i Popullit konsideron se duhet të merren masa të menjëhershme nga autoritetet publike, ai mund të kërkojë ligjërisht që organi administrativ kompetent të ndërmarrë ose të suspendojë një veprim të veçantë, si masë e përkohshme për të parandaluar dëmtimin e papërmirësueshëm të ankuesve apo pasurisë së tyre.

Nëse letrat për intervenim dhe përpjekjet për ndërmjetësim nuk janë të suksesshme, Avokati i Popullit mund të nxjerrë raport, duke siguruar analiza dhe paraqitje publike për shkelje të të drejtave të njeriut ose të ligjeve të aplikueshme, së bashku me rekomandime për institucionin publik, përkatëse për të evituar shkeljet. Raportet janë metoda e fundit e institucionit për avokim, kurse kopjet e raportit i dorëzohen autoritetit që e ka bërë shkeljen, Kuvendit të Kosovës, si dhe organizatave të tjera relevante.

2.3. Institucioni i Avokatit të Popullit i hapur për qytetarët

Institucioni i Avokatit të Popullit ka dyert e hapura për qytetarët. Kur individët i drejtohen Avokatit të Popullit për të parashtruar ankesë ose kërkesë, lidhur me shkeljet e të drejtave dhe interesave të tyre të ligjshme, priten nga këshilltarët ligjorë të IAP-së, të cilët i trajtojnë rastet me kujdes dhe profesionalizëm.

Me qëllim të lehtësimit të qasjes së qytetarëve të Kosovës në IAP, përveç Zyrës Qendrore (selia) të Avokatit të Popullit në Prishtinë, janë themeluar dhe funksionojnë edhe zyra rajonale në Gjilan, Pejë, Mitrovicë, Prizren dhe në Graçanicë. Po ashtu, Avokati i Popullit ka themeluar edhe nënzyrën rajonale në pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës. Staf i profesional në selinë e Avokatit të Popullit dhe në të gjitha zyrat rajonale është në vazhdimësi në shërbim të qytetarëve për t’iu përgjigjur kërkesave dhe ankesave të tyre, si dhe për t’i udhëzuar ata në mbrojtje të të drejtave, për të cilat ata mëtojnë se u janë shkelur.

Ankesat e qytetarëve në Zyrën Qendrore në Prishtinë pranohen çdo ditë pune, nga ora 09:00 deri në orën 15:00. Zyrat rajonale pranojnë ankesa nga e hëna e deri të enjten, nga ora 09:00 deri në orën 15:00. Për raste urgjente, qytetarët mund të paraqiten edhe jashtë orarit të përcaktuar.

Këshilltarët ligjorë të IAP-së bëjnë vizita të rregullta në komuna të ndryshme, në vendbanime dhe në zona, në të cilat gjenden bashkësi të konsiderueshme etnike të ndryshme. Gjithashtu, duke pasur parasysh se të arrestuarit, të ndaluarit, të paraburgosurit dhe të burgosurit kanë qasje të kufizuara në institucione, zyrtarët e institucionit të Avokatit të Popullit bëjnë vizita të rregullta në të gjitha burgjet dhe në vendet e ndalimit të personave në Kosovë.

Përfaqësuesit e IAP-së, në të gjitha qendrat e paraburgimit, shpërndajnë formularë edhe broshura me informacion për misionin e IAP-së, në mënyrë që të gjithë personat e privuar nga liria, të jenë të informuar për të drejtat e tyre, si dhe për mundësitë e parashtrimit të ankesave dhe të kërkesave. Që nga viti 2004, në të gjitha burgjet dhe në qendrat e paraburgimit në territorin e Republikës së Kosovës, në vende të dukshme, IAP ka vendosur kutitë postare, të cilat hapen vetëm nga përfaqësuesit e autorizuar. Kjo praktikë ka dëshmuar se kutitë e vendosura nëpër burgje, përkatësisht në qendra të paraburgimit apo të ndalimit, kanë ndihmuar shumë të burgosur ose të paraburgosur për të vënë kontaktin e parë me Avokatin e Popullit

Në këtë mënyrë arrihet komunikimi i drejtpërdrejtë me të burgosurit, në bashkëpunim me autoritetet e Shërbimit Korrektues të Kosovës, si dhe me autoritetet përgjegjëse të burgjeve në Kosovë. Një kuti e tillë postare është e vendosur edhe në Entin për Kujdes Social në Shtime, e cila e lehtëson qasjen e pacientëve të këtij enti në Institucionin e Avokatit të Popullit. Entin në fjalë, e vizitojnë edhe përfaqësuesit e Avokatit të Popullit, në baza të rregullta mujore.

Për t'u ofruar qasje të drejtpërdrejtë dhe më të lehtë qytetarëve, si dhe me qëllim të afrimit më të madh me qytetarët, që dëshirojnë të bisedojnë me zyrtarët e IAP-së, Avokati i Popullit ose zëvendësit e tij, i kanë bërë tashmë praktikë ditët e hapura në shumë qytete të Kosovës. Me atë rast ankuesit mund të takohen personalisht me Avokatin e Popullit ose me ndonjërin nga zëvendësit e tij. Ditët e hapura organizohen një herë në muaj, në të gjitha qendrat e mëdha në Kosovë. Avokati i Popullit, gjithashtu, është i gatshëm t'i vizitojë edhe qytetarët e qyteteve ose të vendbanimeve të tjera të Kosovës, të cilët bëjnë kërkesë të tillë. Zyrat rajonale i njoftojnë qytetarët për ditët e hapura me anë të publikimit të datave nëpër komunat përkatëse, nëpërmjet mediave lokale dhe nëpërmjet ueb faqes zyrtare të IAP-së.

Lehtësisht qytetarët, mund t'i qasen IAP-së edhe përmes postës elektronike, e cila të shumtën e rasteve përdoret për parashtrimin e ankesave nga qytetarët që jetojnë jashtë Kosovës. Ekziston edhe linja telefonike në Zyrën Qendrore të IAP-së për raste urgjente, e cila është e lidhur drejtpërdrejt me zyrën kryesore të këshilltarëve ligjorë, pa kaluar nëpër centralin telefonik të IAP-së.

3. Gjendja e të drejtave dhe lirive themelore në Kosovë

Sikurse edhe raportet e mëparshme të Institucionit të Avokatit të Popullit, të cilët kanë sipërfaqësuar gjendjen e të drejtave të njeriut, edhe raporti i dhjetë, që në njëfarë mënyre shënon një jubile modest, ka arritur të sublimojë gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Republikën e Kosovës, jo vetëm duke e përshkruar dhe duke e paraqitur atë në bazë të ankesave të qytetarëve ndaj institucioneve publike, por edhe duke bërë një analizë qëmtuese për gjithë gjendjen e të drejtave dhe lirive të njeriut.

E drejta për jetën është e drejta themelore dhe kushti i parë për ekzistimin e të gjitha lirive dhe të drejtave të tjera. Kjo e drejtë e përjashton privimin arbitrar të njeriut nga jeta dhe është e mbrojtur me Kushtetutë. IAP në këtë periudhë raportuese nuk ka marrë asnjë ankesë për aspektet materiale të së drejtës për jetë.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës mbron *dinjitetin e njeriut*, si një të drejtë të pacenueshme dhe bazë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Avokati i Popullit është i përkushtuar në qasjen aktive në vendet ku mbahen personat e privuar nga liria anembanë Kosovës. Po ashtu, Avokati i Popullit, ka publikuar një raport për gjendjen e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas në kampet në veri të Mitrovicës dhe në Leposaviq, ku është rekomanduar zhvendosja e ose ofrimi i kushteve për jetë më të dinjitetshme të tyre.

Barazia para ligjit. Ndonëse barazia para ligjit është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe është sanksionuar me *Ligjin kundër diskriminimit*, fatqësisht deri tash nuk shihet ndonjë përparim në zbatimin e tij. Problemet qëndrojnë në paqartësitë e disa neneve të këtij ligji, përkatësisht të ngatërimi kuptimor i tyre, për të cilat edhe IAP ka shprehur shqetësimet, mirëpo autoritetet përkatëse nuk kanë ndërmarrë asgjë në këtë drejtim.

Ligji për bashkësitë fetare. Për shkak të mungesës së një ligji përkatës, në një pozitë diskriminuese vazhdojnë të mbesin shumica e bashkësive fetare në Kosovë. Në vitin 2006 është miratuar *Ligji për lirinë fetare në Kosovë*, i cili e anashkalon rregullimin e pozitës juridike të bashkësive fetare. Mungesa e një infrastrukture të plotë ligjore krijon probleme ndërfetare, ngase bashkësitë e tjera fetare janë të diskriminuara në raport me Kishën Ortodokse Serbe, e cila falë “diskriminimit pozitiv” gëzon trajtim tjetër nga bashkësitë fetare në Kosovë. Lidhur me këtë Avokati i Popullit ka publikuar Raportin, me të cilin i është drejtuar Kuvendit të Republikës së Kosovës. Mirëpo, deri më tani nuk ka marrë përgjigje lidhur me të.

Pozita e gjyqësorit, në krahasim me pushtetet tjera të shtetit, ende është në pozitë inferiore, ku fatqësisht ka ndërhyrje nga politika. Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme të Kosovës, nuk i respekton të drejtat e qytetarëve, të garantuara me Kushtetutë dhe ligj. Ajo edhe më tutje i detyron qytetarët që kërkesat e tyre, t’i dorëzojnë në gjuhën angleze. Me mospranimin e padive dhe dokumentacionit nga qytetarët e Kosovës në gjuhët zyrtare, kjo gjykatë bën shkelje të nenit 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe *Ligjit për përdorimin e gjuhëve*.

Avokati i Popullit ka publikuar një raport, lidhur me *diskriminim në moshë*, në shpallje të konkurseve për vende pune, por kjo dukuri vazhdon të jetë e pranishme gjatë punësimit. Një diskriminim të tillë e hasim edhe në vendime të organeve të larta drejtuese të institucioneve publike. Avokati i Popullit e ka publikuar një raport në lidhje me diskriminimin për shkak të moshës dhe e

ka ngritur çështjen për konflikt administrativ në Gjykatën Supreme të Kosovës, por deri më 31 dhjetor 2010, nuk ka marrë përgjigje.

Edhe më tej kategori e rrezikuar nga çdo lloj diskriminimi mbeten *personat me aftësi të kufizuara*. Problemet e ngritura edhe në raportet e mëparshme, si infrastruktura rrugore dhe e objekteve në përgjithësi për lëvizje të lirë për personat me mjete ndihmëse, mbeten të pazgjidhura.

Shumë familje, të cilat në pamundësi për të bërë zgjidhje vetanake për strehim, edhe më tej vazhdojnë t'u drejtohen kuvendeve komunale për të kërkuar *ndihmë për strehim humanitar*. Shumë komuna tani e dhjetë vite pas luftës, po dështojnë të bëjnë zgjidhje të strehimit për familjet në gjendje të rëndë sociale dhe të pastrehë.

Trajtimi diskriminues nga Agjencia Kosovare e Pronës (AKP) vazhdon akoma duke punuar me standarde të dyfishta gjatë trajtimit dhe shqyrtimit të lëndëve. Pronat në pjesën veriore të Mitrovicës, tash e dhjetë vite nuk janë liruar nga uzurpuesit e paligjshëm. Dështimi i AKP-së për realizimin e misionit të saj, si dhe trajtimi diskriminues i ankuesve, sidomos diskriminimi në baza etnike, përbën shkelje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Në bazë të ankesave në IAP-së vihet re se *diskriminimi në baza gjinore* është i pranishëm, si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat. Sipas të dhënave zyrtare, për periudhën për të cilën raportohet, shihet se numri i vajzave të cilat e braktisin shkollën, edhe pse në rënie, është shqetësues. Pabarazia gjinore reflektohet në profilet arsimore, të cilat dëshmojnë për formën patriarkale të ndarjes në profesionet e meshkujve dhe të femrave.

Ankesat nga gratë, në IAP, kanë të bëjnë me diskriminimin nga Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave, sa i përket trajtimit mjekësor jashtë vendit. Në rastet kur Ministria e Shëndetësisë ka vendosur pozitivisht, Ministria Financave nuk ka përfillur udhëzimin.

IAP, në këtë periudhë, ka pranuar një numër të caktuar të ankesave, të cilat kishin të bëjnë me zvarritje të proceseve gjyqësore. Pjesa më e madhe e tyre ka të bëjë me marrëdhëniet pronësore juridike, ku pjesëtarët e gjinisë femërore janë të dëmtuara.

Është inkurajues fakti se *dhuna në familje* është kualifikuar si vepër penale dhe sanksionohet me ligj. IAP ka pasur disa ankesa, në lidhje me dhunën familjare. Sfida pakrahasueshëm më e madhe e shoqërisë dhe institucioneve publike në Kosovë për përmirësimin, në fushën e barazisë gjinore në Kosovë, është dhuna në familje dhe *trafikimi me qenie njerëzore*.

Kushtetuta e Kosovës, Kodi Penal i Kosovës dhe instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut garantojnë se “*Askush nuk duhet t'i nënshtrohet torturës, a trajtimeve ose dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese*”. Gjatë vitit 2010, lidhur me shkeljen e kësaj të drejte në IAP janë regjistruar 7 raste, të cilat janë në procedim e sipër. Kurse numri më i madh i ankesave në burgje janë të drejtuara kundër Panelit për Lirim me Kusht dhe ankesa sa i përket trajtimit mjekësor.

Të drejtat e të akuzuarit. IAP, gjatë kësaj periudhe ka monitoruar qendrat e ndalimit dhe të mbajtjes së të akuzuarve për vepra të ndryshme penale dhe ka zhvilluar vizita të rregullta në këto qendra paraburgimi dhe burgje. Nga raporti i Shërbimit Korrektues të Kosovës, vërehet se në Burgun e Dubravës, në pritje të vendimit final për dy e më shumë vite janë gjithsej 11 të burgosur, ndërsa në qendrat e paraburgimit në Pejë dhe Mitrovicë nga një.

E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm është e drejtë themelore e njeriut, e mbrojtur nga Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut. Kjo e drejtë është rregulluar edhe me Ligjin mbi gjykatat, Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale dhe me Ligjin për Procedurën

Kontestimore. IAP ka pranuar një numër të konsiderueshëm të ankesave të qytetarëve për shkeljet e së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor, sidomos të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor. Shumica e ankesave të qytetarëve për zvarritje të tepruar të procedurave gjyqësore, janë konteste pronësore dhe detyrimore. Këto procedura, deri në marrjen e vendimit gjyqësor zgjasin 5 deri 6 vite.

E drejta për mjete juridike, është e drejtë e garantuar me Kushtetutë dhe është kërkesë edhe e instrumenteve juridike ndërkombëtare. Lidhur me procedurat gjyqësore dhe administrative, gjatë shfrytëzimit të mjeteve juridike, IAP ka pranuar 99 ankesa të qytetarëve, prej të cilave 35 janë mbyllur dhe 64 janë ende të hapura.

Nga analizat e bëra është konstatuar se pjesa më e madhe e ankesave i përket sistemit gjyqësor, pastaj komunave, ministrive, si dhe kompanive publike.

Ankesat e paraqitura kundër gjyqësorit kanë të bëjnë kryesisht me zvarritjen e procedurave gjyqësore, deri në marrjen e vendimit gjyqësor pas ushtrimit të mjetit juridik.

Ankesat e drejtuara kundër organeve shtetërore kanë të bëjnë me nxjerrjen e vendimeve joligjore në dëm të qytetarëve. Ankesat drejtohen edhe për shkak të mosrespektimit të vendimeve të nxjerra nga vetë organet, si dhe të mosrespektimit apo *moszbatimit të vendimeve të institucioneve të pavarura*. Vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës nuk zbatohen nga organet shtetërore. Qytetarët kërkojnë nga Avokati i Popullit që të përdor autoritetin dhe kompetencat e tija ligjore për zbatimin e vendimeve.

Parimi i ligjshmërisë dhe proporcionalitetit, si njëri nga parimet e të drejtës penale, është garantuar me Kushtetutë dhe është sanksionuar me Kodin Penal. IAP, gjatë periudhës për të cilën raportohet, nuk ka pranuar ndonjë ankesë përkitazi me cenimin e parimit të ligjshmërisë.

Liria e lëvizjes, sipas Kushtetutës nënkupton të drejtën për lëvizje të lirë në tërë territorin e një shteti, pa kufizime apo ndërhyrje të paligjshme. Nëse kjo vështrohet nga standardi i përgjithshëm në Kosovë, atëherë, kjo e drejtë nuk gëzohet plotësisht. Në këtë periudhë raportuese, është i dukshëm zvogëlimi i sulmeve fizike. Por, pavarësisht zvogëlimit të incidenteve serioze të dhunës, rasteve të ngacmimit, frikësimit dhe ndjenja e pasigurisë është ende e pranishme në pjesë të ndryshme të Kosovës, varësisht nga përkatësia etnike.

Liria e lëvizjes së pjesëtarëve të komuniteteve pakicë. Përfaqësuesit e komuniteteve pakicë me numër më të vogël si, turqit dhe boshnjakët, ashtu sikurse ashkalinjtë dhe egjiptasit, nuk kanë pengesa për të lëvizur në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, me përjashtim të pjesës veriore të Kosovës dhe në disa enklava serbe si psh. në Ranillug e Korminjan. Këto kufizime nuk vlejnjë për goranët. Ndërsa pjesëtarët e pakicës serbe dhe romët ndihen të rrezikuar për të lëvizur lirshëm në shumë pjesë të territorit të Kosovës. Përparimet më të mëdha, në aspektin e lirisë së lëvizjes të pjesëtarëve të komunitetit serb dhe komunikimit ndëretnik, vërehen në rajonin e Gjilanit dhe Vitisë. Përmirësimi i situatës vërehet edhe në rajonin e Prishtinës, në një pjesë të mirë në Prizren dhe Pejë, por nuk mund të thuhet e njëjta gjë edhe për rajonin e Gjakovës dhe Mitrovicës.

Liria e lëvizjes për popullatën shqiptare dhe pjesëtarët e komuniteteve pakicë turq, ashkali e egjiptas, kryesisht të tillë që nuk janë serbfolës dhe ortodoksë, nuk mund të qarkullojnë lirshëm në veri të Mitrovicës. Rreziku kryesor për banorët shqiptarë, në pjesën veriore të Mitrovicës, paraqesin bandat e organizuara kriminale të përkrahura nga Republika e Serbisë. Kufizime, por më të vogla, ka edhe në vendbanimet serbe si Ranillug dhe Korminjan.

Mbështetje të vetme për *transportin publik* për serbët dhe romët nëpër vendbanimet serbe në Kosovë, paraqet i ashtuquajturin transport humanitar, të cilin e organizon dhe financon Qeveria e Kosovës. Në pjesën veriore të Kosovës nuk funksionon as transporti publik dhe as ai privat me regjistrim të Republikës së Kosovës. Si në rastin e parë ashtu edhe në të dytin, ky do të thotë një kufizim i lirisë së lëvizjes për qytetarët në pjesë të ndryshme të Kosovës.

E drejta e privatësisë është e garantuar me Kushtetutë dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Për periudhën e këtij raportimi, lidhur me të drejtën e privatësisë, në IAP janë pranuar gjithsej 5 ankesa, të cilat kanë të bëjnë me forma të ndryshme të cenimit të kësaj të drejte.

Avokati i Popullit ka ofruar shërbime të mira për ankuesit, duke ndihmuar për *pajisjen me dokumentet e nevojshme* në Republikën e Kosovës, me qëllim të respektimit të të drejtave të njeriut, të përcaktuara me standardet ndërkombëtare.

IAP ka shprehur shqetësim, lidhur me *zhurmën* e padurueshme në *vendet publike* në Prishtinë, sikurse edhe për shkak të *përgjimit të mjeteve të telefonisë*. Gjatë kësaj periudhe raportuese, IAP ka pranuar nga një ankesë, në lidhje me këto çështje.

E drejta e martesës dhe familjes janë bazë për krijimin e një shoqërie të shëndoshë dhe në ndërtimin e një shteti. Në periudhën raportuese, është vërejtur një tendencë rritjeje e numrit të shkurorëzimeve në Kosovë. Avokati i Popullit edhe gjatë kësaj periudhe të raportimit ka pranuar një numër të madh të ankesave që kanë të bëjnë me zvarritjen e procedurave lidhur me shkurorëzimin; mosrealizimin e kontakteve të rregullta më fëmijë, si dhe me zvarritjen e procedurave për të vendosur përkitazi me të drejtat e besimit të fëmijëve. Avokati i Popullit, gjatë kësaj periudhe ka publikuar një raport që ka të bëjë me *zvarritjen e procedurës së ekzekutimit të një vendimi të plotfuqishëm nga Gjykata* lidhur me kontaktet personale të nënës me fëmijët e saj të mitur.

Kushtetuta e Kosovës dhe Ligji për të Drejtat dhe Liritë Fetare në Kosovë garantojnë respektimin e *lirive fetare, lirinë e besimit dhe lirinë e manifestimit të fesë*. Gjatë vitit 2010, theks i veçantë është vënë në mosekzistimin e dispozitave ligjore, me të cilat do të rregullohej çështja e pozitës juridike të bashkësive fetare në Kosovë. Gjatë muajve maj dhe korrik të vitit 2010, organizata të ndryshme joqeveritare kanë protestuar, duke shprehur mospajtimin për mohimin e të drejtave të nxënëseve për të bartur shami, gjatë qëndrimit në shkollë. Për besimtarët e Kishës Ortodokse, ngjarja më e rëndësishme ka qenë inaugurimi i Patriarkut Irinej në Patrikanën e Pejës, më 3 tetor 2010. Për fat të keq, kjo ngjarje nuk kaloi pa provokime të dyanshme. Ngjarja më e rëndësishme e Kishës Katolike në Kosovë, gjatë vitit 2010, ishte shugurimi i katedrales Nëna Terezë në Prishtinë. Pjesëtarët e Kishës Protestante Ungjillore të Kosovës, si problem e kanë theksuar mungesën e legjislacionit për rregullimin e statusit juridik të tyre dhe sulmet e shumta që i kanë përjetuar.

Liria e shprehjes, e garantuar me të Kushtetutë dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përbën njërin nga gurët bazë të shoqërisë demokratike. Gjatë vitit 2010, IAP nuk ka marrë asnjë ankesë, në lidhje me shkeljen e kësaj të drejte.

E drejta e qasjes në dokumente publike, është po ashtu e drejtë e garantuar. IAP ka pranuar numër të pakët të ankesave gjatë kësaj periudhe. E drejta për qasje në dokumentet publike u është mohuar edhe vetë përfaqësuesve të Avokatit të Popullit gjatë zhvillimit të hetimeve. Çështja e qasjes në dokumente zyrtare, si dhe mungesa e transparencës, mbeten ndër problemet kryesore, me të cilat vazhdojnë të ballafaqohen, sidomos gazetarët kosovarë.

Përveç garantimit që ofron sistemi juridik në Kosovë, në mënyrë të veçantë Kushtetuta, lidhur me *lirinë e mediave*, ajo vazhdon të mbetet një nga problemet më shqetësuese në shoqërinë tonë, edhe pse në IAP nuk është paraqitur asnjë ankesë nga përfaqësuesit e mediave.

E drejta e qytetarëve për tubime paqësore është një e drejtë universale, e garantuar edhe me Kushtetutë. Avokati i Popullit konstaton se, me gjithë rekomandimin nga raporti i kaluar, pika 3 e nenit 12, të Ligjit për Tubimet Publike, nuk është amendamentuar dhe ndryshuar. Avokati i Popullit, sërish rekomandon që neni i lartpërmendur të plotësohet dhe të ndryshohet, në mënyrë që të harmonizohet me standardet evropiane.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës ofron garanci për *lirinë e asociimit*, si e drejtë e çdo qytetari për të themeluar organizatë, pa pasur nevojë që të sigurojë leje për të qenë ose për të mos qenë anëtar i një organizate, si dhe për të marrë pjesë në aktivitetet e një organizate. Gjatë kësaj periudhe Avokati i Popullit nuk ka pranuar ndonjë ankesë, sa i përket cenimit të lirisë së asociimit.

E drejta e zgjedhjes dhe e pjesëmarrjes është e drejtë themelore e qytetarit dhe si e tillë është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligjin mbi Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, të cilët janë në përputhje me nenin 3 të KEDNJ. Si pasojë e ngërçit politik në vend, më 12 dhjetor 2010, u mbajtën zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare në Kosovë, të cilat i ka monitoruar IAP pothuajse në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, me përjashtim të komunave Leposaviq dhe Zubin Potok. Procesi i votimit është monitoruar edhe në vendet ku mbahen personat e privuar lirie, ose ata me nevoja të veçanta. Avokati i Popullit ka bërë një rekomandim, përmes të cilit ka kërkuar ndërmarrjen e veprimeve të parapara me ligj, për fillimin e hetimeve, për rastet e pohuara të keqpërdorimit të votës, në mënyrë që kryesit e tyre të vihen para drejtësisë.

E drejta e pronës sipas garancionit kushtetues, mbron çdo person në Kosovë se nuk mund të privohet nga prona në mënyrë arbitrarë. Problemet pronësore-juridike në Kosovë mbeten ende një problem delikat.

Çështja e shpronësimit në Kosovë është e rregulluar me ligj. Në IAP janë regjistruar ankesa të qytetarëve kundër institucioneve publike për shkelje të marrëveshjeve për kompensim. Gjykatat kompetente në Kosovë dështojnë të mbrojnë të drejtën pronësore të individëve, duke mos i ekzekutuar vendimet e tyre.

Çështja e ndërtimeve pa leje dhe formimi i lagjeve joformale, mbetet akoma një problem shqetësues në tërë Kosovën. Sipas Agjencisë Kadastrale të Kosovës, në Kosovë ekziston një diskrepancë në mes të pronarëve aktualë dhe gjendjes në terren, sepse azhurnimet ligjore të pronave nuk kanë mundur të mbahen në nivelin e duhur. Kjo është pasojë *mungesës së dokumentacionit kadastral*, i cili është zhdukur apo është marrë gjatë dhe pas luftës nga shteti serb. Problemet edhe më tej janë aktuale me Agjencinë Kosovare të Pronës. Deri më tani në këtë Agjenci janë regjistruar rreth 40.000 kërkesa. Prej tyre rreth 26.000 janë shqyrtuar, ndërsa rreth 17.000 prej tyre janë zgjidhur. Problem jashtëzakonisht i madh mbetet çështja e uzurpimit të pronave në veri të Mitrovicës, i cili vazhdon të jetë i pazgjidhur.

E drejta për arsimim është e garantuar me Kushtetutë. E drejta për t'u arsimuar ka shënuar progres me miratimin e Ligjit për Arsimin. Institucioni i Avokatit të Popullit kërkon që sa më shpejtë të miratohet kurrikulumit për ciklet e ulëta të shkollimit, ngase nxënësit janë të mbingarkuar me tekste shkollore. *Dhuna nëpër shkolla* ende mbetet një dukuri shqetësuese. Siguria në shkolla është përgjegjësi e MASHT-it, ndërkaq nisma në disa shkolla që për sigurinë e tyre të participojnë vetë

nxënësit, sado e qëlluar, nuk është veprim ligjor. Një problematikë tjetër, e cila në vazhdimësi e shoqëron sistemin e arsimit, është mungesa e ambienteve shkollore. Në disa raste numri i tyre arrin deri në 47 nxënës në një klasë. Në kontekst të zbatimit të së drejtës për arsim mbetet shqetësuese *dukuria e braktisjes së shkollimit dhe analfabetizmi*. Komuniteti serb, si dhe një pjesë e komunitetit rom dhe goran, vazhdojnë të jenë jashtë sistemit arsimor të Kosovës.

Liria e krijimtarisë artistike dhe shkencore është e garantuar me Kushtetutë dhe është në përputhje me instrumentet ndërkombëtare. Gjatë kësaj periudhe të raportimit, IAP nuk ka marrë asnjë ankesë për cenimin e lirisë së artit dhe të shkencës, edhe pse mund të ketë pasur shkelje të kësaj të drejte.

E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit është njëra nga të drejtat themelore të njeriut, e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe mbrohet edhe me instrumente juridike ndërkombëtare. Çështja e *papunësisë në Kosovë* edhe më tutje mbetet çështja sociale më serioze, me të cilën përballen të gjithë qytetarët e Kosovës. Avokati i Popullit vlerëson se edhe pas miratimit të Ligjit të Punës në Kosovë, nuk është shënuar ndonjë progres, lidhur me zbatimin e dispozitave ligjore nga punëdhënësit, si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat. Shkeljet më të mëdha janë vërejtur me rastin e punësimit, në shkeljen e procedurave të punësimit, ndërprerjen e marrëdhënies së punës, moskompensim për punën jashtë orarit, mosshfrytëzim i drejtës për pushim vjetor etj. Gjatë vitit 2010, IAP, lidhur me të drejtën e punës dhe ushtrimit të profesionit, ka regjistruar 51 ankesa. Nga këto vetëm 3 raste janë zgjidhur pozitivisht. IAP ka pranuar një numër të madh ankesash, lidhur me *moszbatimin e vendimeve* të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës (KPMK), të cilat konsiderohen shkelje serioze e të drejtës së punës. Edhe pse KPMK është institucion i pavarur kushtetues, vendimet e tij nuk zbatohen nga institucionet përgjegjëse. Lidhur me këtë Avokati i Popullit ka bërë rekomandime për autoritetet publike.

Në realitetin kosovar mbrojtja dhe respektimi i *të drejtave të fëmijëve* mbetet edhe më tutje sfidë e madhe. Edhe pse fusha e arsimit është përcaktuar si prioritet i Qeverisë së Kosovës, *dhuna ndaj fëmijëve* si dhe *dhuna në shkolla* vazhdon të mbetet çështje shumë shqetësuese. IAP ka pranuar ankesa për dhunën nëpër shkolla.

Me qëllim të përmirësimit të situatës, lidhur me *punën e fëmijëve*, në kuadër të prioritetëve të Planit Nacional në fushën e mirëqenies sociale, gjatë kësaj periudhe të raportimit, MPMS ka vazhduar ndërmarrjen e aktiviteteve që ndërlidhen me funksionalizimin e Komitetit Kosovar për parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve. Puna e rëndë dëmton shëndetin dhe mirëqenien e fëmijëve dhe si e tillë paraqet edhe shkelje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të Konventës për të Drejtat e Fëmijës.

Fëmijët me nevoja të veçanta janë në gjendje më të rëndë se fëmijët e tjerë. Në këtë kontekst, lidhur me çështjen e mospagesës së shumës së caktuar të të hollave familjeve, që në gjirin e tyre kanë nën përkujdesje fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme, IAP u është drejtuar autoriteteve përkatëse.

IAP ka pranuar një ankesë e cila kishte të bënte me *trafikim të qenieve njerëzore* sidomos me *fëmijët viktime*. Po kështu, IAP ka pranuar disa ankesa që kanë të bëjnë me moszbatimin e vendimeve të gjykatave, në lidhje me kontaktet personale të prindërve me fëmijë, si dhe për zvarritje të procedurës gjyqësore për të vendosur përkritazi me të drejtën e marrjes së fëmijës në mbikëqyrje, që fëmijët dhe prindërit e tyre i vënë në situata të rënda.

Edhe njëmbëdhjetë vite pas lufte, për Kosovën vazhdojnë të mbeten sfidë politikat sociale. Kosovarët vazhdojnë të mbeten pa mbrojtje shëndetësore dhe sociale, kurse rreth 36 mijë familje,

janë të evidentuara si përfituese nga skema sociale e MPMS-së, por të cilat nuk i plotësojnë as nevojat elementare të përfituesve të tyre.

Shumë familje kosovare, me *fëmijë me aftësi të kufizuar*, si me pengesa në të folur dhe të dëgjuar apo me sëmundje të natyrës së ngecjeve të zhvillimit psikologjik, nuk mund të jenë shfrytëzues të ndihmës materiale të garantuar me këtë ligj, ngase fëmijët e tyre nuk janë të përfshirë në kategorizimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar të përhershme.

Skema pensionale për kategoritë e caktuara të qytetarëve, me qëllim të uljes së varfërisë, edhe më tej aplikohet në Kosovë. Në vitin 2005, MPMS ka përgatitur *projektligjin për Sigurimin Pensional dhe Invalidor*, i cili është dërguar për miratim në Qeverinë e Kosovës, e cila që 5 vite zvarrit miratimin e këtij projektligji. Kërkesa e Avokatit të Popullit për miratimin e ligjit për sigurimin pensional dhe invalidor, mbetet ndër kryesoret në të gjitha paraqitjet e tij deri në miratimin dhe implementimin e tij. *Mungesa e këtij ligji nuk ka asnjë arsyetim.*

Problemet në shëndetësinë e Kosovës sipas të dhënave në IAP, janë shumë të mëdha. Qytetarët ankohen kundër personelit mjekësor, ngase profesionistët e kujdesit shëndetësor publik, në pothuajse të gjitha rastet, gjatë orarit të punës së rregullt në institucionin publik, edhe pse trajtimi, përkujdesja dhe aparatura janë të njëjta, i udhëzojnë, shpeshherë edhe i detyrojnë qytetarët, të shkojnë për kurim në sektorin privat (aty ku ata punojnë, pas orarit të rregullt). IAP është duke i hetuar rastet e tilla.

Me qëllim të krijimit të një *mjedisi* të shëndetshëm për popullin e Kosovës, si dhe zbatimit të standardeve për mjedis të Bashkimit Evropian, Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton përgjegjësitë e shtetit dhe të qytetarit për një mjedis të shëndetshëm. Avokati i Popullit ka pranuar një ankesë që ka të bëjë me *mbrojtjen e mjedisit*. Nxjerrja e gurëve, zhavorrit nga shtretërit dhe luginat e lumenjve dhe pjesëve shkëmbore ende vazhdon në mënyrë të egër, gjë që ngjall shqetësim për Avokatin e Popullit, për arsye të ankesave të qytetareve pranë institucionit, lidhur me degradimin e mjedisit, zhurmën dhe pluhurin e krijuar, përmbytjet e deri tek rrezikimi i së drejtës së pronës, si pasojë i lëvizjeve të dheut, që shkakton drejtpërdrejt çarjen e shtëpive përreth.

Kushtetuta e Kosovës garanton të *drejtën e mbrojtjes gjyqësore* të gjithë qytetarëve. Avokati i Popullit është jashtëzakonisht i shqetësuar për shkak të mosshtrirjes së pushtetit gjyqësor në tërë territorin e vendit. Që nga shpallja e pavarësisë së Republikës së Kosovës, Gjykata e Qarkut dhe ajo Komunale, Prokuroria e Qarkut dhe ajo Komunale, Gjykata për Kundërvajtje në Mitrovicë, Gjykata për Kundërvajtje në Zubin Potok dhe Leposaviq, vazhdojnë të mbeten jashtë sistemit gjyqësor të Kosovës.

Një shqetësim i veçantë për Avokatin e Popullit, janë *213.967 lëndë të pazgjidhura nëpër gjykatat e Kosovës*, të trashëguara që nga viti 2000. Lëndët e pashqyrtuara, civile dhe penale, nga gjykatat dhe prokuroritë, rrezikojnë të parashkruhen, kurse parashkrimi, në thelb, është mohim i drejtësisë.

Gjatë vitit 2010, në IAP janë paraqitur gjithsej 180 *ankesa ndaj gjyqësorit*, 70 prej tyre janë shpallur të papranueshme. Numri më i madh i parashtrësive, janë drejtuar kundër gjykatave komunale, gjykatave të qarkut dhe Gjykatës Supreme të Kosovës. Qytetarët kryesisht janë ankuar për *zvarritje të procedurave gjyqësore*, pastaj për *mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore*, si dhe *dyshime në objektivitetin e gjyqtarit*. Pas analizave të ankesave të pranuar në IAP, sipas objektit të tyre, rezultojnë se qytetarët ankohen për zvarritje, herë-herë disavjeçare, të procedurave gjyqësore në shqyrtimin e lëndëve nga gjykatat.

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, në IAP janë pranuar 25 ankesa apo kërkesa të qytetarëve ndaj prokurorisë nga 25 individë të ndryshëm. Ndaj prokurorive të qarkut janë paraqitur gjithsej 13 ankesa, kurse ndaj prokurorive komunale 12.

Të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre janë të rregulluara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me zbatimin e drejtpërdrejtë të konventave ndërkombëtare për mbrojtjen e minoriteteve dhe të drejtave të tyre.

Komuniteti serb e kultivon identitetin e vet kombëtar dhe kulturor përmes një sistemi relativisht të zhvilluar të partive politike, organizatave joqeveritare, organizatave humanitare dhe kulturore. Kurse identitetin fetar, e pjesërisht edhe atë politik, ky komunitet e kultivon përmes Kishës Ortodokse Serbe. Mundësitë për ruajtjen e gjuhës, zakoneve, trashëgimisë kulturore dhe traditës së komunitetit turk janë të pamjaftueshme, dhe rreth kësaj çështjeje është bërë fare pak. E ngjashme është situata edhe me komunitetin boshnjak. Megjithëse janë formuar disa parti politike dhe organizata joqeveritare boshnjake dhe, për herë të parë në Kosovë, ka filluar mbajtja e mësimit në gjuhën boshnjake, mundësia për ruajtjen e gjuhës, zakoneve, trashëgimisë kulturore dhe traditës është mjaft e vështirë dhe nuk ka mbështetje institucionale. Nga rreth 40 shoqëri kulturo-artistike rome në Kosovë, sot vetëm një merret me *kultivimin e kulturës dhe traditës rome*. Kurse sa i përket komuniteteve ashkali dhe egjiptas, të cilat gjenden në një situatë të ngjashme, vetëm komuna e Fushë Kosovës ka bërë një hap pozitiv modest, duke caktuar koordinatorin e kulturës për pjesëtarët e komuniteteve shkali dhe egjiptas.

Serbët në Kosovë e dhe një pjesë e pjesëtarëve të komunitetit romë, arsimohen në një sistem paralel të arsimit, ku aplikohet plan-programi mësimor i Republikës së Serbisë. Turqit dhe boshnjakët mund ta përcjellin mësimin, në shkollat fillore dhe të mesme, edhe në gjuhët e tyre amtare, Ndërkaq, problem është mungesa e teksteve në gjuhën e tyre. Shumica e pjesëtarëve të komunitetit goran, kanë shprehur dëshirë të shkollohen në gjuhën serbe. Ashkalinjtë, egjiptasit dhe një pjesë tjetër e romëve mësimin e vijnë në gjuhën shqipe.

Komunitetet pakicë dhe mediat. Përveç komunitetit serb, i cili ka tri stacione lokale private televizive, asnjë nga komunitetet e tjera pakicë në Kosovë, nuk kanë stacionin e vet televiziv. Ndërkaq, ekzistojnë radiostacione, që ekskluzivisht emetojnë program në gjuhën serbe. Komuniteti turk ka dy radiostacione private në gjuhën turke. RTK është i vetmi institucion shtetëror medial, i cili përveç programit në gjuhën shqipe, përgatit dhe emeton TV dhe radio programe në gjuhën serbe, boshnjake, turke dhe rome. Komuniteti serb ka gazetën "Jedinstvo" (e cila shtypet në Mitrovicë, financuar nga Qeveria e Republikës së Serbisë). E vetmja gazetë në gjuhën boshnjake në Kosovë është "Alem". Në gjuhën rome nuk ekziston asnjë revistë apo gazetë ditore. Me gjithë faktin se gjuha shqipe është gjuhë amtare e ashkalinjve dhe egjiptasve, qasja e tyre në media është mjaft e kufizuar.

Sipas Kushtetutës së Republikës dhe sipas Ligjit mbi përdorimin e gjuhëve, gjuha shqipe dhe serbe, si edhe përdorimi i shkrimit të tyre janë *gjuhë zyrtare* në Kosovë. Gjuha turke, boshnjake dhe rome kanë status të gjuhëve zyrtare në nivelin komunal, sipas kushteve të parapara me ligj.

Shoqëria kosovare ende është e ndarë sipas linjave gjuhësore. Mosnjohja e gjuhës shqipe nga komunitetet pakicë paraqet pengesë, që ndikon negativisht në integrimin e tyre në shoqëri. Komuniteti turk në Kosovë është në pozitë më të mirë, sepse shumica e tyre e flasin gjuhën shqipe. Për ashkalinjtë dhe egjiptasit shqipja është gjuhë amtare, por një numër shumë i vogël i serbëve, boshnjakëve, goranëve dhe romëve e flasin gjuhën shqipe.

4. Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës

4.1. *Zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare*

Shtetet e kanë për obligim të respektojnë, të mbrojnë dhe të përmbushin të drejtat e njeriut, ndërsa zbatimi i tyre nënkupton edhe obligimin që ka shteti dhe organet e tij për realizimin e këtyre të drejtave të pranuar. Një numër i rëndësishëm i instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut janë inkorporuar në të drejtën e brendshme me rastin aplikimit të tyre në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.⁵

Kushtetuta e Republikës së Kosovës shprehimisht parasheh zbatimin e drejtpërdrejtë të: Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj, Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj, Konventës Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor, Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas, Konventës për të Drejtat e Fëmijës, Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Më të Rënda, Konventës për të Drejtat e Femijëve dhe Poshtrësive. Këto instrumente ndërkombëtare të përfshira në Kushtetutën e Republikës së Kosovës kanë një rëndësi të veçantë në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, sepse edhe në rastet kur në legjislacionin e brendshëm ka mangësi apo zbrastje ato do të mund të zbatohen drejtpërdrejt.

Institucioni i Avokatit të Popullit vëren se në disa raste ato janë shkelur seriozisht. Në bazë të ankesave të pranuar në Institucionin e Avokatit të Popullit shihet se shumica e shkeljeve kanë të bëjnë me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e drejta për një proces të rregullt. Mbingarkesa e gjykatave me lëndë të vjetra të pazgjidhura, vonesa në trajtimin e lëndëve të reja, moskzekutimi i vendimeve të formës së prerë, janë disa nga çështjet që kanë rënduar mbi gjyqësorin tash e sa vite, duke cenuar kështu të drejtën e qytetarëve të Kosovës për një proces të drejtë dhe të paanshëm.

Bazuar në informatat me të cilat disponon IAP, institucionet kompetente të Republikës së Kosovës e kanë neglizhuar zgjidhjen e kësaj çështjeje. Neni 6, paragrafi 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në fjalë, i obligon shtetet për organizimin e sistemit juridik në mënyrë të tillë, që t'u mundësojë gjykatave të realizojnë të gjitha detyrimet që burojnë prej tij, duke përfshirë shqyrtimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm, i cili është shkelur në vazhdimësi nga gjyqet. Një gjendje e tillë e zhvillimit të gjyqësorit e lëkund besimin e qytetarëve, edhe ashtu të zbehur shumë dhe e dobëson rolin e tyre.

Megjithatë, në këtë drejtim ka një veprim shpresdhënës. Rekrutimi, në vazhdimësi i gjykatësve dhe prokurorëve të rinj, si dhe miratimi i Ligjit për Gjykatat, sipas së cilit do të bëhet edhe riorganizimi i sistemit gjyqësor dhe i prokurorisë në Republikën e Kosovës, megjithëse janë veprime të vonuara,

⁵ *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, Neni 22.

janë një lajm i mirë. Në këtë drejtim duhet përshëndetur edhe përmirësimin e dukshëm të pozitës materiale të punonjësve të gjykatave në Kosovë.

Megjithëse, konventat ndërkombëtare, Kushtetuta dhe ligjet e ndalojnë përdorimin e dhunës apo trajtimin çnjerëzor dhe poshtëruese, ato është evidente. Nga ankesat e qytetarëve, drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit, shihet se një pjesë e tyre kanë të bëjnë me ushtrimin të dhunës nga autoritetet policore. Në vitin që lamë pas, IAP ka trajtuar disa raste në të cilat është konstatuar se është përdorur dhuna dhe tortura në qendrat e ndalimit, në vende publike e gjetiu, duke shkelur kështu edhe aktet e lartpërmendura ndërkombëtare.⁶

Ajo çka e vështirëson gjendjen është fakti se veprimtaria hetuese, në këto raste, është mjaft komplekse, sepse kjo zakonisht ndodhë në ambiente të mbyllura dhe ku nuk ka dëshmitarë të mjaftueshëm për të vërtetuar atë se çka ka ndodhur në të vërtetë. Kur kësaj ia shtojmë edhe faktin e refuzimit të dhënies së informacioneve nga autoritetet përkatëse, kjo e vështirëson tej mase hetimin, duke i lënë kështu viktimat e dhunës në mëshirën e torturuesve të tyre.⁷

Të përkujtojmë se dispozitat materiale që përmban KEDNJ, në nenin 3, e që kanë të bëjnë me torturën, nuk parashohin përjashtime.⁸ Me rastin e dyshimeve për përdorimin e torturës dhe veprimeve të tjera çnjerëzore dhe poshtëruese, duhet të ndërmerren hetime zyrtare dhe të efektshme, në mënyrë që të identifikohen dhe të dënohen autorët e këtyre veprimeve. Në të kundërtën, pavarësisht prej rëndësisë së nenit 3, të KEDNJ dhe Konventës kundër Torturës, zbatimi tyre në praktikë do të ishte joefikas, sepse do t'u jepte mundësi zyrtarëve policorë që t'i përsërisin ato veprime, pa pasur frikë se do të ndëshkohen për to.

Për të realizuar një monitorim më të efektshëm gjithëpërfshirës, në institucionet ku mbahen personat e privuar prej lirisë, Avokati i Popullit e shih të nevojshme edhe zbatimin e dispozitave të Protokollit Opsional të Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve të tjera Çnjerëzore dhe Poshtëruese. Prandaj, Institucioni i Avokatit të Popullit, së bashku me disa nga OJQ-të vendore, ka mbajtur disa takime me qëllim të krijimit të një grupi punues që do të veprojë si pararendës i Mekanizmit Kombëtar Kundër Torturës, krijimi i të cilit parashihet me nenin 3 të këtij protokollit⁹. Me themelimin e këtij mekanizmi do të mundësohej qasje më e mirë dhe mbrojtje më efektive e të drejtave të njeriut.

Avokati i Popullit, përmes këtij raporti, edhe njëherë shpreh shqetësimin e tij për mospërfshirjen në Kushtetutë edhe të Konventës për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore. Disa nga të drejtat që përmban Konventa për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, siç janë e drejta për strehim adekuat, e drejta nga fusha e punës, e drejta për sigurim shëndetësor dhe një numër të drejtash sociale dhe ekonomike vazhdojnë të mos kenë mbrojtjen e duhur ligjore. Përfshirja e kësaj Konvente, në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, është e domosdoshme dhe do të ishte një garanci shtesë për qytetarët e Kosovës dhe për mbrojtjen e të drejtave të tyre.

⁶ *Raporti ex officio nr. 207/2010*, Institucioni i Avokatit të Popullit, lidhur me rastin e intervenimit policor në selinë e Lëvizjes Vetëvendosje, në Prishtinë, për arrestimin e Albin Kurtit.

⁷ *Shih Ribitsch v. Austria*, (application number 18896/91, datë 04 dhjetor 2005. Gjykata Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut nënvizoi se në rast se konstatohen lëndime trupore tek i arrestuari, që ka qenë në kontrollin tërësor të policëve, autoritetet duhet të sqarojnë rrethana në të cilat kanë ndodhur lëndimet.

⁸ *Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut*, Neni 3, ndalimi i torturës “Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese”.

⁹ *Protokollit Opsional i Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve të tjera Çnjerëzore dhe Poshtëruese*, Neni 3 „Çdo Shtet Palë krijon, projektin ose mban në nivel kombëtar një ose disa organe vizitore për parandalimin e torturës dhe trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruese (tani e tutje quhet mekanizmi parandalues kombëtar)“.

4.2. *Dinjiteti i njeriut*

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, me nenin 23 të saj mbron dinjitetin e njeriut, duke e përcaktuar atë si *të pacenueshëm dhe bazë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut*. Nga ky nen kuptohet qartë se të drejtat e njeriut dhe dinjiteti i tij janë të pandashme me njëri-tjetrin.

Edhe pse, i trajtuar si kategori morale, fetare, sociale, politike dhe juridike, përkufizimi i dinjitetit të njeriut nuk është aq i lehtë. Si përkufizim, dinjiteti paraqet tërësinë e vlerave morale të një individi dhe të drejtën e tij për t'u nderuar, që buron nga vetë ekzistenca e njeriut. Pra, dinjiteti i njeriut është i lindur dhe si i tillë është i paqjetërsueshëm.

Nisur nga njohuritë e përgjithshme, shkelja e të drejtave të njeriut dhe cenimi i dinjitetit të tij ngjan më tepër në situata të pafavorshme për individin, veçanërisht kur ai është i pafuqishëm që t'i mbrojë, t'i kërkojë dhe të luftojë për të drejtat e tij, qoftë për shkak të privimit nga liria apo për shkak të moshës së shtyrë. Avokati i Popullit, me qëllim të parandalimit të shkeljes së dinjitetit dhe të drejtave të njeriut në situata të tilla, është i përkushtuar të ketë një qasje sa më praktike dhe aktive. Prandaj, si pjesë të pandashme të punës së tij janë vizitat e rregullta, në vendet ku mbahen personat e privuar nga liria anembanë Kosovës, si dhe vizitat periodike në Shtëpinë e të Moshuarve në Prishtinë. Këto vizita shërbejnë për t'u siguruar nëse në ato vende mbrohet dhe respektohet dinjiteti i njeriut, sipas standardeve më të mira ndërkombëtare.

Avokati i Popullit, gjatë vizitave në institucionet korrektuese, ka vërejtur parregullsi dhe papajtueshmëri në zbatimin e rregullave dhe praktikave të institucioneve korrektuese në Kosovë me legjislacionin përkatës vendor dhe atë ndërkombëtar, që përveç të tjerash, cenojnë dinjitetin e njeriut.

Kështu, Avokati i Popullit, duke parë se të burgosurit nuk sistematizohen në dhoma sipas veprave penale të kryera, kohëzgjatjes së dënimit, si dhe personat e dënuar me burg dhe burg afatgjatë mbahen në qendra të paraburgimit, hapi hetimin me vetiniciativë (*ex officio*) dhe përmes një raporti të veçantë i rekomandoi Komisionarit të Shërbimit Korrektues dhe Ministrisë së Drejtësisë të ndërmerr veprimet e duhura, brenda kompetencave të tij, për t'i përbushur detyrimet ligjore, me qëllim të përmirësimit të kushteve dhe praktikave në burgje dhe në qendra të paraburgimit në Kosovë.

Për më tepër, Avokati i Popullit, në rekomandimin e bërë, përkujtoi se trajtimi me humanizëm dhe respekt për dinjitetin njerëzor i të gjithë personave të privuar nga liria dhe sistematizimi i të dënuarve dhe i atyre që gjenden në paraburgim është kërkesë e domosdoshme dhe e paraparë në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, si dhe në Rregullat Evropiane të Burgjeve, të dy këto instrumente të zbatueshme drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës.

Po ashtu, duke parë gjendjen tepër të vështirë të jetesës së komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas, banorë të kampeve në Mitrovicën Veriore dhe Leposaviq, përkatësisht helmimin e banorëve me plumb, për shkak se jetojnë në një ambient jashtëzakonisht të ndotur dhe në kushte të varfërisë së skajshme, Avokati i Popullit, me vetiniciativë, publikoi Raportin e veçantë, të cilin ia drejtoi Kryetarit të Kuvendit dhe Kryeministrit të Republikës së Kosovës.

Përmes këtij raporti, Avokati i Popullit rekomandoi marrjen e veprimeve të duhura nga institucionet e Kosovës, duke përfshirë zhvendosjen e banorëve në vende më të sigurta, me qëllim të mbrojtjes së

shëndetit të tyre dhe ofrimit të kushteve për një jetë më të dinjitetshme për banorët e këtyre kampeve.

Avokati i Popullit, po ashtu rikujton se situata e personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Kosovës nuk është aspak e kënaqshme. Shqetësim të veçantë për Avokatin e Popullit paraqet, sidomos, moszbatimi i infrastrukturës ligjore, që për qëllim primar ka zbutjen e diskriminimit të personave të kësaj kategorie. Një mospërfillje e dukshme ligjore vërehet sidomos në rastin e ndërtimeve të ndryshme të karakterit publik, të ndërtesave të institucioneve publike dhe rrugëve, të cilat në shumë raste nuk përkojnë fare me qëllimin për lehtësi²⁸

min e qasjes së kësaj kategorie të personave në institucionet publike. Madje, në këtë drejtim nuk qëndrojnë më mirë as institucionet shëndetësore, ku kjo është e domosdoshme.

4.3. Barazia para ligjit

Një nga elementet kryesore të një shteti ligjor janë: kushtetutshmëria dhe ligjshmëria, barazia para ligjit për të gjithë qytetarët pa asnjë dallim, liritë dhe të drejtat e njeriut, ndarja e pushtetit, gjyqësia e pavarur, etj. Barazinë para ligjit e garanton Kushtetuta e Republikës së Kosovës¹⁰ dhe të gjitha instrumentet ndërkombëtare të zbatueshme drejtpërdrejt në Kosovë.¹¹

Në shkurt të vitit 2004 u miratua Ligji kundër diskriminimit,¹² i cili ka për qëllim t'u sigurojë subjekteve të drejtën për barazi para ligjit dhe mbrojtje të barabartë, barazi të mundësive për të gëzuar dhe ushtruar të drejtat dhe mbrojtje efektive nga çdo sjellje diskriminuese apo që e nxit atë.

Me keqardhje dhe shqetësim duhet konstatuar se, deri më tani, nuk shihet ndonjë përparim në zbatimin e këtij ligji. Problemi qëndron se në këtë ligj nuk ka përkrahim të qartë të kreut të II-të, që rregullon procedurat për inicimin e rasteve dhe përcakton organin kompetent për shqyrtimin e rasteve të diskriminimit si dhe sanksionet.

Neni 7.1 i këtij ligji nuk është i qartë. Aty nuk është e rregulluar qartë, nëse rastet e diskriminimit do të shqyrtohen dhe të vendosen nga gjykatat e rregullta apo nga organet administrative. Edhe nëse mund të kuptohet se rastet e diskriminimit shqyrtohen nga një organ administrativ, nuk është e përcaktuar se cili organ do të jetë ai.

Gjithashtu, neni 7.1 dhe neni 7.2 janë përpiluar në formë të pakuptueshme. Mënyra e fillimit të procedurës dhe forma e inicimit, me ankesë apo parashtrësë, nuk është e qartë. Po këtë problem e hasim edhe në nenin 7.3. Njëkohësisht, ligji me emërtim të tillë, në të cilën mbështetet neni 7.1 nuk ekziston.

Neni 9 i Ligjit kundër diskriminimit, në pikën 4, parasheh që, mjetet e nxjerra nga shqiptimi i dënimeve, të parapara me këtë ligj, të grumbullohen në një fond të veçantë, i cili u dedikohet për ndihmë juridike falas personave fizikë dhe juridikë, të cilët ankohen se u është shkelë e drejta në trajtim të barabartë. Ky nen gjithashtu është paqartë. Aty nuk ka ndonjë udhëzim për personat juridik apo fizik, që me vendime gjyqësore shpallen të diskriminuar, me çfarë procedure ligjore ata do të mund të iniciojnë kërkesën për kompensim material.

¹⁰ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 24.

¹¹ Po aty, Neni 22.

¹² Ligji kundër diskriminimit, nr. 2004/3.

Rrjedhimisht, bazuar në normat aktuale të këtij ligji, në asnjë mënyrë nuk mund të kuptohet se si dhe ku do të fillojë një procedurë, lidhur me pohimin për diskriminim. E gjithë kjo bën që ligji kundër diskriminimit në praktikë nuk gjen zbatim as në organet administrative dhe as nëpër gjykata të rregullta.

Pas miratimit të këtij ligji, Institucioni i Avokatit të Popullit i ka shprehur shqetësimet lidhur me nenet e lartpërmendura, mirëpo nuk është vërejtur ndonjë veprim për amandamentimin e këtyre neneve apo nxjerrjen e ndonjë udhëzimi administrativ, ku do të sqaroheshin procedurat dhe sanksionet lidhur me rastet e diskriminimit.

Rishqyrtimi i ligjit kundër diskriminimit, si dhe amandamenti i neneve të lartpërmendura, do të krijonin një mundësi që ky ligj të mos mbetet edhe më tej vetëm një shkronjë në letër, i pazbatueshëm në realitet. Një veprim i tillë, urgjentisht i domosdoshëm, do të dëshmonte për përpjekjet e institucioneve përgjegjëse, përkatësisht Kuvendit dhe Qeverisë, për të siguruar barazinë dhe mosdiskriminim për të gjithë qytetarët e Kosovës, ashtu siç është e garantuar me Kushtetutë.

Sundimi i ligjit është parim bazë i veprimit të institucioneve vendore. Sundimi i ligjit, si parakusht ka ekzistimin e ligjeve të qarta dhe të kuptueshme për të gjithë. Edhe pse në Kosovë ekziston një bazë e kënaqshme ligjore me të cilën rregullohen çështje të caktuara, ka shumë raste që nga vetë ligji në fuqi, kategori të caktuara mbesin të diskriminuar. Mungesa e një ligji të mirëfilltë, për të rregulluar çështjet në mënyrë të drejtë apo ekzistimi i një çështje në mënyrë gjysmake, krijon vakume të tilla ligjore, përmes të cilave kategori të caktuara mbesin të diskriminuara dhe të nëpërkëmbura nga vetë ligji.

4.3.1. Mungesa e ligjit për bashkësitë fetare

Në një pozitë të këtillë diskriminimi vazhdojnë të mbesin dhe bashkësitë fetare në Kosovë. Statusi i bashkësive fetare në Kosovë para vitit 1990, ka qenë i rregulluar me Ligjin mbi pozitën juridike të bashkësive fetare. Pas kësaj periudhe, për t'i realizuar të drejtat e tyre dhe për të ushtruar veprimtarinë dhe funksionin e tyre në përputhje me statusin juridik, bashkësitë fetare janë rekomanduar të regjistrohen si organizata joqeveritare, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut, nr. 1999/22.

Rekomandimet drejtuar bashkësive fetare për t'u regjistruar si organizata joqeveritare, në bazë të Rregullores nr. 1999/22, bien në kundërshtim me Ligjin për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare, i cili përjashton të drejtën për regjistrimin e bashkësive fetare si organizata joqeveritare.¹³

Në Republikën e Kosovës në vitin 2006 është miratuar *Ligji për lirinë fetare në Kosovë*. Mirëpo, ky ligj rregullon vetëm lirinë fetare në vend, duke lënë anash çështjen e rregullimit të pozitës juridike të bashkësive fetare.¹⁴

Në të gjitha shtetet e rajonit, statusi juridik, kompetencat dhe veprimtaria e bashkësive fetare, janë të rregulluara me Ligjin për pozitën juridike të bashkësive fetare. Një ligj i këtillë tani i mungon vetëm Republikës së Kosovës. Dhe, mosrregullimi i pozitës juridike të bashkësive fetare në Kosovë,

¹³ *Ligji për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare*, nr. 2009/03-L-134., neni 1, pika 2.

¹⁴ *Ligji për lirinë fetare në Kosovë*, nr. 02/L-31.

shkaktohen humbje të gjithanshme. Bashkësitë fetare nuk i kanë të qarta të drejtat e veta. Me rregullimin e subjektivitetit ligjor, të gjitha bashkësitë fetare të regjistruara do të kishin të drejtë t'i menaxhojnë çështjet financiare përmes llogarive bankare, të zotërojnë prona dhe objekte përkatëse dhe të kryejnë veprime të tjera ligjore.

Përveç bashkësive fetare, ky vakum ligjor sjellë në pozitë të palakmueshme edhe institucionet publike të vendit, të cilat në mungesë të një infrastrukture të plotë ligjore, hamenden se si t'i zgjidhin kërkesat e shumta të bashkësive fetare. Në këtë mënyrë, institucionet publike janë të detyruara të ofrojnë edhe zgjidhje joformale dhe joligjore.

Mungesa e një instrumenti ligjor për rregullimin e pozitës juridike të bashkësive fetare paraqet akt diskriminues dhe është në kundërshtim me nenin 38 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Duke pas parasysh faktin se në Kosovë ka pjesëtarë të bashkësive të ndryshme fetare, mungesa e një infrastrukture të plotë ligjore krijon probleme ndërfaqetare. Gjendja rëndohet akoma më tepër, ngase bashkësitë e tjera fetare ndihen dhe realisht janë të diskriminuara në raport me Kishën Ortodokse Serbe, e cila falë “diskriminimit pozitiv” gëzon trajtim tjetër nga bashkësitë fetare në Kosovë. Lidhur me këtë Avokati i Popullit ka publikuar Raportin me nr. 145/2010,¹⁵ me të cilin i është drejtuar Kuvendit të Republikës së Kosovës. Mirëpo, deri më tani nuk ka pranuar përgjigje lidhur me të.

4.3.2. Diskriminimi i gjyqësorit dhe nga gjyqësori

Ndarja e pushteteve është shtylla kryesore e një shteti funksional demokratik. Kjo ndarje manifestohet në tri forma themelore: legjislativi, ekzekutivi dhe gjyqësori, të cilat janë të balancuara dhe të kufizuara në bazë të përgjegjësisë të përcaktuara nga Kushtetuta. Fatkeqësisht duhet theksuar se në Republikën e Kosovës, pozita e gjyqësorit, në krahasim me dy shtyllat e tjera të shtetit, ende është në pozitë inferiore. Edhe pse si kategori kushtetuese e barabartë, për pozitën e gjyqësorit në Kosovë ende ka ndërhyrje nga politika.

Sistemi gjyqësor përcaktohet me ligj dhe mbështetet në organizimin dhe funksionimin unik të hierarkisë funksionale të një shteti. Në sistemin gjyqësor në Kosovë, në periudhën për të cilën po raportojmë, është bërë riemërimi i gjyqtarëve, me qëllim të mbarëvajtjes dhe efikasitetit në punë. Me gjithë përmirësimin e bazës materiale të gjyqtarëve, që është për t'u përshëndetur, gjyqësori ende ballafaqohet me mungesë të madhe të kuadrit të gjyqtarëve të angazhuar, por edhe me mungesa të shumta infrastrukture. Pikërisht për këtë, ende nuk vërehet ndonjë përparim i dukshëm. Edhe më tej qytetarët ballafaqohen me probleme, si zvarritje të procedurave për shqyrtim dhe vendosje të rasteve, si dhe me drejtësinë efektive.¹⁶

Përveç mangësive të cekura, materiale dhe infrastrukture, fatkeqësisht duhet theksuar se edhe në vetë gjyqësorin ka raste të mosrespektimit të parimit për drejtësinë efektive nga ana e gjykatave, të cilat me vendimet e tyre të bazuara në fakte joekzistuese, i dëmtojnë qytetarët e Kosovës, të cilët u drejtohen atyre për të mbrojtur drejtësinë. Jashtëzakonisht shqetësues ka qenë rasti i aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës, lidhur pensionet e punëtorëve të Korporatës Energjetike të Kosovës. Gjykata Supreme e Kosovës kishte miratuar revizionin e KEK-ut, duke prishur vendimet

¹⁵ Raporti nr. 145/2010, Institucioni i Avokatit të Popullit-www.ombudpersonkosovo.org

¹⁶ Më gjerësisht, lidhur me këtë temë, shih pjesën për gjyqësorin.

e Gjykatës së Qarkut dhe asaj Komunale, duke u arsyetuar vendimin e vet në një ligj, i cili nuk ekziston.

Ankesën e punëtorëve të KEK-ut, në këtë vendim të Gjykatës Supreme të Kosovës, Gjykata Kushtetuese e Kosovës e ka pranuar, si të bazuar ankesën e punëtorëve, duke gjetur shkelje të Kushtetutës, prandaj ka vendosur që këto aktgjykime të kthehen në rishqyrtim në pajtim me aktgjykimin e saj.¹⁷

Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme të Kosovës, gjatë punës së saj nuk i respekton të drejtat e qytetarëve, të garantuara me Kushtetutë dhe ligj. Me gjithë faktin se përdorimi i gjuhëve në Kosovë është i rregulluar me nenin 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Ligjin për përdorimin e gjuhëve, nr. 02/L-37, qytetarët e Kosovës janë të obliguar që kërkesat e tyre, në Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme, t'i dorëzojnë në gjuhën angleze. Me mospranimin e padive dhe dokumentacionit nga qytetarët e Kosovës në gjuhët zyrtare, kjo gjykatë bën shkelje të nenit 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe Ligjit për përdorimin e gjuhëve.¹⁸

Duke pasur parasysh faktin se përkthimi i dokumentacionit në gjuhën angleze nga gjuhët zyrtare ka kosto të lartë, kjo bën që shumica e qytetarëve të Kosovës nuk i drejtohen kësaj gjykate për të kërkuar realizimin e një të drejte të tyre të humbur. Me këtë rast, qytetarët e Kosovës, përveç se janë të diskriminuar në përdorim të gjuhëve zyrtare, ata tërthorazi janë, po ashtu, të privuar nga e drejta e tyre për ankesë, që e kanë të garantuar me Kushtetutë. Në këtë aspekt vlen të theksohen rastet e 20 përqindëshit nga ndërmarrjet e privatizuara, si dhe shumë nga kontestet e tjera pronësore, ku shumë qytetarë, për shkak të shpenzimeve të larta për përkthim të dokumenteve, nuk kanë mundur ta ngritnin çështjen e tyre në Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme.

4.3.3. Pabarazia e grup-moshave në sferën e punësimit

E drejta për të qenë i lirë nga çdo lloj diskriminimi përbën një nga parimet themelore të drejtave të njeriut. Diskriminimi i bazuar në moshë ndodh kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa personi i një grup-moshe tjetër, në rrethana të njëjta ose të ngjashme, pikërisht për shkak të moshës së tij.

Pavarësisht faktit se Avokati i Popullit ka publikuar një raport, lidhur me diskriminim në moshë, në shpallje të konkurseve për vende pune, kjo dukuri vazhdon të jetë e pranishme në çështjet e punësimit. Është për të habitur fakti se një diskriminim të tillë ne sot e hasim edhe në vendime të organeve të larta drejtuese të institucioneve publike. Në këtë rast, me theks të veçantë duhet nënvizuar vendimin e senatit të Universitetit të Prishtinës, i cili ka të bëjë me kufizimin e moshës, si kriter për punësim për herë të parë në pozitën e mësimdhënësit në Universitetin e Prishtinës.

Lidhur me këtë, Avokati i Popullit, përveç publikimit të raportit,¹⁹ në bazë të kompetencave të tij, sipas Ligjit për Konfliktet Administrative, e ka ngritur çështjen për konflikt administrativ në

¹⁷ *Vendimi nr. KI 40/90-web faqja - Gjykata Kushtetuese e Kosovës.* Shkeljet kanë të bëjnë me nenin 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në lidhje me nenin 1, të Protokollit 1, të KEDNJ-së, si dhe të nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

¹⁸ *Ligji për përdorimin e gjuhëve, nr. 02/L-37.*

¹⁹ *Raport nr. 170/2010- Institucioni i Avokatit të Popullit-www.ombudspersonkosovo.org.*

Gjykatën Supreme të Kosovës. Deri më 31 dhjetor 2010, Avokati i Popullit nuk ka marrë përgjigje, në lidhje me këtë konflikt administrativ.

Gjatë procesit të privatizimit në Kosovë, shumë qytetarë që ishin të punësuar nëpër ndërmarrje publike kanë mbetur pa punë. Ata janë të diskriminuar, ngase nuk kanë asnjë mbështetje ligjore apo institucionale. Në njëërën anë, papunësia e madhe, mosha e tyre e shtyrë, gjendja e tyre shëndetësore, për ta paraqesin pengesa objektivisht të pakalueshme për të gjetur ndonjë vend tjetër pune. Në anën tjetër, shumica prej tyre nuk i përmbushin kushtet për të pasur të drejtë në pensionin bazë të pleqërisë, në pensione të parakohshme për persona me aftësi të kufizuar, apo ndonjë formë tejtër ndihme, e cila së paku do t'i zbuste kërkesat e tyre elementare për jetesë.

Avokati i Popullit e ka ngritur këtë çështje në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, mirëpo deri më sot nuk ka informata se është ndërmarrë ndonjë veprim për përmirësimin e situatës së tyre. E vetmja mundësi që i ofrohet kësaj kategorie është mundësia për të aplikuar për ndihmë sociale, e të cilën do ta fitojë vetëm pasi t'i ketë plotësuar kushtet sipas kritereve për përfshirje në skemën sociale.

4.3.4. Diskriminimi i personave me aftësi të kufizuara

Edhe më tej kategori e rrezikuar nga çdo lloj diskriminimi mbeten personat me aftësi të kufizuara. Nuk vërehet ndonjë përparim lidhur me krijimin e ndonjë infrastrukture për pavarësimin e tyre në përditshmëri.

Problemet e ngritura edhe në raportet e mëparshme, si infrastruktura rrugore dhe e objekteve në përgjithësi për lëvizje të lirë për personat me mjete ndihmëse, mbeten të pazgjidhura. Kjo infrastrukturë nuk është e rregulluar, as edhe në institucionet publike më frekuentuese, si: spitale, shkolla, gjykata e kuvende komunale. Është për shqetësim fakti se edhe nëpër ato vende ku ekzistojnë pjerrinat për lëvizje me mjete ndihmëse, sikurse në rastin e ndërtesës ku është i vendosur IAP, ato janë të ndërtuara pa standarde dhe në këtë mënyrë është e pamundur lëvizja e lirë e personave me aftësi të kufizuara lëvizjeje, pa ndihmën e përcjellësve. Kjo ndikon shumë që personat me aftësi të kufizuara, të varur nga mjetet ndihmëse për lëvizje (karroca), të mos mund të realizojnë as të drejtat e tyre elementare të garantuara me Kushtetutë dhe ligje, si: shkollimi, shërimi, kërkimi i drejtësisë etj. dhe pa fajin e tyre të mbeten analfabetë, të sëmurë, pa drejtësi etj.

Shumë familje, të cilat në pamundësi për të bërë zgjidhje vetanake për strehim, edhe më tej vazhdojnë t'u drejtohen Kuvendeve Komunale për të kërkuar ndihmë për strehim humanitar. Shumë komuna të Kosovës dhe sidomos komuna e Prishtinës, tani e dhjetë vite pas luftës, edhe më tej po dështojnë të bëjnë zgjidhje të strehimit për familjet në gjendje të rëndë sociale dhe të pastrehë.

Që nga fillimi i vitit 2010 ndërtesa me 60 banesa në Prishtinë, mbetet e boshatisur. Në muajin shtator të vitit 2010, Komisioni për çështje banesore i Kuvendit Komunal të Prishtinës ka shpallur konkurs për ndarje të banesave për raste sociale. Kjo ndërtesë ka në dispozicion vetëm 60 banesa, kurse vetëm për 15 ditët e para, pas hapjes së konkursit, zyra e pranimit në Kuvendin Komunal ka pranuar 180 kërkesa. Pavarësisht nga fakti që kërkesat e qytetarëve, të cilat janë të evidentuara, si raste sociale, janë pranuar për shqyrtim, Kuvendi Komunal i Prishtinës edhe më tej vazhdon të dështojë në krijimin dhe organizimin e një komisionit për ndarje të këtyre banesave.

Me qëllim që ky proces të jetë transparent, me kërkesën e qytetarëve të Prishtinës, të cilët kanë aplikuar për strehim humanitar në Kuvendin Komunal të Prishtinës, si dhe në kuadër të mandatit dhe kompetencave të tij, Institucioni i Avokatit të Popullit ka kërkuar nga Kuvendi Komunal i Prishtinës që të monitorojë procesin e ndarjes së këtyre banesave. Mirëpo, deri më sot nuk ka pranuar përgjigje lidhur me këtë kërkesë.

4.3.5. Trajtimi diskriminues nga Agjencia Kosovare e Pronës

Agjencia Kosovare e Pronës (AKP) edhe më tej vazhdon me standarde të dyfishta trajtimin dhe shqyrtimin e lëndëve për të cilat vendos në bazë të kompetencës së tyre. Pronat në pjesën veriore të Mitrovicës, tash e dhjetë vite nuk janë liruar nga uzurpuesit e paligjshëm. Këtu vërehet një dështim i punës së AKP-së për të realizuar mandatin e tij. Edhe më tej në skemën e qirasë nuk janë përfshirë pronarët shqiptarë, të cilët pronat e tyre i kanë në pjesën veriore të Mitrovicës, derisa pronat e pronarëve serbë dhe të komuniteteve të tjera, nëpër vendet e tjera të Kosovës, janë të përfshira në skemën e qirasë.

Qytetarët shqiptarët të pjesës veriore të Mitrovicës, të cilët ende i kanë pronat e tyre të uzurpuara dhe i kanë deponuar kërkesat e tyre në AKP, janë të obliguar t'i paguajnë qira AKP-së për shfrytëzimin e pronave të pronarëve serbë, në pjesët e tjera të qytetit apo të Kosovës nën administrimin e tyre, por këtë të drejtë AKP nuk u garanton edhe shqiptarëve për pronat e tyre, në pjesën veriore të Mitrovicës.

Lidhur me veprimet e lartpërmendura, AKP arsyetimin e vet e bazon në shkaqet politike dhe mungesën e mbështetjes nga policia e Kosovës. Arsyetimi i tillë i AKP-së tash e dhjetë vite, nuk e arsyeton dështimin e saj për realizimin e obligimit ligjor, në bazë të mandatit, si dhe trajtimin jo të barabartë të qytetarëve të Kosovës. Dështimi i AKP-së për realizimin e mandatit të saj për çfarë është themeluar, si dhe trajtimi jo i barabartë i parashtruesve të ankesave, sidomos dallimi në baza etnike, përbënë shkelje të nenit 24 dhe nenit 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Nga e tërë kjo që u tha më lart, shihet qartë se është mjaft evidente prania e formave diskriminuese në institucionet publike të Republikës së Kosovës. Institucionet publike, në radhë të parë Kuvendi dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, duhet të kenë parasysh se garantimi i barazisë është një ndër parimet kryesore të sundimit të ligjit. Prandaj, ky parim nënkupton njëkohësisht edhe kufizimin ligjor të arbitraritetit të pushtetit, jo vetëm nëpërmjet garancive ligjore, por edhe me veprime konkrete.

4.3.6. Barazia gjinore

Koncepti i diskriminimit gjinor përfshin çdo dallim që për pasojë ka përjashtimin, kufizimin, rrezikimin ose pamundësimin e gëzimit ose shfrytëzimit, në bazë të gjinisë, të të drejtave njerëzore dhe lirive themelore në fushën politike, shoqërore, kulturore, qytetare ose lëmi tjetër.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës e thekson barazinë e të gjithë qytetarëve para ligjit dhe të drejtën e mbrojtjes ligjore pa diskriminim, pa marrë parasysh gjininë, gjuhën, përkatësinë religjioze, kulturore, etnike, politike, statusin ekonomik dhe shoqëror, orientimin seksual apo ndonjë status

tjetër të qytetarëve.²⁰ Gjithashtu, Kushtetuta e Kosovës i obligon të gjitha institucionet për zbatimin e konventave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përfshirë edhe Konventën ndërkombëtare kundër të gjitha formave të diskriminimit të gruas (CEDAW).²¹

Mbrojtja nga diskriminimi në Kosovë, sidomos nga ai në baza gjinore, është e rregulluar edhe me Ligjin mbi barazinë gjinore. Ky ligj paraqet njëherësh edhe bazën juridike për punë të Njësisë për barazi gjinore, pranë Institucionit të Avokatit të Popullit në Kosovë.²²

Duke pasur parasysh specifikat e tranzicionit kosovar, nga rastet e paraqitura dhe hetimet e bëra nga IAP, në fushën e diskriminimit gjinor, është vërejtur se ekzistojnë faktorë të caktuar, të cilët e vështirësojnë aplikimin e këtyre normave ligjore dhe kushtetuese.

Pozita e femrës në tregun e punës është shumë e rëndësishme për barazinë gjinore. Diskriminimi, në bazë gjinore në tregun e punës, sidomos gjatë fazës së punësimit, është shumë i përhapur. Diskriminimi fillon qysh me publikimin e shpalljeve, ku gjinia theksohet si një prej kriterëve për punësim në punë apo pozita të caktuara. Aspekte të tjera të diskriminimit paraqesin edhe largimet joligjore, pengimi i përparimit në punë dhe pamundësia e aftësisimit profesional dhe ngritjes së vazhdueshme.

Në bazë të ankesave të pranuar në IAP, në këtë periudhë, mund të konkludohet se diskriminimi është i pranishëm si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat. Rastet e diskriminimit në punë rrallëherë denoncohen nga frika e humbjes së punës, për shkak të mosnjohjes të drejtave të tyre si dhe mungesës së praktikës gjyqësore në rastet e diskriminimit.

Sa i përket diskriminimit të grave në fushën e arsimit, IAP në raportet e tij të mëhershme ka theksuar disproporcionin e madh në të dhënat e ndjeshme gjinore, sipas të cilave numri i grave të pashkolluara ishte shumë më i madh se ai i meshkujve. Sipas të dhënave zyrtare, për periudhën për të cilën raportohet, shihet se numri i fëmijëve, përkatësisht i vajzave të cilat e braktisin shkollën, edhe pse është në rënie, janë shqetësuese. Po ashtu, pabarazia gjinore gjithashtu reflektohet në profilet arsimore, të cilat dëshmojnë për formën patriarkale të ndarjes në profesionet e meshkujve dhe të femrave.

Situata në fushën e mbrojtjes shëndetësore është gjithashtu mjaft e vështirë. Pamundësia e shfrytëzimit të së drejtës për mbrojtje shëndetësore dhe sigurim social për shkak të situatës së keqe të përgjithshme ekonomike e gjithashtu kriterëve ligjore e krijon mundësinë e shfaqjes të diskriminimi edhe në këtë fushë.

Ankesat të cilat i ka pranuar IAP në këtë periudhë, nga gratë, kanë të bëjnë me diskriminimin nga Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave, sa i përket trajtimit mjekësor jashtë vendit. Në rastet kur Ministria e Shëndetësisë ka vendosur pozitivisht, ka dhënë udhëzimin që pacientja duhet të mjekohet jashtë vendit, Ministria Financave nuk ka përfillur këtë udhëzim, me arsyetimin e mungesës së mjeteve financiare. Kjo punë e pakoordinuar e këtyre dy ministrive, paraqet shkeljen e të drejtës për mbrojtje shëndetësore të personave të cilëve u është pranuar kjo e drejtë nga e njëjta qeveri.

Në fushën e diskriminimit gjinor, as gjyqësori kosovar nuk është imun. IAP, në këtë periudhë, ka pranuar një numër të caktuar të ankesave, të cilat kishin të bëjnë me zvarritje të proceseve

²⁰ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 3.

²¹ Po aty, neni 22.

²² Ligji për Barazi Gjinore, nr. 2004/2, miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 7 qershor 2004.

gjqësore. Pjesa më e madhe e tyre ka pasur të bëjë me marrëdhëniet pronësore juridike. Në të vërtetë, duke pasur parasysh traditën në Kosovë, lidhur me të drejtat pronësore brenda familjes, është i njohur fakti se gratë në Kosovë heqin dorë nga të drejtat e tyre pronësore në favor të anëtarëve meshkuj. Ndërsa, në rastet kur femrat e marrin pjesën e tyre të trashëgimisë, kjo në të shumtën e rasteve bëhet shkak i çrregullimit të marrëdhënieve familjare në familjen patriarkale kosovare.

Përveç aktualizimit të problemeve të kësaj fushe në shoqëri, inkurajues është edhe fakti se ekspertët kërkuar ndryshimin e disa normave ligjore në Ligjin mbi trashëgiminë, me qëllim të përmirësimit të pozitës së gruas në procesin trashëgimisë dhe gëzimit të drejtave pronësore.

Shikuar nga aspekti i barazisë gjinore, fatkeqësisht ekziston ende një dallim i madh i informimit dhe ndërgjegjësimit midis grave nga mjediset urbane dhe rurale në Kosovë. Kjo vërehet edhe nga numri i ankesave të paraqitura në IAP. Por, ky dallim vërehet edhe në të gjitha fushat e tjera.

Dhuna në familje nuk është dukuri e re dhe e panjohur. Ajo gjithmonë ka qenë e pranishme në çdo shoqëri, madje edhe në shoqërinë kosovare. Inkurajues është fakti se në periudhën e pasluftës, dhuna në familje është kualifikuar si veprë penale dhe sanksionohet me ligj.

Dhuna në familje paraqet ndër shkeljet më të rënda të drejtave njerëzore dhe është baza e diskriminimit të gruas. Koncepti i dhunës në radhë të parë lidhet me dhunën fizike. Mirëpo, është inkurajuese se në kohë të fundit dhuna shikohet dhe trajtohet nga aspekti ekonomik, psikologjik, sociologjik dhe kulturor. Shumë shpesh varësia ekonomike e viktimës dhe lidhja emocionale me kryesin e dhunës e rëndojnë pozitën e saj, ashtu që ajo shpeshherë nuk e paraqet rastin në institucionet kompetente.

Një problem më vete dhe njëkohësisht pengesë të madhe, gjatë paraqitjes së rastit të dhunës në familje, paraqet edhe pikëpamja e pranuar në këto hapësira, se dhuna në familje është çështje private dhe jo publike dhe se si e tillë ajo duhet të mbetet brenda rrethit familjar.

IAP ka pasur disa ankesa, në lidhje me dhunën familjare. Rasti më i rëndë është paraqitur nga Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve (QMGF) në Prishtinë. QMGF ka kërkuar bashkëpunimin dhe monitorimin e procesit gjyqësor për rastin nga IAP. Viktimë e dhunës në familje ishte një vajzë tetëmbëdhjetë vjeçare, e cila ishte keqtrajtuar seksualisht nga prindi i saj prej vitit 2004, deri në vitin 2008, deri në momentin kur rasti është paraqitur në policinë e Kosovës dhe vajza është vendosur në shtëpi të sigurt. IAP rregullisht e ka monitoruar rastin në procesin gjyqësor. Përfaqësueset e IAP-së, me këtë rast kanë kontaktuar prokurorin, gjyqtarin, si dhe vetë viktimën. Gjykimi ka përfunduar në dhjetor dhe kryesi i veprës penale është dënuar me 15 vjet burgim.

Një dukuri e re në shoqërinë kosovare është dhuna në familje, ku meshkujt janë viktimat të dhunës familjare. Natyrisht, në relacion me numrin e rasteve kur femrat janë viktimat, është shumë më i vogël. IAP i ka pasur dy raste të tilla, me ç'rast ka reaguar tek organet kompetente, përkatësisht në polici dhe gjyq, në lidhje me hetimin e këtyre rasteve.

Sfida pakrahasueshëm më e madhe e shoqërisë dhe institucioneve publike në Kosovë për përmirësimin, në fushën e barazisë gjinore në Kosovë, është trafikimi me qenie njerëzore.

Prandaj, bazuar në gjendjen aktuale në Kosovë, në fushën e barazisë gjinore dhe nga sa u cek më lart, obligim i të gjitha institucioneve publike kompetente dhe sidomos i Qeverisë së Kosovës është që, gjatë hartimit të planeve dhe programeve vepruese, si dhe të buxhetit duhet medoemos të kihen parasysh edhe këto:

Rekomandime

- Të zbatohet kuota e paraparë me Ligjin për barazinë gjinore, që gruaja në pozitat vendimmarrëse në organet e qeverisjes, në të gjitha nivelet, të jetë së paku 40 %,
- Qeveria e Kosovës të zhvillojë programe dhe masa afirmative për kyçje të grave në tregun e punës,
- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të nxisë programe për arsimim të vazhdueshëm dhe kualifikim të grave, në përputhje me nevojat e tregut të punës,
- Të zbatohet programi për trajnim të punësuarve në institucione, të cilat merren me të drejtat e njeriut dhe me çështjen e barazisë gjinore, në nivelin qendror dhe lokal,
- Të organizohen trajnime shtesë për të punësuarit, të cilët merren me çështjen e dhunës në familje, çështjen e grave mbajtëse të familjes dhe sidomos të grave të moshuara, të cilat jetojnë vetëm,
- Qeveria e Kosovës të iniciojë, pa humbur kohë, miratimin e Ligjit për sigurim social dhe shëndetësor në Kosovë,
- Të aktivizohet çështja e financimit të shtëpive të sigurta dhe telefonave SOS për viktimat e dhunës në familje,
- Të funksionalizohen njësitë për barazi gjinore në komuna dhe të forcohen ato në të gjitha nivelet,
- Të sigurohet futja e statistikave gjinore në organet dhe institucionet e Republikës të Kosovës.

4.4. E drejta për jetën

E drejta për jetën është e drejta themelore dhe kushti i parë për ekzistimin e të gjitha lirive dhe të drejtave të tjera. E drejta lind së bashku me njeriun. Ajo nuk falet e as dhurohet. Kjo e drejtë mbrohet me ligj që nga momenti i zënies. Çdo njeri ka të drejtë t'i respektohet jeta. Kjo e drejtë e përjashton privimin arbitrar të njeriut nga jeta.²³

KEDNJ e fuqizon këtë të drejtë, duke theksuar detyrimin e përgjithshëm të shtetit për mbrojtjen ligjore të jetës. Jeta nuk konsiderohet e privuar në kundërshtim me këtë nen, nga përdorimi i forcës, i bërë absolutisht i domosdoshëm.²⁴ Në lidhje me përdorimin e termit “*absolutisht e domosdoshme*”, e domosdoshme është një analizë e thellë dhe bindëse në lidhje me domosdoshmërinë e veprimit dhe të mjeteve të përdorura, në krahasim më atë që është zakonisht e zbatueshme nga një shtet në një shoqëri demokratike.²⁵

Shoqëria demokratike të cilën po e synon Kosova, të drejtën e jetës e koncepton në kuptim më të gjerë, në drejtim të lirisë, sigurisë, të mirëqenies, si dhe një tërësie kushtesh sociale. Në këtë kuptim,

²³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 25.

²⁴ KEDNJ, neni 2.

²⁵ Po aty, nenet 8 dhe 11.

inkurajues është fakti se vazhdimisht ka rritje të sigurisë së lëvizjes dhe për zhvillimin e veprimtarive politike, ekonomike, kulturore e sociale, në të gjithë territorin e vendit, përveç pjesës veriore të Kosovës.

Megjithatë, në Kosovë krimi shfaqet në forma të ndryshme, të rënda, që cenojnë të drejtën e jetës. Disa nga format e cenimit të drejtës për jetën janë krimet për hakmarrje ose gjakmarrje, konfliktet që kanë për bazë problemet e pronësisë, krimet kundër moralit, krimet e ndërlydhura me forma të ndryshme të trafikeve, si ai i drogës dhe i qenieve njerëzore. Këto dukuri shqetësuese kërkojnë marrjen e masave të domosdoshme të karakterit ligjor, më qëllim parandalimin dhe luftimin e tyre.

Shqetësim të veçantë për Avokatin e Popullit paraqet është mungesa e hetimeve për rastet e paraqitura, në lidhje me shkeljen e nenit e drejta për jetën. IAP në këtë periudhë raportuese nuk ka marrë asnjë ankesë për aspektet materiale të së drejtës për jetë. Ndërsa në çështjet procedurale, janë vërejtur probleme të dukshme. Ankesat kanë të bëjnë me mungesën e hetimeve nga autoritetet publike lidhur me ndriçimin e rasteve. IAP këtë vit ka lëshuar një raport individual, lidhur me mungesën e hetimeve efektive nga autoritetet kompetente.²⁶

Avokati i Popullit, pas shqyrtimit të këtij rasti ka ardhur në përfundim se ka pasur shkelje të së drejtës për një proces të rregullt hetimor. Avokati i Popullit përkujton se, KEDNJ e thekson shprehimisht se *“E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj.”*²⁷

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), ka konsideruar se *“Vetëm fakti se autoritetet janë në dijeni për një vrasje, obligon shtetin, sipas nenit 2 të (KEDNJ), për të zhvilluar hetime efektive mbi rrethanat lidhur me rastin e vdekjes”*²⁸ dhe se çfarëdo hetime të zhvilluara do të duhej të shpijnë deri te identifikimi dhe dënimi i atyre që janë përgjegjës.²⁹

Qëllimi thelbësor i një hetimi të tillë është që të sigurojë zbatimin efektiv të ligjeve të brendshme që mbrojnë të drejtën për jetën, madje edhe në ato çështje ku përfshihen agjentët apo organet e shtetit, në mënyrë që të sigurojë përgjegjshmërinë e tyre për vdekjet që ndodhin nën përgjegjësinë e tyre. Forma e hetimit që do të përbushë ato qëllime mund të ndryshojë në vartësi të rrethanave. Gjithsesi, pavarësisht nga mënyra që do të përdoret, autoritetet duhet të ndërmarrin veprimet ligjore, sapo t’u jetë parashtruar çështja.

Hetimi duhet të jetë efektiv, për të konstatuar nëse forca e përdorur në çështje të tilla është e justifikuar apo jo, si dhe për të identifikuar dhe ndëshkuar personat përgjegjës. Ky nuk është vetëm një detyrim për të nxjerrë rezultate, por është mjeti për ta nxjerrë të vërtetën në dritë. Autoritetet duhet të ndërmarrin të gjitha hapat e duhura me mjetet që kanë në dispozicion, për të siguruar provat në lidhje me incidentin, duke përfshirë ndërmjet të tjerash: dëshmitarët okularë, provat e mjekësisë ligjore dhe kur është e nevojshme, autopsinë për të marrë të dhëna të plota e të sakta të plagëve dhe një analizë objektive të zbulimeve klinike, duke përfshirë shkakun e vdekjes. Cilido lëshim në kryerjen e hetimit që dëmton përcaktimin e shkakut të vdekjes, do të rrezikojë të bjerë në kundërshtim me këtë standard.

Për të njëjtat arsye, GJEDNJ kërkon po ashtu një element të mjaftueshëm të mbikëqyrjes publike në lidhje me hetimin apo rezultatet e tij, për të siguruar përgjegjshmërinë në praktikë. Shkalla e kësaj mbikëqyrjeje publike mund të ndryshojë nga rasti në rast. Megjithatë, në të gjitha çështjet i afërmi i

²⁶ Rasti Q.B., A. 1546/2004.

²⁷ KEDNJ, neni 2, p.1.

²⁸ Rasti *Tanrikulu kundër Turqisë*, më 8.7.1999, si dhe rastin *Denizi dhe të tjerët kundër Qipros*, më 23.5.2001.

²⁹ Rasti *Ogur kundër Turqisë*, i datës 20 maj 1999.

viktimit duhet të përfshihet në procedurë, deri në atë masë sa të sigurojë në proces që mbrojnë interesat e tij/saj legjitime.³⁰

Roli i Avokatit të Popullit, qëndron vetëm në senzibilizimin dhe në nxitjen e administratës publike dhe shtetërore të Republikës së Kosovës, që të përmbushë detyrat e saj për mbrojtjen e të drejtave të personave të prekur.

Avokati i Popullit, vëren se edhe pas 10 vitesh nga mbarimi i luftës, ankuesit që janë të prekur nga mungesa e hetimeve të autoriteteve përgjegjëse, nuk disponojnë mjete të përshtatshme efektive, që do t'ua mundësojnë realizimin e një kompensimi të dëmit për vuajtjet e shkaktuara.

Nisur nga sa u tha më lart, Avokati i Popullit rekomandon që cilësia dhe transparenca e procesit legjislativ duhet të përmirësohet në masë të madhe, jo vetëm për t'i ofruar Kosovës një kornizë ligjore të shëndoshë, por edhe për ta përmirësuar besimin në sistemin juridik.

Menaxhimi aktiv dhe efikas i procedurave penale është thelbësor për sundimin e ligjit. Kur gjykatat dhe prokuroritë dështojnë t'i mbrojnë në mënyrë adekuate të drejtat e palëve gjatë administrimit të këtyre procedurave, nuk bëhet fjalë vetëm rënies së efikasitetit të sistemit gjyqësor, por edhe humbje e besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë në përgjithësi.

Avokati i Popullit, po ashtu, rekomandon ofrimin e të gjitha kushteve të domosdoshme për zbatimin efikas të hetimeve për mbrojtjen e të drejtave të viktimave, për evitimin e vonesave të panevojshme dhe miratimin e kërkesave ligjore të ankuesve në procedimet ligjore.

Instituti Gjyqësor i Kosovës duhet të vazhdojë me trajnimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në lëmitë penale lidhur me hetimin e veprave penale dhe gjykimin e tyre.

Qytetarët duhet të ofrohen mjete të përshtatshme juridike për realizimin e kompensimit për dëmet e shkaktuara në rastet e dështimit të institucioneve publike kompetente për hetimin dhe ndriçimin rasteve të penale dhe zbulimin e dënimit e kryerësve të këtyre veprave.

Deri në krijimin e mekanizmave të tillë ligjorë, sistemi juridik në Republikën e Kosovës nuk do të jetë në pajtim me standardet e pranuar ndërkombëtare lidhur me zbatimin e nenit 2 të KEDNJ, si dhe nenin 25 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

4.5. Ndalimi i torturës, trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruar

Kushtetuta e Kosovës, Kodi Penal i Kosovës dhe instrumentet ndërkombëtare garantojnë se *“Askush nuk duhet t'i nënshtrohet torturës, a trajtimeve ose dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese”*.³¹

Termi torturë nënkupton çdo akt, me anë të të cilit një personi, me qëllim i shkaktohet dhembje ose vuajtje e madhe fizike ose mendore, frikësim ose detyrim, me synim që nga ai ose nga personi i

³⁰ Rasti *Guleç kundër Turqisë*, vendimi i 27 korrikut 1998, par. 82. I ati i viktimës nuk u njoftua për vendimet për të mos proceduar ligjërisht; *Ogur kundër Turqisë*, vendimi i 20 majit 1999, par. 92, familja e viktimës nuk kishte njoftime për hetimet dhe dokumentet e gjykatës; *Gal kundër Turqisë*, vendimi i 14 dhjetorit 2000, par. 93.

³¹ *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*; Shih Neni 27, *Kodi i Përkohshëm Penal i Republikës së Kosovës*; KEDNJ, Romë, 4. XI. 1950; *Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut*, 10.12.1948; *Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike*, 2200 A (XXI), 16 12 1966

tretë të merret njoftim ose deklaratë, që mund të ndikojë në dënimin e tij ose të personit të tretë, për ndonjë vepër që e ka kryer ose që dyshohet ta ketë kryer.

Edhe gjatë vitit të kaluar Institucioni i Avokatit të Popullit ka vazhduar të përcjellë zbatimin e normave ligjore vendore dhe ndërkombëtare, të zbatueshme në Republikën e Kosovës, që kanë të bëjnë me mbrojtjen nga tortura. Gjatë vitit 2010, lidhur me shkeljen e kësaj të drejte në IAP janë regjistruar 7 raste, të cilat raste janë në procedim e sipër. Në bazë të rasteve të regjistruara, por edhe të gjendjes së përgjithshme në Kosovë, Avokati i Popullit nuk vëren ndryshime të dukshme, për më tepër vëren një stabilitet të pakënaqshëm.

Më 5 korrik 2010, Avokati i Popullit publikoi një raport, lidhur me ngjarjet që ndodhën gjatë intervenimit policor në selinë e Lëvizjes Vetëvendosje në Prishtinë, në përpjekje për arrestimin e z. Albin Kurti. Hetimet ex officio u përqendruan në sjelljen e Policisë së Kosovës gjatë dhe pas ndërhyrjes. Nga hetimet e zhvilluara, Avokati i Popullit vuri në dukje se policia ka bërë shkelje të normave vendore dhe ndërkombëtare të zbatueshme në Republikën e Kosovës.³² Raporti u është drejtuar niveleve më të larta shtetërore si: kryetari të Kuvendit; kryeministrit; ministrit të Punëve të Brendshme, Komisionit parlamentar për të drejtat e njeriut, barazi gjinore, persona të pagjetur dhe peticione; Komisionit për punë të brendshme dhe siguri; Inspektoratit Policor të Kosovës.

Avokati i Popullit, rekomandoi³³ që autoritetet kompetente të fillojnë hetimet urgjentisht dhe të sjellin para drejtësisë personat të cilat kanë tejkaluar kompetencat dhe kanë bërë shkeljen e të drejtave të njeriut. Më 9 nëntor 2010, Avokati i Popullit është njoftuar me shkresë nga Inspektorati Policor i Kosovës se kanë filluar hetimet disiplinore në përputhje me Ligjin për polici.

Edhe gjatë periudhës raportuese IAP ka vazhduar të mbikëqyrë në baza të rregullta mujore vendet ku mbahen personat e privuar nga liria: qendrat e paraburgimit, qendrat korrektuese dhe burgjet. Përfaqësuesit e Avokatit të Popullit janë takuar me personat e mbajtur në to, si dhe kanë marrë ankesat e tyre, në formë të shkruar nga kutitë e ankesave të vendosura nëpër këto qendra, ku kanë qasje kanë vetëm ata. Rekomandimet nga ankesat e pranuar dhe shqetësimet, përfaqësuesit e IAP-së i kanë përcjellë drejtpërdrejt tek autoritet e këtyre institucioneve. Bashkëpunimi i IAP-së dhe përfaqësuesve të tij që bëjnë monitorimin e këtyre vendeve, si dhe pranimi i rekomandimeve ka qenë i kënaqshëm.

Në kuadër të monitorimit të zgjedhjeve parlamentare në Republikën e Kosovës, në të cilat IAP ishte monitorues, një ekip i IAP-së ka vëzhguar edhe votimin në burgje dhe qendra të paraburgimit. Procesi i votimit në këto vende ka shkuar në mënyrë të rregullt dhe pa ndonjë vërejtje serioze, përveç në qendrën e paraburgimit në Pejë. Aty fillimisht nuk janë lejuar të votojnë të burgosurit me dokumente të identifikimit me afat të skaduar, por pas ndërhyrjes të IAP-së, tek komisionari komunal për zgjedhjet parlamentare, kjo paqartësi është eliminuar.

Ankesat më të shumta që janë pranuar në qendrat e ndalimit kanë pasur të bëjnë me vendimet e gjykatave, respektivisht raste në pritje të vendimit final. Kurse numri më i madh i ankesave në burgje drejtohen kundër Panelit për Lirim me Kusht dhe ankesa sa i përket trajtimit mjekësor.

³² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Shih Neni 23 dhe neni 27; të Neni 2.1 pika b dhe neni 12.2 të Ligjit për Policinë e Kosovës, nr. 03/L-035; Neni 5 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut; Neni 3 i KEDNJ; Neni 7 dhe neni 10 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.

³³ Raport ex officio 207/2010, lidhur me rastin e intervenimit policor në selinë e Lëvizjes Vetëvendosje në Prishtinë për arrestimin e z. Albin Kurti.

Sipas informatave të marra nga autoritetet e burgut në momentin e raportimit, numri i të burgosurve, me aktakuzë të ngritur dhe që janë në pritje të vendimit është 152, ndërsa numri i rasteve në pritje të vendimit final, prej 5 muaj e deri mbi 3 vite, është 111. Më 13 tetor 2010, përfaqësuesit e IAP-së janë takuar edhe me kryesuesin e Këshillit Gjyqësor, ku kanë përcjellë shqetësimet e tyre për këtë situatë. Të njëjtat shqetësime janë ngritur, vazhdimisht, edhe tek autoritetet përgjegjëse, sidomos në takimet me kryesuesit e gjykatave gjegjëse.

Më 8 shtator 2010, Avokati i Popullit priti udhëheqësin e sistemit shëndetësor të burgjeve të Kosovës dhe zëvendësen e tij. Sipas udhëheqësit të sistemit shëndetësor, trajtimi i të burgosurve në aspektin shëndetësor është përafërsisht i njëjtë, sikurse në institucionet publike.³⁴ Mirëpo, ai ngriti shqetësimet e tij sa i përket mangësive që ka Ligji mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale³⁵ dhe nevojën e plotësimit të tij. Bashkëpunimi i vazhdueshëm i IAP-së me këtë shërbim është një shembull i mirë i bashkëpunimit të institucioneve publike.

Më 15 shtator 2010, Avokati i Popullit vizitoi Qendrën Korrektuese të Smrekovnicës. Kjo qendër ka filluar punën më 28 nëntor 2009, pasi është bërë pranim-dorëzimi nga KFOR-i francez. Me gjithë përpjekjet e mëdha të drejtorisë së burgjeve, dhe sidomos të drejtorisë së kësaj qendre për të përmirësuar gjendjen, kjo qendër vazhdon të ketë probleme, sa i përket aspekteve të ndryshme të funksionalitetit të saj dhe sidomos mungesave të shumta në infrastrukturë.

Gjatë vizitave të rregullta në burgje, përfaqësuesit e IAP-së kanë vërejtur edhe renovimet që janë bërë në këto qendra. Renovimet në pavijonet 5, 7 dhe 8, në burgun e Dubravës, janë të nivelit të kënaqshëm. Gjithashtu, vlen të përmendet edhe ndërtimi i objektit të ri për të dënuarit - dëshmitarë të mbrojtur. Ndërsa, instalimi i sistemit të kamerave vëzhguese në të gjitha qendrat korrektuese, me qëllim të parandalimit të dukurive negative, është për t'u përshëndetur.

Vizita të rregullta janë bërë edhe në Qendrën Korrektuese në Lipjan. Të gjitha problemet dhe shqetësimet e ngritura nga të burgosurit në ankesat e pranuar, nga IAP janë proceduar tek autoritetet e burgut dhe autoritetet e tjera përgjegjëse. Shqetësimet kryesisht kanë të bëjnë me vendimet e Panelit për Lirim me Kusht. Në këtë drejtim, përveç vërejtjeve nga ana e të burgosurve, vërejtje të vazhdueshme ka pasur edhe nga ana e autoriteteve të burgut, si dhe nga vetë IAP.

Edhe në Qendrën Korrektuese në Lipjan ka pasur renovime, siç janë: kuzhina, vrojtoret, objekti i ri për vizitorë dhe salla e rekreacionit në pavijonin e femrave.

Më 6 dhjetor 2010, përfaqësuesit e IAP-së u takuan me koordinatoren e Panelit për Lirim me Kusht, me qëllim të përcjelljes së shqetësimeve dhe ankesave të shumta që i pranon IAP. Gjithashtu, qëllimi i takimit ishte edhe përcjellja e interesimit tonë për monitorimin e seancave të tyre, ngjashëm me monitorimin e seancave gjyqësore. Edhe pse takimi u cilësua si i suksesshëm dhe pritet të shihet se si do të veprojë ky panel në të ardhmen, ndonjë veprim konkret nuk ka pasur.

Në kuadër të Protokollit Opsional të Konventës së OKB kundër Torturës – OPCAT, shtetet anëtare janë të detyruara të krijojnë mekanizmin kombëtar për parandalimin e torturës (MKP), për të kryer inspektime të pavarura në vendet e vuajtjes së dënimit, përfshirë burgjet, qendrat e paraburgimit, qendrat për të mitur, stacionet policore qendrat e migracionit dhe të gjitha vendet e tjera ku mbahen personat e privuar lirie. Ky mekanizëm duhet të jetë një institucion publik, i pavarur, i krijuar nga parlamenti kombëtar i vendit. Si pjesë të mekanizmit, varësisht nga mënyra dhe forma e

³⁴ Shih *Raporti vjetor i punës së sistemit shëndetësor të burgjeve të Kosovës* për vitin 2010, Shërbimi Korrektues i Kosovës.

³⁵ *Ligji mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale*, RA 2004/46.

organizimit, mund të jenë edhe një apo më shumë organizata nga shoqëria civile, të cilat merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut. MKP duhet të krijohet për të avancuar monitorimin e të gjitha hapësirave publike ku mbahen të ndaluar personat e privuar nga liria dhe, në asnjë rrethanë nuk mund të jetë arsytim për të anashkalluar ndonjë aktor aktiv dhe efikas të shoqërisë civile të angazhuar në këtë drejtim. Një mekanizëm i tillë do të avancojë Kosovën në sferën e respektimit të drejtave të njeriut në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Me këtë do të sigurohej një mekanizëm kontrollues i rregullt, i përhershëm dhe i pavarur nga ndikimet politike vendore dhe ndërkombëtare.

Avokati i Popullit është duke punuar në këtë drejtim shumë ngushtë me shoqërinë civile. Në bashkëpunim me Qendrën Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT)³⁶ dhe Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ).³⁷ IAP është duke u angazhuar në krijimin e grupit punues, i cili do t'i paraprinte krijimit të MKP, si në aspektin e ndërtimit të infrastrukturës së domosdoshme ligjore, po ashtu edhe në krijimin e praktikave funksionale të veprimit në frymën e instrumenteve ndërkombëtare. Deri më tani, ky grup punues në mbështetje të OSBE³⁸ dhe Zyrës së UNHCHR-së, ka përgatitur marrëveshjen e bashkëpunimit.³⁹

Duke pasur parasysh gjendjen e tanishme në këtë fushë, Avokati i Popullit, rekomandon:

- *Të organizohen seminare ose kurse trajnimi për institucionet ku mbahen personat e ndaluar, me qëllim të zgjerimit të njohurive për të drejtat e njeriut, sidomos në fushën e mbrojtjes nga tortura, të garantuara në instrumentet ndërkombëtare, që janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë.*
- *Të respektohen dhe zbatohen pa vonesë rekomandimet që Avokati i Popullit i drejton autoriteteve përgjegjëse mbi respektimin e standardeve të njohura për të drejtat e njeriut dhe personave të privuar nga liria.*

4.6. Të drejtat e të akuzuarit

Të drejtat e garantuara me Kushtetutë, shprehimisht kërkojnë, që çdokush që akuzohet për veprë penale, gëzon të drejtat minimale si: të njoftohet menjëherë në gjuhën që e kupton, për natyrën e shkakut e akuzës kundër tij; të njoftohet për të drejtat e tij sipas ligjit; të ketë kohë, mundësi dhe mjete të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet; të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën në të cilën zhvillohet gjykimi; të ketë ndihmën e një mbrojtësi që e zgjedhë të komunikojë lirisht me të dhe nëse nuk ka mjete të mjaftueshme, t'i sigurohet mbrojtja falas, të mos shtrëngohet për të dëshmuar kundër vetvetes ose të pranojë fajësinë e vet.⁴⁰

Edhe instrumentet ndërkombëtare universale dhe rajonale në fushën e të drejtave të njeriut, të zbatueshme drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës⁴¹, garantojnë të drejtat e të akuzuarit.⁴²

³⁶ Website: www.krct.org

³⁷ <http://www.cdhrf.net>

³⁸ <http://www.osce.org/kosovo>

³⁹ Më 10 maj 2011, në praninë e përfaqësuesve të Kuvendit dhe të Qeverisë së Republikës së Kosovës, IAP, KMDLNJ dhe QKRMT nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit për krijimin e grupit punues.

⁴⁰ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 30.

⁴¹ Po aty, neni 22.

Edhe me Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (KPPPK) disa nene përcaktojnë të drejtat e të akuzuarit.⁴³ Duke filluar nga dispozitat themelore neni 5, parasheh të drejtën e të akuzuarit të kërkojë që procedura penale të zbatohet brenda një afati të arsyeshëm; neni 11 kërkon që i akuzuari të njoftohet në hollësi për shkaqet e akuzës në gjuhën që e kupton; nenet 73 dhe 74 përcaktojnë hollësitë për angazhimin e mbrojtësit,⁴⁴ si dhe nene të tjera.

Institucioni i Avokatit të Popullit, gjatë kësaj periudhe raportimi ka monitoruar qendrat e ndalimit dhe të mbajtjes së të akuzuarve për vepra të ndryshme penale dhe ka zhvilluar vizita të rregullta në këto qendra paraburgimi dhe burgje si: në Lipjan, Dubravë, Gjilan, Prishtinë, Mitrovicë dhe Prizren.

Gjatë vizitës së rregullt në qendrën e paraburgimit në Lipjan, në mars 2010, zyrtarët e IAP-së u njoftuan nga drejtori i Qendrës së Paraburgimit se kishte vendosur që në një qeli të vendoseshin nga tre të paraburgosur, edhe pse qelitë ishin të parapara vetëm për dy persona. Ky veprim ishte ndërmarrë me arsyetimin, se në këtë mënyrë rritej kontrolli shoqëror dhe në këtë mënyrë të ndikohet në zvogëlimin e rasteve të vetëlëndimeve apo edhe të vetëvrasjeve, që në të kaluarën kishin ndodhur. Edhe pse ky arsyetim binte ndesh me vëllimin dhe sipërfaqen e hapësirës së lejuar me ligj për të burgosur, arsyetimin kishte një logjikë pragmatike. Mbetet që praktika të dëshmojë për efektin e këtij veprimi. Situata në këtë qendër do të vëzhgohet rregullisht dhe në bazë të rezultateve të veprohet në pajtim me ligjin.

Për shkak të rasteve të pazgjidhura nga gjykatat, shumë të paraburgosur detyrohen të qëndrojnë më gjatë në qendrat e paraburgimit, në të cilat nuk kanë hapësirë të mjaftueshme dhe as aktivitete të cilat do të ndikojnë në mundësitë e tyre për rehabilitim. Disa persona mbahen në paraburgim edhe disa vite pas ngritjes së aktakuzës. Qendra e Paraburgimit në Lipjan punon me kapacitet pothuajse të plotë. Nga 150 persona sa është kapaciteti i kësaj qendre, në mbajtje gjendeshin 148 persona.

Në rastin e regjistruar në Institucionin e Avokatit të Popullit më 26 tetor 2010, nr. 271/2010, në Burgun e Dubravës, Avokati i Popullit vëren se ankuesi me vite priste që rasti i tij të shqyrtohej nga Gjykata Supreme dhe vendimi të bëhej i plotfuqishëm. Në mungesë të një vendimi të plotfuqishëm, ai nuk kishte mundësi që të përfitonte asnjë nga benificionet që ofronte shërbimi korrektues. Përgjigjet që Avokatit të Popullit i ka pranuar nga Gjykata Supreme, në lidhje me këtë rast, nuk kanë qenë të plota. Janë zhvilluar disa takime edhe me Kryetarin e Këshillit Gjyqësor edhe me atë të Gjykatës Supreme, por përveç premtimeve se “lënda do të shqyrtohet së shpejti”, deri në fund të periudhës raportuese, nuk ishte ndërmarr asnjë veprim për shqyrtimin e këtij rasti.

Por fatkeqësisht, ky nuk është rasti i vetëm. Nga raporti i Shërbimit Korrektues të Kosovës, vërehet se në Burgun e Dubravës, në pritje të vendimit final për dy e më shumë vite janë gjithsej 11 të burgosur, ndërsa në qendrat e paraburgimit në Pejë dhe Mitrovicë nga një.⁴⁵

⁴² *Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut*, neni 11; *Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike*, neni 14; *Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut*, neni 6.

⁴³ *Rregullore nr. 2003/26*.

⁴⁴ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin: *Luedicke, Belkacem and Koç v. Germany* (application no. 6210/73; 6877/75; 7132/75) më 28 nëntor 1978, lidhur me të drejtën e që i akuzuari të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi kur nuk flet ose nuk e kupton gjuhën në të cilën zhvillohet gjykimi, ka konstatuar se Republika Federale e Gjermanisë kishte shkelë nenin 6 paragrafi 3 (e) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, me rastin e caktimit të obligimit që i akuzuari t'i paguaj shpenzimet e përkthimit.

⁴⁵ *Raporti i Shërbimit Korrektues të Kosovës "Raporti i punës për periudhën janar – shtator 2010"*, Resmi Hoxha, Komisar i Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Avokati i Popullit, me shqetësim vlerëson se në disa raste policia e Kosovës dhe disa nga mediat audiovizuale, elektronike dhe të shkruara, në disa raste të arrestimeve kanë shkelur mbi parimin e prezumimit të pafajësisë.⁴⁶ Në ekranet televizive janë transmetuar momente nga arrestimet, pamje të operacioneve policore në të cilat shfaqeshin të arrestuarit, me duar të lidhura dhe në shoqërim të policëve. Këto veprime kundërligjore në masë të madhe e dëmtojnë prestigjin e të akuzuarve, shkaktojnë trauma dhe ngarkesa të rënda shoqërore, sidomos për rrethin e ngushtë familjar. Për këtë arsye, Avokati i Popullit i është drejtuar me letër RTK dhe Policisë së Kosovës, përmes së cilës ka tërhequr vërejtjen që këto veprime të mos përsëriten në të ardhmen.

Avokati i Popullit, sikurse edhe në raportin e vitit të kaluar, vëren se avokatët mbrojtës, të caktuar sipas detyrës zyrtare, madje edhe ata të angazhuar nga vet të akuzuarit, në disa raste nuk ofrojnë përfaqësim ligjor efektiv. Kjo përcillet me pasoja serioze për tërë rrjedhën e procesit gjyqësor, madje reflektohet edhe në vetë vendimet e gjykatës, në dëm të të akuzuarit.

Dështimi i paarsyeshëm i përfaqësuesit të autorizuar për të marrë pjesë në seancë gjyqësore apo edhe kërkesat e paarsyeshme për shtyrje të seancave, paraqesin shkelje të obligimeve profesionale të avokatit ndaj klientit dhe ndaj gjykatës. Në këtë mënyrë ata drejtpërdrejt ndikojnë në të drejtën për gjykim të drejtë dhe brenda kohës së arsyeshme, në kuptimin e nenit 6, paragrafi 1 të Konventës Evropiane.

Bazuar në atë që u tha më lart, Avokati i Popullit rekomandon që

- *Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministria e Drejtësisë, të hartojë projekte për ndërtimin e qendrave të reja të paraburgimit, qendra korrektuese dhe qendra të ndalimit, apo edhe zgjerimin e atyre ekzistuese, në mënyrë që të akuzuarit, të cilët mbahen në to, të kenë hapësirë të mjaftueshme për akomodim, sipas kërkesës së ligjit.*

Niveli aktual i popullimit të shumicës qendrave të paraburgimit nuk përkon me Rregullat e Standardeve Minimale të OKB-së dhe ato evropiane, sipas të cilave kërkohet që të paraburgosurit të vendosen në qeli individuale.⁴⁷

- *Policia e Kosovës, si dhe mediat t'i kushtojnë më shumë rëndësi respektimit të parimit të prezumimit të pafajësisë, sepse transmetimi në televizion i momenteve të arrestimit të të akuzuarve, cenon dinjitetin e tyre dhe në një mënyrë paragjykon fajësinë e tyre.*

4.7. E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm

E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm është pjesë e të drejtave themelore të njeriut, të mbrojtura nga Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.⁴⁸ E drejta në procedurën gjyqësore, për çështjet penale apo civile, është elementi bazë i nocionit të sundimit të ligjit në një shtet.

⁴⁶ Shih *KEDNJ*, neni 6 par. 2 “Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht”.

⁴⁷ Në rastin *Kallashnikov kundër Rusisë* (application no. 47095/99), Gjykata kishte konstatuar se “kushtet e paraburgimit të parashtruesit, në veçanti mjedisi i mbipopulluar dhe aspak sanitar, si dhe ndikimi i tij dëmtes në shëndetin dhe mirëqenien e parashtruesit, kombinuar me kohëzgjatjen e periudhës, gjatë të cilës parashtruesi, është mbajtur në kushte të tilla, përbënë trajtim degradues”.

⁴⁸ *KEDNJ*, neni 6, par.1.

Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile, ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Publikimi i vendimeve gjyqësore mund të kufizohet në raste të veçanta nga gjykata, kur konstatohet se do të dëmtonte interesat e drejtësisë sipas ligjit.

E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm është e paraparë edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe në legjislacionin penal e civil. Ligjvënësit kosovarë, në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, i kanë bërë një interpretim të gjerë dhe gjithëpërfshirës kësaj të drejte, sipas kuptimit të nenit 6 të KEDNJ.⁴⁹

Pasi Republika e Kosovës nuk është palë e KEDNJ-së, qytetarët e Kosovës, të cilët konsiderojnë se u është shkelur e drejta e gjykimit, brenda afatit të arsyeshëm, nuk mund të parashtrojnë padi në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ).

E drejta e gjykimit të drejtë është rregulluar edhe me Ligjin mbi gjykatat të Republikës së Kosovës,⁵⁰ Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale⁵¹ dhe me Ligjin për Procedurën Kontestimore.⁵² Nga dispozitat e ligjeve të lartpërmendur mund të konstatojmë se e drejta për gjykim brenda afatit të arsyeshëm mbron në mënyrë të njëjtë të drejtat në procedurë civile dhe penale.

E drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm është një koncept i gjerë, që ka evoluar me kalimin e kohës në kuptimin progresiv nga praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila zbatimin/interpretimin e nenit 6 të KEDNJ-së, e bën në kuptimin e pozitivitetit të drejtave të njeriut. Nuk është e mjaftueshme që këto të drejta të garantohen vetëm formalisht me akte ligjore, por ato duhet të sigurohen në mënyrë të atillë që të zbatohen në praktikë në çdo rast.

Në këtë periudhë të raportimit, IAP ka pranuar një numër të konsiderueshëm të ankesave të qytetarëve, pjesa më e madhe e të cilave kishin të bënin me pretendimet për shkeljet e së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor, sidomos të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor. Ka pasur edhe ankesa për dyshime në objektivitetin e vendimeve, si dhe për mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore, nga ana e gjykatave, si dhe të vonesave në dhënien e vendimeve gjyqësore.

Shumica e ankesave të qytetarëve për zvarritje të tepruar të procedurave gjyqësore, janë konteste pronësore dhe detyrimore. Këto procedura, deri në marrjen e vendimit gjyqësor zgjasin 5 deri 6 vite. Në të gjitha rastet, ku janë konstatuar shkelje të tilla, Avokati i Popullit ka hapur hetime dhe ka kërkuar njoftime nga gjykatat e niveleve të ndryshme, lidhur me veprimet që janë marrë për zgjidhjen këtyre çështjeve.

Nga përgjigjet prej gjykatave të ndryshme të Kosovës, Avokati i Popullit nuk është i kënaqur me nivelin e trajtimit të rekomandimeve të tij nga ana e gjyqësorit. Në të shumtën e përgjigjeve me shkrim, gjykatat theksojnë “se rasti do të shqyrtohet kur t’i vijë radha” apo përgjigjja tjetër “se rasti gjendet në radhë për shqyrtim”. Avokati i Popullit është i shqetësuar me trajtimin e letër këmbimeve me gjykata posaçërisht të përgjigjeve të tilla, ku nuk dihet koha e shqyrtimit të çështjeve të qytetarëve. Natyrisht, Avokati i Popullit ka parasyrsh edhe ngarkesën me lëndë të vjetra

⁴⁹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 31.

⁵⁰ Ligji për Gjykatat, nr. 03/L-199, neni 7, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.79, 24 gusht 2010.

⁵¹ Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale, nr. 03/L-199, neni 7, par. 2.

⁵² Ligji për Procedurën Kontestimore, nr. 03/L-006, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 38, 20 shtator 2008, neni 10, par.1.

nëpër të gjyqësisë në Kosovë, si dhe mungesën e stafit të nevojshëm për përshpejtimin e procedurave.

Si pasojë e gjendjes së rëndë në gjyqësor, ka mjaft raste kur çështjet e ngritura nga qytetarët hidhen poshtë pa u shqyrtuar, si pasojë e parashkrimit ligjor të lëndës. Prokuroria komunale e Ferizajit, lidhur me rastin e qytetarit XH.R. nga Ferizaj, kishte ngritur padinë në Gjykatën Komunale në Ferizaj më 19 shkurt 2005, ndërsa qytetari i dëmtuar XH.R., në muajin janar 2011, kishte marrë vendimin gjyqësor për hedhjen poshtë të padisë. Se sa është numri i lëndëve të cilat parashkruhen në vazhdimësi, nuk dihet, sepse mungojnë statistikat e publikuara. Kjo punë duhet bërë Këshilli Gjyqësor i Kosovës, si institucion kushtetues për menaxhimin e gjyqësorit.

Qytetari R.G., nga Prishtina më 24.08.2010, ka paraqitur rastin e tij në IAP, për shkak të marrjes së pronës së tij, në Prishtinë, në mars të vitit 2009, nga Ministria e Transportit (MT), për ndërtimin e rrugës në segmentin M2, Fushë Kosovë-Arllat. Kjo Ministri ka bërë shpronësimin, pa përfilljen e procedurave të shpronësimit dhe kompensimit sipas ligjit.

Më 17 shtator 2010, Avokati i Popullit, me qëllim të hetimit të rastit, i dërgoi letër MT, e cila me shkresën e datës 18.10.2010 e njofton Avokatin e Popullit se rasti gjendet në procedurë të kompensimit dhe se lënda për vlerësim dhe kompensim është dërguar në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave (MEF). Më 19.10.2010 dhe më 27.10.2010 përfaqësuesi i Avokatit të Popullit kontaktoi drejtorin e Departamentit të Tatimit në Pronë në MEF, lidhur me gjendjen e lëndës së ankuesit për kompensimin e pronës. Zyrtari i MEF-it deklaroi se lënda e ankuesit nuk është kompletuar në pajtim me ligjin nga MT, andaj më 20.10.2010 lënda i është kthyer për kompletim MT. Pasi nuk është bërë kompensimi i pronës në procedurën administrative, më 2.11.2010 pala njoftohet që në bazë të ligjit,⁵³ ai çështjen e kompensimit mund ta realizojë në procedurën gjyqësore.

Duke u ballafaquar me një zvarritje dhe neglizhencë të këtellë të autoriteteve publike, pala heziton ketë ta bëjë, për shkak të procedurave të tejzgjatura në gjykata në shqyrtimin e lëndëve dhe përvojës jo të mirë me gjyqësorin, ku paraprakisht një kontest gjyqësor pronësor i kishte zgjatur 5 vite, në Gjykatën Komunale në Prishtinë.

Gjendja e rëndë në sistemin gjyqësor, sidomos si pasojë e trajtimit dhe zvarritjes jashtëligjore të rasteve dhe gjendja aspak e kënaqshme dhe neglizhencia e paarsyeshme në pjesë të ekzekutivit, ka ndikuar që shumica e qytetarëve të humbin besimin në sistemin e drejtësisë dhe të orientohen në forma jashtë institucionale dhe joligjore të zgjidhjes së kontesteve të tyre.

Mungesa e numrit të mjaftueshëm të gjyqtarëve, demotivimi i tyre material me paga të ulëta, mungesa e personelit ndihmës për të garantuar përmbartimin e vendimeve gjyqësore dhe infrastruktura e dobët, janë faktorët që po ndikojnë në rritjen e numrit të rasteve të pazgjidhura në gjykata të Kosovës. Kjo gjendje në gjyqësor ka sjellë humbjen e besimit të qytetarëve në drejtësinë institucionale dhe shoqërore. marrjen e drejtësisë në duart e veta nga individët, por njëherazi përbën një nga shkeljet më të rënda të të drejtave të njeriut.

Për Avokatin e Popullit shkelje të rënda të kësaj të drejte paraqiten në procedurat penale. Në këto raste, gjykimet zvarritjen në masë të paarsyeshme dhe gjithsesi joligjore. Kjo rëndon më shumë në rastet e pritjes së gjykimit në paraburgimet, pastaj zvarritjet në konfirmimin e padive, caktimin e

⁵³ Ligji për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, nr. 031/1-139, neni 35, par.2.

seancave dëgjimore dhe lëshimin e vendimeve gjyqësore, etj. Gjendje jashtëzakonisht shqetësuese dhe e rëndë është në rajonin e Mitrovicës, për shkak të mosfunksionimit të gjyqësorit.

Zbatimi i Ligjit për gjykata, veçanërisht përmirësimi i pagave të gjyqtarëve,⁵⁴ si dhe premtimet për rritjen e numrit të gjyqtarëve sipas standardeve evropiane, 23 gjyqtarë për 100 mijë banorë, si dhe investimet e mëdha materiale dhe njerëzore të premtuara për gjyqësorin, janë shpresëdhënëse për përmirësimin e realizimit të kësaj të drejte të qytetarëve sipas dispozitave ligjore.

Gjendja aktuale e gjyqësisë vendore, si në aspektin kualitativ, ashtu edhe në atë kuantitativ, bazohet dhe në kërkesën e GJEDNJ-së për autoritetet kombëtare. Ato duhet t'i organizojnë sistemet e tyre ligjore në atë mënyrë, që ato të punojnë në pajtim me standardet e të drejtave të njeriut. Në Republikën e Kosovës ky kriter ende nuk është plotësuar, me gjithë deklaratimet dhe dëshirat e shprehura.

Prandaj, Avokati i Popullit konsideron se krijimi i një sistemi të pavarur gjyqësor, si dhe forcimi i tij, është garancia më e mirë për sundimin e ligjit në Kosovë. Një reformë e sistemit gjyqësor, një përmirësim i dukshëm i pozitës shoqërore, institucionale, si dhe materiale e gjyqësorit, është e domosdoshme dhe e pashmangshme.

Gjyqtarët në Kosovë duhet ta kenë sigurinë institucionale dhe materiale që të mund ta kryejnë obligimin e tyre ligjor drejt dhe në mënyrë plotësisht të pavarur, nga çdo ndikim i jashtëm. Po ashtu, gjyqtarëve duhet t'u ofrohet mundësia që të bëjnë interpretime kualitative dhe të pavarura, në mënyrë që të kthehet besimi i qytetarëve në gjyqësorin e Kosovës, që paraqet njërën nga tri shtyllat kryesore të funksionimit të shtetit të së drejtës dhe demokracisë.

4.8. E drejta për mjete juridike

E drejta për mjete juridike, është e drejtë e përcaktuar me legjislacionin vendor,⁵⁵ e cila është kërkesë edhe e instrumenteve juridike ndërkombëtare.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe në përgjithësi legjislacioni penal, civil dhe administrativ, ia garantojnë qytetarit mundësinë e shfrytëzimit të mjeteve juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative, të cilat i cenojnë të drejtat ose interesat e tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.

E drejta për mjete juridike, e përcaktuar edhe me KEDNJ,⁵⁶ sidomos sa u përket afateve kohore, duhet të sigurohet nga gjykatat dhe organet administrative në të gjitha nivelet.⁵⁷ Administrimi i drejtësisë brenda një kohë të arsyeshme kohore krijon siguri ligjore dhe i kontribuon sundimit të ligjit.

Çdo qytetar mund t'i shfrytëzojë mjetet juridike kundër çdo vendimi të nxjerrë nga autoritetet publike shtetërore. Shfrytëzimi i mjetit juridik është një mundësi e mirë që autoritetet publike shtetërore t'i rishqyrtojnë vendimet e tyre, t'i përmirësojnë gabimet ose lëshimet eventuale, që mund të ndodhin gjatë zhvillimit të procedurave të ndryshme.

⁵⁴ *Ligji për Gjykatat*, nr. 03/L-199, neni 29. Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 79, 24 gusht 2010.

⁵⁵ *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, neni 32.

⁵⁶ *KEDNJ*, neni 13.

⁵⁷ *Ligji i Procedurës Kontestimore*, neni 10.

Në procedurat gjyqësore penale, mjetet juridike dhe afatet kohore për shqyrtimin e ankesave, si ato kundër ndalimit, caktimit ose vazhdimin të paraburgimit, ankimimit të vendimeve gjyqësore, si dhe të ushtrimit të mjeteve të jashtëzakonshme juridike, janë të rregulluara dhe të përcaktuara me ligj.⁵⁸

Po ashtu, mjetet juridike, afatet për zhvillimin e procedurës dhe për nxjerrjen e vendimit në rastet administrative, janë të parapara edhe me Ligjin e procedurës administrative. Nëse, sipas këtij ligji, 30 ditë nga dita e paraqitjes së mjetit juridik nuk merret vendimi nga organi kompetent administrativ, palët e fitojnë të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës në përputhje me Ligjin mbi Konfliktet Administrative.

Përcaktimi i mjeteve juridike dhe afateve ligjore, mundëson parandalimin e padrejtësive, shpërdorimin e pushtetit dhe garanton parimin e sundimit të ligjit.

Në këtë periudhe të raportimit, lidhur me procedurat gjyqësore dhe administrative, gjatë shfrytëzimit të mjeteve juridike, IAP ka pranuar 99 ankesa të qytetarëve, prej të cilave 35 janë mbyllur dhe 64 janë ende të hapura.

Nga analiza e bërë e ankesave të paraqitura, sipas subjekteve, konstatohet se pjesa më e madhe e tyre i përket sistemit gjyqësor, pastaj komunave, ministrive si dhe kompanive publike. Ankesat paraqiten për shkak të joefektivitetit të mjetit juridik përkatësisht të mos shqyrtimit të ankesave në afatet ligjore dhe moszbatimit të vendimeve administrative.

Një pjesë e ankesave të qytetarëve të paraqitura janë në të vërtetë kërkesa që IAP të hartojë mjete juridike si kërkesa, ankesa dhe padi, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të tyre për të cilat ankuesit pretendonin se u ishin shkelur. Po ashtu ka pasur kërkesa edhe për përfaqësimin e tyre në kontestet pranë institucioneve kompetente, kjo ishte si rezultat i mosnjohjes së kompetencave të Avokatit të Popullit, dhe si rezultat i besimit të qytetarëve ndaj këtij IAP. Mirëpo, shqetësues për Avokatin e Popullit është mosbesimi i qytetarëve në punën dhe drejtësinë e ofruar nga institucionet kompetente, sidomos të gjyqësorit dhe të avokatëve në Kosovës.

Në këto raste, ankuesit janë këshilluar që t'u drejtohen institucioneve kompetente të vendit, si Komisionit për Ndihmë Juridike dhe shoqatës joqeveritare, që kryen shërbime të ndihmës juridike CLARD.⁵⁹

Nga ankesat e paraqitura kundër gjyqësorit, lidhur me mjetin juridik, ato kryesisht janë të paraqitura kundër gjykatave të gjitha niveleve, si dhe Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme, lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Ankesat e qytetarëve gati krejtësisht kanë të bëjnë me zvarritjet e tepruara të procedurave gjyqësore deri në marrjen e vendimit gjyqësor pas ushtrimit të mjetit juridik. Kjo e bën joefektiv mjetin juridik, për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të garantuar me aktet ligjore. Në këtë rast mungon një mjet normativ adekuat, një mjet juridik procedural efikas, për mbrojtje të të drejtës për mjete juridike për shqyrtim dhe vendimmarrje brenda afatit të arsyeshëm ligjor.

Po ashtu shumë ankesa ishin të adresuara kundër administratës shtetërore si ministrive, komunave, por edhe kundër ndërmarrjeve publike. Ankesat e drejtuara kundër organeve shtetërore kanë të bëjnë me nxjerrjen e vendimeve joligjore në dëm të qytetarëve. Ankesat drejtohen edhe për shkak të

⁵⁸ *Kodi i Procedurës Penale.*

⁵⁹ CLARD është një OJQ lokale e themeluar në 2007, si trashëgimtare e aktiviteteve, të cilat OJQ-ja spanjolle, MPDL - Lëvizja për Paqe ka qenë aktive në Kosovë që nga viti 2002, me fondet e qeverisë nga Agjencia Spanjolle për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (AECID).

mosrespektimit të vendimeve të nxjerra nga vet organet, si dhe të mosrespektimit apo moszbatimit të vendimeve të institucioneve të pavarura administrative. Vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës nuk u zbatuan nga organet e shtetërore, si ato të nivelit lokal, ashtu edhe ato të nivelit qendror. Qytetarët kërkuar nga Avokati i Popullit që të përdor autoritetin dhe kompetencat e tija ligjore për zbatimin e vendimeve.

Në të gjitha rastet e ankesave të paraqitura tek Avokati i Popullit, si në procedurat administrative edhe ato gjyqësore, kur janë konstatuar shkelje të së drejtës për mjete juridike, për shkak të veprimit apo mosveprimit të paligjshëm të autoriteteve publike, Avokati i Popullit ka hapur hetime dhe ka kërkuar informata nga organet e administratës dhe gjykatat e niveleve të ndryshme, lidhur me shkaqet e vonesave.

Avokati i Popullit, në përputhje me kompetencat ligjore, pas konstatimit të shkeljes së të drejtës, u është drejtuar me letra autoriteteve publike, me kërkesë për zbatimin e rekomandimeve të dhëna, me qëllim të eliminimit të shkeljeve të të drejtave të njeriut të garantuara me kushtetutë dhe me ligj.

Avokati i Popullit konstaton se, për të qenë efikas mjete juridik në kuptimin e nenit 13 të KEDNJ-së dhe të evitohen shkeljet e të drejtave dhe lirive të njeriut, respektimi i afateve ligjore nga institucionet kompetente, lidhur me lëndën, ose përndryshe sigurimi i kompensimit përkatës, kur këto të drejta shkelen. Kjo e drejtë e njeriut nuk është realizuar sipas standardeve ndërkombëtare dhe ligjeve vendore. Prandaj, Avokati i Popullit rekomandon zbatimin konsekuent të ligjeve vendore dhe instrumenteve ndërkombëtare për ushtrimin e mjeteve juridike nga autoritetet publike.

4.9. Parimi i ligjshmërisë dhe proporcionalitetit në rastet penale

Parimi i ligjshmërisë dhe proporcionalitetit, në rastet penale, në gjitha sistemet juridike bashkëkohore është ngritur në rangun e parimeve kushtetuese. Parimi i ligjshmërisë dhe proporcionalitetit, si njëra nga parimet e të drejtës penale, është paraparë në nenin 33 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe nenin 1 të Kodit Penal të Kosovës. Në këtë mënyrë garantohet siguria ligjore dhe sundimi i ligjit, ashtu që shoqëria dhe vlerat e saj mbrohen me ligj, ndërsa qytetarët dhe të drejtat e tyre mbrohen njëkohësisht nga zbatimi arbitrar i ligjit. Kështu sigurohet baza e shtetit ligjor, sundimit të ligjit dhe demokracisë.

Parimi i ligjshmërisë (*Nullum crimen sine lege, nulla poene sine lege*) është parim themelor i së drejtës penale nga perspektiva e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, drejtësisë dhe paanësisë, i cili garanton që asnjë i pandehur nuk mund të ndëshkohet në mënyrë arbitrare ose retroaktive. Kjo do të thotë se një person nuk mund të dënohet për veprimin, i cili nuk ka qenë i përcaktuar me ligj si vepër penale dhe për të cilin nuk kanë qenë të parapara sanksionet penale në kohën kur ka ndodhur krimi. Në këtë drejtim, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut në nenin 7.1 ka përcaktuar qartë se “Nuk ka dënim pa ligj”.⁶⁰

Institucioni i Avokatit të Popullit, gjatë periudhës për të cilën raportohet, nuk ka konstatuar ndonjë shkelje përkitazi me cenimin e këtij parimi. Prandaj, Institucioni i Avokatit të Popullit është i

⁶⁰ KEDNJ ; Neni 7. 1., Nuk ka dënim pa ligj, “Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim që, në momentin kur është kryer, nuk përbënte vepër penale sipas të drejtës së brendshme ose ndërkombëtare. Po ashtu, nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në momentin kur është kryer vepra penale”.

inkurajuar me faktin se parimi *Nullum crimen, nulla poena sine lege*, është trajtuar në mënyrë të drejtë në sistemin ligjor dhe në zbatimin e tij në praktikë.

4.10. Liria e lëvizjes

Liria e lëvizjes është e drejtë themelore që i takon individit si qenie njerëzore dhe është e garantuar me instrumente ndërkombëtare si Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut⁶¹ dhe Konventa Evropiane e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.⁶² Kushtetuta e Republikës së Kosovës,⁶³ në pajtim me garantimin e integritetit personal, garanton edhe lirinë e lëvizjes dhe zgjedhjen e vendbanimit, si dhe të drejtën për ta lëshuar vendin⁶⁴. E drejta e çdo qytetari për ndërrimin e vendbanimit apo vendqëndrimin, si dhe liria e largimit nga territori i Kosovës dhe rikthimi në të, është e rregulluar hollësisht me ligje të veçanta.⁶⁵

Gjithashtu, me Kushtetutë është paraparë që shtetasit e Kosovës nuk mund të ekstradohen kundër dëshirës së tyre, përveç kur është paraparë ndryshe me ligj apo me marrëveshje ndërkombëtare, ndërsa të drejtat e hyrjes së të huajve dhe qëndrimi i tyre në territorin e Republikës së Kosovës janë rregulluar me ligj të veçantë.⁶⁶

Liria e lëvizjes nënkupton të drejtën apo lirinë për lëvizje të lirë, në tërë territorin e një shteti, pa kufizime apo ndërhyrje të paligjshme. Nëse kjo vështrohet nga standardi i përgjithshëm i në Kosovë, atëherë, kjo e drejtë nuk gëzohet plotësisht.

Edhe pse, në këtë periudhë raportuese, është i dukshëm zvogëlimi i sulmeve fizike dhe pavarësisht zvogëlimit të incidenteve serioze të dhunës, rasteve të ngacmimit, frikësimit dhe ndjenja e pasigurisë dhe frikës është ende e pranishme në pjesë të ndryshme të Kosovës, varësisht nga përkatësia etnike. Ngacmimi dhe frikësimi nuk shkakton lëndime fizike, vështirë dëshmohen dhe shpesh nuk merren seriozisht, por këto incidente ndikojnë negativisht në gëzimin e të drejtave themelore të njeriut, posaçërisht, në lirinë e lëvizjes. Përveç kësaj, nuk duhet anashkaluar ndikimin negativ kumulativ dhe psikologjik, që shkaktohet tek qytetarët, sepse kanë ndikim negativ në perceptimin e sigurisë.

4.10.1. Liria e lëvizjes së pjesëtarëve të komuniteteve pakicë

Megjithëse liria e lëvizjes, në tërë territorin e Kosovës, është përmirësuar dukshëm, në aspektin e cilësisë dhe të qëndrueshmërisë. Situata ndryshon nga një lokacion dhe rajon në tjetrin, varësisht nga përkatësia etnike dhe varësisht nga situata politike dhe ajo e sigurisë.

Përfaqësuesit e komuniteteve pakicë me numër më të vogël si, turqit dhe boshnjakët, ashtu sikurse ashkalinjtë dhe egjiptasit, nuk kanë pengesa për të lëvizur në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, me përjashtim të pjesës veriore të Kosovës dhe në disa enklava serbe, në pjesën lindore të

⁶¹ *Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut*, Neni 13.

⁶² *KEDNJ*, Protokoll nr. 4, Neni 2,

⁶³ *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, Neni 35.

⁶⁴ *Po aty*, Neni 35.,

⁶⁵ *Ligji për vendqëndrimin dhe vendbanimin*, nr. 02/L-121.

⁶⁶ *Ligji për të huajt*, nr. 03/L-126.

Kosovës, si psh. në Ranillug e Korminjan. Por, këto kufizime nuk vlejnjë për goranët. Ndërsa romët përveçse janë shpërngulur tërësisht nga shumë vendbanime të Kosovës gjatë dhe pas përfundimit të luftës në Kosovë, ata mund të ndihen të rrezikuar për të lëvizur lirshëm në shumë pjesë të territorit të Kosovës.

Gjatë takimeve me përfaqësuesit e komunitetit serb, pa marrë parasysh në cilat enklava jetojnë dhe përparimin në drejtëm të lirisë së lëvizjes, ata gjithmonë e theksojnë ndjenjën e pasigurisë dhe të frikës kur lëvizin nëpër Kosovë.

Përparimet më të mëdha, në aspektin e lirisë së lëvizjes dhe komunikimit ndëretnik, shihen në rajonin e Gjilanit dhe Vitisë. Serbët në këtë pjesë të Kosovës, lëvizin më shumë, shëtisin rrugëve, vizitojnë dyqane, kryejnë punë në shërbime publike, udhëtojnë, kanë marrëdhënie të ndërsjella, tregtojnë në tregun e gjelbër dhe nxjerrin në shitje prodhimet e tyre. Përmirësimi i situatës vërehet edhe në rajonin e Prishtinës, në një pjesë të mirë në Prizren dhe Pejë, por nuk mund të thuhet e njëjta edhe për rajonin e Gjakovës dhe Mitrovicës.

Megjithatë, në disa pjesë të rajonit të Pejës dhe Prizrenit (komuna e Klinës, Istogut dhe Suharekës) ende nuk ekziston liria e plotë e lëvizjes për pjesëtarët e komunitetit serb dhe rom. Në këto rajone ka pasur edhe sulme fizike ndaj të kthyerve.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, në komunën e Klinës kanë ndodhur disa incidente në të cilat viktimat ishin serbët. Dy herë është gjuajtur me gurë një plakë. Policia e Kosovës i ka gjetur kryesit e veprës. Në rajonin e njëjtë kanë ndodhur edhe plaçkitjet e pronave të serbëve, është plaçkitur dhe pastaj djegur shtëpia e një familje që ishte kthyer në fshatin Petriq. Dy autobusë që bëjnë transportin humanitar të pakicave janë gjuajtur me gurë.⁶⁷

Në komunën e Istogut, gjatë periudhës raportuese, në muajin mars, ka ndodhur një incident në të cilin janë sulmuar të kthyerit e fshatit Zhaç, ndërsa ka edhe shumë raste të uzurpimit të tokave punuese. Kryesuesi i zyrës për komunitete në fshatin Osojan, në komunën e Istogut, ka theksuar se pavarësisht incidenteve të përmendura, liria e lëvizjes në këtë komunë është shumë më e mirë sesa në periudhën e kaluar.⁶⁸

Në rajonin e Prishtinës, në muajin tetor, në rrugën Janjevë – Graçanicë, është rrahur një serb 52 vjeçar, sepse ka drejtuar një veturë me regjistrim të vjetër të Prishtinës. Ai është sulmuar kur është përpjekur të rregullonte një dëm në veturën e tij. Incidenti është paraqitur në Policinë e Kosovës në Graçanicë.

Sulme kanë ndodhur edhe ndaj besimtarëve dhe famullitarëve të Kishës Ortodokse Serbe, të cilët udhëtojnë jashtë manastireve të tyre. Në muajin tetor, në rajonin e Pejës, janë gjuajtur me gurë disa autobusë dhe vetura private të besimtarëve të cilët po ktheheshin nga ceremonia e inaugurimit të Patriarkut Irinej.⁶⁹

Sidoqoftë, situata momentale dhe incidentet jo të rralla në pjesë të ndryshme të Kosovës ndikojnë në vendosmërinë e pjesëtarëve të pakicës serbe për të qëndruar dhe jetuar në këto hapësira dhe kthimin në shtëpitë e tyre.

⁶⁷ Informatat janë marrë nga takimi i mbajtur më 23.11.2010, në komunën e Klinës, me zyrtarin e Zyrës për komunitete.

⁶⁸ Informatat janë marrë nga takimi i mbajtur më 23.11.2010, në komunën e Istogut, me zyrtarin e Zyrës për komunitete në fshatin Osojan.

⁶⁹ Portali i Kishës Ortodokse Serbe, <http://www.spc.rs/sr/>.

Avokati i Popullit konstaton se kërcënimi i dhunës, apo edhe vetë perceptimi i pasigurisë, edhe më tutje janë të pranishme, e kjo dukshëm vështirëson ngritjen e mirëbesimit të pakicës serbe ndaj popullatës shumicë.

4.10.2. Liria e lëvizjes për popullatën shqiptare

Sa i përket situatës së sigurisë në veri të Kosovës, në rajonin e Mitrovicës, ajo vazhdon të jetë e rëndë dhe e paqëndrueshme, edhe gjatë kësaj periudhe raportuese. Shqiptarët dhe pjesëtarët e komunitetit turk, ashkali e egjiptas, kryesisht të tillë që nuk janë serbfolës dhe ortodoksë, nuk mund të qarkullojnë lirshëm në veri të lumit Ibër.

Kjo gjendje vazhdon tani e 11 vjet. Kjo situatë ka sjellë pasoja të rënda për stabilitetin e përgjithshëm të situatës së sigurisë në Republikën e Kosovës. Situata e sigurisë është përkeqësuar sidomos në muajt e fundit, për shkak të vrasjeve të kryera nga bandat e organizuara kriminale në pjesën veriore të Kosovës.⁷⁰ Ky vazhdon ende të paraqet problemin më të madh politik dhe të sigurisë në Republikën e Kosovës. Rreziku kryesor për banorët shqiptarë, në pjesën veriore të Mitrovicës, paraqesin bandat e organizuara kriminale të përkrahura nga Republika e Serbisë⁷¹.

IAP ka shprehur shqetësim, lidhur me çështjen lirisë së lëvizjes, për banorët në veri të Mitrovicës, në lagjen “Kodra e Minatorëve”. Banorët shqiptarë të lagjes së lartcekur janë ankuar, ndër të tjera, edhe për mungesën e lirisë së lëvizjes.⁷² Në këtë rast, liria e lëvizjes është lidhur drejtpërdrejt me të drejtën e lirisë dhe sigurisë, sipas nenit 29 të Kushtetutës. Vështirësitë paraqiten për vijimin e nxënësve në shkolla, sidomos të atyre të klasës së nëntë, shkolla e të cilëve gjendet në pjesën jugore, ndërsa banojnë në pjesën veriore të qytetit. Me po të njëjtat probleme ballafaqohet edhe personeli shëndetësor që punon në këtë lagje. Për shkak të sigurisë, ata punojnë vetëm deri në orën 12:00, kurse pas kësaj kohe, deri në mëngjesin e ditës së nesërme, nuk ka kujdes shëndetësor për banorët shqiptarë.

Po ashtu, liria e lëvizjes si dhe mungesa e sigurisë fizike, ndër të tjera, ishin ankesat kryesore të banorëve shqiptarë të fshatrave Bistricë, Cerajë dhe Koshtovë, në Komunën e Leposaviqit, në takimin me Avokatin e Popullit, më 15 korrik 2010. Këta banorë ankohen se nuk mund të punojnë tokat e tyre, që gjenden përkaj magjistrales Mitrovicë-Leposaviq dhe se nuk mund të udhëtojnë me veturat e tyre me regjistrim të Republikës së Kosovës. E vetmja mënyrë e lëvizjes së tyre në drejtim të qytetit të Mitrovicës është një autobus, shpeshherë vetëm me përcjellje të Policisë së Kosovës. Në qershor të këtij viti, në fshatin Koshtovë kishin hyrë në mënyrë provokative rreth 60 motoçiklistë serbë. Me atë rast gratë dhe fëmijët i kishin lëshuar shtëpitë e tyre.

Për këtë rast Avokati i Popullit ka shprehur shqetësimin, duke iu drejtuar me shkrim ministrit të Administrimit të Pushtetit Lokal dhe ministrit të Punëve të Brendshme, lidhur me situatën e krijuar, për mungesë të lirisë së lëvizjes dhe sigurisë, si dhe për standardin jopërkatës të jetesës.

⁷⁰ Më 7 shtator 2010, në lagjen “Kodra e Minatorëve” në Mitrovicë, para dyerve të shtëpisë së tij, është vrarë qytetari Hakif Mehmeti.

⁷¹ Webfaqja e komunës së Mitrovicës, 6 dhjetor 2010.

⁷² Rasti i paraqitur në IAP.

Shqetësimin e tij, në lidhje me rrezikun e lëvizjes, për banorët shqiptarë e ka shprehur edhe kryetari i Mitrovicës, z. Avni Kastrati, me shkrim, si dhe në takim me Avokatin e Popullit, më 18 mars 2010, me gjithë bashkëpunimin me Policinë e Kosovës, EULEX-in dhe KFOR-in.⁷³

Në vizitën e bashkëpunëtorëve të Avokatit të Popullit, më 1 shtator 2010, në lagjen “Kodra e Minatorëve”, në veri të Mitrovicës, u informua nga vetë banorët shqiptarë për mungesën e sigurisë, kufizimin e lëvizjes, dëmtimin e pronave, sulmet fizike nga grupe të organizuara personash të përkatësisë etnike serbe. Edhe personeli i shkollës, si dhe i ambulancës, në veri të Mitrovicës ishin në gjendje të rëndë.

Edhe nga raportet e zakonshme të zyrtarëve të komunës së Mitrovicës, në lidhje me gjendjen e sigurisë për tremujorin e tretë të vitit 2010, theksi i raportit binte në mungesën e sigurisë, incidentet e shkaktuara nga strukturat serbe në veri të Mitrovicës.⁷⁴

Po këtë shqetësim, në lidhje me mungesën e sigurisë dhe kufizimin e lirisë së lëvizjes, në pjesën veriore të Mitrovicës dhe të Kosovës, e dëshmoi edhe nënkryetari i komunës së Mitrovicës, z. Riza Haziri, në takim in e datës 6 dhjetor 2010, me Avokatin e Popullit, në kuadër të “Javës për të Drejtat e Njeriut”.

Shpërthimet, sulmet fizike, rrahjet dhe rasti i një vrasjeje që ka ndodhur më 7 shtator 2010, e kanë sjellë gjendjen në një pikë kritike dhe padurueshme. Kjo ka bërë mobilizimin për rritjen e sigurisë, duke rritur numrin pikave të lëvizshme të sigurisë.

Problem të një natyre të veçantë vazhdojnë të paraqesin zyrtarët e administratës së UNMIK-ut, në pjesën veriore të komunës së Mitrovicës, të cilët në mënyrë arbitrare dhe politikisht të njëanshme, duke kërkuar ndërprerjen e rregullimit të një rruge të fshatit Vidimiriq, si dhe rrënimin e një shtëpie në këtë fshat, pronë private e një qytetari të Kosovës⁷⁵

4.10.3. Transporti publik i udhëtarëve

Kur flasim për transportin publik dhe transportin e udhëtarëve, mund të themi se ende nuk ka transport urban dhe ndërrurban për të gjithë qytetarët e Kosovës. Transporti publik nuk funksionon në mjediset ku shumicë janë pjesëtarët e komunitetit serb dhe rom. Ata, janë ende të detyruar t'i përdorin minibusët, të cilët bëjnë transportin e udhëtarëve nëpër enklava, si dhe shfrytëzimin e veturave private.

Mbështetje të vetme për transportin publik për serbët dhe romët paraqet i ashtuquajtimi transport humanitar, të cilin e organizon dhe financon Qeveria e Kosovës, funksionon në territorin e Kosovës, ndërsa shërben për udhëtim të këtyre komuniteteve. Pjesëtarët e komunitetit turk, boshnjakë, ashkalinj dhe egjiptas nuk i kanë problemet e sipërpërmendura, lidhur me lirinë e lëvizjes dhe lirshëm e shfrytëzojnë transportin publik.

Në pjesën veriore të Kosovës nuk funksionon as transporti publik dhe as ai privat me regjistrim të Republikës së Kosovës. Ky është një kufizim shumë egër i lirisë së lëvizjes për qytetarët shqiptarë, banorë në pjesën veriore të Kosovës dhe të pjesëve të tjera të Kosovës.

⁷³ Shkresa e komunës së Mitrovicës, nr. 220, datë 20 gusht 2010.

⁷⁴ “Raport për gjendjen e sigurisë, gjatë tre muajve të fundit”, gjendja deri më 8 nëntor 2010.

⁷⁵ Drejtoria për mbrojtje dhe komuna e Mitrovicës shpëtim, “Raport për gjendjen e sigurisë gjatë tre muajve të fundit”, 8 nëntor 2010

Qytetarët shqiptarë ballafaqohen me probleme të lëvizjes me automobila privatë dhe publikë, me regjistrim të Kosovës, në pjesën veriore të Kosovës, që ligjërisht është territor i Republikës së Kosovës. I njëjti kufizim i lirisë së lëvizjes vlen për qytetarët e Republikës së Kosovës, të cilët nuk mund të udhëtojnë me veturat e tyre, me regjistrim të Republikës së Kosovës, në territorin e Republikës së Serbisë. Përkundrazi, në tërë territorin e Republikës së Kosovës pronarët e automjeteve me përkatësi etnike serbe, qofshin qytetarë të Republikës së Kosovës apo të Republikës së Serbisë, lirisht mund të qarkullojnë me tabela e regjistrimit të Republikës së Serbisë, apo edhe me tabela të vjetra, të cilat po që janë të paligjshme i përdorin në mënyrë provokuese.

Mosrespektimi i të drejtës së lirisë së lëvizjes cenon dhe kufizon qasjen në një varg të drejtash ekonomike e sociale, e posaçërisht të drejtën për kujdes shëndetësor, arsimim, mundësi punësimi, qasje në pronë, mbrojtje sociale, qasje në shërbime publike dhe komunale etj.

Nga ajo që u tha më sipër, është obligim i autoriteteve publike, në Kosovë që secilit individ t'ia sigurojë mbrojtjen e të drejtës së lëvizjes, ashtu siç e kërkon ligji. Në këtë drejtim duhet të shtohen përpjekjet në zhvillimin e masave mbrojtëse, të cilat do të jepnin rezultate të dukshme, në mënyrë që të gjithë qytetarët e Kosovës, pa asnjë kufizim të mund ta realizojnë plotësisht të drejtën e lirisë së lëvizjes, që njëherësh do t'i kontribuonte në krijimin e mirëbesimit të të gjithë qytetarëve ndaj institucioneve për mbrojtjen e qetësisë dhe sigurisë.

4.11. E drejta e privatësisë

E drejta e privatësisë drejtë është garantuar me nenin 36 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në nenin 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në kuadër të së cilës përfshihet respekti për të drejtën private dhe për jetën familjare, pacenueshmërinë e banesës, fshehtësinë e korrespondencës, të telefonisë dhe të komunikimeve të tjera.

Më 29 prill 2010, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, nr. 03/L-172. Qëllimi kryesor i këtij ligji është përcaktimi i të drejtave, përgjegjësisve, parimeve dhe masave, lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe të themelojë institucionin përgjegjës për mbikëqyrjen e legjitimitetit të përpunimit të dhënave. Mirëpo, për të drejtën e privatësisë kemi mungesë të një ligji, me të cilin do të krijohej siguri juridike për qytetarët.

Për periudhën e këtij raportimi, 1 janar 2010 - 31 dhjetor 2010, lidhur me të drejtën e privatësisë, në IAP janë pranuar gjithsej 5 ankesa, të cilat kanë të bëjnë me forma të ndryshme të cenimit të kësaj të drejte.

4.11.1. Sigurimi i dokumenteve lidhur me marrjen e shtetësisë

Gjatë vizitës që Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës i bëri homologut të vet, Avokatit të Popullit të Republikës së Maqedonisë, u diskutua lidhur me vështirësitë e disa banorëve të Republikës së Maqedonisë, me prejardhje nga Republika e Kosovës, për t'u pajisur me dokumentin e shtetësisë. Ligji aktual i Republikës së Maqedonisë për shtetësinë, kërkon dokumente shtesë, për personat që aplikojnë për marrjen e shtetësisë në këtë vend. Disa kërkesa të qytetarëve me përkatësi

etnike shqiptare, për marrjen e shtetësisë, ishin refuzuar me arsyetimin e sjelljes së dokumentacionit shtesë.

Lidhur me këtë, Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës ka ofruar shërbime të mira për ankuesit, duke ndihmuar pajisjen me dokumentet e nevojshme në Republikën e Kosovës, me qëllim të respektimit të të drejtave të njeriut, të përcaktuara me standardet ndërkombëtare.

4.11.2. Mënjanimi i zhurmës në vendet publike

Pas ankesave të qytetarëve, IAP ka shprehur shqetësim lidhur me zhurmën e padurueshme për banorët e lagjes “Ganimete Tërbeshi”, në Prishtinë, të cilët janë ankuar se OSBE kishte vendosur aparate për ventilim, që shkaktonin zhurmë të madhe. Ankuesit, më 1 shtator 2010, i ishin drejtuar komunës së Prishtinës.

Pas ndërhyrjes nga ana e përfaqësuesit të IAP-së, në Drejtorinë e Inspektoratit Komunal në Prishtinë dhe Drejtorinë e Urbanizmit në komunën e Prishtinës, është bërë e mundur që administrata e OSBE-së ta bëjë porositjen e aparaturës për ventilim të pazëshëm. Pas intervenimit të Avokatit të Popullit dhe reagimit të shpejtë të komunës së Prishtinës, ky rast është zgjidhur, sipas kërkesës së drejtë të banorëve të lagjes në fjalë.

4.11.3. Pacenueshmëria e banesës dhe e vendbanimit

Një nga format e shprehjes së të drejtës së privatësisë është edhe çështja e pacenueshmërisë së banesës, sipas të cilës garantohet dhe rregullohet e drejta e qasjes dhe e shfrytëzimit të banesës dhe të vendbanimit.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka pranuar ankesën e një qytetari, përgjatë pronës, oborrit, të të cilit kalon një kanal me ujëra të zeza dhe atmosferike të mullirit të Xërxës, i cili paraqet rrezik për jetën dhe shëndetin e anëtarëve të familjes së tij. Rrezik të madh paraqet sidomos për fëmijët, të cilët çdo ditë vijnë në mesimet në shkollën e fshatit, me ç’rast u duhet të kalojnë mbi atë kanal, përmes një ure të improvizuar dhe të pasigurt. Përfaqësuesit e IAP-së e kanë vizituar vendin e ngjarjes. Ndërkaq, lidhur me këtë problem, Avokati i Popullit ka shprehur shqetësimin, duke iu drejtuar me një letër kryetarit të komunës së Rahovecit. Avokati i Popullit ka marrë një përgjigje nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Shërbime Komunale, Kadastër, Gjeodezi, Pronësi në Rahovec, e cila është përgjigjur se në kanalin e hapur, që mbledhë ujërat atmosferike dhe derdhet në Drinin e Bardhë, që kalon edhe nëpër pronën e ankuesit, është i pamundshëm dislokimi në këtë periudhë (përgjigja e datës 27 prill 2010), sepse këto sipërfaqe gjenden jashtë planit zhvillimor urban dhe se dislokimi nuk mund të bëhet derisa të bëhet zgjidhja detaje për këtë kompleks – kanal. Përkundër, shprehjes së shqetësimit tonë përmes letrave dhe tërheqjes së vëmendjes, deri më tani, lidhur me dislokimin e kanalit, ose evitimin e ndotjes, situata ka mbetur e njëjtë.

4.11.4. Kontrolli dhe përgjimi i mjeteve të komunikimit-telefonisë

Gjatë kësaj periudhe raportuese, IAP ka pranuar një ankesë, në lidhje me çështjen e përgjimit. Në përgjithësi, çështja e përgjimit, sidomos e telefonisë mobile në Kosovë nuk është e rregulluar me ligj të veçantë. Në Republikën e Kosovës, ligje në të cilat përfshihen dispozita për përgjimin janë: Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, nr. 03/L 063 dhe Kodi i Procedurës Penale 26/2003.

Duke pasur parasysh këtë fakt, për Avokatin e Popullit shqetësim të veçantë paraqet mosrregullimi ligjor i përgjimit dhe i formave të tjera të kontrollit të bisedave telefonike, si një formë e ndërhyrjes së rëndë në jetën private dhe të korrespondencës. Lidhur me këtë çështje nuk ekziston ndonjë ligj i veçantë, i cili duhet të përmbajë dispozita të qarta e të detajuara të përgjimit dhe të kontrollit. Kjo është e domosdoshme, veçanërisht në epokën e modernizimit teknologjik të mjeteve të përgjimit dhe të kontrollit, që janë gjithnjë e më të sofistikuara.

Gjithashtu, edhe në këtë vit, IAP i ka kushtuar rëndësi të veçantë mbrojtjes së fshehtësisë së korrespondencës, në vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, duke u kujdesur për kutitë postare të IAP-së, në të gjitha vendet në Republikën e Kosovës, ku mbahen personat e tillë, të cilat hapen vetëm nga përfaqësuesit e IAP.

Bazuar në rastet e paraqitura në IAP, si dhe në mangësitë ligjore ekzistuese, në lidhje me të drejtën e privatësisë, Avokati i Popullit rekomandon që:

- *Institucionet publike kompetente, me një seriozitet më të madh të angazhohen për mënjanimin e shkeljeve të së drejtës së privatësisë, në rastet kur ajo është evidente dhe kur kërkohet nga Avokati i Popullit.*
- *Sa më shpejt që të jetë e mundur të miratohen dispozita të veçanta ligjore, të kompletuara, për mbrojtjen e të drejtës së privatësisë në të gjitha format e shprehura të saj.*

4.12. E drejta e martesës dhe familjes

E drejta e martesës dhe familjes janë bazë për krijimin e një shoqërie të shëndoshë dhe në ndërtimin e një shteti. Në bazë të pëlqimit të lirë, çdokush ka të drejtën të martohet dhe të krijojë familje në pajtim me ligjin.⁷⁶ Martesa dhe zgjidhja e saj rregullohen me ligj dhe bazohen në barazinë e bashkëshortëve. Familja gëzon mbrojtje të veçantë nga shteti dhe është rregulluar me ligj.

Martesa nënkupton një bashkësi midis dy personave të gjinive të ndryshme, të regjistruar sipas ligjit, të cilët lirshëm vendosin të jetojnë bashkë dhe të krijojnë familje. Burri dhe gruaja kanë të drejtë të lidhin martesë dhe të formojnë familje pa ndonjë kufizim në bazë të racës, përkatësisë kombëtare apo religjionit, si dhe janë të barabartë gjatë lidhjes së martesës, vazhdimit dhe zgjidhjes së saj.⁷⁷

Parimet bazë që rregullojnë të drejtat e detyrimet e ndërsjella të bashkëshortëve janë barazia e bashkëshortëve në përfitimin e të drejtave dhe marrjen përsipër të detyrimeve gjatë martesës,

⁷⁶ Kushtetuta e Republikës së Kosovës neni 37.

⁷⁷ Ligji për familjen i Kosovës, nr. 32/2004 neni 14.

respektimi i të drejtave të njeriut brenda lidhjes martesore, si dhe bashkëpunimi në interes të familjes dhe të bashkëjetesës.

Sipas KEDNJ-së, bashkëshortët gëzojnë barazinë e të drejtave dhe të përgjegjësisve me karakter civil midis tyre edhe në marrëdhëniet me fëmijët e tyre gjatë lidhjes bashkëshortore dhe pas zgjidhjes së saj. Kjo e drejtë përfshin edhe detyrimin e shtetit për ta respektuar këtë të drejtë dhe për të siguruar mekanizma për mbrojtje të saj. Ky nen nuk i pengon shtetet të marrin masat e nevojshme në interes të fëmijëve.⁷⁸

KEDNJ shprehimisht kërkon që çdo personi “*t’i respektohet jeta e tij private dhe familjare*”. Autoritetet publike nuk mund të ndërhyjnë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveç kur kjo është parashikuar me ligj, dhe kur është e domosdoshme për arsye të sigurisë kombëtare dhe publike, për mirëqenien ekonomike të vendit për mbrojtjen e rendit ose për parandalimin e veprave penale.⁷⁹

Në periudhën raportuese, sikurse është vërejtur edhe në raportet e mëhershme, vërehet një tendencë rritjeje e numrit të shkurorëzimeve në Kosovë. Në rastin e shkurorëzimeve lindin probleme rreth kujdestarisë së fëmijëve të mitur, si dhe kontaktit të prindërve me fëmijët. Kjo dëmton fëmijët, të cilët pa fajin e tyre ndodhen në situata kur duhet të jetojnë ndaras nga njëri prind, veçanërisht kjo ndikon negativisht në zhvillimin, edukimin dhe mirëqenien e tyre.⁸⁰

Avokati i Popullit edhe gjatë kësaj periudhe të raportimit ka pranuar një numër të madh të ankesave që kanë të bëjnë me zvarritjen e procedurave lidhur me shkurorëzimin, për mosrealizimin e kontakteve të rregullta më fëmijë, si dhe me zvarritjen e procedurave për të vendosur përkitazi me të drejtat e besimit të fëmijëve.

Avokati i Popullit, gjatë kësaj periudhe ka publikuar një raport që ka të bëjë me zvarritjen e procedurës së ekzekutimit të një vendimi të plotfuqishëm nga Gjykata lidhur me kontaktet personale të nënës me fëmijët e saj të mitur. Pas shqyrtimit të këtij rasti, Avokati i popullit ka ardhur në përfundim se ka pasur shkelje të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor.⁸¹ Zvarritja e procedurës gjyqësore dhe mosekzekutimi pas parashtrimit të propozimit për ekzekutim nga ankuesja, është në kundërshtim me parimet e sundimit të ligjit, qeverisjes së mirë dhe me respektimin e të drejtave të njeriut. IAP përkujton se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka vendosur se e drejta për gjykim të drejtë dhe e drejta që të procedohet sipas parashtrimit të kërkesës në afatin e arsyeshëm kohor, paraqet pjesë të së drejtës për një procedim adekuat gjyqësor, i cili është i garantuar me nenin 6 të KEDNJ.⁸²

Institucioni i Avokatit të Popullit, në Kosovë është i brengosur për dështimin e gjykatave për të kërkuar këshilla nga ekspertët e Qendrave për Punë Sociale (QPS), në rastet kur ekspertiza e tyre është qenësore dhe është kërkesë ligjore, garantuar edhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat

⁷⁸ KEDNJ, Neni 5 i Protokollit nr. 7.

⁷⁹ *Po aty*, neni 8.

⁸⁰ Informata të siguruar nga Departamenti i Mirëqenies Sociale në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), me datë 20 dhjetor 2010. Numri i përgjithshëm i kërkesave për prishjes së kurorës, prishjes së martesës, gjatë kësaj periudhe në tërë Kosovën është /559 raste, ndërsa i fëmijëve nga këto raste 262 fëmijë të mitur. Nga ky numër i paraqitjes së kërkesave të rasteve një numër i tyre nuk kanë fëmijë, ndërsa shumica e kërkesave nga rastet e paraqitura të shkurorëzimeve kanë fëmijë të mitur. Numri i përgjithshëm i ndarjeve brenda kësaj periudhe raportuese është 95, ndërsa i fëmijëve të mitur nga këto raste është 122. Numri i paraqitur i fëmijëve të mitur nga këto ndarje është brengosës për tërë shoqërinë kosovare.

⁸¹ *Raporti A. 485/2009*.

⁸² *Rasti Golder v. The United Kingdom*, Publ. A 018, m; 21.02.1975.

e njeriut.⁸³ Avokati i Popullit gjithashtu është i brengosur edhe me dështimet e QPS-së për t'u përgjigjur brenda kohës së arsyeshme kërkesave të gjykatës për këshillë profesionale.

Në kontekst të drejtës martesore dhe familjare, është edhe çështja e adoptimit (birësimit). Avokati i Popullit në këtë periudhë raportuese nuk ka marrë asnjë ankesë, lidhur me këtë çështje. Por, sipas një raporti të OSBE-së, shihet se procedurat gjyqësore që kanë të bëjnë me adoptimin, zbulojnë shumëllojshmëri konfuze të praktikave. Birësimet nuk gjykohen ekskluzivisht nga gjykatat, ashtu siç parashihet me Ligjin për Familjen. Shumica e birësimeve sot gjykohen nga organet administrative, nga QPS-të.⁸⁴

Ligji për Familjen nuk bënë dallim ndërmjet procedurës që duhet të ndiqet në rast të fëmijës së braktisur dhe procedurës që duhet të ndiqet në rast të fëmijës prindërit e të cilit janë të njohur (përveç pjesëve të veçanta lidhur më atë se si duhet të inicohet kërkesa për birësim).⁸⁵

Roli gjykues i QPS-ve dhe vendimmarrës i panelit për vendosjen e fëmijës në rastet e birësimit të fëmijëve, përbën shkelje të ligjit vendor dhe ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Nëse ekspertiza e këtyre organeve administrative është e rëndësishme për ta përmbushur funksionin e ndihmës profesionale për gjykatat në rastet e birësimeve, nuk mund ta arsyetojë uzurpimin e funksionit gjyqësor, që është i rezervuara për gjyqësorin, bazuar në Ligjin për Familjen në fuqi.

Sipas Ligjit për familjen, ekzistojnë dy çështje kyçe procedurale shqetësuese në rastet e birësimit të gjykuara nga gjykatat, siç është paraparë në Ligjin për Familje. Së pari, çështja e nivelit të gjykatave me juridiksion origjinal mbi procedurat e birësimit. Së dyti, çështja ligjit procedural që duhet të zbatohet në procedurat e birësimit. Mungesa e qartësisë lidhur me këto çështje dëmton efikasitetin e gjykatave që gjykojnë këto raste. Ligji për Familjen nuk specifikon se a do të jetë gjykata komunale apo ajo e qarkut, kompetente me juridiksion të shkallës së parë në rastet e birësimit. Disa gjykata komunale janë shpallur inkompetente në rastet e kërkesave të birësimit të parashtruara te ato për shkak të mungesës së juridiksionit.

Veç kësaj, Ligji për Familjen nuk e specifikon se cilin ligj procedural duhet ta zbatojë gjykata në rastet e birësimit. Prandaj në mungesë të udhëzuesve të veçantë, disa gjykata komunale zbatojnë Ligjin për Procedurën Jokontestimore (LPJK) dhe të tjerat zbatojnë Ligjin për Procedurën Kontestimore (LPK).⁸⁶

Sipas Ligjit për Familjen, vetëm gjykatat mund të gjykojnë birësimet. QPS-të mundën të ndihmojnë në rastet e birësimeve me dhënien e mendimeve dhe këshillave nga ekspertet në rastet e kërkesave nga gjykatat gjatë marrjes së vendimit mbi adoptimin.

Si përfundim, korniza ligjore në Kosovë parasheh që birësimet të gjykohen nga gjykatat. Kur organet administrative vazhdojnë të vendosin birësimet përkundër mungesës së mandatit ligjor, sundimi i ligjit zbehet në masë të madhe.

⁸³ *Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve (KDF)*, neni 12, para. 2, parasheh që fëmijës i jepet mundësia që të dëgjohet në çdo procedurë gjyqësore.

⁸⁴ Shih *Raporti i Misionit të OSBE-së në Kosovë*, gusht 2010.

⁸⁵ *Ligji për Familjen*, neni 182.

⁸⁶ *Raporti i OSBE-së*, gusht 2010. OSBE ka hasur gjatë monitorimit të gjykatave e sidomos duke i ndjekur procedurat e birësimit (adoptimit) nga gjykatat në Kosovë.

Rekomandime

- *Avokati i Popullit konsideron se Kuvendi i Kosovës duhet të ketë parasysh ndryshimin e normave në pjesën e pestë të Kapitullit të dytë të Ligjit për Familjen, për të ofruar më shumë qartësi në rregullimin në fushën e birësimeve dhe për qartësimin e juridiksionit gjatë aplikimit të procedurave;*
- *Avokati i Popullit rekomandon që Instituti Gjyqësor duhet të vazhdojë me organizimin e trajnimeve specifike për gjykimin e rasteve që trajtojnë çështjet familjare, sidomos ato që kanë të bëjnë shkurrëzimin dhe adoptimin, me përqendrim të veçantë në kushtet e parapara me Ligjin për Familjen dhe rolin këshillëdhënës të qendrave për punë sociale.*

4.13. Liria e besimit, ndërgjegjes dhe fesë

Kushtetuta e Kosovës dhe Ligji për të Drejtat dhe Liritë Fetare në Kosovë garantojnë respektimin e lirive fetare dhe lirinë e manifestimit të fesë. Barazia e bashkësive fetare, karakterizimi si shtet laik dhe pamundësia e promovimit të fesë shtetërore është theksuar në nenin 8 të Kushtetutës. Gjithashtu, Kushtetuta e Kosovës u jep përparësi instrumenteve ndërkombëtare, në rast konflikti me normat vendore.⁸⁷

4.13.1. Analiza e gjendjes në Kosovë

Gjatë viti 2010, theks i veçantë është vënë në mosekzistimin e dispozitave ligjore, me të cilat do të rregullohej çështja e pozitës juridike të bashkësive fetare në Kosovë. Në vazhdimësi bashkësitë fetare në Kosovë, si Bashkësia Islame e Kosovës, ashtu edhe Bashkësia e Kishës Ungjillore e Kosovës, e kanë potencuar nevojën për nxjerrjen e dispozitave ligjore me të cilat do të rregullohej kjo lëmi.

Më 29 prill 2010, Avokati i Popullit, sipas detyrës zyrtare dhe në bazë të informacioneve që ka marrë pas takimit me myftiun e Bashkësisë Islame të Kosovës, ka hartuar raportin lidhur me mungesën e akteve ligjore me të cilat do të zgjidhej pozita dhe statusi juridik i bashkësive fetare në Kosovë.⁸⁸

Në të vërtetë, para vitit 1999, statusi juridik i bashkësive fetare në Kosovë ishte i rregulluar me ligj.⁸⁹ Pas vitit 1999, në Kosovë nuk janë nxjerrë dispozita ligjore që e rregullojnë këtë lëmi. Me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/22, bashkësive fetare në Kosovë u është rekomanduar që të regjistrohen si organizata joqeveritare. Kjo rregullore është në kundërshtim me Ligjin për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare, sepse “Ky ligj nuk vlen për parti politike, sindikata dhe organizatat sindikale si dhe as për qendra të besimit fetar apo faltore dhe fusha tjera që rregullohen me ligje të veçanta”.⁹⁰

⁸⁷ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008, neni 19, par. 2.

⁸⁸ Shih Raporti i Avokatit të Popullit, ex-officio nr. 145/2010.

⁸⁹ Ligji për Statusin Juridik të Bashkësive Fetare, Gazeta zyrtare e RFPJ- nr. 22/1953” dhe “ Gazeta zyrtare e RSS nr. 44/1977”.

⁹⁰ Ligji për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare , Neni 1, par. 2..

Në vitin 2006 është miratuar Ligji për Liritë Fetare në Kosovë.⁹¹ Megjithatë, ky ligj, edhe pse i rregullon çështjet e lirive dhe të drejtave fetare në mënyrë të drejtë dhe në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare, për fat të keq nuk përmban dispozita për rregullimin e statusit juridik të bashkësive fetare.

Mungesa e legjislacionit në këtë fushë hap një numër të madh çështjesh, si psh. rregullimi i çështjeve pronësore (të luajtshme dhe të paluajtshme), llogarive bankare, ndërtimi i objekteve dhe realizimi i të drejtave tjera të cilat do t'u mundësoheshin bashkësive fetare, ashtu siç u është mundësuar organizatave dhe shoqatave të tjera të cilave u është dhënë statusi i personit juridik.

Përveç problematikës juridike e cila ka ardhur për shkak të rekomandimit që bashkësitë fetare ta rregullojnë statusin juridik si organizatat joqeveritare në kuadër të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/22, bashkësitë fetare vihen në pozitë të palakmueshme, sepse me këtë rekomandim injorohet vazhdimësia dhe rëndësia e tyre kulturore, tradicionale dhe historike.

Gjithashtu, mosrregullimi ligjor i kësaj fushe, tek bashkësitë fetare të ndryshme krijon një bindje se disa bashkësi fetare gjenden në pozitë më të mirë apo më të keqe se të tjerat se janë të diskriminuara. Me të drejtë vërehet diskriminimi që atyre u bëhet në raport me Kishën Ortodokse Serbe, e cila, falë “diskriminimit pozitiv”, si rezultat i marrëveshjeve politike, është e vetmja bashkësi fetare në Republikën e Kosovës që gëzon statusin e personit juridik. Kjo thëllon edhe më shumë hendekun, i cili në njëfarë mënyre ekziston ndërmjet bashkësive fetare në Kosovë, dhe nuk e favorizon mirëqenien e shoqërisë multietnike dhe multikonfesionale.

Lidhur me këtë çështje, me qëllim të plotësimit të boshllëkut ligjor në këtë fushë, Avokati i Popullit më 7 korrik 2010, i ka rekomanduar Kuvendit të Kosovës që të plotësojë Ligjin për Lirinë Fetare në Kosovë, nr. 02/L-31, me një kapitull shtesë, i cili do të rregullonte pozitën juridike të bashkësive fetare në Kosovë, apo të nxjerr një ligj të veçantë, i cili rregullon pozitën juridike të bashkësive fetare në Republikën e Kosovës. Deri më 31 dhjetor 2010, rekomandimi i Avokatit të Popullit nuk është marrë parasysh dhe nuk janë nxjerrë dispozita ligjore që do ta rregullonin këtë fushë.

4.13.2. Bashkësitë fetare në Kosovë

Me Kushtetutën e Kosovës dhe me Ligjin për Liritë Fetare, me qëllim të ruajtjes së multikonfesionalizmit, çështja e respektimit të lirive fetare është rregulluar në hollësi.

Feja Islame në Kosovë ka numrin më të madh të besimtarëve, ndërsa besimtarët janë kryesisht shqiptarë, boshnjakë, goranë, turq, romë, ashkalinj dhe egjiptas. Kisha Ortodokse Serbe, sipas numrit të besimtarëve, është e dyta për nga madhësia. Besimtarët e saj janë kryesisht të komunitetit serb dhe malazez. Kisha katolike në Kosovë, që është e treta për nga madhësia, përbëhet kryesisht nga besimtarë të komunitetit shqiptar. Besimtarët e Kishës Protestante Ungjillore, janë po ashtu kryesisht të komunitetit shqiptar dhe është e katërta për nga madhësia.

Gjatë vitit 2010, Avokati i Popullit, po ashtu ka tërhequr vëmendjen edhe për problemin e bartjes së shamive në shkollat fillore dhe të mesme në Kosovë. Më 17 mars 2010, Avokati i Popullit ka mbajtur një konferencë për shtyp, me rastin e refuzimit të organeve komunale për arsim në Viti për

⁹¹ Ligji për Liritë Fetare në Kosovë, nr. 2/L-31

të respektuar dhe ekzekutuar vendimin e datës 17 nëntor 2009, të Gjykatës së Qarkut në Gjilan në lidhje me këtë çështje.

Gjatë muajve maj dhe korrik të vitit 2010, organizata të ndryshme joqeveritare kanë organizuar protesta me qëllim të shprehjes së mospajtitimit për mohimin e të drejtave të nxënësve të cilat bartin shami edhe gjatë qëndrimit në shkollë.

Për besimtarët e Kishës Ortodokse, ngjarja më e rëndësishme ka qenë inaugurimi i Patriarkut Irinej në Patrikanën e Pejës, më 3 tetor 2010. Për fat të keq, kjo ngjarje me gjithë përpjekjet për organizimin të jashtëzakonshëm, nuk kaloi pa provokime të dyanshme. Derisa vetë Patriarku Irinej kërkonte nga komuniteti ndërkombëtar mosnjohjen e pavarësisë së Republikës së Kosovës, Policia e Kosovës nuk e lejoi hyrjen e zyrtarëve politikë të Republikës së Serbisë në Kosovë. Policia e Kosovës, po ashtu arrestoi tre persona sepse kishin gjuajtur me gurë tre autobusë me besimtarë ortodoksë,⁹² të cilët ktheheshin nga Peja.⁹³

Në tërë Kosovën, me rastin e shkuarjes së besimtarëve ortodoks në varrezat autoqefale, për festën dimërore të Shën Mitrit, më 6 nëntor 2010, kanë ndodhur disa incidente. Ndaj autobusëve të cilët ishin me përcjellje të KFOR-it austriak dhe Policisë së Kosovës, të cilët udhëtonin në drejtim të varrezave në fshatin Mushtisht të komunës së Suharekës, është gjuajtur me armë automatike por fatmirësisht nuk ka pasur të lënduar.⁹⁴

Gjithashtu, më 6 nëntor 2010, me rastin e shkuarjes për festat përkujtimore në varreza në Deçan, besimtarët kanë vërejtur se një numër i madh i varreve ishte dëmtuar në periudhën pas datës 28 gusht 2010 kur është organizuar vizita e fundit në varrezat e Deçanit.⁹⁵

Krahas inaugurimit të patriarkut Irinej, ngjarje e rëndësishme është edhe kurorëzimi i peshkopit Teodosije, të Rashkës dhe Prizrenit, më 26 dhjetor 2010 në selinë e Peshkopatës Rashkë-Prizren, në kishën e Shën Gjergjit në Prizren. Në aktin e përirimit morën pjesë mbi njëmijë besimtarë nga vise të ndryshme. Pas ceremonisë së kurorëzimit, besimtarët e mbledhur, në mënyrë të organizuar kanë shëtitur nëpër rrugët kryesore të Prizrenit. Gjatë ceremonisë së kurorëzimit dhe shëtitjes nëpër qytet, nuk ka pasur probleme dhe provokime të mëdha.⁹⁶

Kisha Katolike e Kosovës është e organizuar si administratë apostolike në Prizren. Pjesëtarët e kishës katolike i përkasin nacionalitetit shqiptar por ekziston edhe bashkësia e komunitetit kroat, të cilët kryesisht janë të koncentruar në vendet si Janjeva dhe Letnica. Kishat katolike ekzistojnë në tërë Kosovën, janë gjithsej 24 famulli në të cilat shërbejnë 37 famullitarë dhe 79 motra nderi.⁹⁷

Ngjarja më e rëndësishme e Kishës Katolike në Kosovë gjatë vitit 2010 ishte shukurimi i katedrales Nëna Terezë në Prishtinë, ku morën pjesë disa mijëra besimtarë.

Pjesëtarët e Kishës Protestante Ungjillore të Kosovës, si problemin më të madh gjatë vitit 2010 e kanë theksuar mungesën e legjislacionit për rregullimin e statusit juridik dhe sulmet dhe bezditë e shumta që ata i kanë përjetuar.

⁹² Shih: <http://www.SETimes.com>, 04.10.2010.

⁹³ http://www.spc.rs/sr/eparhija_raskoprizrenska_izrazava_protest_nezadovoljstvo_zbog_odsustva_medjunarodne_osud_e_napada_na.

⁹⁴ <http://www.naslovi.net/2010-11-06/blic/kosovo-zadusnice-uz-pucnjavu/2097655>, 02.12.2010.

⁹⁵ <http://www.naslovi.net/2010-11-06/s-media/zadusnice-uz-pucnjavu/2097562>, 02.12.2010.

⁹⁶ http://www.spc.rs/sr/uz_prizrenu_svecano_ustolicen_novoizabrani_episkop_raskoprizrenski_g_teodosije, 05.01.2011.

⁹⁷ <http://www.kishakatolike.org/>, 05.01.2011.

Problemet më të mëdha sa i përket pozitës së parregulluar juridike janë: pamundësia e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme në emër të Kishës Protestante Ungjillore të Kosovës dhe refuzimi i të drejtës për ndërtimin e kishave protestante nëpër Kosovë. Problem të madh paraqet edhe kundërshtimi i të drejtës për formimin e varrezave të veçanta për besimtarët e kishës protestante në qytete të ndryshme të Kosovës. Si pasojë, besimtarët e kësaj kisha janë të detyruar që të bëjnë varrimin në varrezat myslimane, me çka u cenohet e drejta për të shprehur besimin e tyre dhe manifestuar ritet fetare.⁹⁸

Një nga ngjarjet më shqetësuese për besimtarët e Kishës Protestante ka ndodhur më 19 mars 2010, kur në dritaret e Kishës Protestante Ungjillore të Kosovës janë vërejtur pllakate të ngjitura, që shprehnin protestë kundër priftërinjve të Kishës Katolike. Këshilli Ministror i Kishës Protestante Ungjillore ka kërkuar që të arrestohen kryesit e kësaj vepre, dhe ata nuk do të pranojnë që besimtarët protestantë të bien viktimë e këtij konfuzioni.

Gjithashtu, në natën ndërmjet 23 dhe 24 mars 2010, persona të pidentifikuar kanë sulmuar Kishën Ungjillore të Mesisë në Prishtinë. Kjo kishë ndodhet në rrugën “Nazim Gafurri”. Gjatë këtij sulmi janë thyer xhamat e dritareve por e gjitha ka kaluar pa dëme në njerëz. Gjithashtu, nuk ishte vjedhur asgjë nga inventari.⁹⁹

Sipas të dhënave nga portali zyrtar i Kongresit Evropian të Hebrenjve,¹⁰⁰ në Kosovë nuk ekziston bashkësia fetare e hebrenjve, por sipas origjinës diku rreth 40 persona nga dy familje në Prizren kanë rrënjë hebraike. Nuk ka të dhëna për ndonjë sinagogë apo ndonjë institucion tjetër hebraik.

4.14. Liria e shprehjes

Liria e shprehjes, e garantuar me nenin 40 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përbën njërin nga gurët bazë të shoqërisë demokratike. Subjekt i lirisë së shprehjes nuk janë vetëm informatat ose idetë të cilat pranohen në mënyrë jo ofensive ose indiferente por edhe ato që shpesh shqetësojnë dhe shokojnë.¹⁰¹

Avokati i Popullit thekson se kjo e drejtë, me gjithë detyrimet që kanë autoritetet publike në Kosovë për të interpretuar në pajtim me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ende vazhdon të mbetet më tepër një dekor i sistemit juridik.

Në praktikë ekziston një perceptim i përgjithshëm se nuk ka një debat të hapur, lidhur me çështjet që konsiderohen të jenë thelbore në interesin publik. Autoritetet duket se më shumë e trajtojnë këtë të drejtë si një çështje të kompetencës së tyre, sesa si një të drejtë themelore.

Avokati i Popullit konstaton se Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, inkurajon të gjitha vendet të promovojnë të drejtat e njeriut, duke aprovuar instrumente specifike nacionale që japin mbrojtje shtesë, duke përfshi edhe marrëveshjet ndërkombëtare. Mekanizmat ligjorë në fuqi në Republikën e Kosovës, në shumicën e rasteve dështojnë të përmbajnë dispozita ndëshkuese për mosrespektimin e të drejtave në këtë fushë. Edhe në rastet kur me instrumente ligjore obligohen të

⁹⁸ http://www.kishaprotestante.net/index.php?option=com_content&view=article&id=183&Itemid=163&lang=en, 05.01.2011.

⁹⁹ <http://www.kishaprotestante.net>, 05.01.2011.

¹⁰⁰ http://www.eurojewcong.org/ejc/section.php?id_rubrique=72#, 05.01.2011.

¹⁰¹ Vendimi i Gjykatës Evropiane, “Giniewski v. France”, i 31 janarit 2006, § 43.

nxjerrin akte nënligjore për zbatim të ligjit, dështojnë t'i nxjerrin ato brenda një kohe të arsyeshme ose fare nuk i nxjerrin.¹⁰²

Një numër i shteteve demokratike sot kanë kaluar nga sistemi tradicional i sekretit zyrtar tek regjimi i lirisë së informacionit zyrtar. Republika e Kosovës duhet të miratojë instrumente të tjera ligjore shitesë që mundësojnë dhe sigurojnë administrimin e “qeverisë së hapur”, që nënkupton se informacioni është “publik”, nëse ai mbahet dhe menaxhohet nga autoritetet publike, ose nëse është pranuar, hartuar dhe miratuar nga ato autoritetet dhe është i dedikuar për publikun.

Komisioni Evropian, kritikoi ndaj Kosovës edhe kësaj radhe i fokuson kryesisht në mungesën e lirisë së shprehjes, ku thuhet se *në Kosovë nuk është e garantuar në praktikë liria e shprehjes*.

Gjatë vitit 2010, IAP, nuk ka pasur ankesa në lidhje me shkeljen e kësaj të drejte.

4.15. E drejta e qasjes në dokumente publike

E drejta e qasjes në dokumente publike, është e drejtë e garantuar me nenin 41, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Kjo e drejtë, që shpreh shkallën e zhvillimit të demokracisë së një vendi, po ashtu është e paraparë në nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

Duke pasur parasysh mangësitë e Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare, nr. 2003/12, si dhe në mënyrë që të bëhet harmonizimi me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe standardet ndërkombëtare, Kuvendi i Kosovës, në tetor të vitit 2010, miratoi Ligjin për Qasje në Dokumente Publike, nr. 03/L-215.

Në mënyrë që ligji i ri të evitonte mangësitë e ligjit paraprak, si dhe t'i përshtatet realitetit në Kosovë, është inkurajues fakti që në grupin punues për hartimin e ligjit të ri, janë përfshirë përfaqësuesit e Avokatit të Popullit, shoqërisë civile, si dhe të organizatave ndërkombëtare.

Edhe pse lidhur me zbatimin e ligjit paraprak dhe të udhëzimeve administrative përkatëse janë organizuar një sërë fushatash për vetëdijesim, nga institucionet qendrore, organizatat ndërkombëtare dhe shoqëria civile, Institucioni i Avokatit të Popullit kishte evidentuar një sërë parregullsish, si dhe një shkallë të ulët të zbatimit të këtij ligji. Vërejtjet kryesore kishin të bënin me mospërputhjen midis ligjit në fjalë dhe udhëzimeve administrative, mosmbajtja e regjistrave të detyrueshëm nga institucionet publike, krijimi i pozitave të personave përgjegjës në institucione publike për trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike.

Avokati i Popullit rekomandon krijimin e zyrave apo pozitave gjegjëse në institucionet publike, për trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike, ashtu siç është paraparë me ligj.

Institucioni i Avokatit të Popullit edhe këtë vit, ka pranuar numër të pakët të ankesave. Numër po ashtu të vogël të kërkesave për realizimin e kësaj të drejte ka pranuar edhe Zyra e Kryeministrit.¹⁰³

E drejta për qasje në dokumentet publike u është mohuar edhe vetë përfaqësuesve të Avokatit të Popullit gjatë zhvillimit të hetimeve.

¹⁰² Shih Ligji civil kundër shpifjes dhe fyerjes, nr. 2006/02-L65; Ligji për Komisionin e pavarur për media dhe transmetim, nr. 2005/02-L15.

¹⁰³ Bazuar në të dhënat e Zyra Këshillëdhënëse për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabartë dhe Çështje Gjinore (ZQM), gjatë vitit 2010 janë pranuar vetëm 8 kërkesa.

Me qëllim të zhvillimit të hetimeve, përkritazi me ankesën e një grupi të qytetarëve, lidhur me zbatimin e Ligjit kundër zhurmës, më 25 tetor 2010, përfaqësuesja e Avokatit të Popullit ka parashtruar kërkesën për qasje në rregulloren e brendshme të zyrës ligjore të komunës së Prishtinës. Mirëpo, me gjithë mandatin e Institucionit e Avokatit të Popullit (IAP), si dhe të drejtës për qasje në dokumente publike, kjo e drejtë iu mohua. Një veprim i tillë, që bie ndesh me Ligjin për Qasje në Dokumente Zyrtare, tregon haptazi mosgatishmërinë e zyrtarëve komunalë për zbatimin e këtij ligji. E nëse një zyrtar i IAP ballafaqohet me probleme të tilla, si institucion i mandatar për zbatimin e këtij ligji, mund të merret me mend se me çfarë vështirësish ballafaqohen qytetarët, për realizimin e të drejtës së tyre për qasje në dokumente publike. Njëkohësisht, kjo është edhe një dëshmi për nivelin e ulët të zbatimit të ligjit në Kosovë.

Avokati i popullit rekomandon një fushatë ndërgjegjësimit dhe informimi të administratës publike, përkritazi me përgjegjësinë ligjore për sigurimin e qasjes së papenguar në dokumentet publike, për të gjitha palët e interesuara, si dhe për rolin e IAP-së në zbatimin e këtij ligji.

Çështja e qasjes në dokumente zyrtare, si dhe mungesa e transparencës, mbeten ndër problemet kryesore, me të cilat vazhdojnë të ballafaqohen, sidomos gazetarët kosovarë, gjatë punës së tyre. Ata përballen me probleme të mëdha, sidomos, kur kërkojnë informata, lidhur me tenderët. Atyre, në të shumtën e rasteve, nuk u jepen dokumentet dhe informacionet e kërkuara.¹⁰⁴

Sipas Nenit 4.3 të Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare, Qeveria e Kosovës duhet të hartojë listën e dokumenteve që do të trajtoheshin si të ndjeshme, me qëllim të mbrojtjes së interesit publik. Mirëpo, Qeveria e Kosovës, që nga viti 2003, ende nuk e ka hartuar një listë të tillë.

Edhe pse neni 10 i Ligjit për Qasje në Dokumentet Zyrtare, parashihte mbajtjen e regjistrave të dokumenteve publike, shumë nga institucionet publike nuk kanë regjistra të tillë. Asnjë nga komunat e Kosovës apo ministritë, nuk ka publikuar, në uebfaqet e tyre zyrtare regjistrin e dokumenteve publike.¹⁰⁵

Gjatë vitit 2010 është miratuar Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale, nr. 2010/03-L-172. Mirëpo, qytetarët e Kosovës nuk janë, apo janë fare pak të informuar, për të drejtat e tyre, në lidhje me mbrojtjen e të dhënave të tyre personale.¹⁰⁶ Edhe pse ligji është miratuar më 29 prill 2010, institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ende nuk është formuar.

Institucioni i Avokatit të Popullit konkludon se ligji paraprak nuk ka qenë i zbatueshëm, në mënyrë të kënaqshme. Andaj, mbetet sfidë, si dhe kërkesë për institucionet e Kosovës *zbatimi i ligjit të ri në përputhje me standardet ndërkombëtare, miratimi i legjisllacionit sekondar përkatës, krijimi i zyrave dhe pozitave të personave përgjegjës, sipas ligjit, si dhe organizimi i fushatave të vetëdijesimit për zyrtarët publikë dhe qytetarët, në përgjithësi.*

¹⁰⁴ Hulumtim, "Gazetarët dhe Qasja në Dokumente Zyrtare", Asociacioni i Gazetarëve Profesionistë të Kosovës (AGPK).

¹⁰⁵ GAP, Analizë Politikash Parlamentare, Qasja në Dokumente Publike.

¹⁰⁶ Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Kosovën 2010.

4.16. *Liria e mediave*

Përveç garantimit që ofron sistemi juridik në Kosovë, në mënyrë të veçantë Kushtetuta e Republikës së Kosovës,¹⁰⁷ lidhur me lirinë e mediave, ajo vazhdon të mbetet një nga problemet më shqetësuese në shoqërinë tonë.

Një prej çështjeve që vazhdimisht është ngrit në raportet e ndryshme mbi Kosovën është pavarësia e mekanizmave mediatikë të pavarur dhe infrastruktura ligjore adekuate,¹⁰⁸ në fushën e lirisë së mediave.

Avokati i Popullit vëren se çështja e pasigurisë ligjore lidhur me përfshirjen e shpifjes dhe fyerjes në kodin penal, krijon zbrazëti juridike. Edhe pse kjo çështje ka mbetur të korrigjohet pas ndryshimeve që do t'i bëhen Kodit Penal, vetë fakti i ekzistimit të saj në këtë kod paraqet shqetësim të arsyeshëm.

Përveç zbrazëtisë juridike dhe mungesës së pavarësisë adekuate të mekanizmave, si Komisioni i Pavarur për Media (KPM), Avokati i Popullit, është shumë i shqetësuar edhe me faktin e ushtrimit të dhunës ndaj gazetarëve. Në maj të vitit 2010, janë evidentuar kërcënime ndaj Flaka dhe Veton Surroit, që përfaqësojnë gazetën “Koha Ditore” dhe televizionin “Kohavision”.

Në shtator të vitit 2010, një ekip gazetarësh i stacionit televiziv “Klan Kosova” është sulmuar dhe mbyllur në mënyrë të paligjshme në një klasë të shkollës “Gjon Serreqi” në Ferizaj, nga vetë drejtori i shkollës. Po në këtë muaj, një ekip i shtëpisë së mediave “Koha” është mbajtur në mënyrë të paligjshme në stacionin e policisë në Deçan nga një toger i Policisë së Kosovës. Gjatë po kësaj periudhe është kryer sulmi me mjet shpërthyes në shtëpinë e kryeredaktorit të Radio Mitrovicës në gjuhën serbe, C. Milisavleviq në Zveçan.

Në nëntor të vitit 2010, është regjistruar kërcënimi ndaj drejtorit të përgjithshëm të TV “Klan Kosova” z. Baton Haxhiu, nga ana e përfaqësuesit të një partie politike në Republikën e Kosovës, përkatësisht i Lidhjes Demokratike të Dardanisë. Një rast tjetër për të cilin ka reaguar organizata ndërkombëtare për mbrojtjen e gazetarëve “Reporterët pa Kufij”, është kërcënimi dhe largimi nga puna e gazetares se Agjencisë se Pavarur të Lajmeve “Kosovapress”, znj. Sabahate. Shala.

Të gjitha rastet e përmendura më lart janë dëshmi e qartë për gjendjen e rëndë të ambientit politik, shoqëror dhe të sigurisë në të cilin punojnë gazetarët, dhe e degradimit të lirisë së shprehjes dhe të mediave.

Në Indeks in e Lirisë së Shtypit në botë për vitin 2010, të Organizatës “Reporterët pa Kufij”, Kosova është radhitur në vendin e 92, për dallim nga viti i kaluar ku renditej në vendin e 75. Rënia e lirisë së shprehjes në vendin tonë për 17 vende brenda një viti, është një dëshmi tjetër dhe pasqyrë e qartë se si shihet Republika e Kosovës nga komuniteti ndërkombëtar në këtë fushë. Pra, vërehet një përkeqësim i gjendjes së lirisë së shprehjes dhe të mediave. Këtë përkeqësim e ka vërejtur edhe Komisioni Evropian, në Raportin e Progresit 2010 për Kosovën, i cili konstaton mungesën e lirisë së mediave në vend.

Një shqetësim tjetër i madh, për çka vazhdimisht ka tërhequr vërejtjen edhe Unioni i Gazetarëve të Kosovës, paraqesin problemet që e kanë shoqëruar dhe po e shoqërojnë transmetuesin e vetëm

¹⁰⁷ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 42 i

¹⁰⁸ Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2010.

publik në vend, Radio Televizionin e Kosovës (RTK). Raporti i organizatës “Reporterët pa Kufij”, nënvizon me theks të veçantë, sidomos, kontrollin e drejtpërdrejt të Qeverisë mbi RTK-në.

Mungesa e fondeve dhe investimeve nga jashtë i ka lënë gazetat e dobëta përballë presionit politik dhe grupeve të veçanta të interesit, të cilat kërcënojnë se do i tërheqin reklamat nëse mediat nuk janë në favor të tyre.

Avokati i Popullit e vlerëson gjendjen si jo të kënaqshme edhe sa i përket informimit dhe mediave në gjuhën e komuniteteve. Ekziston nevojë për zgjerimin e emisioneve, forcimin e kuadrit të programeve si dhe zhvillimin e mediave të shkruara në gjuhën e tyre. Duke e pasur parasysh gjendjen e përgjithshme në Kosovë dhe në veçanti të komuniteteve, nuk ka mundësi për përmirësimin e kësaj situatë pa përkrahjen e institucioneve shtetërore. Në këtë aspekt me theks të veçantë duhet nënvizuar sidomos gjendjen absolutisht të papranueshme dhe të keqe të mediave për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas. Duhet theksuar se mediat luajnë një rol të rëndësishëm në integrimin e komuniteteve në shoqërinë tonë.

Avokati i Popullit konstaton se respektimi i plotë i lirisë së mediave është themelore për funksionimin e demokracisë si dhe për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Liria e mediave është gjithashtu çështje kyçe për të siguruar që qytetarët të mund të kenë rolin aktiv në sigurimin e paqes, dhe të proceseve demokratike.

Avokati i Popullit bën thirrje që të merren masat e duhura nga institucionet relevante për krijimin e hapësirës së nevojshme, për ngritjen e lirisë së mediave. Sidomos, rëndësi e veçantë duhet kushtuar të drejtës së mediave në mënyrë që t’u sigurohet qasje adekuate dhe efektive në informata dhe të njëjtën kohë të sigurojë zbatim adekuat të Ligjit për qasjen në dokumente publike.

Avokati i Popullit kërkon nga Kuvendi i Kosovës që ta zgjidh njëherë e përgjithmonë çështjen e financimit të Transmetuesit Publik RTK, në mënyrë që ky medium i vetëm publik të jetë në shërbim të qytetarëve jashtë ndikimit politik shtetëror dhe të grupeve të ndryshme të interesit.

Gjithashtu, Avokati i Popullit, konsideron se një prej njërive matëse të zhvillimit të nivelit demokratik të Republikës së Kosovës është liria e shprehjes dhe e mediave. Si e tillë, ajo do të jetë vazhdimisht edhe njëra nga aspektet e vlerësimit të organizmave ndërkombëtarë, në të cilat Kosova mëton të jetë anëtare. Prandaj, është shumë e nevojshme të ketë kontroll dhe iniciativë parlamentare për të debatuar dhe vlerësuar gjendjen e lirisë së mediave në Kosovë

Gjatë periudhës së raportimit, Institucioni i Avokatit të Popullit nuk ka regjistruar raste të veçanta në lidhje me nenin 42 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

4.17. Liria e tubimit

E drejta e qytetarëve për tubime paqësore është një e drejtë universale, e garantuar edhe me nenin 43, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e cila ofron garanci të plotë dhe është në pajtueshmëri edhe me normat ndërkombëtare.

Çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor.¹⁰⁹ Ushtrimi i kësaj të drejte nuk mund t’i nënshtrohet kufizimeve të tjera, përveç atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare ose të sigurisë publike, për mbrojtjen e

¹⁰⁹ KEDNJ, neni 11.

rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirisë të të tjerëve.¹¹⁰ Ky nen nuk ndalon kufizime të ligjshme të ushtrimit të këtyre të drejtave nga pjesëtarë të forcave të armatosura, të policisë ose të administratës shtetërore.

Avokati i Popullit, në raportin e kaluar vjetor 2008-2009, kishte ngritur shqetësimet, lidhur me nenin 12, të Ligjit për Tubimet Publike, pasi ky nen përmban elemente që konsiderohen të mos jenë në përputhje me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që e paraqet detyrimisht bazën e interpretimit të të drejtave në Kosovë.¹¹¹ Në nenin 12, të Ligjit për Tubimet Publike, i cili u miratua nga Kuvendi i Kosovës, në vitin 2008, ligjvënësit kosovarë e lënë një pjesë të kompetencave në duart e të ashtuquajturve “kujdestarë”, që caktohen ad hoc nga vetë organizatori i tubimit. Ky delegim i obligimeve tek organizatorët e tubimeve, nga ana e autoriteteve shtetërore, bie ndesh me parimet e nenit 11 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Kjo ndodh për faktin se shteti për garantimin e lirisë së tubimit nuk mund të kufizohet vetëm në qëndrimin pasiv të mosndërhyrjes. Detyrim ligjor i shtetit është veprimi aktiv për mbrojtjen e personave që organizojnë dhe marrin pjesë në tubim.¹¹²

Avokati i Popullit ka vërejtur se nëse “kujdestarët” angazhohen për mbarëvajtjen e një tubimi, angazhimi i tyre lidhet drejtpërdrejt me mbarëvajtjen e tubimit, në kuptimin e arritjes së qëllimit të organizatorit të tubimit, që nuk mund të dalë jashtë kërkesave të deklaruara të organizatorit. Por “kujdestarëve” nuk mund t’u delegohet detyrimi që të “kujdesen që pjesëmarrësit të mos i dëmtojnë të mirat materiale që ekzistojnë në vendin e mbajtjes së tubimit”, ashtu siç e parasheh pika 2 e nenit 12 të Ligjit për Tubimet Publike.

Ky veprim e përfshin ruajtjen e pasurisë publike ose private dhe mund të jetë detyrim ekskluziv i autoriteteve shtetërore dhe/ose i agjencive të specializuara, posaçërisht për këtë veprimtari dhe të lejuara me ligj, por nuk ka të bëjë me kërkesat dhe me qëllimin e tubimit, ndërsa “kujdestarët” e caktuar ad hoc nga organizatori i tubimit nuk i takojnë kategorisë së personave të përgatitur dhe të legjitimuar në këtë drejtim.

Praktika e Gjykatës Evropiane tërheq vërejtjen se liria efektive për një tubim paqësor nuk mund të pretendohet vetëm nëse shteti i ka përmbushur detyrimet e tij, duke lejuar dhe duke mos ndërhyrë, por në rast nevojë kërkon të merren masa pozitive, qoftë edhe në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet individëve.¹¹³

Nisur nga të gjitha këto që u thanë më lart, Avokati i Popullit konstaton se pika 3 e nenit 12, të Ligjit për Tubimet Publike, sipas së cilës detyrimi ligjor që ligjvënësi ia delegon “kujdestarit” të një tubimi “*ta kapë dhe ta dorëzojë te policët pjesëmarrësin ose personin tjetër që qarkullon pranë vendit të tubimit publik, nëse e prish rendin, qetësinë, nëse mban armë ose objekte të rrezikshme, ose shenja të ndaluara*” janë detyrim ekskluziv i organeve shtetërore të rendit dhe nuk mund të delegohet tek asnjë person tjetër juridik ose fizik.

Avokati i Popullit, edhe një herë, rekomandon që neni i lartpërmendur i Ligjit për Tubimet Publike të plotësohet dhe të ndryshohet, në mënyrë që të harmonizohet me standardet evropiane.

¹¹⁰ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 53.

¹¹¹ Po aty.

¹¹² Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Vendimi i datës 21 qershor 1988, Aplikacioni nr. 10126/82).

¹¹³ Po aty.

4.18. *Liria e asociimit*

Çdo njeri gëzon të drejtën e lirisë së organizimit në shoqata me të tjerët, përfshirë të drejtën për të formuar dhe për të hyrë në sindikata për mbrojtje të interesave të tij.¹¹⁴ Po ashtu liria e asociimit dhe organizimit shërben edhe si bazë për realizimin e disa lirive dhe të drejtave të tjera themelore, siç është liria e shprehjes.¹¹⁵

Kushtetuta e Republikës së Kosovës ofron garanci për lirinë e asociimit, duke e përshkruar si të drejtë të çdo qytetari për të themeluar organizatë, pa pasur nevojë që të sigurojë leje për të qenë ose për të mos qenë anëtar i një organizate, si dhe për të marrë pjesë në aktivitetet e një organizate.¹¹⁶

Kuvendi i Kosovës, në vitin 2009, ka miratuar Ligjin për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare. Me këtë ligj janë rregulluar procedurat dhe kushtet e regjistrimit dhe të çregjistrimit të OJQ-ve, qeverisja e brendshme, statusi i tyre dhe kërkesat për raportim financiar. Mirëpo, për shkak të disa problemeve teknike, respektivisht gabimeve në referime të neneve të caktuara të këtij ligji, Ministria e Administratës Publike (MAP), në fillim të vitit 2010, ka nisur procesin e plotësimit dhe ndryshimit të ligjit, ndërsa Kuvendi i Kosovës, më 25 shkurt 2010, kishte vendosur që projektligji të futet në listën e projektligjeve me prioritet.¹¹⁷

Në përgjithësi nuk mund të raportohet për një progres të madh në këtë fushë. OJQ-të nuk janë sa duhet aktive në fushën e legjislacionit dhe ndikimit të tyre në administratën qendrore. Pjesëmarrja e tyre në këto procese është *ad hoc* dhe fondet e tyre më së shumti varen nga donacionet ndërkombëtare. Si rrjedhojë e kësaj, kapacitetet monitoruese të OJQ-ve, edhe pse në rritje, ende mbeten të kufizuara. Komisioni Evropian ka shprehur shqetësimin sa i përket mjedisit në të cilin veprojnë OJQ-të në Kosovë, si dhe ka theksuar se iniciativa e Qeverisë së Kosovës për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për OJQ-të duhet të merr parasysh vërejtjet e ngritura nga shoqëria civile.¹¹⁸

Në grupin punues të Qeverisë për përgatitjen e projektligjit ishin ftuar të marrin pjesë edhe përfaqësues nga shoqëria civile, të cilët ishin kundër ndryshimeve përmbytjesore të ligjit, e sidomos tendencave të disa OJQ-ve mikrofinanciare dhe MAP-së, të cilat kërkonin që t'u lejohet institucioneve mikrofinanciare të shndërrohen në banka private.

Grupi punues qeveritar kishte përfunduar punën e tij dhe ndryshimet që ishin bërë në ligj ishin në harmoni me standardet evropiane. Mirëpo, situata kishte ndryshuar, pasi MAP kishte dërguar një version tjetër nga ai për të cilin ishte dakorduar grupi punues qeveritar. Në këtë rast kishte pasuar edhe reagimi i shoqërisë civile të cilat kishin kërkuar nga Zyra e Kryeministrit, që të mos pranohen ndryshimet e bëra nga MAP. Zyra e Kryeministrit e kishte pranuar kërkesën e OJQ-ve dhe versioni i projektligjit, sipas propozimit të MAP-së ishte refuzuar, ndërsa ishte caktuar një takim tjetër i grupit punues qeveritar. Në shtator, grupi punues qeveritar kishte përfunduar punën e vet, duke i inkorporuar vërejtjet e ngritura nga shoqëria civile dhe projektligji me ndryshime i është dërguar për miratim Kuvendit të Kosovës.

Avokati i Popullit rekomandon që gjatë procesit të shqyrtimit të projektligjeve nga Kuvendi i Kosovës, respektivisht komisionet parlamentare, të merren parasysh vërejtjet dhe sugjerimet e dala

¹¹⁴ KEDNJ, neni 11.

¹¹⁵ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 40, KEDNJ, neni 10.

¹¹⁶ Po aty, neni 44.

¹¹⁷ Vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 03-V-261, Prishtinë, 25 shkurt 2010.

¹¹⁸ Raporti i Progresit për Kosovë i Komisionit Evropian, 2010.

nga grupet e ndryshme të interesuara të shoqërisë, grupet profesionale dhe shoqëria civile, në mënyrë që plotësimet dhe ndryshimet e bëra në ligj të jenë transparente, të mbështeten nga shoqëria dhe si përfundim, ligji të jetë në harmoni me standardet evropiane.

Gjatë kësaj periudhe Avokati i Popullit nuk ka pranuar ndonjë ankesë, sa i përket cenimit të lirisë së asociimit.

Gjatë këtij viti është ngritur bashkëpunimi i OJQ-ve me IAP-në. Debatet e përbashkëta me shoqërinë civile, nëpër komuna dhe rajone të ndryshme në Kosovë, si dhe adresimi i kërkesave të OJQ-ve në IAP, për ngritjen e çështjeve me interes për qytetarin e Republikës së Kosovës, në Gjykatën Kushtetuese apo edhe në institucione të tjera publike, janë tregues shpresëdhënës për një lëvizje pozitive. Kërkesa e një grupi të OJQ-ve për të referuar Ligjin për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetëve në Gjykatën Kushtetuese, është shembulli më tipik. IAP ka vlerësuar se kishte bazë të mjaftueshme ligjore që kjo çështje të shqyrtohej nga Gjykata Kushtetuese. Më 22 dhjetor 2010, Gjykata Kushtetuese mori vendim për lejimin e masës së përkohshme me të cilin e pezulloi zbatimin e neneve të kontestuara të ligjit në fjalë.

4.19. E drejta e zgjedhjes dhe e pjesëmarrjes

E drejta e zgjedhjes është e drejtë themelore dhe si e tillë është e paraparë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës,¹¹⁹ Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme¹²⁰ dhe Ligjin mbi Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës,¹²¹ të cilët janë në përputhje me nenin 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut,¹²² si dhe me instrumentet e tjera ndërkombëtare, të zbatueshme në Kosovë.

Gjatë vitit 2010, zgjedhjet kanë kaluar nëpër sfida të ndryshme, si në nivel lokal, ashtu dhe në nivel qendror. Si rezultat i parregullsive që ndodhën në zgjedhjet lokale të vitit 2009, Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) organizoi përsëritjen e votimit të zgjedhjeve të raundit të dytë për kryetar të komunave në Lipjan dhe Prizren, me datën 31 janar 2010. Zgjedhjet u përsëriten edhe në komunën e Gjilanit, me datën 14 mars 2010. Gjithashtu, zgjedhje të jashtëzakonshme ka pasur për kryetar komune në Istog,¹²³ të mbajtura me datën 4 prill 2010.

Si rezultat i krijimit të komunave të reja, më 20 qershor 2010, janë mbajtur zgjedhjet lokale dhe ato për kryetar komune në Partesh.

Zgjedhje të jashtëzakonshme për kryetarin e komunës janë mbajtur në Rahovec, më 21 nëntor 2010, si dhe më 19 dhjetor 2010, pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, për shkak të dorëheqjes së kryetarit të komunës të zgjedhur në zgjedhjet e lokale të vitit 2009.

Si pasojë e ngërçit politik të krijuar në vend, gjatë 3 muajve të fundit të viti 2010, më 12 dhjetor 2010, u mbajtën zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare në 37 komuna të Republikës së Kosovës. Bazuar në raportin e (KQZ),¹²⁴ për këto zgjedhje ishin angazhuar gjithsej 19.241 anëtarë të Këshillave të Vendvotimeve (KVV), si dhe 6.447 persona të trajnuar si staf teknik, në kuadër të

¹¹⁹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 45.

¹²⁰ Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nr. 03/L-073.

¹²¹ Ligji për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nr. 073/L-072.

¹²² KEDNJ, Protokoll 1, neni 3

¹²³ Këto zgjedhje janë mbajtur për shkak të vdekjes së kryetarit të Istogut, z. Fadil Ferati, më 30 janar 2010.

¹²⁴ Shih www.kqz-ks.org, (.04.2011).

Qendrave të Votimit (QV). Numri i Vendvotimeve (VV) për vitin 2010 është rritur, për arsye se numri i votuesve për një VV nga 750 votues, sipas KQZ-së ishte rritur në 950 votues.

Institucioni i Avokatit të Popullit, duke u bazuar në përgjegjësitë dhe kompetencat e veta ligjore dhe Kushtetuese, si dhe me qëllim të mbarëvajtjes së zgjedhjeve, ka marrë pjesë si monitorues i zgjedhjeve parlamentare të vitit 2010, pothuajse në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, me përjashtim të komunave Leposaviq dhe Zubin Potok. Nga përfaqësuesit e IAP-së janë vizituar gjithsej 142 qendra votimi dhe 208 vendvotime.

Procesi i votimit është monitoruar edhe në vendet ku mbahen personat e privuar lirie, ose ata me nevoja të veçanta si: qendrat e paraburgimeve, Qendra Korrektuese në Dubravë, Shtëpia e Shëndetit Mendor në Shtime etj.

Avokati i Popullit, bazuar në raportet e bashkëpunëtorëve nga terreni i ka vlerësuar këto zgjedhje, si të qeta dhe pa incidente, por ato janë përcjellë nga një varg parregullsish, si në vijim:

- *Llambat verifikuese të cilat nuk ishin funksionale ose kishin dritë të dobët;*
- *Spreji për spërkatje të gishtit ishte i cilësisë së dobët, në shumicën e vendvotimeve;*
- *Listat e votuesve nuk ishin të plota;*
- *Votimi familjar;*
- *Listat e kandidatëve në kabinat e votimit kanë qenë (në shumë raste) të hapura tek një subjekt politik, madje edhe të rrethuar deri në pesë numra;*
- *Votuesit nuk gjenin emrat në listë;*
- *Vonesa e përgatitjes së materialit që kishte shkaktuar vonesa dhe pritje për votim;*
- *Moslajmërimi i institucioneve me të drejtë vote tek Komisari Komunal i Zgjedhjeve dhe privimi nga kjo e drejtë, si psh. Qendra Integruese, ku janë vendosur personat e moshuar në Pejë.*

Gjatë këtij monitorimi Avokati i Popullit veçon se ka pasur shkelje të rënda të procesit zgjedhor në Skenderaj, Drenas dhe Deçan, si:

- *Ndërhyrjet nga simpatizantë të ndonjë partie politike në vendvotime;*
- *Probleme me votimin familjar, kur një anëtar votonte në emër të familjes.*

Parregullsitë e paraqitura më lart, të evidentuara nga ekipet monitoruese të IAP, paraqesin shkelje të procesit zgjedhor dhe përbëjnë vepra penale të parapara me Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK). Sipas KPPK keqpërdorimi i votës përbën vepra penale të përfshira në Kapitullin e XVI.¹²⁵

KQZ ka anuluar rezultatet e zgjedhjeve në disa komuna dhe miratuar planin operacional për procesin e rivotimit që planifikohet të mbahet më 9 janar 2011, në Komunën e Drenasit, Skenderaj, Deçan, mbajtjen pjesërisht të zgjedhjeve në Komunën e Lipjanit dhe Malishevës dhe rivotim në komunën e Mitrovicës.

Bazuar nga shqetësimet e dala dhe konstatuara nga monitorimi i zgjedhjeve dhe shqetësimeve të qytetarëve të Republikës së Kosovës, Avokati i Popullit ka bërë një letër me rekomandim,¹²⁶ duke

¹²⁵ Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, RA-2003/25, datë 6 korrik 2003.

¹²⁶ Shih <http://ombudspersonkosovo.org>, Raporti për vëzhgimin e zgjedhjeve parlamentare në Republikën e Kosovës, datë 12 shkurt 2011.

kërkuar nga institucionet përgjegjëse ndërmarrjen e veprimeve të parapara me ligj, për fillimin e hetimeve sipas detyrë zyrtare, për rastet e pohuara të keqpërdorimit të votës, në mënyrë që kryesit e tyre të vihen para drejtësisë.

Avokati i Popullit me këtë letër rekomandim i është drejtuar institucioneve përgjegjëse, duke filluar nga u.d. së kryetarit të Republikës së Kosovës; Ministrisë së Punëve të Brendshme; kryetarit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa; kryesuesit të Këshillit Gjyqësor dhe kryeprokurorit të Republikës së Kosovës, që të ndërmarrim sa më shpejt veprimeve e duhura.

4.20. E drejta e pronës

E drejta e pronës është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës¹²⁷. Sipas kësaj garancie, askush nuk mund të privohet nga prona në mënyrë arbitrare.

Problemet pronësore-juridike në Kosovë mbeten ende një problem delikat, tani e dhjetë vjet pas luftës. Institucionet publike në Kosovë, vazhdojnë të përballen me vështirësi në mbrojtjen e të drejtave themelore pronësore. Problemet pronësore në Kosovë janë të natyrave të ndryshme. Shpronësimi i pasurisë private, me qëllim të zhvillimit të infrastrukturës publike, problemi i uzurpimeve ilegale të tokave dhe ndërtimeve, sistemi i regjistrimit të tokave dhe pronësisë, si dhe mbrojtja e trashëgimisë fetare e kulturore e të gjitha komuniteteve, që jetojnë në Kosovë, janë edhe më tej evidente.

Sipas normave ligjore të zbatueshme në Kosovë, individët dhe personat juridikë kanë të drejtë të posedojnë, të shesin dhe të shfrytëzojnë pronat e tyre. Në rrethana të caktuara, shteti mund të kufizojë realizimin e të drejtave pronësore. Nëse shteti kufizon, privon apo kontrollon realizimin e të drejtës pronësore të një personi, këtë mund ta bëjë vetëm duke u bazuar në ligj, i cili është i qartë, i qasshëm dhe që ofron mbrojtje nga arbitrariteti.¹²⁸

Çështja e shpronësimit në Kosovë është e rregulluar me ligj.¹²⁹ Me këtë ligj përcaktohen rregullat dhe kushtet, sipas të cilave shteti mund të bëjë shpronësimin e pronës së paluajtshme të një personi. Ky ligj përcakton edhe procedurat për kryerjen e shpronësimit ose kufizimit të pronësisë, rregullat dhe procedurat të cilat do të përdoren për përcaktimin e shumës dhe pagesës për kompensimin. Shpronësimi apo privimi nga e drejta pronësore nga institucionet publike duhet të jetë e bazuar vetëm në ligj. Përndryshe, shpronësimi dhe privimi nga e drejta pronësore është i kundërligjshëm dhe arbitrar.

Në Institucionin e Avokatit të Popullit janë të regjistruara raste, ku qytetarët e Kosovës ankohen kundër institucioneve publike për shkelje të marrëveshjeve për kompensim. Një rasti i tillë është ai i pronarëve të lokaleve afariste, të cilat janë rrënuar për ndërtimin e nënkallimit në lagjen “Pejton” në Prishtinë. Komuna e Prishtinës, e cila është *organ shpronësues*,¹³⁰ nuk e ka respektuar afatin e rindërtimit të tyre, sipas marrëveshjes paraprake, midis palëve (komunës së Prishtinës dhe pronarëve individualë), si dhe e ka ndryshuar planin e ndërtimit, me të cilin pronarët e lokaleve janë dëmtuar materialisht.

¹²⁷ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 46.

¹²⁸ Protokollin e KEDNJ-së, Neni 1.

¹²⁹ Ligji Nr. 03/L-139, për shpronësimin e pronës së paluajtshme.

¹³⁰ Termi organ shpronësues përdoret si sinonim për institucionet publike ose institucionet e shtetit.

Në bazë të KEDNJ-së, të gjitha institucionet publike janë të detyruara të respektojnë dhe mbrojnë të drejtat pronësore. Kjo domethënë se shteti nuk duhet të pengojë në mënyrë arbitrare realizimin e të drejtës pronësore, si dhe duhet të ndërmarrë masat e parandalimit apo korrigjimit të një pengimi të tillë.

Ky është detyrim i gjyqësorit, i cili duhet të parandalojë pengimin e padrejtë për realizimin e të drejtave pronësore dhe të mbrojë individin nga padrejtësitë. E drejta për mjet juridik efikas apo edhe për ankesë kundër një vendimi të posaçëm, që pengon realizimin e së drejtës pronësore, është e garantuar me Kushtetutë dhe me instrumente ndërkombëtare.¹³¹ Në aspektin praktik, sipas kuptimit të KEDNJ-së, kjo domethënë se shteti është i obliguar të mbrojë, në mënyrë efikase, të drejtat pronësore, përfshirë këtu edhe mjetet juridike dhe ato administrative, si dhe mekanizmat implementues të cilët duhet të veprojnë, pa zvarritje të panevojshme.

Në shumë raste, gjykatat kompetente në Kosovë dështojnë të mbrojnë të drejtën pronësore të individëve, duke mos i ekzekutuar vendimet e tyre. Raste të tilla në Institucionin e Avokatit të Popullit janë regjistruar, si psh. rasti i Gjykatës Komunale të Prishtinës, e cila që nga viti 2008 nuk e ka ekzekutuar vendimin për rrënim të objektit të ndërtuar pa leje të personit NN (të dhënat gjendet në arkivin e IAP-së), i cili i pengon banorët e lagjes për shfrytëzim të lirë të pronës së tyre.

Çështja e ndërtimeve pa leje dhe formimi i lagjeve joformale, mbetet akoma një problem shqetësues në tërë Kosovën. Shumë komuna e kanë rregulluar deri në një masë çështjen e ndërtimeve të kundërligjshme, duke i legalizuar apo duke i hequr/rrënuar ato. Një lloj kontrolli për ndërtimet pa leje e ka filluar komuna e Prishtinës, e cila ka miratuar Rregulloren për trajtimin e ndërtimeve pa leje,¹³² me qëllim të trajtimit të ndërtimeve ekzistuese pa leje dhe ndërprerjes së ndërtimeve të tilla në të ardhmen. Sipas kësaj rregulloreje, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit bën regjistrin e ndërtimeve pa leje, në afat prej 90 ditësh, nga dita e hyrjes në fuqi të saj.¹³³

Kontestet më të mëdha, natyrisht, kanë lindur pas luftës së vitit 1998-1999 në Kosovë. Ka prej tyre që janë edhe më të hershme, për shkak të neglizhencës së qytetarëve për të bërë (azhurnimin e pronave) bartjen ligjore përmes gjykatave dhe zyrës kadastrale. Në shumë raste, ish-trashëgimtarët më nuk janë në mesin e të gjallëve. Prona e tyre ka pësuar transformime të ndryshme, për shkak të mosbartjes të pronësisë në kohë të duhur. Kjo shpesh ka ngjarë me qëllim të shmangies së tatimit në pronë.

Rastet më të komplikuar janë ato kur një patundshmëri është shitur disa herë. Blerësit kanë ndërtuar shtëpi, apo kanë ngritur biznese, por ligjërisht nuk i kanë prona të tyre. Kjo dukuri është shumë e shprehur në Kosovës e sidomos pas vitit 1999.

Në IAP është i regjistruar rasti i ankuesit NN (identiteti i personit i njohur për IAP-në) 395/2009, i cili në vitin 1999 ka blerë banesën dhe për të posedon dokumentet e nevojshme. Drejtoria për çështje pronësore dhe banesore ka vendosur në favor të parashtruesit të ankesës. Në ndërkohë, e njëjta pronë, përmes dokumenteve të falsifikuara nga personi i tretë, është shitur përsëri dhe kontrata e shitblerjes është vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë. Parashtruesi i ankesës, pas kontestit pronësor të zhvilluar në Gjykatën Komunale në Prishtinë, është urdhëruar ta lirojë banesën në afat prej 15 ditësh. Lidhur me këtë rast për të njëjtën pronë është vendosur dy herë: njëherë në

¹³¹ Shih *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, neni 46; *KEDNJ*, neni 13, si dhe neni 6, p. 1.

¹³² Shih *Rregullorja për trajtimin e ndërtimeve pa leje*, e Komunës së Prishtinës, bazuar në Ligjin për vetëqeverisje lokale 03/L – 04; Ligjin për ndërtim nr. 2004/37; Statutin e Komunës së Prishtinës 01. nr. 110 – 455.

¹³³ *Po aty*.

Drejtorinë për Çështje Pronësore dhe Banesore dhe herën e dytë në Gjykatën Komunale në Prishtinë. Vendimet e këtyre dy institucioneve publike janë në kundërshtim njëri me tjetrin. Ndërkaq, viktimë është qytetari i pafajshëm.

Ligjet në fuqi në Kosovë e mundësojnë regjistrimin e pronës, duke u bazuar në dokumentacionin aktual, i cili mundëson që secila pronë të jetë në funksion të tregut të lirë, të pronarit dhe të zhvillimit ekonomik. Ndërkaq, dokumentimi i të drejtave pronësore ofron bazë të fuqishme për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave pronësore nëpërmjet të institucioneve dhe mekanizmave të ndryshëm.

Sipas Agjencisë Kadastrale të Kosovës, në Kosovë ekziston një diskrepancë në mes të pronarëve aktualë dhe gjendjes në terren, sepse azhurnimet ligjore të pronave nuk kanë mundur të mbahen në nivelin e duhur. Kjo është pasojë mungesës së dokumentacionit kadastral, i cili është zhdukur apo është marrë gjatë dhe pas luftës nga shteti serb. Mirëpo, edhe mungesa e bashkëpunimit dhe moskoordinimi midis institucioneve publike në Kosovë, e rëndon edhe më tej situatën rreth dokumenteve kadastrale.

Në IAP është paraqitur ankuesi NN (identiteti i personit i njohur për IAP-në), i cili pohon se i tërë dokumentacioni, i cili e dokumenton të drejtën e tij pronësore, i është zhdukur gjatë luftës në Kosovë. Në regjistrat kadastrale të Kosovës prona e tij nuk është e evidentuar fare. Sipas zyrtarëve, parashtuesi i ankesës duhet kërkuar dokumentacionin e tij në Serbi. Raste të ngjashme në Kosovë ka shumë, kur pronarët pengohen për shfrytëzim të lirshëm të pronave të tyre për shkak të mungesës së dokumentacionit.

Prandaj, si detyrë imediate e institucioneve publike të Kosovës, sidomos e Qeverisë, shtrohet angazhimi serioz dhe urgjent, për gjetjen e formave dhe rrugëve, që pronarëve të cilët prona e tyre nuk i kanë të evidentuara në regjistrat kadastrale, t'u ofrohet zgjidhje ligjore për t'i regjistruar ato, në mënyrë që të mund t'i shfrytëzojnë lirshëm.

Me problemin e regjistrimit të pronave në regjistra kadastrale përballen edhe bashkësitë fetare në Kosovë (për këtë më gjerësisht shih në pjesën *Barazia para ligjit*, të këtij raporti).

Problemet edhe më tej janë aktuale me Agjencinë Kosovare të Pronës. Deri më tani në këtë Agjenci janë regjistruar rreth 40.000 kërkesa. Prej tyre rreth 26.000 janë shqyrtuar, ndërsa rreth 17.000 prej tyre janë zgjidhur. Problem jashtëzakonisht i madh mbetet çështja e uzurpimit të pronave në veri të Mitrovicës, i cili vazhdon të jetë i pazgjidhur.

Rasti tipik është ai i ankuesit NN (identiteti i personit i njohur për IAP-në), i cili pohon se prona e tij gjendet në veri të Mitrovicës dhe është nën administrim të Agjencisë Kosovare të Pronës. Për pronën e tij ai asnjëherë nuk është kompensuar në formë qiraje. Ndërsa, për pronën të cilën ai e shfrytëzon në pjesën jugore të Mitrovicës, e cila po ashtu është nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Pronës, ai është i detyruar që për çdo muaj të paguajë qira, sepse në të kundërtën kërcënohet të dëbohet. Edhe ky rast dëshmon se Agjencia Kosovare e Pronës, ashtu edhe si vitet e mëparshme, vazhdon të dështojë në implementimin e skemën e qiradhënies dhe qiramarrjes.

Duke pas parasysh mandatin e Agjencisë Kosovare të Pronës, si pasardhëse e Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore, duhet që urgjentisht dhe me përpikëri të përmbushë misionin e vet ligjor, të krijojë një skemë, e cila përfshin edhe qiranë apo kompensimin e arsyeshëm për bartësit e të drejtës pronësore, të cilët prona e tyre i kanë në pjesën veriore të Mitrovicës nën administrim të tyre.

Nga sa u tha më lart, me gjithë faktin e ekzistimit të kornizës ligjore, problemet pronësore në Kosovë edhe më tej mbeten pothuajse, si në vitet paraprake. Edhe më tej shihen qartë dështimet institucionale për mbrojtjen e të drejtës pronësore. Një përparim shumë i vogël vërehet por ende mbetet shumë për t'u bërë.

Obligim i Qeverisë së Kosovës mbetet mbrojtja e të drejtës pronësore, ashtu siç është e garantuar me Kushtetutë, me ligje vendore dhe me instrumente ndërkombëtare dhe t'i mundësojë secilit person të ushtrojë të drejtat pronësore, në mënyrë të plotë, të papënguar. Kjo do të kontribuonte në zhvillimin e gjithmbarshëm politik dhe ekonomik në Kosovë.

4.21. E drejta për arsimin

E drejta për arsimim, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës parasheh që “secili person gëzon të drejtën e shkollimit themelor pa pagesë. Shkollimi rregullohet me ligj dhe financohet nga fondet publike.”¹³⁴ Kushtetuta përcakton edhe detyrimin që institucionet publike t'i sigurojnë mundësi të barabarta arsimimi çdo personi sipas aftësive dhe nevojave të tij/saj.¹³⁵ Po këtë, e garanton edhe Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollin e saj (KEDNJ), që zbatohet drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës.¹³⁶

Çështja e arsimit dhe e së drejtës për t'u arsimuar ka shënuar progres me miratimin e Ligjit për Arsimin në Komunitat e Republikës së Kosovës.¹³⁷ Me këtë ligj ka filluar bartja e kompetencave në arsim nga autoritet qendrore në ato lokale. Ky proces i decentralizimit përfshin bartjen e kompetencave në nivel shkolle, duke ua lejuar shkollave menaxhimin dhe planifikimin e buxhetit të tyre. Ky është një hap pozitiv, sepse pushteti lokal ka mundësi më të mëdha për të vlerësuar nevojat reale të një komuniteti të caktuar. Gjithsesi, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) mbetet përgjegjëse për zhvillimin e politikave, hartimin dhe zbatimin e legjislacionit për zhvillimin e arsimit, duke përfshirë zhvillimin e arsimit të lartë dhe të shkencës në Kosovë; promovimin e sistemit arsimor jodiskriminues në të cilin respektohet e drejta e secilit person për arsimim; krijimin dhe menaxhimin e një sistemi të përgjithshëm të certifikimit të të gjithë mësimitdhënësve në Kosovë etj.¹³⁸

Sipas ligjit në fjalë, drejtoritë komunale të arsimit, janë përgjegjëse për punësimin e mësimitdhënësve dhe të drejtorëve të shkollave; për pagesën e mësimitdhënësve dhe të stafit ndihmës; infrastrukturën dhe mirëmbajtjen e shkollave; trajnimin e mësimitdhënësve dhe stafit administrativ; monitorimin e shkollave, etj.¹³⁹

Sipas zyrtarëve të MASHT-it, në diskutim është Projektligji për Arsimin Parauniversitar. Me këtë ligj synohet që shkollimi parafillor dhe ai i mesëm të bëhen të detyrueshëm, si dhe shkollave t'u jepet autonomi më e gjerë financiare.

¹³⁴ *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, Neni 47, paragrafi 1.

¹³⁵ *Po aty*, Neni 47, paragrafi 2.

¹³⁶ *Protokolli nr. 1 i KEDNJ*, Neni 2: "Askujt nuk mund t'i mohohet e drejta për arsimim. Shteti, në ushtrimin e funksioneve që merr përsipër në fushën e edukimit dhe të arsimit, respekton të drejtën e prindërve për të siguruar këtë edukim dhe arsim në përputhje me bindjet e tyre fetare dhe filozofike."

¹³⁷ *Shih Ligjin për Arsimin në Komunitat e Republikës së Kosovës*, nr. 03/L – 068.

¹³⁸ *Po aty*, Neni 3.

¹³⁹ *Po aty*, Neni 5.

Duke pasur parasysh gjendjen e përgjithshme në shoqërinë kosovare, përkritazi me arsimimin, Avokati i Popullit përshëndet dhe inkurajon nismat e tilla.

Në vitin 2007, MASHT-i ka publikuar dokumentin “Strategjia për zhvillimin e arsimit parauniversitar në Kosovë 2007-2017”. Sipas objektivave të kësaj strategjie parashihet rishikimi dhe miratimi i Kornizës së Kurrikulumit. MASHT-i, në bashkëpunim me institucionet e tjera angazhohet që në kurrikulat shkollore dhe në standarde të përfshihen shkathtësitë bazë të kërkuara nga Bashkimi Evropian (BE), e të cilat duhet t’i zotërojë një nxënës. Korniza e Kurrikulumit paraqet dokumentin kryesor për ciklin e ri të reformave në sistemin e arsimit në Kosovë. Në kuadër të kësaj MASHT-i ka hartuar Kornizën e Kurrikulumit, e cila në maj të vitit 2010 është nxjerr në diskutim publik. Mirëpo, deri më tani nuk është miratuar për shkak të opinioneve të ndryshme të ekspertëve ndërkombëtarë rreth asaj se a duhet të aplikohet vetëm në klasën e parë apo edhe për klasën e gjashtë e të dhjetë.¹⁴⁰

Institucioni i Avokatit të Popullit kërkon që sa më shpejtë të miratohet kurrikulumit për ciklet e ulëta të shkollimit, ngase nxënësit janë të mbingarkuar me tekste shkollore.

Dhuna nëpër shkolla ende mbetet një dukuri shqetësuese. Më 26 maj 2008, MASHT-i ka nënshkruar një memorandum bashkëpunimi me Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Drejtësisë, Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, që ka të bëjë me parandalimin e sjelljeve asociale dhe delikuate në institucionet edukative-arsimore në Republikën e Kosovës. Me gjithë këtë, dhuna dhe sjelljet delikuate nëpër shkolla, ende janë evidente. Madje, në disa raste, edhe me pasoja tragjike.¹⁴¹ Disa drejtori të shkollave kanë organizuar vendosjen e kamerave për monitorimin e hapësirave brenda shkollave. Po ashtu, në disa shkolla janë organizuar edhe kompani private të sigurimit, për të mbajtur rendin brenda hapësirave shkollore, ndërsa pagesa e punonjësve të sigurimit bëhet nga participimi i vet nxënësve. Siguria në shkolla është përgjegjësi e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe se nismat në disa shkolla që për sigurinë e tyre të participojnë vetë nxënësit, sado të jenë të qëlluara dhe të efektshme ato si të tilla nuk mund të lejohen.

Avokati i Popullit rekomandon që MASHT-i të hartojë një plan të detajuar veprimi për krijimin e një ambienti të më sigurt dhe më të përshtatshëm për nxënësit dhe mësimdhënësit, përmes bashkëpunimit më të ngushtë me institucionet e tjera shtetërore.

Një problematikë tjetër, e cila në vazhdimësi e shoqëron sistemin e arsimit, është mungesa e ambienteve shkollore. Edhe pse MASHT-i, gjatë këtij viti, ka realizuar disa projekte të ndërtimit të objekteve shkollore dhe ka ndarë mjete për ndërtimin e disa objekteve të tjera shkollore, megjithatë në disa shkolla në Kosovë ende punohet në tri ndërrime dhe me numër të madh të nxënësve nëpër klasa. Në disa raste numri i tyre arrin deri në 47 nxënës në një klasë,¹⁴² që realisht e pamundëson mësimnxënien dhe mësimdhënien efektive

Në kontekst të zbatimit të së drejtës për arsim mbetet shqetësuese dukuria e braktisjes së shkollimit dhe analfabetizmi. Braktisja e shkollimit është e shprehur sidomos në zonat rurale. Faktorë që e favorizojnë braktisjen e shkollimit janë: kushtet e vështira ekonomike; mungesa e përkrahjes së mjaftueshme nga familja; mentaliteti patriarkal, në disa zona të vendit (sidomos për vajza); largësia

¹⁴⁰ Intervista e ministrit të MASHT-it, Enver Hoxhaj, dhënë gazetës së përditshme “Kosova Sot”, më 28 dhjetor 2010.

¹⁴¹ Rasti i vrasjes në tentativë në ambientet e gjimnazit “Kuvendi i Arbrit” në Ferizaj, me ç’rast u plagosën tre nxënës.

¹⁴² Deklaratë e drejtorit të DKA-së në Podujevë. z. Nexhmi Rudari, gazeta “Zëri”, e hënë, 4 tetor 2010. Shih po ashtu gjimnazin “Xhevdet Doda” në Prishtinë, dhjetor 2010.

e shkollës; emigracioni; mungesa e informacioneve për rolin e vërtetë të shkollës, si dhe rastet për shkak të gjakmarrjes.¹⁴³

Institucioni i Avokatit të Popullit rekomandon MASHT-in që në bashkëpunim me drejtoritë komunale të arsimit të organizojnë fushata vetëdijesimi për nxënësit dhe prindërit e tyre, për rëndësinë e shkollimit, sidomos në zonat rurale.

Po ashtu, Avokati i Popullit rekomandon që të gjenden forma për të përkrahur familjet në nevojë, përmes sigurimit të transportit, në mënyrë që të ndikohet në uljen e dukurisë së braktisjes së shkollimit.

MASHT-i, në bashkëpunim me drejtoritë komunale të arsimit, ka disa vite, që është duke e zhvilluar programin për shkollim joformal dhe shkollimin e të rriturve, përmes të cilit është ndikuar që numri i përgjithshëm i analfabetëve të ulët. Mirëpo, numri i personave analfabetë, në Republikën e Kosovës, mbetet ende me përmasa shqetësuese.

Niveli i pjesëmarrjes së nxënësve nga komunitetet pakicë, në procesin arsimor, ende mbetet i ulët. Edhe pse qeveria e Kosovës, në vitin 2007, ka miratuar “Strategjinë për Integrimin e Komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian 2007 – 2017”, statistikat dëshmojnë se niveli i pjesëmarrjes së tyre në procesin e arsimit ende është shumë i ulët.¹⁴⁴

Braktisja e shkollimit nga pjesëtarët e këtyre komuniteteve të lartpërmendura është kryesisht pasojë e gjendjes së tyre të rëndë ekonomike, por edhe të njohurive të pakta të prindërve për rëndësinë e shkollimit të fëmijëve të tyre. MASHT-i ka zhvilluar plan-programet nga klasa e I deri në klasën e XIII, në gjuhën turke dhe boshnjake, si dhe ka botuar, gjatë vitit 2010, disa tekste në gjuhët e këtyre komuniteteve. Mirëpo, ende vihet re mungesa e teksteve për shkolla të mesme profesionale dhe për gjimnaze, në gjuhët e këtyre komuniteteve.

Avokati i Popullit kërkon nga Qeveria e Republikës së Kosovës, sidomos nga MASHT-i, që të ndër marrë hapa konkretë për implementimin e strategjisë për integrimin e komuniteteve pakicë në Republikën e Kosovës.

Komuniteti serb, si dhe një pjesë e komunitetit rom dhe goran, vazhdojnë të jenë jashtë sistemit arsimor të Kosovës. Këto komunitete vazhdojnë të punojnë, me një organizim të sistemit arsimor paralel, duke zbatuar plan-programet arsimore të servuara nga Ministria e Arsimit e Republikës së Serbisë. Në këtë mënyrë, dy sisteme të ndara arsimore pengojnë integrimin dhe ndërveprimin në mes vetë nxënësve, por edhe mësimdhënësve të të dy komuniteteve, rom dhe goran. Muajve të fundit, një pjesë e mësimdhënësve të disa lokaliteteve me shumicë serbe, ka filluar nënshkrimin e kontratave të punës me drejtoritë komunale të arsimit të Republikës së Kosovës, por në këtë drejtim ende ka paqartësi në mesin e mësimdhënësve të komunitetit serb, prandaj një pjesë e tyre heziton të nënshkruajë kontrata pune me drejtoritë komunale të arsimit, për t’u bërë pjesë e sistemit arsimor të Republikës së Kosovës.¹⁴⁵

Sa i përket motivimit të mësimdhënësve vihen re disa përparime. Një ndikim pozitiv në pozitën sociale të punëtorëve të arsimit pritet të ketë mospërfshirja e mësimdhënësve në Ligjin për

¹⁴³ Në rastin e regjistruar në Institucionin e Avokatit të Popullit parashtruesi i ankesës N.N. nga Komuna e Ferizajt është ankuar për shkak se 9 fëmijë të familjes së tij, që nga muaji shkurt i vitit 2010, nuk kanë mundur të vijnë në mësim në shkollë, për shkak të frikës së hakmarrjes nga familja me të cilën ankesi ishte në hasmëri.

¹⁴⁴ Shih “Statistikat e Arsimit në Kosovë 2009/2010”, publikuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

¹⁴⁵ Kryetari i komunës së Parteshit, z. Nenad Cvetković, gazeta “Koha Ditore”, datë 6 janar 2011.

Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.¹⁴⁶ Me këtë lejohet fleksibilitet në politikën e pagesave dhe procedurave administrative, gjë e cila pritet të sjellë ndryshime të rëndësishme pozitive në statusin social të mësimdhënësve në Kosovë. Në anën tjetër, programi i MASHT-it, për rikualifikimin dhe avancimin e mësimdhënësve, përveç se do të ndikojë në ngritjen e tyre profesionale, do të ketë efekt edhe në mënyrën e pagesave.

Viteve të fundit Universiteti i Prishtinës e ka rritur numrin e studentëve të rinj. Ndërkaq një problem që e përcjell tash e sa vite Universitetin e Prishtinës, është mungesa e teksteve përkatëse për studim. Studentët, në mungesë të literaturës përkatëse janë të detyruar të mësojnë, në të shumtën e rasteve, vetëm nga shënimet e ndryshme, të cilat arrijnë t'i sigurojnë gjatë ligjëratave, apo nga të ashtuquajturat "skripta", përmes të cilave studentët vështirë se do të mund të realizojnë studim të mirëfilltë. Deri më tani MASHT-i dhe Universiteti i Prishtinës nuk kanë ndërmarrë ndonjë hap drejt përmirësimit të kësaj gjendjeje. Fatkeqësisht, edhe konkurrenca nga sektori privat i arsimit universitar, me gjithë përpjekjet individuale për futjen e metodave të reja të studimit, si dhe botimin e disa teksteve universitare, nuk ka ndikuar dukshëm në ngritjen e nivelit të arsimit universitar.

4.22. Liria e artit dhe e shkencës

Liria e krijimtarisë artistike dhe shkencore është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës¹⁴⁷ dhe është në përputhje me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të zbatueshme drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës.¹⁴⁸

Të drejtat e autorit janë ndër format më të vjetra të pronës intelektuale dhe përfshinë të drejtat mbi veprat e autorëve në lëmin e letërsisë, shkencës dhe artit. Nga të gjitha të drejtat tjera që burojnë nga prona intelektuale, të drejtat e autorit janë ato që shkelen më së shumti

Kuvendi i Republikës së Kosovës e ka miratuar Ligjin për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të përafërta, i cili ka për qëllim mbrojtjen dhe zhvillimin e pronës intelektuale në përgjithësi dhe mbrojtjen e të drejtave të autorit në veçanti.¹⁴⁹

E drejta e pronës intelektuale në Kosovë, përveç ligjit të lartpërmendur mbrohet edhe me ligjet në vijim: Ligji për Patenta; Ligji për Dizajnin Industrial, si dhe Ligji për Markat Tregtare.¹⁵⁰

Gjatë kësaj periudhe të raportimit, Institucioni i Avokatit të Popullit nuk ka marrë asnjë ankesë për cenimin e lirisë së artit dhe të shkencës, edhe pse jemi të bindur se ka shkelje të kësaj të drejte. E gjithë kjo ndodhë, veç të tjerash për shkak të mungesës së njohurive të opinionit në përgjithësi dhe për mundësitë që i ofron ligjet në fuqi. Pikërisht kjo ka bërë që edhe gjykatat të mos kenë asnjë rast, në të cilën pretendohet për shkelje të këtij ligji.

¹⁴⁶ Ligji për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr. 03/L – 149, Neni 4, paragrafi 1.

¹⁴⁷ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 48.

¹⁴⁸ Shih KEDNJ, neni 10; Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, neni 19.

¹⁴⁹ Ligji për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e tjera të Përafërta, nr. 2004/45, 29 qershor 2006.

¹⁵⁰ Shih Ligji për Patenta, 2004/49; Ligji për Dizajnin Industrial, 2005/02 L 45; Ligji për Markat Tregtare, 2006/2 L 54.

4.23. E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit

E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit është njëra nga të drejtat themelore të njeriut, e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Kjo e drejtë rregullohet dhe mbrohet edhe me instrumente juridike ndërkombëtare, siç janë konventat dhe rekomandimet e Organizatës Ndërkombëtare të Punës.

Pas miratimit të Ligjit të Punës nga Kuvendi i Kosovës,¹⁵¹ kjo e drejtë mbrohet edhe me një instrument ligjor vendor, i cili i përcakton të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës dhe ofron një mbrojtje më efektive ligjore të drejtave të punëtorëve, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat.¹⁵² Avokati i Popullit përshëndet çdo lëvizje pozitive në fushën e të drejtave ekonomike dhe sociale sidomos rregullimin e marrëdhënies së punës dhe inkurajon të gjitha institucionet publike dhe aktorët tjerë relevantë për zbatimin e këtyre normave ligjore në praktikë.

Çështja e papunësisë në Kosovë edhe më tutje mbetet çështja sociale më serioze, me të cilën përballen të gjithë qytetarët e Kosovës. Përveç papunësinë e madhe, praktika ka dëshmuar se për sa i përket të drejtës për punë dhe sidomos të drejtave në punë, institucionet e publike në Kosovë, nuk i zbatojnë të gjitha dispozitat ligjore dhe në vazhdimësi kemi shkelje të drejtës së punës dhe ushtrimit të profesionit.

Institucioni i Avokatit të Popullit, në kuadër të mandatit kushtetues dhe ligjor, në vazhdimësi ka përcjellë edhe këtë fushë. Në bazë të dhënave aktuale të Ministrisë së Punë dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), gjatë vitit 2010 është shënuar një rënie e shkallës së papunësisë. Në vitin 2009, në Kosovë të papunë ishin 338.895 persona, të cilët ishin të regjistruar në shërbimet publike të punësimit. Ndërsa në vitin 2010 janë regjistruar 335.926 persona të papunë, nga ta 160.065 janë femra dhe 175.861 meshkuj. Këto të dhëna bazohen në Raportin e Performancës për vitin 2009/2010, të hartuar nga Departamenti i Punës dhe i Punësimit (DPP) i MPMS.¹⁵³

Sipas vlerësimeve të MPMS-së në Kosovë rreth 38 deri në 40 % e popullatës aktive është e papunë. Sipas gjitha gjasave këto shifra nuk e paraqesin gjendjen reale të papunësisë, sepse shumë persona të papunë nuk paraqiten fare në shërbimet publike të punësimit për t'u regjistruar si punëkërkues.

Avokati i Popullit vlerëson se edhe pas miratimit të Ligjit të Punës në Kosovë, nuk është shënuar ndonjë progres, lidhur me zbatimin e dispozitave ligjore nga punëdhënësit, si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat. Shkeljet më të mëdha janë vërejtur me rastin e punësimit, në shkeljen e procedurave të punësimit, ndërprerjen e marrëdhënies së punës, moskompensim për punën jashtë orarit, mosshfrytëzim i drejtës për pushim vjetor etj. Nga hetimet e bëra dhe nga informacionet e marra, rezulton se në sektorin privat edhe më tutje një numër i konsiderueshëm i punëdhënësve punësojnë fuqinë punëtore nga tregu i zi me qëllim që të mos lidhin kontratë pune, e cila do t'i mbronte të drejtat e të punësuarve.

Edhe më tutje, ndër çështjet më shqetësuese në përgjithësi për shoqërinë kosovare e njëkohësisht edhe për Avokatin e Popullit mbetet çështja e punës së fëmijëve. Fëmijë të moshës jo madhore i hasim duke punuar (duke shitur cigare, me karrocë dore, etj.), madje edhe në orët e vona të natës. E kjo është e dëmshme dhe shumë e rrezikshme për shëndetin e tyre. Edhe pse kjo është e ndaluar dhe fëmijët gëzojnë mbrojtje ligjore, si me legjislacionin vendor, po ashtu edhe me Konventën mbi të

¹⁵¹ *Ligji i Punës* nr.03/L-212, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës, më 1nëntor 2010.

¹⁵² *Po aty*.

¹⁵³ *Raporti i Performancës i DPP të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, 2009/2010 (06/2009-06-2010)*.

Drejtat e Fëmijës, kjo dukuri vazhdon pa ndonjë ndryshim. Veprimi i institucioneve publike përgjegjëse, për parandalimin e punës së fëmijëve, nuk vërehet. Në këtë drejtim, nuk vërehet as ndonjë ndryshim i qasjes shoqërore ndaj kësaj dukurie të dëmshme dhe jashtëzakonisht të rrezikshme.

Përveç dukurisë së punës së fëmijëve, shkeljet e mëdha ndodhin në vetë tregun e punës, si në atë publik, ashtu edhe në atë privat. Avokati i Popullit konsideron se Inspektorati i Punës, si një mekanizëm parandalues dhe përgjegjës për zbatimin e ligjit, duhet të kontrollojë të gjitha vendet e punës, si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat. Përveç përmbushjes së kërkesave tjera ligjore, Inspektorati i Punës duhet të fokusohet, sidomos në kontrollimin e kushteve të punës, sigurinë dhe shëndetin në punë dhe ambientin e punës. Ai po ashtu duhet të veprojë në mënyrë aktive për ndalimin e të gjitha llojeve të diskriminimit në vendin e punës, e sidomos t'i kushtojë kujdes të veçantë moshës minimale të të punësuarve në tregun privat të punës. Inspektorati i Punës është njëkohësisht edhe përgjegjës për zbatimin e dispozitave të aplikueshme nga marrëdhënia e punës.

Deri në fund të vitit 2010, Institucioni i Avokatit të Popullit, lidhur me të drejtën e punës dhe ushtrimit të profesionit, ka regjistruar 51 ankesa. Nga këto vetëm 3 raste janë zgjidhur pozitivisht. Mirëpo, kur kihet parasysh se jo të gjitha rastet lajmërohen në IAP, në rastet e problemeve nga marrëdhënia e punës, Avokati i Popullit vlerëson se numri personave që ballafaqohen me mohimin apo edhe shkeljen e të drejtës së punës, mund të jetë edhe më i madh.

Bazuar në hetimet e zhvilluara dhe në periudhën raportuese, Avokati i Popullit vlerëson se këto raste të shkeljes të së drejtës nga marrëdhënia e punës, paraqesin edhe dështimin e autoriteteve publike si palë përgjegjëse, që t'u përgjigjen rekomandimeve të Avokatit të Popullit.

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, Institucioni i Avokatit të Popullit ka pranuar një numër të madh ankesash, lidhur me *moszbatimin e vendimeve* të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës (KPMK), të cilat konsiderohen shkelje serioze e të drejtës së punës. Edhe pse KPMK është institucion i pavarur kushtetues,¹⁵⁴ vendimet e tij nuk zbatohen nga institucionet përgjegjëse. Lidhur me moszbatimin e tyre, Avokati i Popullit u ka dërguar letra dhe ka bërë rekomandime për autoritetet publike, për moszbatimin e vendimeve të KPMK-së.

Në muajin maj 2010, Avokati i Popullit, e pranoi një ankesë të një individi nga Komuna e Shtimes, i cili pohonte se Kryetari i Kuvendit Komunal të Shtimes, kishte dështuar të zbatojë Vendimin e KPMK.¹⁵⁵ Avokati i Popullit, me një letër-rekomandim të datës 14 maj 2010, e përkujtoi kryetarin e komunës së Shtimes, lidhur me moszbatimin e vendimit të KPMK-së.¹⁵⁶ Lidhur me rastin, Avokati i Popullit rekomandoi që të ndërmerren masat e menjëhershme për zbatimin e vendimit të KPMK. Deri në publikimin e këtij raporti vjetor, Avokati i Popullit *nuk ka marrë asnjë përgjigje* në këtë letër-rekomandim dhe nuk është i informuar nëse është vepruar apo do të veprohet sipas rekomandimeve të tij.

Më 29 shtator 2010, IAP e pranoi një ankesë lidhur me shkeljen e të drejtës nga marrëdhënia e punës të një qytetari, drejtor i një shkolle në komunën e Prishtinës.¹⁵⁷ Me këtë vendim KPMK kishte aprovuar ankesën e parashtruesit dhe komuna e Prishtinës ka qenë e obliguar ta zbatojë të

¹⁵⁴ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 101.2.

¹⁵⁵ Shih *Vendimi i KPMK-së A 02/176/2009*, datë 11.09.2009.

¹⁵⁶ *Ligji për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil të Kosovës*, neni 13: "Vendimi i Këshillit paraqet vendimin administrativ të formës së prerë dhe ekzekutohet nga zyrtarit të nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës".

¹⁵⁷ Shih *Vendimi i KPMK-së*, nr. 02/196/2009, datë 1 mars 2010.

njëtin. Bazuar në ankesën e qytetarit dhe vendimin e KPMK-së, Avokati i Popullit i dërgoi një letër Drejtorit të Drejtorisë për Arsimit të komunës së Prishtinës, duke kërkuar të mësojë për arsyet e moszbatimit të vendimit. Deri në publikimin e këtij raporti, Avokati i Popullit nuk ka pranuar përgjigje nga komuna e Prishtinës nëse është zbatuar vendimi i KPMK-së.

Duke iu referuar rasteve të lartpërmendura dhe rasteve tjera të ngjashme, Avokati i Popullit konstaton se moszbatimi i vendimeve të KPMK nga autoritetet publike, nuk i shërben ngritjes dhe përmirësimit të standardeve të shtetit ligjor. Përkundrazi, zbeh autoritetin e institucioneve dhe krijon premisa për humbjen e besimit për drejtësinë dhe shtetin ligjor, duke cenuar të drejtat dhe liritë e qytetarëve të garantuara me Kushtetutë dhe ligje.

Në periudhën raportuese, përveç rasteve të dështimit të institucioneve në zbatimin e vendimeve të institucioneve të pavarura, sidomos të KPMK, IAP ka regjistruar edhe 3 raste të ankesave të zgjidhura pozitivisht, pjesërisht ose drejtpërdrejt, si rezultat i angazhimit të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Më 30 dhjetor 2009, Institucioni i Avokatit të Popullit ka pranuar një ankesë kundër MPMS, lidhur me moszbatimin e vendimit të KPMK.¹⁵⁸ Avokati i Popullit, bazuar në mandatin ligjor, me një letër i është drejtuar ministrit të MPMS-së, z. Rashi, për rastin e ankuesit.¹⁵⁹ Rasti është zgjidhur në pajtim me ligjin, në favor të ankuesit. Nga letra të cilën Avokati i Popullit e pranoi nga MPMS, merret vesh se rasti është zgjidhur pozitivisht dhe ankuesi ka filluar punën.

Bazuar në gjithë atë që u tha më lartë, AP rekomandon që të respektohen dispozitat e Ligjit të Punës në Republikën e Kosovës dhe ato të zbatohen nga institucionet përgjegjëse.

Veçanërisht, Avokati i Popullit kërkon nga të gjitha institucionet publike të Republikës së Kosovës që të respektojnë dhe zbatojnë vendimet dhe rekomandimet e institucioneve të pavarura, ndër to edhe të IAP dhe të KPMK, dhe njëkohësisht që të gjithë personat përgjegjës për mos-respektimin e tyre të sanksionohen sipas ligjeve në fuqi.

4.24. Të drejtat e fëmijëve në Kosovë

Në realitetin kosovar mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të fëmijëve mbetet edhe më tutje sfidë e madhe, me gjithë përparimet dhe përpjekjet e bëra, në këtë drejtim, nga institucionet e Kosovës.

Pozita e fëmijëve, mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të tyre, përveç të tjerash është e kushtëzuar edhe me situatën e përgjithshme ekonomike dhe sociale të vendit, e cila është e rëndë për shumicën e popullsisë në Kosovë.

Niveli i mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, respektimi, si dhe avancimi i tyre ndërlihet edhe me mënyrën e zbatimit të legjislacionit për të drejtat e fëmijëve, nga institucionet që kanë obligim ta bëjnë këtë e që shpeshherë është i pamjaftueshëm, jo adekuat apo edhe jo efektiv. Por, gjithsesi, mbrojtja, respektimi dhe avancimi i të drejtave të fëmijëve, respektivisht përmirësimi i jetës së fëmijëve në Kosovë, nuk mund të kuptohet dhe nuk është obligim vetëm i institucioneve shtetërore.

¹⁵⁸ *Po aty*, nr. 20/2010, datë 18 mars 2010.

¹⁵⁹ Shih *Letra e Avokatit të Popullit*, drejtuar Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, më 1 qershor 2010. Në përgjigjen e MPMS-së, drejtuar Avokatit të Popullit, më 04 qershor 2010, nr. 3960, njoftohet se ankuesi ka filluar të punojë në vendin e tij të punës, nga data 4 maj 2010.

Për këtë duhet angazhim maksimal edhe i akterëve të tjerë, që punojnë në këtë lëmi dhe, para së gjithash, i shoqërisë në tërësi. Për zbatimin adekuat dhe efektiv të kornizës ligjore, planeve dhe politikave të mirëfillta shoqërore e institucionale, që në fokus të tyre kanë mbrojtjen dhe interesin më të mirë të fëmijës, të gjithë ne jemi përgjegjës.

4.24.1. Zbatimi i Strategjisë dhe Planit Nacional të Veprimit për të drejtat e fëmijëve

Me qëllim të zbatimit përkatës të legjislacionit për të drejtat e fëmijëve, si dhe koordinimit të punës së institucioneve qeveritare për mbrojtje efektive të të drejtave të fëmijëve, Qeveria e Republikës së Kosovës, në vitin 2009, miratoi Strategjinë dhe Planin Nacional të Veprimit për të drejtat e fëmijëve për periudhën 2009-2011. Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe në Konventën për të Drejtat e Fëmijës, Plani Nacional i Veprimit ka përcaktuar fushat prioritare, në të cilat është planifikuar ndërmarrja e veprimeve të nevojshme për përmirësimin e përgjithshëm të situatës së të drejtave të fëmijëve, e që i referohen përveç të tjerash edhe qeverisjes, arsimit, shëndetit dhe mirëqenies sociale.

Kur flitet për këtë plan dhe afatet e përcaktuara për realizimin e tij, mund të themi se disa nga detyrimet e marra përsipër janë përmbushur pjesërisht nga institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës, por megjithatë ende shumë mbetet për t'u bërë në këtë aspekt.

Sa i përket fushës së qeverisjes plani në fjalë, përveç të tjerash, ka paraparë funksionalizimin e Komitetit Ndërmintor për të Drejtat e Fëmijëve, komiteti i cili nuk është funksional. Ky komitet, si mekanizmi më i lartë qeveritar, është themeluar në vitin 2008, me qëllim të përmirësimit të efektivitetit të mekanizmave institucional ekzistues dhe që të garantojë zbatimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve në Kosovë. Në këtë kontekst, institucionalizimi i plotë i pozitave të zyrtarëve të veçantë për të drejtat e fëmijëve në nivelin qendror dhe lokal, është i domosdoshëm.

4.24.2. Mangësitë në fushën e arsimit të fëmijëve

Me këtë plan, fusha e arsimit është përcaktuar si prioritet i Qeverisë së Kosovës. Sipas tij është parashikuar gjithëpërfshirja e fëmijëve në arsim cilësor, zbatimi i ligjeve të arsimit parauniversitar, zbatimi i infrastrukturës që sanksionon dhunën në shkolla, përfshirja e orës së kujdestarisë në programet shkollore, si dhe organizimi i fushatave kundër dhunës ndaj fëmijëve.

Me gjithë faktin se disa nga këto zotime janë realizuar nga institucionet përkatëse qeveritare, dhuna ndaj fëmijëve vazhdon të mbetet çështje shumë shqetësuese. Gjatë kësaj periudhe raportuese, IAP ka pranuar ankesa për dhunën nëpër shkolla.

4.24.3. Dukuria e dhunës në shkolla

Rasti i keqtrajtimit të një nxënësi nga ana e arsimtarit, në një shkollë fillore të komunës së Gjilanit, është vetëm një nga shembujt. Për shkak të lëndimeve të pësuar nxënësin e keqtrajtuar e kishin dërguar në qendrën emergjente të spitalit të qytetit. Avokati i Popullit lidhur me rastin u është

drejtuar autoriteteve përkatëse, duke kërkuar ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme të parapara me legjislacionin e zbatueshëm.

Institucionet përgjegjëse, me qëllim të zvogëlimit të kësaj dukurie, duhet të vazhdojnë me zbatimin e legjislacionit përkatës, si dhe plotësimin e tij. Ato duhet të ndërmarrin aktivite për ngritje të vetëdijes së shoqërisë, në veçanti të mësimitdhënësve, se përdorimi i dhunës ndaj fëmijëve është i dëmshëm, i kundërligjshëm dhe si i tillë nuk mund të tolerohet. Në këtë kontekst, është e domosdoshme që në shkollat e Kosovës, përveç personelit tjetër shkollor të përfshihen edhe pedagogë dhe psikologë, që po ashtu do të ndihmonin në këtë drejtim. Gjithashtu, me qëllim të mbarëvajtjes së procesit cilësor mësimor, institucionet përkatëse, veç të tjerash, do të duhej të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme që ora e kujdestarisë të përfshihet detyrimisht në programet shkollore .

4.24.4. Braktisja e shkollimit

Në lidhje me synimet e realizimit të së drejtës së arsimit për të gjithë, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), ka hartuar Planin e Veprimit kundër braktisjes së shkollës, i cili u publikua në vitin 2010. Edhe pse nga të dhënat e siguruar nga MASHT rrjedh se numri i nxënësve që e kanë lënë shkollën, në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët, për vitin shkollor 2009/2010, ka shënuar rënie në krahasim me vitin shkollor 2008/2009, braktisja e shkollës nga 1920 nxënës, gjatë vitit 2009/2010, është brengosëse. MASHT, së bashku me institucionet e tjera relevante do të duhej të vazhdonte ndërmarrjen e veprimeve përkatëse, të përcaktuara me planin e veprimit, me qëllim të parandalimit të kësaj dukurie. Ndërkaq, shkaqet e braktisjes së shkollës mund të jenë nga më të ndryshmet, kurse shpesh ndërliiden edhe me gjendjen e rëndë ekonomike dhe varfërinë.

IAP është angazhuar në një rast ku fëmijët e një familjeje kishin braktisur shkollën për shkak të gjakmarrjes. Këtyre fëmijëve - nxënës, mësimitdhënësit e shkollës së fshatit për çdo ditë u mbanin 1-2 orë mësim në shtëpi. IAP nga autoritetet përkatëse kishte kërkuar që këtyre fëmijëve mësimi t'u mbahet me më shumë orë, derisa të mos gjendej një zgjedhje adekuate. Në rastin konkret, IAP përveç ndërmjetësimit tek familjet e hasmuara, ka kërkuar nga institucionet gjegjëse të sigurojnë lëvizjen e lirë, të drejtën e punës dhe vazhdimin e shkollimit, për të gjithë, pa marrë parasysh natyrën e konfliktit, ashtu si është e paraparë me Kushtetutë dhe ligj.

4.24.5. Puna e fëmijëve

Me qëllim të përmirësimit të situatës, lidhur me punën e fëmijëve, në kuadër të prioriteteve të Planit Nacional në fushën e mirëqenies sociale, gjatë kësaj periudhe të raportimit, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), me partnerë të tjerë përgjegjës, ka vazhduar ndërmarrjen e aktiviteve që ndërliiden me funksionalizimin e Komitetit Kosovar për parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve. Ndër të tjera, ky komitet do të duhej të merrej me zbatimin e listës për punët e rrezikshme, monitorimin dhe vlerësimin e punëve të rrezikshme nga komitetet lokale të veprimit, si dhe me shpërndarjen e të dhënave mbi situatën dhe progresin e monitorimit të punës së fëmijëve. Nisur nga situata e rëndë ekonomike-sociale e vendit, me gjithë aktivitetet e ndërmarrja,

çështja e punës së fëmijëve mbetet sfidë e madhe për shoqërinë dhe institucionet publike të Kosovës.

Pavarësisht nga kjo situatë e rëndë, Qeveria e Kosovës medoemos duhet që sa më shpejtë të miratojë një strategji dhe planin e veprimit për parandalimin dhe eliminimin e formave më të rrezikshme të punës së fëmijëve në Kosovë, si dhe të fillojë me zbatimin konsekuent dhe adekuat të saj. Detyrimi i miratimit të një strategjie dhe plani të tillë rrjedh edhe nga Udhëzimi Administrativ nr. 17/2008, për parandalimin dhe eliminimin e punëve më të rrezikshme për fëmijët në Kosovë. Dhe, që nga viti 2008, nuk është ndërmarrë gjë.

Puna e rëndë dëmton shëndetin dhe mirëqenien e fëmijëve dhe si e tillë paraqet edhe shkelje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës¹⁶⁰ dhe të Konventës për të Drejtat e Fëmijës,¹⁶¹ e cila është drejtpërdrejt e zbatueshme në Republikën e Kosovës.¹⁶²

4.24.6. Mungesa e mirëqenies sociale për fëmijët

Në planin e mirëqenies sociale, me gjithë përparimet e bëra, fatkeqësisht duhet konstatuar se fëmijët me nevoja të veçanta janë në gjendje më të rëndë se fëmijët e tjerë. Në këtë kontekst, lidhur me çështjen e mospagesës së shumë s s caktuar të të hollave familjeve, që në gjirin e tyre kanë nën përkujdesje fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme, IAP u është drejtuar autoriteteve përkatëse. Gëzimi i kësaj të drejte u ishte mohuar për shumë muaj atyre, edhe pse kjo u garantohej me Ligjin nr. 03/L-022 për Përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme. Mospagesa e saj kishte rënduar edhe më tepër gjendjen e tyre ekonomike, e cila edhe ashtu ishte mjaft e rëndë, e në veçanti ka përkeqësuar mirëqenien e fëmijëve. Në këtë drejtim Qeveria e Kosovës, duhet të ndajë mjete të mjaftueshme financiare për të siguruar realizimin e kësaj të drejte pa pengesa. Po ashtu, Qeveria e Kosovës duhet të sigurojë që mjetet e ndara për të ndihmuar këtë kategori të familjeve të shfrytëzohen vetëm për qëllimin për të cilin edhe janë ndarë.

4.24.7. Diskriminimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara

Sipas Konventës për të Drejtat e Fëmijës, fëmija me paaftësi mendore ose fizike duhet të bëjë jetë normale dhe të përshtatshme, në kushte që garantojnë dinjitetin e tij, që nxisin autonominë dhe lehtësojnë pjesëmarrjen e tij aktive në jetën e bashkësisë.¹⁶³ Atyre dhe të tjerëve që kujdesen për ta, shteti, përveç të tjerash, brenda mundësive duhet t'u sigurojë edhe një ndihmë materiale të përshtatshme për një jetë dinjitoze. Në këtë drejtim, Qeveria e Kosovës, gjithashtu, do të duhej ta përfronte dhe përshtaste legjisllacionin vendor që rregullon këtë fushë me legjisllacionin ndërkombëtar, i cili do t'u garantonte përkrahje sociale të gjithë fëmijëve me aftësi të kufizuara të pjesshme, mendore apo fizike, që nga mosha 0 deri në 18 vjeç.

¹⁶⁰ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 50.

¹⁶¹ Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, neni 32, i cili garanton të drejtën e fëmijës që të jetë i mbrojtur nga shfrytëzimi për përfitime materiale, nga kryerja e punëve që mund të jenë të rrezikshme, që pengojnë arsimimin e fëmijës apo mund të dëmtojnë shëndetin fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror të fëmijës.

¹⁶² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22 .

¹⁶³ Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, neni 23.

4.24.8. Trafikimi me qenie njerëzore- fëmijët viktima

Si pjesë përbërëse e prioriteteve të Planit Nacional të Veprimit për të drejtat e fëmijëve, është edhe luftimi i dukurisë së trafikimit me qenie njerëzore, që doemos duhet të adresohet nga institucionet përkatëse. Nga informatat e siguruar, nga përfaqësues të Policisë së Kosovës, si dhe të Divizionit për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave të Ministrisë së Drejtësisë, pjesën dërrmuese të viktimave të trafikuar gjatë vitit 2010 e përbëjnë vajzat e mitura, të trafikuar për qëllim të shfrytëzimit seksual.

Në këtë kontekst IAP ka pranuar një ankesë me të cilën një prind ankohej se Policia e Kosovës nuk kishte ndërmarrë veprimet e nevojshme, që rasti i bijës së tij të trajtohej si rast i trafikimit të qenieve njerëzore, me gjithë të dhënat dhe elementet e mjaftueshme që tregonin se fjala ishte për trafikim të qenieve njerëzore. Me qëllim të zhvillimit të hetimeve lidhur me rastin përfaqësues të IAP kontaktuan përfaqësues të Sektorit për Hetimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe me institucione të tjera përgjegjëse, që punojnë në identifikimin dhe ofrimin e shërbimeve për viktimat e trafikimit. Rasti është duke u proceduar në institucionin përkatës.

Për luftimin më të suksesshëm të parandalimit të trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe të mbrojtjes së fëmijëve të trafikuar, institucionet përkatëse të Qeverisë së Kosovës do të duhej të vazhdonin me trajnimin e ofruesve të shërbimeve, lidhur me zbatimin e dokumentit mbi procedurat standarde të veprimit për viktimat e trafikimit në Kosovë, si dhe të atij mbi standardet minimale të kujdesit për viktimat e trafikimit.

Gjatë periudhës raportuese, IAP ka pranuar disa ankesa që kanë të bëjnë me moszbatimin të vendimeve të gjykatave, në lidhje me kontaktet personale të prindërve me fëmijë, si dhe për zvaritje të procedurës gjyqësore për të vendosur përkitazi me të drejtën e marrjes së fëmijës në mbikëqyrje, që fëmijët dhe prindërit e tyre i vënë në situata të rënda. Lidhur me këto raste IAP u është drejtuar autoriteteve përkatëse, nga të cilët ka kërkuar marrjen e veprimeve të duhura, të parapara me ligj. Në kontekst të vendosjes për çështjen e besimit të fëmijëve përfaqësueset e IAP, me kërkesën e palëve, kanë monitoruar seancat gjyqësore në disa gjykata të Kosovës. Gjithashtu, me kërkesën e palëve, IAP ka monitoruar seancat gjyqësore, të zhvilluara përkitazi me kërkesat për lëshim të urdhrin mbrojtës, ndarje të pasurisë së përbashkët të krijuar gjatë bashkësisë martesore, si dhe ato që kishin të bënin me lëndimet e pësura trupore, nga ushtrimi i dhunës në familje.

4.25. Mbrojtja shëndetësore dhe sociale

Edhe njëmbëdhjetë vite pas lufte, për Kosovën vazhdojnë të mbeten sfidë politikat sociale, gjendja ekonomike, numri i të papunëve, sistemi i shëndetësisë dhe infrastruktura shëndetësore, shkalla e mortalitetit në institucionet shëndetësore dhe gjendja e tanishme e legjisllacionit.

4.25.1. Problemet sociale dhe mungesa e legjislacionit

Problemi lidhur me bazën ligjore për rregullimin e çështjeve sociale dhe shëndetësore në Kosovë ende është i pazgjidhur. Në Kushtetutën e Republikës së Kosovës nuk është i integruar Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore.¹⁶⁴

Gjendja ekonomike dhe sociale e familjeve të cilat të vetmin burim të ekzistencës i kanë ndihmat sociale është e njëjtë, ashtu siç është raportuar edhe vitin e kaluar. Rreth 36 mijë familje, janë të evidentuara si përfituese nga skema sociale e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS). Sipas kësaj ministrie, buxheti i dedikuar skemave sociale për familjet në nevojë, në vitin 2010, është rritur për 7 %.

Edhe pse kategoritë sociale marrin një përkrahje materiale simbolike prej Qeverisë së Kosovës, skemat e ndihmave sociale nuk i plotësojnë as nevojat elementare të përfituesve të tyre. Këto ndihmat sociale, nuk janë të mjaftueshme. Këto ndihma nuk janë caktuar në bazë shportës ushqimore minimale për familjet në nevojë, ndërsa Qeveria e Kosovës nuk bën fare vlerësimin e nivelit të inflacionit dhe, në harmoni me rezultatet, të bëhet indeksi i këtyre skemave. Këto ndihma nuk garantojnë jetë të dinjitetshme as për një individ, e lëre më për një familje.

Gjithashtu, edhe më tej fëmijët mbi moshën 5-vjeçare mbesin të diskriminuar nga ligji që rregullon ndihmat sociale. Ky ligj, në mënyrë të çuditshme dhe pa ndonjë kriter të arsyetuar ekonomik apo shoqëror limiton moshën për përfitimin e ndihmave nga skema sociale.¹⁶⁵

Ligji për shërbime sociale dhe familjare është hartuar me qëllim të vendosjes së bazës ligjore për rregullimin dhe përparimin e shërbimeve sociale dhe familjare, për personat dhe familjet nevojtare në Kosovë. Ky ligj rregullon ofrimin e drejtpërdrejtë të përkujdesjes sociale, këshillimit, në raste e veçanta edhe të ndihmës materiale për njerëzit në nevojë sociale.¹⁶⁶

4.25.2. Diskriminimi i fëmijëve me aftësi të kufizuar

Në mënyrë që fëmijëve me aftësi të kufizuar të përherëshme, t'u mundësohet një jetë më normale në kushtet që garantojnë dinjitetin dhe lehtësojnë jetën e tyre, Kuvendi i Republikës së Kosovës, ka miratuar ligjin për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuar të përherëshme.¹⁶⁷

Ky ligj parasheh kategorizimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar të përherëshme. Ky nen në vete përfshin vetëm tri kategori të fëmijëve me aftësi të kufizuar të përherëshme.¹⁶⁸ Komisioni vlerësues për përcaktimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar të përherëshme, ka për detyrë të vlerësojë llojin, shkallën dhe peshën e shëndetit fizik, mendor apo shqisor të dëmtuar të fëmijës me aftësi të kufizuar të përherëshme.¹⁶⁹

Ky kategorizim është jo i plotë dhe po përcillet me pasoja të dëmshme. Shumë familje kosovare, me fëmijë me aftësi të kufizuar, si me pengesa në të folur dhe të dëgjuar apo me sëmundje të natyrës së ngecjeve të zhvillimit psikologjik, nuk mund të jenë shfrytëzues të ndihmës materiale të garantuar

¹⁶⁴ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22.

¹⁶⁵ Ligji për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë, nr. 2003/15, neni 4 pika b.

¹⁶⁶ Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare, nr. 02/L-172.

¹⁶⁷ Ligji për Përkrahje Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar të Përherëshme, nr. 03/L-022.

¹⁶⁸ Po aty, neni 6.

¹⁶⁹ Po aty, neni 7.

me këtë ligj, ngase fëmijët e tyre nuk janë të përfshirë në kategorizimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar të përhershme.

4.25.3. Problemi i skemave pensionale

Krijimi dhe aplikimi i skemave pensionale për kategoritë e caktuara të qytetarëve të Kosovës me qëllim të uljes së varfërisë, edhe pse i përkohshëm, edhe më tej aplikohet në Kosovë. Në vitin 2005, MPMS ka përgatitur projektligjin për Sigurimin Pensional dhe Invalidor, i cili është dërguar për miratim në Qeverinë e Kosovës. Mirëpo, Qeveria e Kosovës, tani gati 5 vite e zvarrit miratimin e këtij projektligji.¹⁷⁰

Përpjekje të tjera nga MPMS për miratim të projektligjit në fjalë janë bërë edhe në vitin 2007 dhe 2010, mirëpo deri më sot Qeveria e Kosovës ka dështuar të merret seriozisht me këtë çështje. Miratimi i këtij projektligji do të krijonte përfundimisht një kornizë ligjore për rregullimin e çështjeve për Sigurimin Pensional dhe Invalidor në Kosovë. Aktualisht skemat pensionale janë të bazuara në parimin gjithëpërfshirës, që nënkupton se të gjithë personat mbi moshën 65-vjeçare janë përfutues të pensionit bazë. Kurse të gjithë ata persona që ofrojnë dëshmi se kanë qenë të siguruar, kanë qenë pagues të kontributeve në bazë të marrëdhënies së punës dhe me përvojën e punës mbi 15 vjeçare që kanë, e gëzojnë të drejtën për rritje.¹⁷¹

Meqenëse gjatë luftës në Kosovë, një pjesë e madhe e dokumentacionit është zhdukur në mënyrë të qëllimshme nga forcat okupuese të Serbisë ose është marrë në Serbi, shumë qytetarë të Kosovës ballafaqohen me probleme për të dëshmuar përvojën e punës. Kjo ka ndikuar që shumë ish-punëtorë nuk kanë mundur të përfshihen në rritjen e pensioneve.

Aktualisht në Kosovë ekzistojnë ligje, të cilat e rregullojnë çështjen e pensioneve të kategorive të caktuara, si Ligji për pensionet e pjesëtarëve të Trupave Mbrojtës të Kosovës (TMK) dhe të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK),¹⁷² Ligji për persona me aftësi të kufizuar për personat e rritur.¹⁷³

Në mungesë të ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor, shumica e qytetarëve të Kosovës, duke mos qenë të informuar drejt, bien në konfuzion dhe i drejtohen MPMS-së, me kërkesë për t'u përfshirë në skemën e shfrytëzuesve të pensionit për persona me aftësi të kufizuar. Bazuar në kriteret bazë për fitimin e këtij pensioni, gati të gjithë refuzohen nga komisioni mjekësor, i cili vendos për shkallën e kufizimit të aftësisë së parashtruesve të kërkesës.

Kjo paraqet një problem shtesë për qytetarët e painformuar, sepse palëve u shkaktohet humbje kohe dhe shpenzime të panevojshme për shfrytëzim të mjeteve juridike. rastet ku qytetarët e Kosovës ankohen në Institucionin e Avokatit të Popullit, kundër vendimeve të komisionit mjekësor, janë pothuajse të përditshme. Institucioni i Avokatit të Popullit e ka ngritur këtë çështje në MPMS-së dhe ka marrë përgjigje shteruese bazuar në ligj, por që nuk e rregullon këtë çështje. Sepse, sërish duhet theksuar, mungon një ligj për sigurimin pensional dhe invalidor në Kosovës, që do të rregullonte këtë çështje.

¹⁷⁰ Shih *Vendimi i Qeverisë së Kosovës*, nr. 04/227, i datës 29 nëntor 2006.

¹⁷¹ *Po aty*, nr. 13/277, i datës 31 tetor 2007.

¹⁷² *Ligji për Pensionet e Pjesëtarëve të Trupave Mbrojtës të Kosovës*, nr. 03/L-100.

¹⁷³ *Ligji për Persona me Aftësi të Kufizuar*, nr. 2003/23.

Problemet sociale dhe ekonomike në Kosovë nuk përfundojnë vetëm me rastet e evidentuara sociale. Edhe pse akoma nuk ka statistika zyrtare të sakta për numrin e popullsisë në Kosovë, supozohet se Kosova ka popullatën më të re në Evropë. Nisur nga ky fakt, çështja e përfshirjes së gjeneratave të reja në tregun e punës, në një shkallë të papunësisë mbi 45 % në Kosovë, duket një problem kapital për Qeverinë e Kosovës.

4.25.4. Problemet në shëndetësinë e Kosovës

Sa i përket mbrojtjes shëndetësore, qytetarët e Kosovës edhe më tej po përballen me probleme të cilat, nuk janë duke u trajtuar në mënyrë serioze nga ana e Qeverisë së Kosovës, edhe pse tanimë ka një kornizë ligjore për shëndetësi, e cila nuk është e mjaftueshme.

Miratimi i Ligjit për Sigurime Shëndetësore, i cili do të jetë zgjidhje edhe për problemet e tjera në sistemin shëndetësor, sipas Ministrisë së Shëndetësisë, ka mbetur çështje e hapur në Kuvendin e Kosovës. E kjo zvarritje nga institucionet përgjegjëse, i dëmton qytetarët e Kosovës, të cilët përballen me një gjendje të rëndë shëndetësore.

Rregullimi i sistemit shëndetësor dhe i shërbimeve shëndetësore në Kosovë do të duhej të ishte një nga prioritetet emergjente të Qeverisë së Kosovës. Mungesa e barnave në klinikat e QKUK-së ka qenë dhe është evident akoma. Në listat esenciale të barërave në QKUK janë të përfshira 59 % e barërave, prej të cilave citostatikët përbëjnë 43 %, kurse materiali shpenzues 56.7 %. Qendrat e mjekësisë familjare janë në një gjendje edhe më të keqe, në këtë aspekt. Qeveria e Kosovës përfundimisht duhet të merret seriozisht me furnizimin e institucioneve shëndetësore me barna dhe materiale shpenzuese.¹⁷⁴

Një problem më vete paraqet edhe tregu i barnave medicinale në Kosovë. Është përgjegjësi e Qeverisë së Kosovës që të monitorojë, në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike kualitetin, origjinën, si dhe skadimin e afatit të të gjitha barnave që futen në territorin e Kosovës. Po ashtu Qeveria e Kosovës duhet të kërkojë përgjegjësi nga inspektorati edhe për barnat të cilat gjenden në tregun e Kosovës në qarkullim, udhëzimet e përdorimit të të cilave nuk janë të përkthyer së paku në një rën nga gjuhët zyrtare.

Gjithashtu, kushtet për pacientë, të cilët duhet të qëndrojnë për kurim në klinikat e QKUK, janë shumë të vështira. Përveç kushteve të vështira të pacientëve të shtrirë nëpër këto klinika, këtë vit i është shtuar edhe një problem tjetër. Ata gjatë dimrit që kaloi janë ballafaquar edhe me mungesë të ngrohjes, për shkak të shkycjes së QKUK-së nga rrjeti i Termokosit.

Mungesa e funksionalizimit të Institutit të Onkologjisë, ka bërë që pacientët e diagnostifikuar me kancer të drejtohen në institucionet shëndetësore jashtë vendit. Duke pasur parasysh se procedurat për shërim jashtë venit përmes Ministrisë së Shëndetësisë janë të gjata, shumica e atyre që për shkak të nevojave urgjente kanë qenë të obliguar që shërimin ta bëjnë me mjete financiare të vetat. Duke pas parasysh faktin se shpenzimet për trajtime të tilla janë mjaft të larta, në shumë raste kjo ka ndikuar në përkeqësimin e kushteve ekonomike të rënda të popullit të Kosovës, kurse ata që nuk kanë pasur mundësi ekonomike për të siguruar mjetet e nevojshme financiare, kanë vdekur.

Numri i pacientëve të cilët kanë kërkuar shërim jashtë vendit në Ministrinë e Shëndetësisë për këtë vit ka qenë 1050. Në 6 mujin e parë të vitit 2010, dërgimi për shërim jashtë vendit është ndërprerë

¹⁷⁴ Informata të siguruar nga e përditshma "Kosova Sol", 14 janar 2011.

nga Ministria e Shëndetësisë për shkaqe buxhetore. Nga Ministria e Shëndetësisë raportohet se rreth 300 pacientë janë dërguar në shërim jashtë vendit. Numri më i madh i pacientëve për shërim jashtë vendit është dërguar në Turqi, Gjermani dhe Shqipëri, kurse një numër shumë i vogël në shtete e tjera, si në Austri, SHBA etj.¹⁷⁵

Duke marrë parasysh shkallën e varfërisë dhe nevojat e mëdha, Qeveria e Kosovës, duhet urgjentisht të bëjë investime të nevojshme kapitale në infrastrukturën shëndetësore, në mënyrë që shumica e shërbimeve të avancuara, që kërkojnë ekspertizë të avancuar dhe janë të kushtueshme financiarisht, të mund të kryhen brenda vendit.

Ndër mungesat e shumta, me të cilat ballafaqohen qytetarët e Kosovës, është ekzistenca e një qendre për rehabilitim, si rregullimin e protezave të duarve, këmbëve, syve, dhe problemeve të tjera shëndetësore dhe fizikale, me standarde ndërkombëtare. Me gjithë faktin që numri i të rinjve në Kosovë, me probleme varësie është në rritje, nuk vërehet ndonjë lëvizje për krijimin e institucionit, për trajtimin dhe rehabilitimin e personave me sëmundje varshmërie.

Edhe pse është e rregulluar me ligj mbikëqyrja nga themeluesi i institucioneve që ushtrojnë veprimtari në shëndetësinë publike, si në aspektin menaxheria,¹⁷⁶ po ashtu edhe në atë të mbikëqyrjes profesionale, të brendshme dhe të jashtme,¹⁷⁷ në praktikë është krejt ndryshe.

Ky problem bëhet edhe më i madh kur kihet parasysh fakti se tregu i punës, në fushën e shëndetësisë në Kosovë, është i rregulluar në mënyrë gjysmake. Ky treg është i parregulluar dhe jashtëzakonisht i lënë pasdore dhe me parakushte kaosi e anarkie.

Me *Ligjin për veprimtarinë private në shëndetësi*, profesionisti i kujdesit shëndetësor privat mund të ofrojë shërbime private në institucionet publike shëndetësore.¹⁷⁸ Në anën tjetër, punëtori shëndetësor i punësuar në institucionet e shëndetit publik mund të kryejë veprimtari private të kujdesit shëndetësor, vetëm pas orarit të rregullt të punës.¹⁷⁹ Kjo përzierje ligjore e ofrimit të shërbimeve shëndetësore, pa rregullimin e qartë të tregut të punës në shëndetësinë kosovare, krijon hapësirë për manipulime dhe vë në pikëpyetje shëndetin publik dhe fatin e qytetarëve me kushte të rënda ekonomike dhe sociale e lë në mëshirën e një tregu të egër, të pakontrolluar fare.

Sipas të dhënave në IAP, shumë qytetarë të Kosovës ankohen kundër personelit mjekësor, ngase profesionistët e kujdesit shëndetësor publik, në pothuajse të gjitha rastet, gjatë orarit të punës së rregullt në institucionin publik, edhe pse trajtimi, përkujdesja dhe aparatura janë të njëjta, i udhëzojnë, shpeshherë edhe i detyrojnë qytetarët të shkojnë për kurim në sektorin privat (aty ku ata punojnë, pas orarit të rregullt). IAP është duke i hetuar rastet e tilla.

Nisur nga faktet dhe gjendja e pasqyruar, si një domosdoshmëri logjike, shtrohet nevoja që:

- *Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës të miratojnë infrastrukturën e nevojshme ligjore për rregullimin e skemave pensionale në Kosovë, në mënyrë që pensionistëve t'u sigurohet një jetë e dinjitetshme në pleqëri,*
- *Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës të integrojnë në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, pa vonesë, Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore,*

¹⁷⁵ Informata të siguruar nga e përditshmja "Kosova Sot", 14 janar 2011.

¹⁷⁶ *Ligji për Shëndetësi Publike*, nr. 02/L-78, neni 3, pika 1.

¹⁷⁷ *Po aty*, neni 3 pika 2.

¹⁷⁸ *Ligji për Veprimtarinë Private në Shëndetësi*, nr. 2004/50, neni 2 par. 3.

¹⁷⁹ *Ligji për Shëndetësi*, nr. 2004/4, neni 98, pika 2.

- *Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës të amandamentojë dhe plotësojë Ligjin për Përkrahje Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar të Përhershme, me përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuar me pengesa në të folur dhe të dëgjuar apo me sëmundje të natyrës së ngecjeve të zhvillimit psikologjik,*
- *Qeveria e Kosovës të rregullojë tregun e punës në sektorin shëndetësor, në mënyrë që qytetari i Kosovës të ketë mundësi zgjedhjeje kualitative të shërbimeve shëndetësore,*
- *Qeveria duhet të monitorojë, në mënyre përpiktë, të vazhdueshme dhe sistematike kualitetin e procedurave mjekësore, kualifikimeve të personelit shëndetësor dhe në këtë mënyrë të minimizojë mundësinë e keqpërdorimit të ushtrimit të profesionit në sektorin e shëndetësisë,*
- *Qeveria e Kosovës të shqyrtojë në mënyrë prioritare dhe me shumë seriozitet çështjen e kornizës ligjore dhe të funksionalizimit të sistemit shëndetësor në Republikën e Kosovës.*

4.26. Përgjegjësia për mjedis

Me qëllim të krijimit të një mjedisi të shëndetshëm për popullin e Kosovës, si dhe zbatimin gradual të standardeve për mjedis të Bashkimit Evropian, neni 52 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton përgjegjësinë e të gjithë qytetarëve ndaj mjedisit, si dhe përgjegjësinë e shtetit që të sigurojë një mjedis të shëndetshëm.

Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) e sheh si brengosëse praktikën e ndarjes së buxhetit nga Qeveria prej 1 % për Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Kjo tendencë nuk konsiderohet të shpreh në masë adekuate përkushtimin e autoriteteve publike për trajtimin e kësaj çështje si detyrim pozitiv të shtetit për respektim dhe mbrojtjen e kësaj të drejte. Duke pasur parasysh rëndësinë e kësaj të drejte që drejtpërsëdrejti ka ndikim në të drejtën për jetë, në të drejtën e privatësisë, të drejtën e familjes, shëndetin publik dhe në shoqëri në përgjithësi, është shqetësues fakti se kjo e drejtë, në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, është përcaktuar vetëm si “përgjegjësi” dhe jo e “drejtë”.

Fakt tjetër brengosës për IAP-në është moszbatimi i infrastrukturës ligjore në fuqi, në Republikën e Kosovës, lidhur me mbrojtjen e mjedisit.

Një çështje jashtëzakonisht e rëndësishme, në mbrojtje e mjedisit është raportimi. Duhet pranuar faktin se cilësia e raportimit varet nga cilësia e sistemit të monitorimit, që zbatohet në shkallë vendi dhe niveli i organizimit të sistemit të informimit mjedisor. Duke ditur se këto dy sisteme tek ne nuk janë të organizuara në nivelin e duhur, mund të konkludohet se edhe mungesa e të dhënave të plota dhe besueshmëria e tyre është një tregues i rëndësishëm i gjendjes së mjedisit në Kosovë. Ky është një tregues që bie ndesh drejtpërsëdrejti me parimin e transparencës.

Sa i përket moszbatimit të këtij parimi si dhe mos përmbushjen e obligimeve ligjore lidhur me formimin e njësiteve për mbrojtjen e mjedisit, ngritjen e kapaciteteve njerëzore si dhe publikimeve lidhur me këtë çështje në ueb faqet e tyre, vërejtjet e IAP-së kanë të bëjnë me nivelin lokal dhe atë qendror. Një shembull që ilustron këtë gjendje të mjerueshme të moszbatimit të kornizës ligjore është KK Prishtinë, por dhe komunat e tjera.

Edhe pse gjatë vitit 2010 janë ndarë donacione, për herë të parë për shoqërinë civile, bashkëpunimi dhe pjesëmarrja e tyre në shqyrtimet publike nuk është e kënaqshme. Po ashtu edhe informimi i Avokatit të Popullit, lidhur me këto çështje nuk është në nivel.

Sa i përket çështjes së cilësisë së ajrit, shkalla e ndotjes në shumicën e pikave matëse në Kosovë kalon 3 deri 6 herë mesataren e lejuar, varësisht prej kohës. Mesatarja e lejuar për disa herë tejkalohet sidomos në Prishtinë, ku cilësia e ajrit nuk është e kënaqshme me ndotësin PM10, e cila thuhet në shumicën e rasteve është mbi maksimumin e lejuar. Po ashtu ky fenomen përsëritet edhe rreth vendeve ku janë të vendosura ndotësit më të mëdhenj si KEK/Obiliq, Sharcem/Hani i Elezit, Trepça/Mitrovicë, Ferronikeli/Drenas, deponitë e mbetjeve urbane dhe atyre industriale, si dhe ngrohoret e tri qyteteve (Prishtina, Gjakova dhe Mitrovica).

Mungesa e sistemeve monitoruese të ajrit, është një shqetësim më vete. Monitorimi bëhet ende me metoda klasike. Në sistemet monitoruese ekzistuese mungojnë mjetet për matjen e metaleve në ajër (p.sh. në Stacionin e Drenasit). Lidhur me këtë çështje, mungojnë edhe udhëzimet administrative, me anë të cilave do të përcaktohen vlerat e lejuara të shkarkimit në ajër të elementeve ndotëse. Një strategji kombëtare për mbrojtjen e ajrit në Kosovë mungon.

Fakti që Kosova nuk posedon me asnjë impiant për trajtimin e ujërave të zeza për cilësinë e ujërave në Kosovë. Ligji i ri i Ujërave edhe pse është amandamentuar dhe përmirësuar, ai bashkë me Udhëzimet Administrative, nuk zbatohet nga institucionet publike, gjegjësisht nga inspeksionet komunale. Klasifikimi i ujërave sipas cilësisë, si edhe zonimi mbrojtës i ujërave ende nuk është bërë.

Po ashtu, ka mungesë të hulumtimeve dhe monitorimeve të ujërave nëntokësore. Kosova ende nuk ka plan strategjik për ujërat, plan për administrimin e ujërave, plan për administrimin e pellgjeve dhe plan për administrimin e përmytjeve si dhe nuk ka një sistem të integruar të monitorimit të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Trajtimi i ujërave të pijes bëhet në mënyrë klasike, vetëm me klorifikim, duke mos bërë implementimin dhe shfrytëzimin e teknologjive moderne përpunuese. Në Kosovë, vetëm 72 % e popullsisë ka qasje në ujë të pijshëm, ndërsa vetëm 45 % ka qasje në kanalizim. Është shqetësues fakti se vetëm 1 % e puseve që shfrytëzohen nga 30 % të qytetarëve kontrollohen për të vërtetuar cilësinë e ujit. Ky është një fakt jashtëzakonisht shqetësues, që bie ndesh në të drejtën për ujë të pijshëm.

Aktivitetet dhe ndikimet e vazhdueshme njerëzore shpien deri te degradimi i sipërfaqeve tokësore që kanë pasoja socio-ekonomike. Faktorët kryesorë, që ndikojnë drejtpërsëdrejti në degradimin e mjedisit janë: ndërtimet e paplanifikuara, grumbullimi i mbeturinave industriale, mihjet sipërfaqësore, mbeturinat shtëpiake dhe deponitë, erozioni, shfrytëzimi i pakontrolluar i zhavorrit, etj. Sidomos, me pasoja të rënda dhe të pariparueshme është degradimi i tokave bujqësore, ndotja e tyre me metale të rënda, shkarkimin e ujërave të zeza, depozitë e egra të mbeturinave etj., që përcillen drejtpërsëdrejti me rrezikimin e shëndetit të qytetarëve të Kosovës. Edhe më shumë këtë e rëndon mungesa e sistemeve monitoruese.

Erozioni në të shumtën e rasteve është pasojë e ndërtimit të rrjetit rrugor, si dhe objekteve dhe vendbanimeve të paplanifikuara dhe kjo rrezikon degradimin e tokës bujqësore dhe pyjore. Është inkurajues fakti që me nënshkrimin e memorandumit të mirëkuptimit në mes të Agjencisë për Mbrojtjen e Pyjeve dhe komunave mbikëqyrja e pyjeve ka kaluar në kompetenca komunale. Vetëm

Komuna e Prishtinës nuk është nënshkruese e këtij memorandumi dhe nuk ka drejtori për mbrojtjen e ambientit.

Avokati i Popullit ka pranuar një ankesë nga fshati Lajthishtë, KK Obiliq, që sipas vendimit të Qeverisë është përfshirë në zonën e interesit, pranë xeherores së linjtit. Si pasojë e mihjes dhe erozionit të tokës, shtëpia e ankuesit ishte dëmtuar rëndë, gjë që kishte vënë në rrezik jetën e ankuesit dhe familjes së tij. Edhe pse janë evidente dëmet e shkaktuara nga mihja, nuk ka filluar asnjë procedurë e shpronësimit ose ofrimit të ndonjë zgjidhje alternative nga mekanizmat përgjegjëse. Për dëmet e mëdha të shkaktuara nga mihja, të cilat drejtpërsëdrejti rrezikojnë jetën e njerëzve, si dhe shkeljen e të drejtës së pronës, Avokati i Popullit ka shprehur shqetësimin e vet përmes rekomandimit.

Po ashtu, edhe nxjerrja e gurëve, zhavorrit nga shtretërit dhe luginat e lumenjve dhe pjesëve shkëmbore ende vazhdon në mënyrë të egër, gjë që ngjall shqetësim tek IAP, për arsye të ankesave të qytetareve pranë institucionit, lidhur me degradimin e mjedisit, zhurmën dhe pluhurin e krijuar, përmytjet e deri tek rrezikimi i të drejtës së pronës, si pasojë i lëvizjeve të dheut, që shkakton drejtpërdrejt çarjet e shtëpive përreth. Momentalisht, në tërë territorin e Republikës së Kosovës punojnë mbi 200 gurëthyes, me pëlqimet e lëshuara nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Sistemi i menaxhimit të mbeturinave përcillet me probleme serioze. Nuk ka riciklim të mbeturinave, ndërsa ekziston një diskriminim në sistemin e pagesave tek qytetarët. Ndonëse për këtë janë kompetente komunat, ato nuk zbatojnë ligjet për menaxhimin e mbeturinave. Kjo ngjet edhe për arsye të përzierjes së kompetencave midis institucioneve qendrore dhe komunale, për rajonalizimit jo të plotë dhe të saktë, si dhe papërgjegjësisë së kompanive, që janë kryese të punëve. Mungesa e menaxhimit të mbeturinave industriale, hedhja e mbeturinave të ndërtimit pa kontroll, si dhe ndotja dhe zënia e tokave të punueshme dhe brigjeve të lumenjve me mbeturina, është dukuri shumë e përhapur në Kosovë, kurse kryerësit nuk ndiqen nga askush.

Edhe Udhëzimi Administrativ nr. 02/2009 për administrimin e automjeteve të hedhura dhe mbeturinave të tyre, në mënyrë që të pengohet ndotja e mjedisit, nuk zbatohet. Edhe pse me vendimin e datës 19 qershor 2009, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të gjitha pikat e grumbullimit të hekurishteve obligohen të largohen së paku 1 kilometër nga rrugët magjistrale, ato vërehen ende pranë rrugëve magjistrale.

Zonat e mbrojtura të natyrës dhe biodiversiteti kanë pësuar ndryshime, kryesisht si pasojë e ndikimeve negative të faktorit njeri përmes ndërtimeve ilegale, prerjeve të pakontrolluara të drunjtëve. Të gjitha këto veprime janë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe normat ndërkombëtare për mbrojtjen e ambientit. Natyrisht, edhe faktorët tjerë si, sëmundjet, zjarret, ndryshimi i kushteve klimatike ndikojnë në ndryshimet në biodiversitetin. Si shembuj të dëmtimit nga faktori njeri vlen të përmenden posaçërisht Parku Kombëtar “Mali Shar”, si dhe “Bjeshkët e Nemuna”. Një faktor tjetër me pasojë negative për ambientin është edhe ndotja industriale dhe është një element tjetër shumë shqetësues në Kosovë. Në Republikën e Kosovës nuk ka leje të integruar mjedisore, sipas të cilës përcaktohen kushtet veprimit të operatorëve industrialë, ashtu siç e kërkon Ligji për mbrojtjen e mjedisit.

Në fushën e ndryshimeve klimatike, Kosova nuk është palë e Konventës Kornizë, të OKB-së mbi ndryshimin e klimës, ashtu siç nuk është nënshkruese e Protokollit të Kiotos. Kosova nuk ka

strategji të ndryshimeve klimatike dhe nuk është i vendosur një inventar të gazrave serrë.¹⁸⁰ Kosova vazhdon të ketë një mungesë të theksuar të resurseve humane dhe të mekanizmave gjegjësis për zbatimin e legjislacionit ekzistues.

Presionet në mjedis të sektorëve të caktuar ekonomikë dhe sektorëve të tjerë, përmes të cilëve njeriu, duke kënaqur nevojat e veta socio-ekonomike, përcillet me ndikime të ndjeshme në mjedis dhe degradim gradual të mjedisit. Shfrytëzimi i hapësirës, shfrytëzimi i resurseve natyrore dhe llojet e ndryshme të shërbimeve të cilat kanë ndikim në mjedis, reflektohen edhe në ndryshimin e baraspeshës natyrore, shterjen e resurseve natyrore dhe në shëndetin e njeriut. Përmasat e këtyre ndikimeve, mekanizmi i veprimeve dhe pasojat në mjedis janë të varura nga shumë faktorë.

Andaj, mund të përfundojmë se çështja e mbrojtjes së mjedisit, në Republikën e Kosovës, për Avokatin e Popullit, është mjaft shqetësuese. Mosndërmarrja e masave përkatëse në parandalimin dhe eliminimin e tyre, në shumicën e rasteve përcillet me pasoja të pariparueshme për mjedisin.

4.27. Mbrojtja gjyqësore e të drejtave

Kushtetuta e Republikës së Kosovës ua garanton të drejtën e mbrojtjes gjyqësore të gjithë qytetarëve “në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me kushtetutë dhe me ligj, si dhe të drejtën për mjete efektive ligjore”, kurdoherë që konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.¹⁸¹

Me gjithë këtë garancion kushtetues për mbrojtjen e të drejtave gjyqësore, realizimi i saj në praktikë vazhdon të përcillet me vështirësi, për shkak të gjendjes në sistemin gjyqësor në vend. Këto vështirësi vazhdojnë, me gjithë paralajmërimet dhe hapat e parë inkurajues për reformat në gjyqësor, me qëllim të funksionalizimit të gjyqësorin kosovar në përputhje me standardet ndërkombëtare, siç janë përfundimi i procesit të riemërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, miratimi i ligjeve bazike për gjyqësorin, ngritja e pagave, si dhe ndërtimi i objekteve gjyqësore.

Ndër vështirësitë kryesore me të cilat ballafaqohet gjyqësori, që për pasojë ka rrënimin e besimit në sistemin e drejtësisë sundimin e ligjit në Kosovë, janë: mosfunksionimi i pushtetit gjyqësor në tërë territorin e vendit; zvarritja e procedurave civile dhe penale; numri i madh i lëndëve të vjetra të pazgjidhura; shkalla e ulët e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore; numri i madh i vendimeve gjyqësore të ndryshuara sipas apelit (rreth 60%); elementet korruptive në gjykata; moszbatimi në praktikë i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe mosinterpretimi i vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në vendimet gjyqësore.

Avokati i Popullit është jashtëzakonisht i shqetësuar për shkak të mosshtrirjes së pushtetit gjyqësor në tërë territorin e vendit, ashtu siç parashihet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.¹⁸² Që nga shpallja e pavarësisë së Republikës së Kosovës,¹⁸³ Gjykata e Qarkut dhe ajo Komunale, Prokuroria e Qarkut dhe ajo Komunale, Gjykata për Kundërvajtje në Mitrovicë, Gjykata për Kundërvajtje në Zubin Potok dhe Leposaviq, vazhdojnë të mbeten jashtë sistemit gjyqësor të Kosovës. Në prokurori

¹⁸⁰ Gazrat serrë janë gazra të liruara nga serrat bujqësore, të cilat e depërtojnë mbështjellësin e ozonit dhe krijojnë vrime të ozonit.

¹⁸¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 54.

¹⁸² Po aty, neni 102, p. 2.

¹⁸³ Më 17 shkurt 2008, Kuvendi i Republikës së Kosovës shpalli Kosovën shtet të pavarur e sovran.

gjenden mbi 11.700 lëndë, ndërsa në gjykata 1.615 lëndë presin të procedohen, e të cilat rrezikohen të parashkruhen, për shkak të kalimit kohës. Po ashtu, shumë dokumente personale si letërnjoftime dhe pasaporta të konfiskuara nga policia, si prova, kanë mbetur në gjykatë. Mosshqyrtimi i lëndëve gjyqësore të qytetarëve nga gjykata dhe prokuroria në Mitrovicë, paraqet shkelje të rëndë të drejtave dhe lirive të njeriut. Ky fakt vazhdon të mbetet një sfidë e madhe për autoritetet e Republikës së Kosovës, për të siguruar funksionimin e shtetit ligjor.

Shqetësimin për këtë gjendje, në lidhje me mosfunksionimin e organeve të judikaturës në pjesën veriore të Mitrovicës, Avokati Popullit e ka shprehur në komunikim me institucionet gjegjëse shtetërore,¹⁸⁴ përmes së cilës kërkoi që të merren masa të duhura dhe të sigurohet qasje e qytetarëve në shërbimet gjyqësore sa më shpejtë që të jetë e mundur. Avokati i Popullit ende nuk ka marrë përgjigje nga institucionet përgjegjëse.

Edhe zotimi i Misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Kosovë - EULEX, se këtë vit do të funksionalizohet gjyqësori në Mitrovicë, me kthimin e gjyqtarëve vendorë të emëruar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, nuk ka prodhuar asnjë efekt pozitiv në këtë drejtim dhe as dihet kur do të ndodhë.

Një shqetësim tjetër për Avokatin e Popullit, janë 213.967 lëndë të pazgjidhura nëpër gjykatat e Kosovës, të trashëguara që nga viti 2000. Lëndët e pashqyrtuara, civile dhe penale, nga gjykatat dhe prokuroritë, rrezikojnë të parashkruhen sipas ligjit, pasi që kanë kaluar afatet ligjore për shqyrtim nga gjykata apo prokuroria. Kurse parashkrimi, në thelb, është mohim i drejtësisë. Kjo paraqet një prej shkeljeve më të rënda të të drejtave dhe lirive të njeriut.

Shkaqet që kanë sjellë në këtë gjendje, janë të shumta: mungesa e infrastrukturës teknike, numri i pakët i gjyqtarëve dhe prokurorëve, pagat e ulëta të gjyqtarëve, prokurorëve dhe të stafit administrativ të gjyqësorit, elementet korruptive brenda sistemit gjyqësor, etj.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka miratuar Strategjinë shtetërore për reduktimin e 200.000 lëndëve të vjetra.¹⁸⁵ Me strategji janë caktuar grupet dhe personat përgjegjës për zbatimin e saj, por nuk parashikohen afatet kohore për reduktim dhe zgjidhje përfundimtare të të gjitha lëndëve të vjetra. Mbetet të shihet se cilat do të jenë efektet e strategjisë për trajtimin e këtyre lëndëve dhe zvogëlimin e numrit të tyre.

Në muajin shkurt 2010 filloi projekti i verifikimit dhe riemërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, sipas Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2008/2, i udhëhequr nga Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe i Prokurorisë. Ky projekt është përkrahur dhe mbështetur nga Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Procesi i riemërimit kishte synim rikthimin e besimit të publikut për gjyqësorin. përmes verifikimit të historikut të kandidatëve, kompetencës dhe përgatitjes etike e profesionale të tyre. Gjatë procesit të verifikimit, u emëruan dhe riemëruan 274 gjyqtarë dhe 60 prokurorë. Prej tyre, 60 % janë persona të cilët për herë të parë të emëruar në këto pozita. Kjo domethënë se është bërë një ripërtëritje në gjyqësorin e vendit.

¹⁸⁴ Shih *Raport me rekomandime*, i datës 19 mars 2010, lidhur me mosfunksionimin e organeve të judikaturës në pjesën veriore të Mitrovicës, drejtuar z. Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit të Kosovës, me kopje për z. Enver Peci, kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Fejzullah Hasani, kryetar i Gjykatës Supreme të Kosovës; Ismet Kabashi, kryeprokuror i Kosovës; Xhevdet Abazi, kryetar i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë.

¹⁸⁵ *Këshilli Gjyqësor i Kosovës*, Vendimi Nr. 22/2010, 18 nëntor 2010.

Presidenti i Republikës së Kosovës, bazuar në kompetencat e tij kushtetuese,¹⁸⁶ sipas rekomandimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës,¹⁸⁷ emëroi kandidatët e verifikuar për gjyqtarë dhe prokurorë. Gjyqtarët dhe prokurorët e angazhuar para procesit të verifikimit, ishin të emëruar nga UNMIK-u.

Shqetësim i Avokatit të Popullit, lidhur me procesin e riemërimit ka të bëjë me procedimin ligjor të lëndëve të mbetura të pakryera. Mosemërimi i 60 % të ish-gjyqtarëve, do të ketë për pasojë shpërbërjen e pjesës dërmuese të kolegjeve penale. Si rezultat i tërë kësaj, mund të paraqitet nevoja për rikthimin nga e para të procedurave të gjykimit për të gjitha lëndët, të cilat janë të lidhura me gjyqtarët, që nuk janë rizgjedhur. Me të njëjtat vështirësi do të ballafaqohen edhe prokuroritë e të gjitha niveleve.

Sa i përket infrastrukturës ligjore për gjyqësorin, janë bërë përparime inkurajuese. Pas shumë zvarritjeve, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar ligjet bazike për gjyqësorin.¹⁸⁸

Por, sfida për institucionet gjyqësore, ashtu sikurse edhe për institucionet tjera në Republikën e Kosovës, do të jetë zbatimi në praktikë i këtyre ligjeve, pasi parashihet themelimi dhe funksionalizimi i institucioneve të reja, si dhe reformimi i sistemit gjyqësor.

4.27.1. Gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it

Sistemi gjyqësor dhe prokurorial i Kosovës mbështetet nga një kontingjent i gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë, të cilët janë të angazhuar në kuadër të misionit evropian për sundim të ligjit në Kosovës - EULEX-it.

Qëllimi i punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it, është të ndihmojë autoritetet gjyqësore vendore për zhvillimin dhe forcimin e një sistemi të pavarur shumetnik të drejtësisë, të lirë nga ndërhyrjet politike, i cili punon duke respektuar standardet e njohura ndërkombëtarisht dhe praktikat më të mira evropiane.

Gjykatësit dhe prokurorët e EULEX-it, kanë përgjegjësi ekzekutive në gjyqësor. Ata punojnë me gjyqtarët vendorë, në panele të përziera, në të gjitha nivelet, në gjykimin dhe hetimin e rasteve të krimeve të luftës, gjenocidit, terrorizmit, krimin të organizuar, korrupsionit, krimeve ndëretnike, vrasjeve, vrasjeve të rënda, krimet ekonomike dhe të krimeve të tjera. Përveç kësaj, gjyqtarët e EULEX-it kanë kompetenca edhe në gjykimin e lëndëve civile. Ata kanë të drejtën e përzgjedhjes së lëndëve civile, sipas kompetencave mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.¹⁸⁹ Këto lëndë kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe lëndët që janë kompetencë të gjitha gjykatave të Kosovës. Ata, po ashtu, merren edhe me ankesat ndaj vendimeve të Komisionit Kosovar për kërkesa pronësore.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk ka kurrfarë kompetenca mbi gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it. Ata emërohen/shkarkohen dhe i përgjigjen Kryetarit të Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it, si

¹⁸⁶ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 104.

¹⁸⁷ Procesi i verifikimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve përfundoi më 26 tetor 2010. Këshilli Gjyqësor i Kosovës mori kompetencat dhe përgjegjësinë për përzgjedhjen dhe emërimin e gjykatësve dhe prokurorëve.

¹⁸⁸ Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nr. 03/L-223; Ligji për Gjykatat, nr. 03/L-199; Ligji për Prokurorinë Publike në Republikën e Kosovës, nr. 03/L-241; Ligji për Prokurorinë e Shtetit, nr. 03/L-225 dhe; Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nr. 03/L-224.

¹⁸⁹ Ligji për Kompetencat, nr. 03L 053, neni 5. p. 1.

dhe Shefit të prokurorëve të EULEX-it, i cili vepron nën urdhrat e Shefit të Komponentës së Drejtësisë të EULEX-it. Aktualisht, në sistemin gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës, në të gjitha nivelet, punojnë 50 gjyqtarë dhe 30 prokurorë të misionit ndërkombëtar EULEX.

4.27.2. Kompetencat e Avokatit të Popullit në raport me gjyqësorin

Në bazë të Kushtetutës dhe ligjit, kompetencat e Avokatit të Popullit për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve nga fusha e gjyqësorit, për dallim nga sferat dhe institucionet e tjera, janë të kufizuara dhe nuk prekin apo rrezikojnë pavarësinë e prokurorëve në zhvillimin e hetimeve dhe gjyqtarëve në marrjen e vendimeve gjyqësore.¹⁹⁰

Avokati i Popullit, vëmendje të veçantë i kushton mbrojtjes së parimeve të gjykimit të drejtë, si dhe të drejtës së gjykimit, brenda afatit të arsyeshem, të garantuara në nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

4.27.3. Ankesat e qytetarëve ndaj gjyqësorit

Gjatë vitit 2010, në IAP kundër gjykatave janë parashtruar gjithsej 180 ankesa, 70 prej tyre janë shpallur të papranueshme.¹⁹¹ Numri më i madh i parashtrësive, është drejtuar kundër gjykatave komunale, të qarkut dhe Gjykatës Supreme të Kosovës. Qytetarët kryesisht janë ankuar për zvarritje të procedurave gjyqësore, pastaj për moszekutimin e vendimeve gjyqësore, si dhe dyshime në objektivitetin e gjyqtarit.

Shumë qytetarë, të pakënaqur me vendimet gjyqësore, i drejtohen Avokatit të Popullit, me parashtrësia në të cilat e shprehin pakënaqësinë e tyre, me kërkesë për ndërhyrje në procesin vendimarrjes në gjyqësor. Shumë herë, qytetarët në ankesat e tyre drejtuar Avokatit të Popullit, kërkojnë hartimin e parashtrësive të ndryshme dhe përfaqësimin e tyre në instancat e ndryshme gjyqësore. Në rend të parë, kjo është si rezultat i mosbesimit të qytetarëve në gjyqësinë kosovare. Në shumë raste kemi të bëjmë me mosinformim të mjaftueshëm të qytetarëve me kompetencat e Avokatit të Popullit. Por, ka edhe shumë raste, kur qytetarët shprehimisht e kanë deklaruar edhe besimin që kanë në IAP.

Në të gjitha rastet, kur kërkesat apo ankesat e qytetarëve, në lidhje me gjyqësorin, nuk kanë qenë në përputhje me kompetencat e Avokatit të Popullit, ata janë drejtuar te institucionet kompetente profesionale për ofrimin e shërbimeve juridike, si në Komisionin për Ndihmë Juridike dhe shoqatat joqeveritare, të cilat kryejnë shërbime ligjore falas për qytetarët.

Ndaj Gjykatës Supreme të Kosovës janë paraqitur gjithsej 56 ankesa. Prej tyre 25 kanë qenë të papranueshme, 8 janë mbyllur dhe 23 janë ende të hapura.

¹⁹⁰ *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, Nenet 132-135; *Ligji për Avokatin e Popullit*, nr. 03/L-195, neni 15, p. 6. “Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe në procedurat ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç në raste të zvarritjeve të paarsyeshme apo keqpërdorimit të dukshëm të pushtetit.”

¹⁹¹ Shih *Ligji për Avokatin e Popullit*, nr. 03/L-195, neni 19, p. 1.3.

Ndaj gjykatave të qarkut janë paraqitur gjithsej 44 ankesa. Prej tyre 17 kanë qenë të papranueshme, 8 janë mbyllur dhe 19 të tjera janë ende të hapura.

Ndaj gjykatave komunale janë paraqitur gjithsej 80 ankesa. Prej tyre 28 kanë qenë të papranueshme, 3 janë mbyllur dhe 49 të tjera janë ende të hapura.

Pas analizave të ankesave të pranuar në IAP, sipas objektit të tyre, rezultojnë se qytetarët ankohen për zvarritje, herë-herë disavjeçare, e procedurave gjyqësore në shqyrtimin e lëndëve nga gjykatat. E kjo paraqet shkeljen e të drejtës së gjykimit brenda afatit të arsyeshëm.

Sipas Avokatit të Popullit, arsyeja për zvarritjen e procedurave në kontestet civile, para së gjithash është pasojë e numrit të madh të lëndëve të trashëguara nga vitet paraprake. Këtë fakt e rëndon edhe më shumë mbërritja e vazhdueshme e numrit të madh të lëndëve të reja nga sfera të ndryshme. Kurse gjenden edhe ashtu të vështirë e bën gati të pa rrugëdalje, sigurisht edhe kufizimi i të gjitha resurseve për gjyqësorin. Sipas një informate të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të paraqitur në muajin dhjetor 2010, numri i lëndëve të pazgjidhura në gjykata është 233.462, me tendencë të qartë rritjeje. Edhe përkundër gjendjes së këtyre, Avokati i Popullit nuk gjen arsye për zvarritjen e procedurave që kanë të bëjnë me konteste civile, kur qytetarët janë të detyruar që vendimet t'i presin madje edhe më gjatë se 5 vjet.

Me gjithë autorizimet e kufizuara, në fushën e gjyqësorit, Avokati i Popullit, në raste të caktuara megjithatë ka dërguar sugjerime dhe rekomandime, veçanërisht në gjykatat e shkallës së parë, përmes së cilave ka kërkuar përsheptimin e procedurës gjyqësore me ndërmarrjen e veprimeve konkrete. Por, Avokati i Popullit nuk është i kënaqur me nivelin e trajtimit të shkresave dhe përgjigjeve të marra nga ana e gjykatave.

Edhe gjatë vitit 2010 në IAP kanë ardhur në disa raste ankesa për veprime e qëndrime të njëanshme të gjyqtarëve gjatë gjykimeve konkrete, për jobjektivitet në shqyrtimin e rasteve dhe është kërkuar ndihma e IAP-së për përjashtimin e tyre nga gjykimi i çështjes. Nga Avokati i Popullit ankuesit janë sqaruar mbi kërkesat e ligjit për përjashtimin e gjyqtarëve dhe rrugën ligjore që duhet të ndjekin për realizimin e këtyre të drejtave. Bazuar në statistikat e KGJK për vitin 2009, më se 60 % të vendimeve të gjykatave komunale të ankmuara ndryshohen nga ana e gjykatave të qarkut, Ky fakt është mjaft domethënës, dhe në njëfarë mënyre dëshmon për arsyeshmërinë e dyshimeve dhe arsyeton ankesat e palëve në objektivitetin e vendimeve gjyqësore.

Ankesa kanë ardhur edhe ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për shkak të mosekzekutimit të tyre nga gjykatat komunale. Në këto raste është kërkuar ndihma dhe ndërhyrja e Avokatit të Popullit, për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore në nivel të vendit është mjaft i ulët. Vetëm rreth 40 % të vendimeve gjyqësore ekzekutohen. Shkaqet të cilat ndikojnë në shkallën e ulët të ekzekutimit të vendimeve të plotfuqishme, sipas KGJK-së, qëndrojnë në numrin e ulët të bashkëpunëtorëve ekzekutivë, si dhe mungesa e adresave të sakta etj.

Në të gjitha rastet e ankesave, Avokati i Popullit ka zhvilluar hetime dhe ka kontaktuar përmes letrave dhe takimeve të drejtpërdrejta me zyrtarë të gjykatave komunale, të cilët janë përgjegjës për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Avokati i Popullit ka kërkuar arsye për zvarritje të ekzekutimit të vendimeve. Në shumë raste, pas veprimit të Avokatit të Popullit gjykatat kanë ndërmarrë veprime për ekzekutimin e vendimeve. Por, në shumë raste, edhe pas intervenimit të Avokatit të Popullit, vendimet nuk janë ekzekutuar nga disa gjykata. Si arsye për zvarritjet e ekzekutimit të vendimeve, zyrtarët e gjykatave kanë deklaruar mungesën e gjyqtarëve ekzekutues dhe bashkëpunëtorëve tjerë ekzekutues. Ndërsa si problem për ekzekutimin e vendimeve me

karakter financiar, sipas zyrtarëve të gjykatave, është mosekzekutimi i vendimeve nga bankat, përkundër urdhrave të lëshuara nga gjykata.

Në disa raste ka pasur ankesa ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë të gjykatave, për të cilat janë shterë të gjitha mjetet e ankimit, duke përfshirë edhe ankimin kushtetues. Nga Avokati i Popullit kërkohet që çështja e tyre të dërgohet për gjykim në “Gjykatën e Strasburgut”.¹⁹² Edhe më shqetësues është fakti se në disa raste ankuesit janë drejtuar tek Avokati i Popullit pas këshillimit me avokatët e tyre mbrojtës. Po ashtu ka pasur ankesa ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë të gjykatave për të cilat janë shterur të gjitha mjetet e ankimit, duke kërkuar ngritjen e çështjes së tyre në Gjykatën Kushtetuese, për shkak të shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut.

Në të gjitha këto raste, sikur ndaj vendimeve ku e drejta e ankimit nuk është shterë, apo edhe kur janë shter të gjitha mjetet e ankimit, krahas sqarimit ligjor nga Avokati i Popullit, ankuesit janë udhëzuar për plotësimin e formularit përkatës, për paraqitjen e rastit dhe kërkimin e ndihmës në institucionet dhe shoqatat për ndihmë juridike.

Ankesa kanë ardhur edhe për zvarritje të padrejta nga administrata e gjykatave, për shkak të mosdërgimit të vendimeve gjyqësore brenda afateve ligjore, si dhe për shkak të pamundësisë së palëve për qasje në lëndën e tyre në gjykatë. Avokati i Popullit, në të gjitha rastet e ankesave të kësaj natyre, ka kontaktuar zyrtarët e gjykatave dhe në bashkëpunim me gjykatat, i ka zgjidhur ankesat e palëve. Palëve u janë dorëzuar vendimet gjyqësore dhe ato janë informuar lidhur me gjendjen e lëndëve në gjykata.

4.27.4. Ankesat e qytetarëve ndaj prokurorisë

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, në IAP janë pranuar 25 ankesa apo kërkesa nga 25 individë të ndryshëm, të cilat kanë pasur për objekt punën e organeve të Prokurorisë. Nga ankesat e parashtruara, 10 prej tyre janë vendosur si të papranueshme, 13 raste janë të hapura dhe 3 raste të mbyllura. Ankesat që kanë qenë në përputhje me kompetencat e Avokatit të Popullit, pas vlerësimit e rastit janë proceduar. Janë ndërmarrë veprime administrative hetimore si, intervistimi dhe marrja e deklaratave të ndryshme, shikimi i dokumenteve, si dhe shikimi i dosjeve hetimore, për të cilat prokuroria kishte vendosur, mosfillimi i procedimit penal, pushimi apo pezullimi i çështjes penale.

Ndaj prokurorive të qarkut janë paraqitur gjithsej 13 ankesa, prej tyre: 5 janë shpallur të papranueshme, 2 të mbyllura dhe, 3 janë ende të hapura.

Ndaj prokurorive komunale janë paraqitur gjithsej 12 ankesa, prej tyre: 5 janë shpallur të papranueshme, 1 është mbyllur dhe, 6 të tjera janë ende të hapura.

Numri i parashtrësive të cilat kishin të bënin me realizimin e të drejtave para organit për ndjekje penale-prokuroritë publike, ishte më i vogël krahasuar me ato që kishin të bënin me gjykatat. Nga analizat e bëra rezulton se, shkak i një pjese të ankesave janë zvarritjet e procedurave hetimore nga prokuroritë publike, deri në marrjen e vendimit. Në shumë raste, për shkak të nevojës për informata plotësuese për vendimin përfundimtar, sipas kallëzimeve penale, kërkohen informata të posaçme nga policia. Në këtë fazë të procedurës, si pasojë pasivitetit dhe iniciativës së pamjaftueshme të prokurorëve publik, shpeshherë vjen deri te ngecjet në punën e prokurorit publik.

¹⁹² Në zhargonin popullor “Gjykata e Strasburgut” përdoret për Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Veprimet e tilla më së shpeshti rezultojnë me skadimin e afatit ligjor, brenda të cilit të dëmtuarit kanë të drejtë ligjore për të iniciuar ndjekje penale si paditës privat. Në këto raste vërehet se ka mungesë komunikimi midis të dëmtuarit, policisë dhe prokurorit.

Po ashtu, ka pasur ankesa për shkak të dyshimit në zhvillimin e hetimeve nga ana e prokurorit, përkatësisht policisë hetimore. Në raste të caktuara ka pasur dyshime për ndryshimin apo manipulimin e fakteve dhe dëshmimeve, në lidhje me rastin në vendin e ngjarjes. Në këto raste ankuesit kanë kërkuar ndërhyrjen e Avokatit të Popullit tek autoritetet hetimore për zhvillim të hetimeve të paanshme.

Një numër i ankesave të qytetarëve të paraqitura në IAP, kanë të bëjnë me mbajtjen në paraburgim dhe të vonesave në ngritjen e aktakuzave nga prokuroritë, për shkak të vonesave në kryerjen e procedurave hetimore lidhur me rastet. Në disa nga këto raste, palëve u vazhdohet qëndrimi në paraburgim me arsyetimet e njëjta.

Avokati i Popullit, në të gjitha rastet e pranueshme ka hapur hetime për ankesat e palëve dhe ka kontaktuar zyrtarët e prokurorive, duke kërkuar sqarime për zvarritjet e procedurave hetimore dhe të vonesave në ngritjen e aktakuzave. Në disa raste, pas veprimit të Avokatit të Popullit, janë vënë në veprim organet për zhvillimin e hetimeve dhe përfundimin e tyre.

Sipas njoftimeve të marra nga Prokurori i shtetit, arsye kryesore për vonesat në zhvillimin e hetimeve penale dhe procedimin e tyre në gjykata, është numri i vogël i prokurorëve në të gjitha nivelet. Me gjithë ngarkesat e shumta dhe mungesat e theksuara në burime njerëzore dhe të infrastrukturës së nevojshme, për Avokatin e Popullit, arsyetimet për vonesat në ngritjen e çështjeve penale në gjykata brenda afateve të parapara ligjore nga prokuroritë, edhe për vetë Kryeprokurorin e shtetit, janë jo gjithmonë të besueshme.

4.27.5. Rekomandime

- *Avokati i Popullit i rekomandon Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Qeverisë dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës, shtrirjen e pushtetit gjyqësor në tërë territorin e vendit, duke përfshirë pjesën veriore të Mitrovicës dhe komunat e tjera, ashtu si parashihet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.*
- *Avokati i Popullit rekomandon funksionalizimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në bazë të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nr. 03/L-223.*
- *Avokati i Popullit rekomandon themelimin, pa zvarritje të mëtutjeshme, të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në bazë të Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nr. 03/L-224.*
- *Avokati i Popullit rekomandon zbatimin e Ligji për Gjykatat, nr. 03/L-199, posaçërisht të neneve 29 dhe 36 të ligjit, me qëllim të përmirësimit të kushteve materiale në gjyqësor dhe të strukturimit të gjykatave sipas ligjit.*
- *Avokati i Popullit rekomandon zbatim efikas të strategjisë dhe të gjitha masave ligjore, të cilat do të ndihmonin në eliminimin e numrit të rasteve të mbetura gjyqësore dhe të deklarohet prioritet i gjyqësorit dhe pushteteve të tjera në Republikën e Kosovës.*

- Avokati i Popullit insiston që problemi i personelit dhe probleme të tjera të gjykatave, të cilat janë shkaktarët kryesorë të zvarritjes në procesin e vendimmarrjes, nuk janë dhe nuk mund të jenë arsye të pranueshme pafundësisht, për shkelje të së drejtës për shqyrtim pa zvarritje, e drejtë kjo e garantuar me Kushtetutë.
- Avokati i Popullit rekomandon ofrimin e të gjitha kushteve të domosdoshme për zbatim efikas të aktit ligjor, që rregullon mbrojtjen e të drejtës për gjykim pa vonesa të panevojshme dhe miratimin e amendamenteve për mbrojtje më të mirë të të drejtave kushtetuese dhe ligjore të klientëve në procedimin lëndëve.
- Avokati i Popullit rekomandon miratimin e masave për të sigurimin e shqyrtimeve më të shpejta të masave të përkohshme parandaluese, pasi nga hetimet e bëra dhe informatat e pranuar, është vërtetuar se disa gjykatave u duhen disa vite për të nxjerrë një masë të përkohshme parandaluese.
- Avokati i Popullit vëren se gjykatat kanë vonesa të gjata kohore në përmbarrimin e vendimeve gjyqësore, prandaj Avokati i Popullit rekomandon ofrimin e të gjitha kushteve për përmbarrimin dhe zbatimin e vendimeve në afatin sa më të shkurtër të mundshëm.
- Avokati i Popullit nënvizon se mospajtimi me vendimet finale gjyqësore, nuk mund të shërbejë si bazë për mosbindje ndaj obligimeve për të gjithë, madje as për institucionet shtetërore në nivel qendror dhe lokal, prandaj Avokati i Popullit rekomandon zbatimin e vendimeve gjyqësore, pa asnjë vonesë.
- Avokati i Popullit rekomandon që autoritetet e ndjekjes penale dhe ato gjyqësore, të garantojnë që kryerësit e veprave, në procedurat e kundërvajtjes, të gëzojnë të drejtat themelore kushtetuese për gjykim të drejtë dhe mjete juridike. Kryerësit e veprave duhet të jenë plotësisht të informuar me akuzat me të cilat ngarkohen, përshkrimin e gjendjes faktike dhe prezantimin e dëshmisë së bazuar, në të cilat ata mund të sfidojnë vendimet në mënyrë efikase.
- Avokati i Popullit rekomandon që gjykatat, në vendimet mbi masën për trajtim psikiatrik, të precizojnë qysh më parë saktësisht kohëzgjatjen e masës, fillimin dhe mbarimin e saj. Po ashtu, në procedurën e rishqyrtimit të marrin vendim në afatin e përcaktuar kohor, lidhur me kohëzgjatjen e masës pas periudhës njëvjeçare të ekzekutimit të saj, duke e informuar të pandehurin pa mëdyshje.
- Avokati i Popullit insiston që autoritet kompetente, të sigurojnë kushtet e përshtatshme në mënyrë që ekspertët dëshmitarë dhe vlerësuesit të jenë në gjendje të kryejnë punën e tyre të ekspertit me tërë përgjegjësinë morale dhe profesionale: saktësisht, me përgjegjësi dhe paanësi dhe në periudhat kohore të përcaktuara me ligj. Prandaj Avokati i Popullit rekomandon hartimin e një rregulloreje për ekspertët gjyqësorë.
- Avokati i Popullit i rekomandon Odës së Avokatëve që të sigurojë kualitet më të madh të ndihmës ligjore, në raste të përfaqësimit, sipas detyrës zyrtare (ex officio) apo të ndihmës ligjore falas dhe të rregullojë qartë dhe pa mëdyshje sigurimin e klientëve të avokatit, në raste të dëmtimit, lidhur me kryerjen e detyrës së avokatit.

4.28. Të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre

Të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre janë të rregulluara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me zbatimin e drejtpërdrejtë të konventave ndërkombëtare për mbrojtjen e minoriteteve dhe të drejtave të tyre.¹⁹³ Përveç konventave ndërkombëtare në fuqi janë edhe disa ligje që merren me mbrojtjen e komuniteteve minoritare siç janë: Ligji për mbrojtjen e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, Ligji mbi përdorimin e gjuhëve zyrtare, Ligji mbi liritë fetare, Ligji mbi trashëgiminë kulturore si dhe Ligji kundër diskriminimit.¹⁹⁴

Kushtetuta garanton edhe mbrojtjen e të drejtave kulturore dhe ruajtjen e identitetit të minoriteteve në fushën e arsimit; përdorimin e gjuhës dhe shkrimin; përdorimit e toponimeve, qasjen dhe përfaqësimin në media, mbajtjen e kontakteve me njëri-tjetrin në territorin e Kosovës dhe jashtë saj, zhvillimin e sektorit joqeveritar, në kuadër të komunitetit të vet, si dhe pjesëmarrjen në punën e sektorit joqeveritar ndërkombëtar në Kosovë.

4.28.1. Përbërja e popullsisë në Republikën e Kosovës

Përbërja e përgjithshme e popullsisë në Kosovës nuk ka pësuar ndryshime në periudhën raportuese. Meqenëse nuk ka pasur ndonjë regjistrim të popullsisë në Republikën e Kosovës përbërja e saktë e popullsisë, sipas komuniteteve në Kosovë, nuk dihet¹⁹⁵. Një problem i cili vazhdon të mbetet aktual është kthimi i të ikurve nga Kosova nga vendet e ndryshme, sidomos në Serbi, si dhe brenda vetë territorit të Kosovës. As në këtë periudhë nuk ka pasur ndonjë lëvizje pozitive në këtë drejtim.

4.28.2. Kultivimi i identitetit politik, kulturor dhe kombëtar

Komuniteti serb e kultivon identitetin e vet kombëtar dhe kulturor përmes një sistemi relativisht të zhvilluar të partive politike, organizatave joqeveritare, organizatave humanitare dhe kulturore. Kurse identitetin fetar, e pjesërisht edhe atë politik, ky komunitet e kultivon përmes Kishës Ortodokse Serbe (KOS). Sistemi “autonom” paralel i arsimit, që përfshin shkollimin fillor, të mesëm dhe atë të lartë punon sipas plan-programeve mësimore të Ministrisë së Arsimit të Republikës së Serbisë (MARS). Ky komunitet, identitetin fetar e kultivon përmes Kishës Ortodokse Serbe (KOS). Mirëpo, sikurse sistemi arsimor i komunitetit serb, ashtu edhe KOS nuk kanë kurrfarë bashkëpunimi me autoritetet kompetente publike në Republikën e Kosovës.

Mundësitë për ruajtjen e gjuhës, zakoneve, trashëgimisë kulturore dhe traditës së komunitetit turk janë të pamjaftueshme, dhe rreth kësaj çështjeje është bërë fare pak. Në kuptim të ruajtjes së identitetit kulturor, të vetmin rol të rëndësishëm e kanë organizatat joqeveritare të cilat merren me

¹⁹³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 22..

¹⁹⁴ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 59.

¹⁹⁵ Regjistrimi i popullsisë në Republikën e Kosovës është bërë prej datës 1 deri më 15 prill 2011. Ky regjistrim, është përcjellë me disa mangësi, të bëra publike nga Avokati i Popullit në konferencën për media të mbajtur më 5 prill 2011. Për shkak të presioneve politike nga Republika e Serbisë e cila ka ftuar komunitetin serb të bojkotojë regjistrimin, regjistrimi nuk është bërë fare në komunat e banuara me shumicë nga komuniteti serb në pjesën veriore të Kosovës, kurse regjistrimi i pjesërisht është bërë në pjesët tjera të Kosovës, në komunat tjera të banuara me shumicë nga pjesëtarët e komunitetit serb.

këtë tematikë dhe teatrot amatore në vendet ku komuniteti turk është më i koncentruar, si në rajonin e Prizrenit, Prishtinës, Mamushës, Vushtrrisë, Mitrovicës dhe Gjilanit. Mirëpo, Ministria e Kulturës e Kosovës, deri më sot nuk është marrë seriozisht me këtë çështje.

E ngjashme është situata edhe me komunitetin boshnjak, që në numër më të madh është i koncentruar në rajonin e Prizrenit, Gjakovës dhe Pejës. Megjithëse janë formuar disa parti politike dhe organizata joqeveritare boshnjake dhe, për herë të parë në Kosovë, ka filluar mbajtja e mësimit në gjuhën boshnjake, mundësia për ruajtjen e gjuhës, zakoneve, trashëgimisë kulturore dhe traditës është mjaft e vështirë dhe nuk ka kurrfarë mbështetje institucionale. Problemin më të madh e paraqet mungesa e teksteve në gjuhën boshnjake. Tekstet mësimore për arsimin fillor dhe të mesëm në këtë gjuhë sigurohen nga Bosnja e Hercegovina dhe Serbia. Mirëpo, në bazë të informatave që kemi marrë nga kryesuesi i zyrës për komunitete në Prizren, problemi me tekstet mësimore, do të duhet të zgjidhej deri në vitin shkollor vijues 2011/2012.

Nga rreth 40 shoqëri kulturo-artistike rromë në Kosovë, sot vetëm një merret me kultivimin e kulturës dhe traditës rromë, bëhet fjalë për Shoqërinë "Durmish Aslan" në Prizren, ndërsa të tjerat janë transformuar në OJQ, të cilat, në të shumtën e rasteve kanë ndërprerë punën, për shkak të mungesës së kuadrit profesional dhe mjeteve financiare.

Në përgjithësi, ky komunitet përherë është ballafaquar me problemin e ruajtjes dhe zhvillimit të identitetit të vet sa i përket fesë, gjuhës, traditës dhe kulturës. Për shkak të specifikave, të dukjes së jashtme dhe gjuhës të cilën e shfrytëzojnë, gjithmonë kanë qenë të diskriminuar nga të gjitha komunitetet, për çka shumë rromë kanë hequr dorë nga prejardhja e tyre dhe janë asimiluar në kuadër të komuniteteve të cilat kanë dominuar numerikisht në trevat në të cilat jetojnë ata.

Tendenca e asimilimit në popullsinë shumicë, qoftë ajo shqiptare apo serbe, ka qenë gjithmonë e pranishme tek ky komunitet, për shkak të presioneve të ndryshme dhe kushteve të rënda ekonomike dhe shoqërore në të cilin ka jetuar dhe jeton. Faktori primar që ndikon në dukurinë e ndryshimit të identitetit është siguria. Faktorë të tjerë me ndikim mund të jenë edhe dëshira personale, interesi politik apo supozimi se në këtë mënyrë do të arrihet deri te perspektiva më e mirë në shoqëri.

Kurse sa i përket komuniteteve ashkali dhe egjiptas, të cilat gjenden në një situatë të ngjashme, vetëm komuna e Fushë Kosovës ka bërë një hap pozitiv modest, duke caktuar koordinatoren e kulturës për pjesëtarët e komuniteteve shkali dhe egjiptas.

4.28.3. Sfidat dhe mundësitë e arsimit të komuniteteve pakicë

Komuniteti serb

Në Kosovë funksionojnë paralelisht dy sisteme të arsimit. Përveç sistemit arsimor të Republikës së Kosovës, ku aplikohet plan-programi i Republikës së Kosovës, në vendet e banuara me pjesëtarë të komunitetit serb dhe pjesërisht të komunitetit rom e goran, aplikohet plan-programi mësimor i Republikës së Serbisë. Personelin shkollor që punon me sistemin arsimor të Republikës së Serbisë e financon MARS. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës (MASHT) këtë e bën në formë të stimulimit material që, në pajtim me përgatitjen profesionale, është caktuar në mënyrë lineare për të gjithë të punësuarit në shkolla. Me nxjerrjen e Ligjit mbi mbrojtjen dhe promovimin e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, në pjesën që ka të bëjë me

arsimin, ky sistem i arsimit (shkollimi fillor dhe i mesëm), si dhe Universiteti në pjesën veriore të Mitrovicës, janë të pranuar sipas nenit 8 të këtij ligji, që nga marsi i vitit 2008.

Komunitetet turk dhe boshnjak

Turqit dhe boshnjakët mund ta përcjellin mësimin, në shkollat fillore dhe të mesme, edhe në gjuhën e tyre amtare. Problemi kryesor me të cilat përballen nxënësit është mungesa e teksteve në gjuhën turke. Kështu, nxënësit e komunitetit turk, mungesën e teksteve tentojnë ta plotësojnë kryesisht me tekste nga Turqia, megjithëse këto tekste nuk u përgjigjen plan-programeve mësimore të Republikës së Kosovës dhe më tepër shfrytëzohen si tekste plotësuese. Komuniteti turk ka institucionin e shkollimit superior në gjuhën e vet në Prizren, ndërsa ekziston Katedra për orientalistikë dhe gjuhë turke në Universitetin e Prishtinës. Boshnjakët mund t'i vijnë shkollat e mesme në gjuhën amtare, e po ashtu mund të vijnë edhe Shkollën e Lartë për Biznes në Pejë, si dhe Fakultetin e Mësuesisë në Prizren. Përveç kësaj, po ashtu ekzistojnë universitete private në të cilët pjesëtarët e këtyre dy komuniteteve mund t'i vijnë nivelet e larta të arsimit në gjuhën e tyre amtare.

Komuniteti goran

Përsëri duhet theksuar se në rajonin e Gorës janë të pranishme të dy sistemet e arsimit, sipas plan-programit të Republikës së Kosovës dhe të Republikës së Serbisë. Shumica e pjesëtarëve të komunitetit goran, kanë shprehur dëshirë që të shkollohen në gjuhën serbe. Meqenëse në kuadër të sistemit të arsimit në Republikën e Kosovës nuk ekzistojnë as tekstet dhe as plan-programi për mësim në gjuhën serbe, por edhe për shkak të mundësive më të mira për vijimin e arsimit të lartë, pjesëtarët e komunitetit goran edhe më tutje i shfrytëzojnë tekstet dhe vijnë mësimin sipas plan-programit të MARS.

Mirëpo, tek pjesëtarët e komunitetit goran situata është paksa më komplekse në kuptim të respektimit të së drejtës së tyre për arsimim. Në të vërtetë, mësimdhënësit e komunitetit goran, deri në vitin 2005 merrnin paga, si nga Qeveria e Republikës së Serbisë, ashtu edhe nga Qeveria e Republikës së Kosovës, por për shkak të presioneve politike, në vitin 2006 kanë shkëputur kontratat me MASHT-in pavarësisht që shkollat në të cilat mbajnë mësim ata janë nën kompetencë të ministrisë së Kosovës. Meqenëse një pjesë e popullsisë në komunën e Dragashit, treva e Gorës, janë deklaruar dhe identifikuar me komunitetin boshnjak, ata pranuan plan-programin e MASHT-it në gjuhën boshnjake, ndërsa mësimdhënësit dhe nxënësit që mbajnë dhe ndjekin mësimin sipas plan-programit të Republikës së Serbisë janë ballafaquar me probleme nga se u është ndërprerë shfrytëzimi i lokaleve në shkollat fillore dhe të mesme gjatë vitit shkollor 2008/2009, pas shkëputjes së kontratës së tyre me MASHT-in. Mirëpo, këtë vit, situata është përmirësuar dhe tani nxënësit dhe mësimdhënësit kanë qasje në objektet shkollore në trevën e Gorës.

Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas

Romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit, të cilët jetojnë në pjesë të ndryshme të Kosovës, mësimin e vijnë në gjuhën shqipe. Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas, edhe më tutje po ballafaqohen me nivel mjaft të ulët të arsimit dhe shkallë të lartë të braktisjes së shkollës. Këto komunitete

gjenden në situatë mjaft të keqe sociale dhe ekonomike, që paraqet një nga arsyet kryesore të braktisjes së shkollave nga pjesëtarët e këtyre komuniteteve, pasi që kushtet për arsimimin e tyre janë minimale apo nuk ekzistojnë fare. Po ashtu duhet theksuar se vajzat rome, ashkali dhe egjiptase, krahasuar me fëmijët e gjinisë mashkullore, janë të diskriminuara nga prindërit apo kujdestarët e tyre dhe shumë herët e braktisin shkollën fillore, ndërsa, përveç ndonjë përjashtimi të rrallë, shkollimin e mesëm pothuajse nuk e vazhdojnë fare. Përveç kësaj, një nga arsyet e braktisjes së shkollave tek pjesëtarët e komunitetit rom është edhe njohja e pamjaftueshme e gjuhës shqipe apo serbe, varësisht se në cilat pjesë të Kosovës jetojnë, që për pasojë ka rezultatin e dobët në shkollë dhe braktisjen e shkollimit.

Në Republikën e Kosovës edhe më tutje nuk ekziston arsimim fillor në gjuhën rome. Ka indikacione se MASHT planifikon të zhvillojë potencialin shkollor në gjuhën rome, në mënyrë që në një të ardhme të afërt të tejkalohet ky problem. Forma e vetme e mësimi në gjuhën rome ekziston në disa shkolla të cilat punojnë sipas plan-programit të Republikës së Serbisë, por edhe kjo është e kufizuar në disa orë në javë. Disa nga shkollat të cilat sigurojnë këtë formë të mësimi gjenden në komunën e Gjilanit, Kamenicës, në veri të Mitrovicës, Uglar (komuna e Fushë Kosovës) dhe në Janjevë (komuna e Lipjanit).

Fëmijët e komuniteteve ashkali dhe egjiptas, kryesisht vijnë në mësimin në gjuhën shqipe, mirëpo edhe te këto komunitete, si dhe tek ai rom, ekziston vetëdija mjaft e ulët për rëndësinë e arsimimit të fëmijëve të tyre, kështu që fëmijët pjesëtarë të këtyre komuniteteve përcaktohen shumë herët ta braktisin shkollën duke filluar të punojnë, si për mungesë të motivimit për shkollim, por në masë të madhe edhe për shkak të kushteve të vështira socio-ekonomike në të cilat jetojnë familjet e tyre.

Një shkëndijë pozitive është funksionimi disa vjeçar i “Qendrës Rome për Arsim”, e cila financohet përmes OJQ-së “Balcan Sunflowers” dhe Fondacionit Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS). Kjo qendër arsimore ofron ndihmë në kryerjen e detyrave të shtëpisë dhe aktivitetit të kësaj qendre kryesisht punojnë me fëmijë parashkollorë dhe shkollorë. Por e kjo nismë e mirë nuk gëzon përkrahjen institucionale.

4.28.4. Kultivimi i gjuhës së komuniteteve dhe sfidat praktike

Shumëgjuhësia nënkupton detyrimin ligjor që të gjitha gjuhët zyrtare, të përdoren në mënyrë të barabartë dhe në të gjitha nivelet, si në atë qendror, ashtu edhe në atë lokal. Mirëpo, e drejta e përdorimit të të gjitha gjuhëve tjera zyrtare, nuk respektohet plotësisht, në veçanti nga organet lokale të qeverisjes dhe të administratës, dhe atë gati në të gjitha komunat. Kjo situatë nuk është përmirësuar dukshëm në krahasim me periudhën paraprake të raportimit të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Situata lidhur me respektimin e gjuhëve zyrtare ndryshon nga komuna në komunë. Po ashtu nuk është përmirësuar situata në shumë komuna ku formularët zyrtarë dhe njoftimet ekzistojnë vetëm në gjuhën shqipe, që u paraqet vështirësi atyre pjesëtarëve të komuniteteve pakicë të cilët nuk flasin shqip, për të realizuar të drejtat e veta ose për të paraqitur ndonjë kërkesë formale në ndonjë organ të qeverisjes lokale.

Edhe më tutje është e përhapur praktika e mosrespektimit gjatë të shkruarit të emrave në gjuhën serbe, boshnjake dhe turke në formën origjinale në dokumente, megjithëse Institucioni i Avokatit të

Popullit e ka theksuar këtë problem disa herë. E njëjtë është situata edhe me përkthimin e dokumenteve zyrtare, aktvendimeve dhe vendimeve në gjuhët e pakicave, të cilat në disa komuna janë edhe gjuhë zyrtare. Dokumentet e tilla ose nuk përkthehen ose janë të cilësisë aq të dobët, sa që shpeshherë vështirë mund të kuptohen nga ata që i lexojnë.

4.28.5. Komunitetet pakicë dhe mediat

Prania e komuniteteve pakicë në radio dhe në televizion

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton qasjen dhe përfaqësimin e komuniteteve pakicë në mediat publike, pastaj themelimin dhe shfrytëzimin e mediave të tyre duke përfshirë edhe ofrimin e informacioneve në gjuhët e tyre, ndër të tjera edhe përmes gazetave ditore dhe shërbimeve kabllore, shfrytëzimit të numrave të rezervuar të frekuencave për mediat elektronike. Edhe pse këto dispozita ligjore janë aplikuar në praktikë, autoritetet e Kosovës nuk kanë mekanizëm përkatës për rregullimin e aplikimit të kësaj të drejte në praktikë e as masa të veçanta të cilat do të nxisnin dhe ndoshta edhe materialisht do të përkrahnin komunitetet pakicë në realizimin e kësaj të drejte mjaft me rëndësi.

Nga të dhënat që posedon Institucioni i Avokatit të Popullit dhe në bazë të dhënave nga Komisioni i Pavarur për Media, nga gjithsej 114 emetues të licencuar të programit të radios dhe televizionit (TV), në Kosovë janë 92 radio stacione dhe 22 stacione televizive. Gjithsej 26 radio stacione emetojnë program në gjuhën boshnjake dhe rome, prej të cilave vetëm një emeton program ekskluzivisht në gjuhën rome, tre në gjuhën boshnjake, ndërsa 18 kanë program shtesë në gjuhën rome, e 6 në gjuhën boshnjake. Nga gjithsej 22 stacione të licencuara televizive, tre kanë program shtesë në gjuhën rome, e dy në gjuhën boshnjake.

Përveç komunitetit serb, i cili ka tri stacione lokale private televizive, asnjë nga komunitetet e tjera pakicë në Kosovë, nuk kanë stacionin e vet televiziv. Ndërkaq, ekzistojnë radiostacione, që ekskluzivisht emetojnë program në gjuhën serbe.

Sa i përket komunitetit turk, si shembull pozitiv mund të theksohet se deri më tani në Kosovë kanë filluar punën dy radio stacione private në gjuhën turke, që kanë karakter lokal dhe me program të përditshëm 24 orësh, radio “Yeni Dönem” dhe radio “Kent FM”. Radio “Yeni Dönem” është radio lokale që emeton program i cili dëgjohet në rajonin e Prizrenit e Pejës (Prizren, Mamushë, Rahovec, Suharekë, Malishevë, Gjakovë, Klinë, Deçan), me programin e vet mbulon 95% të rajoneve të sipërpërmendura. Radio “Yeni Dönem” emeton program në 4 gjuhë, 21 orë në gjuhën turke, 1 orë në gjuhën boshnjake, 1 orë në gjuhën shqipe dhe 1 orë në gjuhën rome.

Radio Televizioni i Kosovës (RTK) është i vetmi institucion shtetëror medial, puna e të cilit financohet nga donacione të ndryshme dhe ndihmohet me mjete nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës. RTK, përveç programit në gjuhën shqipe, përgatit dhe emeton TV dhe radio programe në gjuhën serbe, boshnjake, turke dhe rome.

Në RTK ekziston programi informativ ditor televiziv nga 15 minuta në gjuhën boshnjake, si dhe emisioni serik dokumentar një orësh me titullin “Mostovi”. Në RTK emetohet një herë në javë edhe emisioni “Yekhipë” në gjuhën rome.

RTK po ashtu, për çdo ditë emeton edhe radio program dy orësh në gjuhën boshnjake, por në këtë program kanë qasje vetëm banorët të cilët jetojnë në Prishtinë e rrethinë dhe të cilët kanë qasje në frekuencat AM, ndërsa në gjuhën rome, për çdo ditë emetohet program njëorësh në këtë radio stacion. Po ashtu, në RTK emetohet program informativ edhe në gjuhën serbe, si dhe në gjuhën turke.

Mediat e shkruara

Sa u përket mediave të shkruara, komuniteti serb ka gazetën "Jedinstvo" (e cila shtypet në Mitrovicë, financuar nga Qeveria e Republikës së Serbisë), që del çdo dy javë dhe është e vetmja gazetë në gjuhën serbe në Kosovë.

E vetmja gazetë në gjuhën boshnjake në Kosovë është "Alem", e cila deri në vitin 2008 është botuar çdo të dytën javë, mirëpo për shkak të mungesës së mjeteve financiare, gjatë vitit 2009 dhe 2010 është botuar vetëm periodikisht. Në gjuhën rome nuk ekziston asnjë revistë apo gazetë ditore që botohet rregullisht. Në Prizren pati filluar dalja e revistës "Yekhipe" në gjuhën rome, e cila ndonjëherë botohej edhe në gjuhën shqipe e serbe, e cila duhej të dilte një herë në muaj, por në mungesë të mjeteve financiare del vetëm gjashtë herë në vit. Përveç kësaj, OJQ-të lokale nga Prizreni kanë themeluar portalin informativ në gjuhën rome <http://rroma.courriers.info>.

Shikuar në përgjithësi, mediat rome dhe ato boshnjake ballafaqohen me mungesë gjithnjë e më të madhe financiare, kështu që është çështje kohe kur do të shuhen plotësisht. që flet për atë se Qeveria e Kosovës dhe institucionet kompetente nuk merren me problematikën e mediave të shkruara në gjuhën rome dhe boshnjake.

Shkelja më e madhe e kësaj të drejte ndaj komunitetit turk ka ndodhur me marrjen e lokaleve të punës së ndërmarrjes së suksesshme gazetare botuese "TAN", e cila është shuar pas 30 vjet pune si shtëpi e vetme mediale e profesionale e turqve në Kosovë. Lokalet e kësaj shtëpie botuese ishin të vendosura në ndërtesën e Pallatit të Shtypit në Prishtinë, ku po ashtu ishin të vendosura edhe "Rilindja" në gjuhën shqipe dhe "Jedinstvo" në gjuhën serbe, në të cilin kjo shtëpi botuese ishte e vendosur plotë 22 vjet. Pas ndërprerjes së gazetës "Tan" shtëpia e medias "Yeni Dönem" një kohë botonte revistën javore me të njëjtin emër, e cila shtypej në Prizren, por në mungesë të mjeteve financiare, nga korriku i vitit 2008, kjo gazetë nuk del, kështu që momentalisht në Kosovë nuk botohet asnjë gazetë në gjuhën turke.

Me gjithë faktin se gjuha shqipe është gjuhë amtare e ashkalinjve dhe egjiptasve, qasja e tyre në media është mjaft e kufizuar. Në RTK nuk ekziston asnjë emision i cili do të merrej me informimin lidhur me situatën e këtyre dy komuniteteve, e në veçanti, nuk ekziston një program që do të merrej me kulturën dhe traditën e tyre. Qasjen në media këto dy komunitete e realizojnë vetëm përmes programit një orësh në Radio "K" në Fushë Kosovë, dhe në radio stacionet lokale në Ferizaj dhe Podujevë. Këto tri radio stacione, një herë në javë, emetojnë program për pjesëtarët e komunitetit ashkali dhe egjiptas, në kohëzgjatje prej një ore, e këto emisione kryesisht janë të karakterit muzikor-zbavitës.

4.28.6. Përfundim

Bazuar në gjendjen e përshkruar, Avokati i Popullit konstaton se nuk mjafton vetëm të miratohen ligje dhe të hartohen strategji, me të cilat mbrohen të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, por të njëjtat duhet të zbatohen në mënyrë konsekuente në praktikë. Si rrjedhim logjik dhe praktik, Avokati i Popullit konstaton se është i domosdoshëm një vullnet i mirë politik i organeve publike qendrore dhe lokale të Republikës së Kosovës për zbatimin e ligjeve të sipërpërmendura, zbatimi i të cilave edhe do të dëshmojë për ekzistimin e vullnetit të shumëpërfolur nga vetë institucionet publike për multietnicitetin e shoqërisë kosovare.

Është shqetësuese sidomos mungesa e përkrahjes konkrete politike dhe materiale e komuniteteve më të vogla pakicë, si romët, ashkalinjtë, egjiptasit, turqit dhe boshnjakët.

Në veçanti, në gjendje jashtëzakonisht të rëndë në çdo fushë janë, me theks të veçantë në fushën e arsimit, të mbrojtjes së identitetit kulturor dhe të punësimit, komunitetet ashkalinj, egjiptas dhe rom.

4.29. Përdorimi i gjuhëve

Sipas Kushtetutës së Kosovës¹⁹⁶ dhe sipas Ligjit mbi përdorimin e gjuhëve¹⁹⁷ gjuha shqipe dhe serbe, si edhe përdorimi i shkrimit të tyre janë gjuhë zyrtare në Kosovë dhe kanë status të barabartë në institucionet kosovare.¹⁹⁸ Gjuha turke, boshnjake dhe rome kanë status të gjuhëve zyrtare në nivelin komunal, sipas kushteve të parapara me ligj.

Në mënyrë që të respektohet identiteti gjuhësor i të gjithëve dhe me qëllim të krijimit të një mjedisi të përshtatshëm për pjesëtarët e të gjitha komuniteteve, që të shprehin dhe ruajnë identitetin e tyre gjuhësor, në përputhje me Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj, Konventën Kornizë për Mbrojtjen e të Drejtave të Pakicave Kombëtare, Kartën Evropiane për gjuhët rajonale dhe të pakicave, Rekomandimet e Hagës mbi të Drejtat e Pakicave Kombëtare për Arsimim dhe Rekomandimet e Oslos mbi të Drejtat e Pakicave Kombëtare për përdorimin e gjuhëve të tyre, Kuvendi i Kosovës ka nxjerrë Ligjin mbi përdorimin e gjuhëve.

Ligji mbi përdorimin e gjuhëve i rregullon dispozitat ligjore për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve në sferën e përdorimit të gjuhëve të komuniteteve në jetën publike. Ligji e parasheh që secili person mund të komunikojë dhe t'i ketë të gjitha shërbimet dhe dokumentacionin nga institucionet në nivel qendror dhe lokal apo nga organet e tyre, në njërën nga gjuhët zyrtare.

Barazia e gjuhëve zyrtare vlen edhe për mbledhjet, takimet dhe punën e të gjitha organeve në nivel lokal dhe qendror. Të gjitha ligjet e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet të nxirren dhe publikohen në gjuhët zyrtare, përkthimet anë të barasvlershme. Të gjitha ligjet do të publikohen edhe në gjuhët boshnjake dhe turke. Emërtimet zyrtare dhe shenjat institucioneve lokale dhe qendrore duhet të jenë të shkruara në gjuhët zyrtare, si edhe në gjuhët që janë në përdorim zyrtar nëpër komuna. Institucionet qendrore dhe lokale duhet të sigurojnë që mjediset e tyre të punës të jenë të përshtatshme për përdorim efektiv të gjuhëve zyrtare nga zyrtarët dhe punonjësit e

¹⁹⁶ Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Neni 5.

¹⁹⁷ Ligji për përdorimin e gjuhëve, nr. 02/L-37.

¹⁹⁸ Po aty, e paraparë në nenin 1.1 dhe nenin 1.2.

tyre. Shenjat zyrtare që tregojnë apo përfshijnë emrat e komunave, fshatrave, rrugëve dhe vendeve të tjera publike duhet të jenë të shënuara në gjuhët zyrtare dhe në gjuhët që janë në përdorim zyrtarë në ato komuna, në pajtim me ligjin. Komunitet janë përgjegjëse për zbatimin e Ligjit, pavarësisht përbërjes së tyre demografike. Gjithashtu, me ligj është i ndaluar çfarëdo lloj diskriminimi në bazë të gjuhës.

Përdorimi i gjuhëve zyrtare vlen, gjithashtu, si për ndërmarrjet publike edhe për ato shoqërore. Kjo nënkupton të drejtën e komunikimit dhe marrjes së shërbimeve dhe dokumenteve nga këto ndërmarrje në cilin do nga gjuhët zyrtare.

Gjykatat dhe organet e hetuesisë, si edhe organet e tjera përgjegjëse të përfshira në procedurat ligjore janë të obliguara të sigurojnë, që secili person që merr pjesë në këto procedura të mund të përdor gjuhën zyrtare, sipas zgjedhjes së tij. Gjithashtu, janë të obliguar të lëshojnë dokumente, lidhur me procedurat në gjuhët zyrtare që zgjedhen për procedurën dhe në gjuhët e tjera që janë në përdorim, nëse kjo është kërkuar nga cilado palë në procedurë ose nëse sipas mendimit të gjykatës një akt i tillë është me interes të përgjithshëm publik. Personat e përfshirë në procedurë penale apo në çfarëdo procedure tjetër gjyqësore, që nuk e kuptojnë ose nuk e flasin asnjë nga gjuhët zyrtare, kanë të drejtë në përdorimin e gjuhës së tyre amtare dhe është detyrë e gjykatës dhe organeve të hetuesisë që atyre personave t'u sigurohet përkthimi pa pagesë.

Përdorimi i gjuhëve në arsim duhet të jetë në përputhje me dispozitat e Kushtetutës dhe me ligjet nga fusha e arsimit.

Emrat dhe mbiemrat e personave duhet të jenë të regjistruar në regjistrat publikë, si edhe dokumentet personale dhe dokumentet e tjera zyrtare, në formën e tyre origjinale, në shkrimin e tyre sipas traditës dhe sistemit linguist të gjuhëve të tyre. Forma e tillë duhet të përdoret nga shërbyesit civilë.

Me qëllim të ruajtjes, promovimit dhe ruajtjes së gjuhëve zyrtare dhe statusit të tyre të barabartë në Kosovë, si edhe për mbrojtjen e gjuhëve të cilat nuk janë zyrtare, Ligji për përdorimin e gjuhëve ka paraparë obligimin e Qeverisë së Kosovës që të themelojë Komisionin për gjuhët, i cili do të mbikëqyrte zbatimin e ligjit. Ky Komision është themeluar në vitin 2007. Komisioni për gjuhët, krahas masave për të siguruar statusin e barabartë të gjuhëve zyrtare dhe sigurimin e mbrojtjes së gjuhëve të pakicave, gjuha e të cilëve nuk është gjuhë zyrtare, zhvillon dhe realizon hetimet sipas ankesave ose me vetiniciativë, ndërmerr masa administrative në rast të shkeljeve të dispozitave të Ligjit për përdorimin e gjuhëve, nxjerr rekomandime dhe vërejtje me shkrim aty ku rekomandimet e Komisionit nuk janë zbatuar. Çdo komunitet që mendon që i është shkelur e drejta në përdorimin e gjuhës zyrtare dhe gjuhës në përdorim zyrtar ka të drejtë t'i drejtohet Komisionit për gjuhët dhe të paraqesë ankesë kundër institucionit për të cilin mendon se ka shkelur ligjin. Ky Komision, gjatë periudhës raportuese ka mbajtur pesë tryeza të rrumbullakëta për përdorimin e gjuhëve në këto komuna: Prishtinë, Pejë, Prizren, Mitrovicë dhe Gjiilan. Komisioni është shumë i kënaqur me reagimin dhe shkëmbimin e përvojave dhe me problemet që në praktikë kanë të bëjnë me çështjen e gjuhëve.¹⁹⁹

Portali i Komisionit (deri në përfundimin e periudhës raportuese) nuk është plotësisht funksional në gjuhën serbe.²⁰⁰

¹⁹⁹ Informatat janë marrë në takimin e përfaqësuesve të IAP me kryetarin e Komisionit për gjuhët, i mbajtur më 30.11.2010.

²⁰⁰ <http://www.ks-gov.net/kgjz/>.

Edhe pse ka rezultate të dukshme pozitive, lidhur me zbatimin e *Ligjit për përdorimin e gjuhëve*, ende ekzistojnë probleme rreth implementimit nga autoritetet në nivelin lokal dhe qendror. Mjetet e kufizuara të buxhetit të Kosovës dhe mungesa e burimeve e dëmtojnë procesin e zbatimit të këtij ligji. Avokati i Popullit, gjatë kësaj periudhe raportuese, në procesin e monitorimit të të drejtave të gjuhës ka vërejtur se ekzistojnë dallime në përmbushjen e të drejtave ligjore në përdorimin e barabartë të gjuhëve zyrtare në territore të komunave të ndryshme në Kosovë dhe se zbatimi i politikës gjuhësore varet nga autoritetet komunale dhe shkalla përfshirjes së tyre.

Gjuhët zyrtare përdoren në baza të barabarta, gjatë takimeve, në diskutime gjatë punës së komisioneve, komiteteve, si dhe në takimet publike në institucionet lokale dhe qendrore.

Shenjat e vendosura në hyrje të ndërtesave të institucioneve në nivel komunal dhe qendror, si dhe emërtimet e llojit të shërbimit dhe funksionit të të punësuarve kryesisht janë të shënuara në gjuhët zyrtare. Disa komuna, me qëllim të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të komuniteteve kanë nxjerrë statute dhe rregullore për përdorimin e gjuhëve zyrtare të cilat bazohen në legjislacionin nacional aktual në fuqi, që paraqet një shembull pozitiv.

Shenjat zyrtare, të cilat tregojnë apo përfshijnë emrat e komunave, janë të vendosura në gjuhët zyrtare nëpër rrugët rajonale në tërë territorin e Kosovës. Megjithatë, mund të vërehet se në disa vende ato emërtime janë shkruar gabimisht ose janë shkarravitur emërtimet në gjuhën serbe.

Sa i përket përkthimeve të obligueshme të teksteve ligjore në gjuhën serbe, ato janë të cilësisë dobët kanë shumë gabime gjuhësore dhe gramatikore dhe terminologji të papërshtatshme ligjore. Këto probleme justifikohen me mungesën e numrit adekuat të përkthyesve profesional të cilët vështirë rekrutohen për shkak të kushteve të papërshtatshme të punës, mungesën e mundësive për t'u përsosur profesionalisht dhe pagave të ulëta, kjo është edhe arsyeja pse përkthyesit cilësor shkojnë në ato vende pune që paguhen më mirë.²⁰¹

Kur flitet për të drejtat e komuniteteve që emrat e tyre personalë të regjistrohen në librat amë të evidencës, dokumentet personale dhe dokumentet e tjera që lëshohen nga organet komunale, institucioneve publike dhe kompanive publike në formën origjinale në shkrim dhe sipas drejtshkrimit gjuhësor të komunitetit të cilit i përkasin, vërehet se ato të drejta nuk respektohen plotësisht dhe që shpesh emrat nuk janë të shënuar në mënyrën e duhur, por që shkruhen me shenjat fonetike të gjuhës shqipe. Institucioni i Avokatit të Popullit në periudhat e mëhershme, disa herë ka tërhequr vëmendjen në këtë problem. Nëpër komuna ende ekziston problemi me përkthimin e dokumenteve zyrtare, vendimeve dhe aktvendimeve në gjuhët e pakicave. Jo rrallë ndodhë që të pritet gjatë për përkthime dhe ka raste kur dokumentet shpesh përkthehen vetëm më kërkesa individuale që është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Gjithashtu, përkthimi i dokumenteve të tilla është i cilësisë së dobët dhe shpesh ato vështirë kuptohen nga lexuesit. Përkthyesit joprofesionalë, numri i pamjaftueshëm dhe mbingarkesa e tyre ndikon efikasitetin e shërbimeve të përkthimit. Në asnjë shërbim të përkthimit nuk ekziston lektori i cili do të ishte përgjegjës për verifikimin dhe kontrollin e kualitetit të përkthimit.

Kur flasim për informacionet elektronike, mandatet, aktivitetet, shërbimet dhe rastet për punësim, Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës, si edhe shumë komuna i kanë portalet e tyre në internet. Portali i Kuvendit të Kosovës²⁰² është funksional në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Të gjitha pjesët e portalit rregullisht përditësohen dhe janë të qasshëm në të gjitha gjuhët. Ligjet nuk janë të postuara

²⁰¹ <http://www.ks-gov.net/kgjz/>.

²⁰² www.assembly-kosova.org.

në gjuhën boshnjake dhe turke që paraqet shmangie nga neni 5 paragrafi 5.4, Ligji për përdorimin e gjuhëve.

Portalet zyrtare të disa komunave janë funksionale në gjuhën shqipe por jo edhe në gjuhën serbe, për shembull: Prishtina,²⁰³ Peja²⁰⁴ dhe të tjera, derisa disa të tjera janë plotësisht funksionale edhe në gjuhën serbe, siç është portali i komunës së Gjilanit, por pjesa në gjuhën turke nuk ekziston, edhe pse gjuha turke është në përdorim zyrtar në këtë komunë,²⁰⁵ ndërsa portali zyrtari i komunës së Prizrenit është plotësisht funksional në të gjitha gjuhët zyrtare dhe gjuhët që janë në përdorim zyrtar në atë komunë (gjuha shqipe, serbe, boshnjake dhe turke).²⁰⁶

Në komunat ku komuniteti serb përbën shumicën, *Ligji për përdorimin e gjuhëve* nuk respektohet plotësisht. Shembuj pozitivë tani për tani shihen në komunën e Novobërdës dhe të Shtërpcës, ku jeton një numër i konsiderueshëm i shqiptarëve, statuti i të cilëve është i rregulluar në përputhje me këtë ligj, por ende nuk kanë nxjerrë rregullore për përdorimin e gjuhëve. Vërehen përpjekjet rreth implementimit të plotë të këtij ligj nëpër komunat e reja, të cilat ndodhen ende në fazën e formimit të strukturave komunale. Megjithatë, Ligji për përdorimin e gjuhëve nuk respektohet në komunat serbe në veri të Kosovës (pjesa veriore e Mitrovicës, Leposaviq, Zvečan dhe Zubin Potok). Portalet zyrtare në komunat, ku shumicë janë serbët, ende nuk ekzistojnë.

Gjykatat dhe organet e hetuesisë, si edhe organet e tjera përgjegjëse, që përfshihen në procedurat ligjore në punët e përditshme përdorin gjuhët zyrtare në përputhje me ligjin.

Në bazë të asaj çfarë u tha më sipër, vijmë në përfundim se shoqëria kosovare, edhe më tutje, është e ndarë sipas linjave gjuhësore. Mosnjohja e gjuhës shqipe nga komunitetet pakicë paraqet pengesë e cila ndikon negativisht në integrimin e tyre në shoqëri. Komuniteti turk në Kosovë është në pozitë më të mirë, sepse shumica e tyre e flasin gjuhën shqipe. Për komunitetin ashkalinj dhe egjiptas gjuha shqipe është gjuhë amtare, por një numër shumë i vogël i serbëve të Kosovës, boshnjakëve, goranëve dhe romëve e flasin gjuhën shqipe. Është fakt që gjeneratat e reja të qytetarëve e njohin dhe e flasin vetëm njëri nga gjuhët zyrtare dhe komunikojnë pak përveç, kur kanë nevojë për realizimin e ndonjë të drejte në sistemin institucional. Në të njëjtën kohë, gjeneratat e reja në të ardhmen do ta bartin barrën e përgjegjësisë për sigurimin e përdorimit të barabartë të gjuhëve zyrtare në Qeveri dhe në shoqërinë civile. Natyra e obligimeve të realizimit të drejtave të gjuhës kërkon përpjekje të këmbëngulëse dhe të vazhdueshme dhe në këtë drejtim është e nevojshme që t'i zgjidhim problemet dhe shkaktarët në mënyrë që të ruhet shoqëria shumëgjuhësore.

²⁰³ <http://kk.rks-gov.net/prishtina/Municipality/Assembly.aspx>.

²⁰⁴ <http://www.peja-komuna.org/>.

²⁰⁵ <http://www.gjilani-komuna.org/>.

²⁰⁶ <http://www.komuna-prizreni.org/>.

5. Rekomandimet e Avokatit të Popullit

Barazia para ligjit

- Të zbatohet kuota e paraparë me Ligjin për barazinë gjinore, që gruaja në pozitë vendimmarrëse në organet e qeverisjes, në të gjitha nivelet, të jetë së paku 40 %,
- Qeveria e Kosovës të zhvillojë programe dhe masa afirmative për kyçje të grave në tregun e punës,
- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të nxisë programe për arsimim të vazhdueshëm dhe kualifikim të grave, në përputhje me nevojat e tregut të punës,
- Të zbatohet programi për trajnim të punësuarve në institucione, të cilat merren me të drejtat e njeriut dhe me çështjen e barazisë gjinore, në nivelin qendror dhe lokal,
- Të organizohen trajnime shtesë për të punësuarit, të cilët merren me çështjen e dhunës në familje, çështjen e grave mbajtëse të familjes dhe sidomos të grave të moshuara, të cilat jetojnë vetëm,
- Qeveria e Kosovës të iniciojë, pa humbur kohë, miratimin e Ligjit për sigurim social dhe shëndetësor në Kosovë,
- Të aktivizohet çështja e financimit të shtëpive të sigurta dhe telefonave SOS për viktimat e dhunës në familje,
- Të funksionalizohen njësitë për barazi gjinore në komuna dhe të forcohen ato në të gjitha nivelet,
- Të sigurohet futja e statistikave gjinore në organet dhe institucionet e Republikës të Kosovës.

E drejta për jetën

- Avokati i Popullit rekomandon që cilësia dhe transparencja e procesit legjislativ duhet të përmirësohet në masë të madhe, jo vetëm për t'i ofruar Kosovës një kornizë ligjore të shëndoshë, por edhe për ta përmirësuar besimin në sistemin juridik.
- Avokati i Popullit po ashtu rekomandon ofrimin e të gjitha kushteve të domosdoshme për zbatimin efikas të hetimeve për mbrojtjen e të drejtave të viktimave, për evitimin e vonesave të panevojshme dhe miratimin e kërkesave ligjore të ankuesve në procedimet ligjore.

Ndalimi i torturës, trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues

- Të organizohen seminare ose kurse trajnime për institucionet ku mbahen personat e ndaluar, me qëllim të zgjerimit të njohurive për të drejtat e njeriut, sidomos në fushën e mbrojtjes nga tortura, të garantuara në instrumentet ndërkombëtare, që janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë.

- Të respektohen dhe zbatohen pa vonesë rekomandimet që Avokati i Popullit i drejton autoriteteve përgjegjëse mbi respektimin e standardeve të njohura për të drejtat e njeriut dhe personave të privuar nga liria.

Të drejtat e të akuzuarit

- Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministria e Drejtësisë, të hartojë projekte për ndërtimin e qendrave të reja të paraburgimit, qendra korrektuese dhe qendra të ndalimit, apo edhe zgjerimin e atyre ekzistuese, në mënyrë që të akuzuarit, të cilët mbahen në to, të kenë hapësirë të mjaftueshme, sipas kërkesës së ligjit.
- Niveli aktual i popullimit të shumicës së qendrave të paraburgimit nuk përkon me Rregullat e Standardeve Minimale të OKB-së dhe ato evropiane, sipas të cilave kërkohet që të paraburgosurit të vendosen në qeli individuale.
- Policia e Kosovës, si dhe mediat t'i kushtojnë më shumë rëndësi respektimit të parimit të prezumimit të pafajësisë, sepse transmetimi në televizion i momenteve të arrestimit të të akuzuarve, cenon dinjitetin e tyre dhe paragjykon fajësinë e tyre.

E drejta e privatësisë

- Institucionet publike kompetente, me një seriozitet më të madh të angazhohen për mënjanimin e shkeljeve të së drejtës së privatësisë, në rastet kur ajo është e evidente dhe kur kërkohet nga Avokati i Popullit.
- Sa më shpejtë që të jetë e mundur të miratohen dispozita të veçanta ligjore, të kompletuara, për mbrojtjen e të drejtës së privatësisë në të gjitha format e shprehura të saj.

E drejta e martesës dhe familjes

- Avokati i Popullit konsideron se Kuvendi i Kosovës duhet të ketë parasysh ndryshimin e normave në pjesën e pestë të Kapitullit të dytë të Ligjit për Familjen, për të ofruar më shumë qartësi në rregullimin në fushën e birësimeve dhe për qartësimin e juridiksionit gjatë aplikimit të procedurave;
- Avokati i Popullit rekomandon që Instituti Gjyqësor duhet të vazhdojë me organizimin e trajnimeve specifike për gjykimin e rasteve që trajtojnë çështjet familjare, sidomos ato që kanë të bëjnë shkurorëzimin dhe adoptimin, me përqendrim të veçantë në kushtet e parapara me Ligjin për Familjen dhe rolin këshillëdhënës të qendrave për punë sociale.

E drejta e qasjes në dokumente publike

- Avokati i Popullit rekomandon që urgjentisht të bëhet trajnimi i një numri të caktuar të personave për klasifikimin e dokumenteve publike, në mënyrë që qasja në dokumentet publike të bëhet më transparente dhe jo arbitrare.

- Avokati i Popullit rekomandon krijimin e zyrave apo pozitive gjegjëse në institucionet publike, për trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike, ashtu siç është paraparë me ligj.
- Avokati i popullit rekomandon një fushatë ndërgjegjësimit dhe informimit të administratës publike, përkthazi me përgjegjësinë ligjore për sigurimin e qasjes së papenguar në dokumentet publike, për të gjitha palët e interesuara, si dhe për rolin e IAP-së në zbatimin e këtij ligji.

Liria e tubimit

- Avokati i Popullit konstaton se pika 3 e nenit 12, të Ligjit për Tubimet Publike, sipas së cilës detyrimi ligjor që ligjvënësi ia delegon “kujdestarit” të një tubimi “ta kapë dhe ta dorëzojë te policët pjesëmarrësin ose personin tjetër që qarkullon pranë vendit të tubimit publik, nëse e prish rendin, qetësinë, nëse mban armë ose objekte të rrezikshme, ose shenja të ndaluara” janë detyrim ekskluziv i organeve shtetërore të rendit dhe nuk mund të delegohet tek asnjë person tjetër juridik ose fizik.
- Avokati i Popullit rekomandon që neni i lartpërmendur i Ligjit për Tubimet Publike të plotësohet dhe të ndryshohet, në mënyrë që të harmonizohet me standardet evropiane.

Liria e asociimit

- Avokati i Popullit rekomandon që gjatë procesit të shqyrtimit të projektligjeve nga Kuvendi i Kosovës, respektivisht komisionet parlamentare, të merren parasysh vërejtjet dhe sugjerimet e dala nga grupet e ndryshme të interesuara të shoqërisë, grupet profesionale dhe shoqëria civile, në mënyrë që plotësimet dhe ndryshimet e bëra në ligj të jenë transparente, të mbështeten nga shoqëria dhe si përfundim, ligji të jetë shoqërisht i pranueshëm dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare.

E drejta e zgjedhjes dhe e pjesëmarrjes

- Avokati i Popullit rekomandon që institucionet përgjegjëse (Kryetari të Republikës së Kosovës; Ministrisë së Punëve të Brendshme; Kryesuesit të Këshillit Gjyqësor dhe kryeprokurorit të Republikës së Kosovës), të ndërmarrin veprimet e parapara me ligj, për fillimin e hetimeve sipas detyrë zyrtare, për rastet e pohuara të keqpërdorimit të votës, në mënyrë që kryesit e tyre të vihen para drejtësisë.

E drejta për arsimin

- Avokati i Popullit rekomandon që MASHT-i të hartojë një plan të detajuar veprimi për krijimin e një ambienti të më sigurt dhe më të përshtatshëm për nxënësit dhe mësuesit, përmes bashkëpunimit më të ngushtë me institucionet e tjera shtetërore.
- Institucioni i Avokatit të Popullit rekomandon MASHT-in që në bashkëpunim me drejtoritë komunale të arsimit, të organizojnë fushata vetëdijësimi për nxënësit dhe prindërit e tyre, për rëndësinë e shkollimit, sidomos në zonat rurale.

- Avokati i Popullit rekomandon që të gjenden forma për të përkrahur familjet në nevojë, përmes sigurimit të transportit, në mënyrë që të ndikohet në uljen e dukurisë së braktisjes së shkollimit.
- Avokati i Popullit kërkon nga Qeveria e Republikës së Kosovës, sidomos nga MASHT-i, që të ndër marrë hapa konkretë për implementimin e strategjisë për integrimin e komuniteteve pakicë në Republikën e Kosovës.

E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit

- Avokati i Popullit rekomandon që të respektohen dispozitat e Ligjit të Punës në Republikën e Kosovës dhe ato të zbatohen nga institucionet përgjegjëse.
- Avokati i Popullit kërkon nga të gjitha institucionet publike të Republikës së Kosovës që të respektojnë dhe zbatojnë vendimet dhe rekomandimet e institucioneve të pavarura, të IAP dhe të KPMK, dhe njëkohësisht që të gjithë personat përgjegjës për mos-respektimin e tyre të sanksionohen sipas ligjeve në fuqi.

Mbrojtja shëndetësore dhe sociale

- Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës të integrojnë në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, pa vonesë, Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore,
- Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës të miratojnë infrastrukturën e nevojshme ligjore për rregullimin e skemave pensionale në Kosovë, në mënyrë që pensionistëve t'u sigurohet një jetë e dinjitetshme në pleqëri,
- Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës të amandamentojnë dhe plotësojnë Ligjin për Përkrahje Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar të Përhershme, me përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuar me pengesa në të folur dhe të dëgjuar apo me sëmundje të natyrës së ngecjeve të zhvillimit psikologjik,
- Qeveria e Kosovës të rregullojë tregun e punës në sektorin shëndetësor, në mënyrë që qytetari i Kosovës të ketë mundësi zgjedhjeje kualitative të shërbimeve shëndetësore,
- Qeveria duhet të monitorojë, në mënyrë përpiktë, të vazhdueshme dhe sistematike, kualitetin e procedurave mjekësore, kualifikimeve të personelit shëndetësor dhe në këtë mënyrë të minimizojë mundësinë e keqpërdorimit të ushtrimit të profesionit në sektorin e shëndetësisë,
- Qeveria e Kosovës të shqyrtojë në mënyrë prioritare dhe me shumë seriozitet çështjen e kornizës ligjore dhe të funksionalizimit të sistemit shëndetësor në Republikën e Kosovës.

Mbrojtja gjyqësore e të drejtave

- Avokati i Popullit i rekomandon Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Qeverisë dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës, shtrirjen e pushtetit gjyqësor në tërë territorin e vendit, duke përfshirë pjesën veriore të Mitrovicës dhe komunat e tjera, ashtu si parashihet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

- Avokati i Popullit rekomandon funksionalizimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në bazë të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nr. 03/L-223.
- Avokati i Popullit rekomandon themelimin, pa zvarritje të mëtutjeshme, të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në bazë të Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nr. 03/L-224.
- Avokati i Popullit rekomandon zbatimin e Ligji për Gjykatat, nr. 03/L-199, posaçërisht të neneve 29 dhe 36 të ligjit, me qëllim të përmirësimit të kushteve materiale në gjyqësor dhe të strukturimit të gjykatave sipas ligjit.
- Avokati i Popullit rekomandon zbatim efikas të strategjisë dhe të gjitha masave ligjore, të cilat do të ndihmonin në eliminimin e numrit të rasteve të mbetura gjyqësore dhe të deklarohet prioritet i gjyqësorit dhe pushteteve të tjera në Republikën e Kosovës.
- Avokati i Popullit insiston që problemi i personelit dhe probleme të tjera të gjykatave, të cilat janë shkaktarët kryesorë të zvarritjes në procesin e vendimmarrjes, nuk janë dhe nuk mund të jenë arsye të pranueshme pafundësisht, për shkelje të së drejtës për shqyrtim pa zvarritje, e drejtë kjo e garantuar me Kushtetutë.
- Avokati i Popullit rekomandon ofrimin e të gjitha kushteve të domosdoshme për zbatim efikas të aktit ligjor, që rregullon mbrojtjen e të drejtës për gjykim pa zvarritje dhe miratimin e amendamenteve për mbrojtje më të mirë të të drejtave kushtetuese dhe ligjore të klientëve në procedimin lëndëve.
- Avokati i Popullit rekomandon miratimin e masave për të sigurimin e shqyrtimeve më të shpejta të masave të përkohshme parandaluese, pasi nga hetimet e bëra dhe informatat e pranuar, është vërtetuar se disa gjykatave u duhen disa vite për të nxjerrë një masë të përkohshme parandaluese.
- Avokati i Popullit rekomandon ofrimin e të gjitha kushteve për përmbarrimin dhe zbatimin e vendimeve në afatin sa më të shkurtë të mundshëm të vendimeve gjyqësore.
- Avokati i Popullit nënvizon se mospajtimi me vendimet finale gjyqësore, nuk mund të shërbejë si bazë për mosbindje ndaj obligimeve për të gjithë, madje as për institucionet shtetërore në nivel qendror dhe lokal, prandaj Avokati i Popullit rekomandon zbatimin e vendimeve gjyqësore, pa asnjë vonesë.
- Avokati i Popullit rekomandon që autoritetet e ndjekjes penale dhe ato gjyqësore, të garantojnë që kryerësit e veprave, në procedurat e kundërvajtjes, të gëzojnë të drejtat themelore kushtetuese për gjykim të drejtë dhe mjete juridike. Kryerësit e veprave duhet të jenë plotësisht të informuar me akuzat me të cilat ngarkohen, përshkrimin e gjendjes faktike dhe prezantimin e dëshmisë së bazuar, në të cilat ata mundë të sfidojnë vendimet në mënyrë efikase.
- Avokati i Popullit rekomandon që gjykatat, në vendimet mbi masën për trajtim psikiatrik, të precizojnë qysh më parë saktësisht kohëzgjatjen e masës, fillimin dhe mbarimin e saj. Po ashtu, në procedurën e rishqyrtimit të marrin vendim në afatin e përcaktuar kohor, lidhur me kohëzgjatjen e masës pas periudhës njëvjeçare të ekzekutimit të saj, duke e informuar të pandehurin pa mëdyshje.
- Avokati i Popullit rekomandon hartimin e një rregulloreje për ekspertët gjyqësorë, dhe kërkon që autoritet kompetente, të sigurojnë kushtet e përshtatshme në mënyrë që ekspertët dëshmitarë dhe vlerësuesit të jenë në gjendje të kryejnë punën e tyre të ekspertit me tërë përgjegjësinë morale

dhe profesionale: saktësisht, me përgjegjësi dhe paañesi dhe në periudhat kohore të përcaktuara me ligj.

- Prandaj Avokati i Popullit i rekomandon Odës së Avokatëve që të sigurojë kualitet më të madh të ndihmës ligjore, në raste të përfaqësimit, sipas detyrës zyrtare (*ex officio*) apo të ndihmës ligjore falas dhe të rregullojë qartë dhe pa mëdyshje sigurimin e klientëve të avokatit, në raste të dëmtimit, lidhur me kryerjen e detyrës së avokatit.

6. Aktivitetet e Institucionit të Avokatit të Popullit

6.1. Aktivitetet e Njësisë për Barazi Gjinore

Sipas Nenit 6 të Ligjit për Barazi Gjinore çështja e diskriminimit në bazë të gjinisë trajtohet nga ana e Njësisë për Barazi Gjinore (NJBGJ), brenda Institucionit të Avokatit të Popullit, e cila gjithashtu është përgjegjëse për rishikimin e ligjeve dhe angazhohet në zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore.

Në periudhën për të cilën raportohet, NJBGJ ka pranuar shumë ankesa, në lidhje me diskriminimin në baza gjinore, në fushën e punësimit, edukimit, pronësisë dhe shëndetësisë. Gjithashtu, ka qenë edhe një numër i konsiderueshëm i ankesave të cilat janë paraqitur në NJBGJ, në lidhje me dhunën në familje, mbrojtjen e viktimës dhe strehimin, ankesat për drejtën në qasje në sistemin gjyqësor dhe në fushat e tjera.

Gjatë kësaj periudhe, NJBGJ ka pasur kontakte të rregullta me partnerë të shumtë ndërkombëtarë dhe vendorë, si dhe me përfaqësues të shoqërisë civile: me përfaqësuesit e EULEX-it, UNIFEM dhe përfaqësues të OJQ-ve të ndryshme.

NJBGJ ka bashkëpunuar, po ashtu me Policinë e Kosovës, qendrat për punë dhe mirëqenie sociale, shtëpitë e sigurta, si dhe me OJQ të ndryshme si: Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës, "Norma". Qendra Kosovare për Studime Gjinore", "Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve", "Rrjeti i organizatave të grave rome, ashkali dhe egjiptiane në Kosovë" etj.

Gjatë kësaj periudhe përfaqësuesit e NJBGJ kanë marrë pjesë në disa seminare dhe takime të organizuara nga organizata të huaja dhe vendore, të cilat kanë pasur për qëllim përgatitjen e politikave dhe planeve të veprimit në fushën e barazisë gjinore dhe zbatimin e standardeve të aplikueshme, forcimin e rolit të gruas në shoqëri, në përfaqësimin e saj në politikë etj.

Po ashtu NJBGJ ka qenë e pranishme dhe në emisione radiofonike, për të qenë më pranë qytetarëve dhe për të folur mbi çështjet shqetësuese të dhunës në familje. Në kuadër të kësaj teme, NJBGJ ka marrë pjesë dhe ka dhënë kontributin në takimet e organizuara nga shoqata vendore "Norma" mbi zbatimin e projektit "Të gjithë kundër dhunës". Qëllimi i projektit ka qenë ngritja e vetëdijes në shoqërinë kosovare, lidhur me parandalimin e dhunës në familje.

Më 17 mars 2011, Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ) ka organizuar promovimin e hulumtimit "E drejta e trashëgimisë pronësore të grave në Kosovë". Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi ishte qenë trajtimi i çështjeve që lidhen me të drejtat e trashëgimisë pronësore të grave në Kosovë, problemet, pengesat dhe vështirësitë që hasin gratë në Kosovë, lidhur me realizimin e të drejtës për trashëgimi.

6.2. Aktivitetet e Grupit për të Drejtat e Fëmijëve

Grupi për të Drejtat e Fëmijëve (GDF) në kuadër të Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP) është themeluar me qëllim që me kujdes të veçantë t'i mbikëqyrë, t'i mbrojë dhe t'i hetojë shkeljet e të drejtave të fëmijëve nga autoritetet publike në Kosovë.

GDF, gjatë vitit 2010 përveç shqyrtimit të ankesave të paraqitura në IAP, ka zhvilluar një varg aktivitetesh të tjera, për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e fëmijëve në Kosovë.

Më 12 maj 2010, GDF mori pjesë në konferencën “Mbështetja e reformave të drejtësisë për të mitur në Kosovë”, me të cilën u shënua vazhdimi i fazës së dytë të programit për mbështetje të sistemit të drejtësisë për të mitur në Kosovë, të organizuar nga UNICEF dhe Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian.

Më 1 qershor 2010, GDF mori pjesë në një tryezë të rumbullakët, të organizuar nga Zyra e UNICEF dhe “Forumi 2015”, në të cilën u diskutuan gjetjet e raportit të UNICEF-it “Varfëria e fëmijëve në Kosovë”.

Me qëllim të këmbimit të përvojave në fushën e të drejtave të fëmijëve, si dhe të thellimit të bashkëpunimit ndërinstitucional, GDF zhvilloi dy vizita studimore në dy institucione simotra jashtë Kosovës. Vizita e parë u zhvillua prej 22-23 korrik 2010, në Institucionin e Avokatit të Popullit të Maqedonisë, ndërsa e dyta u zhvillua më 27 gusht 2010, në Institucionin e Avokatit të Popullit të Malit të Zi.

Prej 7deri më 9 tetor 2010, dy përfaqësuese të IAP, në cilësi të vëzhguesit, morën pjesë në takimin vjetor të Rrjetit Evropian të Ombudsmanëve për Fëmijë (ENOC) në Strasburg (Francë). Tema e konferencës kishte të bënte me nenin 12 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, respektivisht me dëgjimin dhe përfshirjen e fëmijëve në promovimin dhe zbatimin e të drejtave të tyre.

Më qëllim të informimit më të mirë të opinionit publik për punën e GDF, si dhe për situatën e të drejtave të fëmijëve në Kosovë, GDF, më 11 tetor 2010, ka marrë pjesë në emisionin “Obligimi ynë”, në Radio Kosova. Emisioni ishte i fokusuar në çështjen e dhunës nëpër shkolla, si dhe përfshirjen e obligueshme të orës së kujdestarisë në programet mësimore të shkollave të Kosovës.

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve profesionale të GDF, dy përfaqësuese të grupit ndoqën mësimet në distancë, të udhëhequra nga Shoqata për Arsimim mbi të Drejtat e Njeriut. Temat e programit ishin “Monitorimi i të drejtave të fëmijëve” dhe “E drejta në arsimim”.

Më 21 dhjetor 2010, GDF mori pjesë në konferencën “Të drejtat e fëmijëve në Kosovë”, të organizuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Në këtë konferencë, përveç tjerash, u diskutua edhe mbi procesin e hartimit të raportit, lidhur me zbatimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës në Republikën e Kosovës, si dhe mbi veprimet e ndërmarra në realizimin e Strategjisë dhe Planit Nacional të Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve, nga ana e disa institucioneve të Republikës së Kosovës.

Më 23 dhjetor 2010 përfaqësueset e IAP-së janë takuar me përfaqësues të Koalicionit të Organizatave Joqeveritare, që punojnë në lëmin e mbrojtjes së fëmijëve (KOJQ). Takimi u realizua me qëllim të shqyrtimit të mundësive për bashkëpunim më të mirë ndërmjet IAP-së dhe KOJQ-së, në përpjekjet për përmirësimin e funksionimit të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në Kosovë.

Në këtë kontekst gjatë kësaj periudhe të raportimit GDF ka vazhduar bashkëpunimin edhe me përfaqësitë e organizatave ndërkombëtare në Kosovë, UNICEF dhe Save the Children Kosovo.

7. Bashkëpunimi i IAP-së

7.1. Bashkëpunimi me institucionet vendore

Avokati i Popullit, gjatë periudhës për të cilën raportohet, është takuar me përfaqësuesit e institucioneve të Republikës së Kosovës, në nivel qendror dhe lokal, duke përfshirë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, komisionet parlamentare, Qeverinë e Kosovës, njësitë për të drejtat e njeriut të të gjitha ministrive, si dhe ato nëpër komuna. Po ashtu, Avokati i Popullit ka zhvilluar takime edhe me kryetarët e pothuajse të gjitha komunave të Kosovës.

Zyrtarët e IAP-së kanë pasur takime të shumta me gjykatat e Kosovës, me qëllim të shqyrtimit të ankesave të shumta të qytetarëve të Kosovës, të cilët i janë drejtuar IAP-së, sidomos çështjet që kanë të bëjnë me mosekzekutimin e vendimeve dhe zvarritjes së procedurave gjyqësore.

Edhe gjatë këtij viti, Avokati i Popullit, ka realizuar takime edhe me institucionet e pavarura të Kosovës, duke përfshirë edhe disa tryeza të rrumbullakëta, të cilat janë realizuar në bashkëpunim me misionin e OSBE në Kosovë, qëllimi i të cilave ishte identifikimi i problemeve të përbashkëta dhe specifike të të gjitha institucioneve të pavarura, si dhe gjetjes së mënyrës së drejtë për zgjidhjen e këtyre problemeve. Në këto takime të pranishëm ishin përfaqësuesit e institucioneve si: Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës, Instituti Gjyqësor i Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Komisioni i Pavarur për Media, Agjencia Kundër Korrupsionit, Banka Qendrore e Kosovës, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit, Zyra e Rregullatorit për Energji, Zyra e Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale etj.

Një bashkëpunim të mirë IAP, gjithashtu, ka pasur edhe me Gjykatën Kushtetuese të Kosovës dhe Gjykatën Supreme, si shtylla kryesore të sistemit gjyqësor në Kosovë, me të cilat janë trajtuar shumë raste që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut në Kosovë.

7.2. Bashkëpunimi me OJQ-të vendore

IAP ka bashkëpunuar ngushtë edhe me OJQ-të vendore siç janë: Këshilli për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut (KMLDNJ), Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT), KDI, CLARD, Lëvizja Fol, Hendikos etj.

Bashkëpunimi me Lëvizjen FOL, në projektin “Fuqizimi i dialogut kundër abuzimit të autoritetit publik”, kishte për qëllim të ndihmojë në zhvillimin e një dialogu cilësor ndërmjet Institucionit të Avokatit të Popullit me Kuvendin e Kosovës, si dhe me shoqërinë civile, duke krijuar kanale dhe duke lehtësuar komunikimin ndërmjet tyre. Me këtë rast janë organizuar disa debate me qytetarë dhe debate televizive, si dhe fushata multimediale për promovimin e institucionit. Në fund nga kjo organizatë u publikua një raport me të gjetura dhe rekomandime, i cili iu dërgua të gjitha institucioneve më të larta shtetërore.

Më 1 nëntor 2010, IAP ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me OJQ Clard, i cili vazhdon nga vitet e kaluara. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është forcimi i bashkëpunimit ndërmjet palëve, me qëllim të sigurimit të mbrojtjes së duhur të të drejtave të njeriut në Kosovë, për të gjithë personat të cilët konsiderojnë që u janë shkelur të drejtat e tyre.

Po ashtu, bashkëpunim shumë të mirë IAP ka edhe me QKRMT dhe KLMDNJ. Nga ky bashkëpunim është formuar një grup punues nga i cili pritet të krijohet një model i mekanizmit kombëtar për parandalimin e torturës. Deri më tani, ky grup punues në mbështetje të OSBE, ka mbajtur disa takime pune dhe ka përgatitur marrëveshjen e bashkëpunimit e cila është nënshkruar.²⁰⁷

7.3. Bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare në Kosovë

Sa i përket bashkëpunimit me organizata ndërkombëtare, IAP-ja ka pasur takime të vazhdueshme me organizatat si: OSBE, OHCHR, UNDP, UNHCR, UNMIK, UNICEF, EULEX, ABA ROLI, SOROS, Këshilli i Evropës etj., si dhe shumë nga ambasadat e huaja në Kosovë, si: Ambasada e Amerikës, Gjermanisë, Zvicërës, Italisë, Norvegjisë, Francës dhe ajo holandeze. Qëllimi i këtyre takimeve ka qenë bashkëpunimi ndërinstitucional në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut si dhe për mundësitë e ngritjes së kapaciteteve të institucionit në të ardhmen.

IAP ka një bashkëpunim të ngushtë me Misionin e OSBE-së në Kosovë, që nga krijimi i institucionit në vitin 2000. Për të krijuar mbrojtje institucionale dhe afatgjatë, Misioni i OSBE-së e mbështet IAP-në, si institucion mbikëqyrës dhe mbrojtës publik i të drejtave të njeriut në Kosovë. Në IAP vazhdimisht angazhuar një këshilltar nga Misioni i OSBE, i cili ndihmon punën e përditshme të IAP-së, me këshilla dhe ekspertizë.

Prej shtatorit të vitit 2010, Institucioni i Avokatit të Popullit po përkrahet edhe nga projekti CDF, i menaxhuar nga Zyra e UNDP në Kosovë dhe KFOS. Projekti i CDF, përmes një këshilltarije e ndihmon IAP-në në ngritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve institucionale dhe profesionale përmes funksionalizimit të plotë të institucionit, me qëllim të realizimit të suksesshëm të misionit të Avokatit të Popullit.

7.4. Bashkëpunimi me institucionet simotra

Institucioni i Avokatit të Popullit ka vazhduar bashkëpunimin e mirë me institucionet simotra, përkatesisht avokatët e popullit të vendeve si: Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Bosnjë e Hercegovina, Sllovenia, Kroacia, Belgjika, Holanda, Hungaria, Greqia dhe Katalonia.

Me rastin e 10-vjetorit të themelimit të Institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës dhe 62-vjetorit të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, IAP ka organizuar konferencën me temën “Sovraniteti dhe të Drejtat e Njeriut”, në të cilën kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të institucioneve simotra të vendeve të ndryshme, institucionet më të larta shtetërore, organizata joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare si dhe disa nga ambasadat në Kosovë.

²⁰⁷ Marrëveshja e bashkëpunimit midis IAP, KMDLJ dhe të QKRMT është nënshkruar më 11 maj 2011 në Prishtinë.

Disa nga konkluzionet më të rëndësishme të konferencës ishin:

- *Shtetet e pranishme në konferencë kanë pasur përvoja nga më të ndryshmet mbi temën e diskutuar dhe Institucioni i Ombudspersonit ka lindur si nevojë e ndryshimeve politike apo kushtetuese të vendeve të Evropës;*
- *Dalja nga konfliktet mundësoi krijimin e institucioneve të Ombudspersonit;*
- *Zbatimi i dokumenteve e instrumenteve të miratuara ndërkombëtare ndikoi në ndryshimin e bazës shoqërore;*
- *Vërehet se në shumicën e vendeve vërehet një përafrim i pozitës së individit në normat kushtetuese në Evropë, e kjo vlen sidomos për vendet e Ballkanit;*
- *Vihet re se forma e sovranitetit klasik ka ndryshuar me kalimin e kohës dhe një ngritje e rolit të sovranit individual në krahasim me atë kolektiv - shtetin;*
- *Nuk vërehen dallime të mëdha midis institucioneve të Ombudspersonit në formë e koncept, e mbi të gjitha vërehet një ngjashmëri e madhe në misionet e tyre;*
- *Po ashtu u theksua se misioni i Institucionit të Ombudspersonit është edhe lehtësimi i punës së gjyqësorit, sidomos në raportet e individit me institucionet tjera publike dhe në rastet e ndërmjetësimit;*
- *Kërkesa e përhershme për bashkëpunim të ngushtë me të gjitha institucionet simotra;*
- *Vlen për tu përmendur dhe përgëzuar fakti që sot në Kosovë mund të flitet e debatohet lirshëm për këtë temë.*

7.5. Ndërtimi i kapaciteteve, konferencat, punëtoritë dhe trajnimet

Gjatë periudhës raportuese, Avokati i Popullit dhe bashkëpunëtorët e IAP-së kanë marrë pjesë në shumë konferenca, punëtori, vizita studimore dhe trajnime.

Më 19-20 janar 2010, tre punonjës të IAP-së morën pjesë në konferencën me temë “*Mbrojtja e të dhënave të policisë dhe gjyqësisë në çështjet penale*”, organizuar nga Komisioni Evropian, mbajtur në Prishtinë.

Më 23 mars 2010, një juriste e IAP-së mori pjesë në punëtorinë për programin dhe planin e veprimit të Qeverisë së Kosovës për parandalimin e vetëvrasjes dhe vetëdëmtimit në Kosovë 2010-2015, organizuar nga zyra për qeverisje të mirë e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, mbajtur Prishtinë.

Më 28 mars - 2 prill 2010, dy punonjëse të administratës, morën pjesë në trajnimin “*Komunikimi dhe sjellja*”, mbajtur në Durrës, Shqipëri.

Më 12 – 23 prill 2010, një jurist i Institucionit të Avokatit të Popullit, mori pjesë në trajnimin lidhur me hetimin e korrupsionit, organizuar nga zyra e Komisionit Evropian, në mbështetje të Agjencisë Kundër Korrupsionit, mbajtur në Prishtinë.

Më 16 prill 2010, një juriste e IAP-së mori pjesë në tryezën e rrumbullakët me temë “*Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave sociale të punës në Kosovë*”, organizuar nga OJQ Clard, mbajtur në Prishtinë.

Më 29 prill 2010, një juriste e IAP-së mori pjesë në punëtorinë lidhur me Ligjin për aftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, organizuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, mbajtur në Prishtinë.

Më 14 maj 2010, punonjësit e IAP-së morën pjesë në punëtorinë me temë *"Planifikimi strategjik"*, organizuar nga OSBE, mbajtur në Therandë.

Më 19 maj 2010, një juriste e IAP-së mori pjesë në konferencën me temë *"Të drejtat e njeriut dhe mjedisi"*, organizuar nga Ombudsmani i Sllovenisë, mbajtur në Brdo Kranj, Slloveni.

Më 20 maj 2010, një jurist i IAP-së mori pjesë në seminarin me temë *"Fuqizimi i bashkëpunimit ndërmjet policisë, prokurorisë dhe gjykatave"*, organizuar nga OSBE, mbajtur në Prishtinë.

Më 26 – 27 maj 2010, punonjësit e IAP-së morën pjesë në trajnimin me temë *"Puna ekipore dhe metodat e zgjidhjes së konfliktit"*, organizuar nga OSBE, mbajtur në Hajvali.

Më 27 – 30 maj 2010, drejtori ekzekutiv, zyrtari për buxhet dhe financa dhe menaxheri i prokurimit, morën pjesë në trajnimin me temë: *"Buxheti, decentralizimi i shpenzimeve dhe menaxhimi i financave publike"*, mbajtur në Durrës, Shqipëri.

Më 3 qershor 2010, një juriste e IAP-së mori pjesë në debat për Projektligjin për qasje në dokumente zyrtare, organizuar nga OJQ Lëvizja Fol, mbajtur në Prishtinë.

Më 13 – 16 qershor 2010, një juriste e IAP-së mori pjesë në konferencën me temë *"Respektimi i të drejtave të njeriut, shëndetit dhe dinjitetit të të burgosurve"*, mbajtur në Bruksel, Belgjikë.

Më 8 – 11 korrik 2010, një jurist i IAP-së mori pjesë në trajnimin me temë *"Procesi i shpronësimit dhe vlerësimit të patundshmërive"*, organizuar nga Financial Low Smart Agency, mbajtur në Durrës, Shqipëri.

Më 20 korrik 2010, Avokati i Popullit dhe dy juriste kanë qenë në vizitë në institucionin e Ombudmanit në Mal të Zi, me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe thellimit të bashkëpunimit në mes të dy institucioneve, Podgoricë, Mali i Zi.

Më 22 – 23 korrik 2010, dy juriste të Grupit për të Drejtat e Fëmijëve morën pjesë në një vizitë studimore në Institucionin e Avokatit të Popullit të Maqedonisë, në Shkup, me qëllim të thellimit të bashkëpunimit ndërinstytucional, veçanërisht në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Më 27 gusht 2010, dy juriste të Grupit për të Drejtat e Fëmijëve morën pjesë në një vizitë studimore në Institucionin e Avokatit të Popullit të Malit të Zi, në Podgoricë, me qëllim të thellimit të bashkëpunimit ndërinstytucional, veçanërisht në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Më 16 – 19 shtator 2010, drejtori i administratës, zyrtari për buxhet dhe financa dhe menaxheri i prokurimit, morën pjesë në trajnimin me temë *"Procesi i buxhetit, prokurimi dhe ekzekutimi i shpenzimeve"*, mbajtur në Durrës, Shqipëri.

Më 18 shtator 2010, punonjësit e IAP-së morën pjesë në seminarin me temë *"Shkrimi dhe citimi akademik"*, organizuar nga OSBE, mbajtur në Hajvali.

Më 20 shtator 2010, Avokati i Popullit, mori pjesë në takim me temë *"Çështja e emigrantëve në Slloveni"*, organizuar nga Ombudsmani i Sllovenisë, mbajtur në Lubjanë, Slloveni.

Më 21- 29 shtator 2010, Avokati i Popullit mori pjesë në sesionin e Këshillit për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara, mbajtur në Gjenevë, Zvicër.

Më 21 shtator 2010, dy juriste të IAP-së morën pjesë në konferencën ndërkombëtare me temë Qasja e personave me aftësi të kufizuar nëpër objektet publike dhe infrastrukturës, në kuadër të projektit “Një ambient i përshatshëm-shoqëri për të gjithë” të organizuar nga Handikos, mbajtur në Prishtinë.

Më 21 – 23 shtator 2010, një jurist i IAP-së mori pjesë në trajnimin me temë “Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit”, organizuar nga Agjencia Kundër Korrupsionit, mbajtur në Ohër, Maqedoni.

Më 29 shtator 2010, një jurist i IAP-së mori pjesë në tryezën me temë “Dialogu Social në Kosovë – përparësitë dhe sfidat”, organizuar nga Friedrich Ebert Stiftung dhe BSPK, mbajtur në Prishtinë.

Më 1 – 2 tetor 2010, është mbajtur trajnimi i dytë për gjithë stafin e IAP-së me temë “Shkrimi dhe citimi akademik”, organizuar nga OSBE, mbajtur në Hajvali.

Më 7 – 9 tetor 2010, dy juriste të IAP-së morën pjesë në konferencën e katërt të Rrjetit Evropian të Ombudsmanëve për Fëmijë (ENOC), me temë “Dëgjimi dhe përfshirja e fëmijëve në promovimin dhe zbatimin e të drejtave të tyre”, mbajtur në Strasburg, Francë.

Më 7 – 10 tetor 2010, Avokati i Popullit mori pjesë në Konferencën e Dhjetë për Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut të mbi 80 vendeve të ndryshme nga mbarë bota, mbajtur në Edinburg, Skoci.

Më 15 tetor 2010, një juriste e IAP-së mori pjesë në takimin e organizuar në kuadër të javës ndërkombëtare të njeriut me shkop të bardhë, organizuar nga Shoqata e të Verbërve të Kosovës, mbajtur në Prishtinë.

Më 20 – 21 tetor 2010, Avokati i Popullit dhe një juriste morën pjesë në Tryezën Rajonale “Mekanizmi Kombëtar kundër Torturës, në kuadër të OPCAT me temë: “Sfidat për implementim dhe roli i Institucioneve për të Drejtat e Njeriut”, mbajtur në Crikvenicë, Kroaci.

Më 21 – 24 tetor 2010, dy punonjës të administratës morën pjesë në trajnimin me temë “Pagesat, pagat dhe pasqyrat financiare”, organizuar nga Financial Low Smart Agency, mbajtur në Ohër, Maqedoni.

Më 4 – 5 nëntor 2010, është mbajtur trajnimi për juristët e IAP-së me temë “Instrumentet ligjore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe praktika gjyqësore lidhur me çështjet e të drejtave të njeriut – Metodologjia dhe teknikat”, me ekspertë nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Këshilli i Evropës, organizuar nga OSBE, mbajtur në Hajvali.

Më 17 – 18 nëntor 2010, dy juriste të IAP-së morën pjesë në punëtorinë me temë “Roli i strukturave kombëtare për të drejtat e njeriut në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut”, mbajtur në Bilbao, Spanjë.

Më 23 nëntor 2010, juristët e IAP-së kanë marrë pjesë në një tryezë të rrumbullakët me temë “Monitorimi i burgjeve dhe qendrave të paraburgimit - shkëmbim eksperiencash” mes IAP, QKRT dhe KLMDNJ, organizuar nga OSBE, mbajtur në Gërmi.

Më 26 nëntor 2010, Avokati i Popullit drejtoi tryezën e rrumbullakët me pjesëtarë të IAP-së dhe mediave lokale në Republikën e Kosovës, me temë “Roli i Avokatit të Popullit dhe Mediat”, organizuar nga OSBE, mbajtur në Gërmi.

Më 26 nëntor 2010, një juriste e IAP-së mori pjesë në konferencën me temë “*Termocentralet, EU-Standardet dhe Mjedisi*”, organizuar nga OJQ Bells në bashkëpunim me ATRC, mbajtur në Vlorë, Shqipëri.

Më 1-3 dhjetor 2010, Avokati i Popullit mori pjesë në takimin e katërt vjetor në kuadër të projektit “*Peer-to-Peer*”, ku është përcaktuar orari i takimeve dhe temat për shqyrtim, të organizuara nga Këshilli i Evropës për Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut në Evropë, organizuar nga Këshilli i Evropës, mbajtur në Strasburg, Francë.

Më 1 - 3 dhjetor 2010, tre juristë të IAP-së morën pjesë në seminarin tre ditor me temë “*Procedura për paraqitjen e kërkesave të autoriteteve publike para Gjykatës Kushtetuese*”, organizuar nga organizata East West Management Institute, mbajtur në Mavrovë, Maqedoni.

Më 8 dhjetor 2010, me rastin e themelimit të 10-vjetorit të themelimit të Institucionit të Avokatit të Popullit në Kosovë dhe me rastin e 62-vjetorit të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës organizoi konferencën me temë “*Sovraniteti dhe të drejtat e njeriut*”, mbajtur në Prishtinë.

Më 13 - 15 dhjetor 2010, dy juriste të IAP-së morën pjesë në forumin e tretë të Kombeve të Bashkuara për çështje të minoriteteve me temë “*Minoritetet dhe participimi i tyre në jetën ekonomike*”, organizuar nga Zyra e Komisionares së Lartë për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara, mbajtur në Gjenevë, Zvicër.

Më 20 - 21 dhjetor 2010, një juriste e IAP-së mori pjesë në konferencë me temë “*Mbikëqyrja e Parlamentit dhe Institucionet e Pavarura*”, organizuar nga OSBE, mbajtur në Tiranë, Shqipëri.

Më 21 dhjetor 2001, juristja e GDF mori pjesë në konferencën me temë “*Të drejtat e fëmijëve në Kosovë*”, organizuar nga zyra për qeverisje të mirë në kuadër të zyrës së Kryeministrit, mbajtur në Prishtinë.

Më 22 dhjetor 2010, Avokati i Popullit mori pjesë në takime me shumë zyrtarë të ndryshëm nga Zyra e Komisionares së Lartë për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara, në të cilat u diskutua lidhur me çështje të ndryshme të të drejtave të njeriut, si dhe format e bashkëpunimit të mëtutjeshëm të këtyre institucioneve, mbajtur në Gjenevë, Zvicër.

8. Buxheti i Institucionit të Avokatit të Popullit

Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Avokatin e Popullit, IAP, si institucion i pavarur, i propozon buxhetin Kuvendit të Kosovës, i cili e miraton atë. Përgjegjësia për përgatitjen, propozimin dhe përdorimin e buxhetit, si institucion i pavarur kushtetues, është kryekëput e IAP-së, ndërsa kontrollin për mënyrën e përdorimit dhe shpenzimit të buxhetit, bazuar në ligjet përkatëse, e bën Auditori i Përgjithshëm në Republikën e Kosovës.

Sipas Ligjit për Avokatin e Popullit, por edhe sipas dokumenteve të tjera relevante ndërkombëtare, Institucionit të Avokatit të Popullit duhet siguruar buxhet të mjaftueshëm dhe mbështetje e përhershme, në mënyrë që institucioni të jetë në gjendje të kryejë obligimet dhe misionin që i ngarkohen me ligj dhe Kushtetutë.

Fatkeqësisht, në realitet nuk ngjajnë as njëra, as tjetra, sepse Kuvendi i Kosovës nuk ka vendosur për buxhetin, sipas propozimit të IAP-së. Këtu, megjithatë, fjalën përfundimtare e thotë Qeveria, përkatësisht Ministria e Financave, e cila mban monopolin e parasë publike dhe menaxhon në atë mënyrë. E rrjedhimisht, IAP-së nuk i sigurohet buxhet i mjaftueshëm dhe mbështetje e përhershme nga Kuvendi dhe Qeveria.

Shuma e buxhetit të aprovuar për vitin raportues nuk është miratuar sipas kërkesës së IAP-së. Buxheti i kërkuar ka qenë në shumë prej 565.442.00 eurosh. Aty është parashikuar një rritje e personelit prej 47 në 51 zyrtarë. Për vitin 2010 nga Buxheti i Konsoliduar i Republikës së Kosovës, Ministria e Ekonomisë dhe Financave ka ndarë për IAP-në buxhetin në shumën prej gjithsej 512,630.00 eurosh, pra 52.812.00 euro më pak sesa ishte kërkesa e IAP-së, me të cilën është paraparë rritja e ngadalshme e personelit të institucionit, për të përcjellë rritjen e angazhimeve dhe të obligimeve ligjore e kushtetuese të IAP-së.

Me këtë buxhet janë financuar këto kategori ekonomike buxhetore: pagat dhe mëditjet, mallrat dhe shërbimet, shpenzimet komunale dhe shpenzimet kapitale.

Tabela 1: Struktura e buxhetit për 2010, sipas kategorive buxhetore

KATEGORITË	TË PLANIFIKUARA	TË SHPENZUARA	DIFERENCA
Paga dhe mëditje	271,425.00 €	271.424.31 €	0.69 €
Mallra dhe shërbime	188,205.00 €	180.253.17 €	7,951.83 €
Shpenzime komunale	46,000.00 €	16,707.75 €	29,292.25 €
Shpenzime kapitale	7,000.00 €	6,032.00 €	968.00 €
TOTALI	512,630.00 €	474,417.23 €	38,212,77 €

Me gjithë buxhetin e kufizuar me Ligjin për Ndarjet Buxhetore të vitit 2010, bazuar në planifikimin dhe kërkesën buxhetore, IAP këtë buxhet e ka administruar në mënyrë efçente dhe sipas destinimit përkatës, duke respektuar kategoritë e veçanta buxhetore. Për plotësimin e nevojave urgjente të institucionit është bërë transferim i buxhetit, në kategorinë buxhetore për shpenzimet kapitale, nga shpenzimet komunale (shih Tabela 2), me qëllim të furnizimit me dy aparateve të rinj fotokopjues.

Shpenzimet buxhetore, për këtë periudhë raportimi, nuk janë realizuar sipas planifikimit buxhetor, sidomos për kategorinë buxhetore për paga dhe mëditje, si rezultat i mosemërimit të zëvendësve të Avokatit të Popullit nga Kuvendi i Kosovës, si dhe të shkëputjes vullnetare të marrëdhënies së punës të disa të punësuarve, si dhe vonesave për rekrutim të bashkëpunëtorëve të rinj, si rezultat i procedurave ligjore të rekrutimit (shpallja dhe ri-shpallja e konkurseve).

Mjetet financiare të pashpenzuara për paga dhe mëditje, sipas këtij destinimi janë shfrytëzuar për pagesat e shujtës për shërbyesit civilë, të bazuar në memorandumimin midis Sindikatës së shërbimit civil dhe Qeverisë.

Gjatë vitit 2010, për aktivitetet e ndryshme, IAP është mbështetur financiarisht edhe nga donatorë vendorë dhe ndërkombëtarë. Zyra e Norvegjisë, Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe Postë-Telekomi i Kosovës (PTK) mbështetën financiarisht organizimin e Konferencës Ndërkombëtare, lidhur me 10-vjetorin e themelimit të IAP-së. Gjithashtu, zyra e UNICEF-it në Kosovë ka mbështetur një seri aktivitetesh, të organizuara në kuadër të projektit, lidhur me fushatën e të drejtave të fëmijëve. OSBE ka organizuar dhe financuar 3 trajnime kolektive për tërë stafin e IAP-së, kurse në faza të ndryshme ka organizuar edhe trajnime të veçanta për zyrtarët ligjorë dhe të administratës.

Pavarësia e një institucioni të pavarur si kategori kushtetuese, është e lidhur ngushtë me pavarësinë financiare. Prandaj, si Kuvendi, ashtu edhe Qeveria e Republikës së Kosovës, rekomandohen që të marrin të gjitha masat e nevojshme, që kjo pavarësi të sigurohet dhe të ruhet, si dhe të pasqyrohet me plotësimin e kërkesës buxhetore dhe burimet njerëzore për vitin 2011, ashtu siç është e rregulluar me ligj.

9. Përmbledhja statistikore e ankesave dhe rasteve për vitin 2010

Nga 1 janari 2010 deri më 31 dhjetor 2010, 1233 persona janë paraqitur në Institutin e Avokatit të Popullit, në selinë e tij në Prishtinë dhe në zyrat rajonale, për të parashtruar ankesa ose për të kërkuar këshilla dhe ndihmë juridike. 414 prej tyre janë proceduar si raste për t'u hetuar, ndërsa për pjesën tjetër të ankesave, palët janë udhëzuar apo këshilluar për hapat që duhet të ndjekin. Gjatë kësaj periudhe 338 persona janë takuar personalisht me Avokatin e Popullit, zëvendësin e Avokatit të Popullit ose drejtorin e hetimeve, gjatë 86 "Ditëve të hapura" të mbajtura në periudhën raportuese.

Numri më i madh i rasteve që janë hetuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit, gjatë periudhës raportuese kanë qenë të lidhura kryesisht me: të drejtën për mjete juridike, mbrojtjen e pronës, të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të drejtën e punës dhe ushtrimit të profesionit, mbrojtjen shëndetësore dhe sociale, barazinë para ligjit, etj.

Tabela 2: Ankesat e pranuar (1 janar 2010 – 31 dhjetor 2010)

	Ankesat e pranuar	1233
Përkatësia etnike e ankuesve		
	Shqiptarë	1080
	Serbë	89
	Boshnjakë	23
	Romë	16
	Turq	10
	Të tjerë	15
Gjinia		
	Meshkuj	942
	Femra	288

Tabela 3: Rastet e hetuara (1 janar 2010 – 31 dhjetor 2010)

	Rastet e hapura për hetim (nga ankesat e pranuar)	414
	Rastet e hapura <i>ex officio</i>	11

Tabela 4: Rastet e mbyllura (1 janar 2010 – 31 dhjetor 2010)

	Të shpallura të papranueshme	160
	Të zgjidhura pozitivisht	183
	Arsye të tjera	112

Tabela 5: Përkatësia etnike e ankuesve, bazuar në rastet e hetuara

	Shqiptarë	332
	Serbë	65
	Boshnjakë	5
	Romë	3
	Të tjerë	9
Gjinia		
	Meshkuj	306
	Femra	108

Tabela 6: Palët përgjegjëse të rasteve të hetuara

	Gjykatat	143
	Ministritë	107
	Komunat	81
	Policia	23
	Të tjera	81

Tabela 7: Raportet, letër rekomandimet, si dhe kërkesat për masa të përkohshme

	Raporte mbi rastet	7
	Raporte <i>ex officio</i>	5
	Letër rekomandime	10
	Kërkesa për masa të përkohshme	1

Tabela 8: Palët përgjegjëse individuale të rasteve të hetuara

SISTEMI GJYQËSOR DHE PROKURORIAL		
	Gjykata Komunale në Prishtinë	33
	Gjykata Supreme e Kosovës	23
	Gjykata e Qarkut në Prishtinë	15
	Gjykata Komunale në Prizren	10
	Gjykata Komunale në Gjilan	8
	Gjykata e Qarkut në Prizren	7
	Gjykata Komunale në Gjakovë	7
	Gjykata e Qarkut në Mitrovicë	4

	Gjykata Komunale ne Ferizaj	4
	Gjykata Komunale në Pejë	4
	Gjykata Komunale në Podujevë	4
	Gjykata Komunale në Rahovec	4
	Oda e Veçantë e Gjykatës Supreme	4
	Gjykata Komunale në Mitrovicë	3
	Gjykata Kushtetuese e Kosovës	3
	Prokuroria Publike Komunale në Prishtinë	3
	Gjykata e Qarkut ne Gjilan	2
	Gjykata Komunale në Skenderaj	2
	Prokuroria Publike e Qarkut në Prishtinë	2
	Prokuroria Komunale në Mitrovicë	2
	Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtine	1
	Gjykata Komunale ne Kaçanik	1
	Gjykata Komunale në Kamenicë	1
	Gjykata Komunale ne Suharekë	1
	Gjykata Komunale në Vushtri	1
	Prokuroria Publike e Qarkut në Mitrovicë	1
	Prokuroria Publike e Qarkut në Gjilan	1
	Prokuroria Publike Komunale në Prizren	1
	Prokuroria Publike Komunale në Gjakovë	1
	Prokuroria Publike Komunale në Pejë	1
	Prokuroria Publike e Qarkut në Pejë	1
AUTORITETET QEVERITARE		
	Ministria e Punëve të Brendshme	10
	Ministria e Shëndetësisë	10
	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	9
	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	8
	Departamenti i Administratës Pensionale te Kosovës	7
	Burgu i Dubravës	5
	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	4
	Ministria e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit	4

	Burgu i Prishtinës	3
	Departamenti për patentë shofer në Pejë	3
	Drejtoria e Administratës Pensionale në Prizren	3
	Administrata Tatimore e Kosovës	2
	Qeveria e Kosovës	2
	Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës	2
	Burgu në Prizren	1
	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	1
	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	1
	Ministria e Ekonomisë dhe Financave	1
	Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport	1
	Ministria e Integritetit Evropian	1
	Shërbimi Korrektues i Kosovës	1
	Agjencia Kosovare për Produkte Medicinale	1
PUSHTETI LOKAL		
	Kuvendi Komunal në Prishtinë	11
	Kuvendi Komunal në Pejë	7
	Kuvendi Komunal në Prizren	7
	Drejtoria e Arsimit në Gjilan	5
	Drejtoria e Arsimit në Vushtrri	4
	Kuvendi Komunal në Ferizaj	4
	Kuvendi Komunal në Rahovec	4
	Kuvendi Komunal Skenderaj	4
	Kuvendi Komunal në Mitrovicë	3
	Kuvendi Komunal në Fushë Kosovë	3
	Kuvendi Komunal në Kaçanik	3
	Qendra për Punë Sociale në Prishtinë	3
	Kuvendi Komunal në Gjilan	3
	Drejtoria e Arsimit në Kamenicë	2
	Kuvendi Komunal në Gjakovë	2
	Kuvendi Komunal në Kamenicë	2

	Kuvendi Komunal në Klinë	2
	Kuvendi Komunal në Lipjan	2
	Kuvendi Komunal në Malishevë	2
	Kuvendi Komunal në Vushtrri	2
	Qendra për Punë Sociale në Prizren	2
	Qendra për Punë Sociale në Vushtrri	2
	Drejtoria e Arsimit në Lipjan	1
	Drejtoria e Arsimit në Mitrovicë	1
	Drejtoria e Arsimit në Pejë	1
	Drejtoria e Arsimit në Prishtinë	1
	Drejtoria e Arsimit në Prizren	1
	Drejtoria e Arsimit në Shtime	1
	Drejtoria e Arsimit në Skenderaj	1
	Drejtoria e Arsimit në Viti	1
	Kuvendi Komunal në Ranillug	1
	Kuvendi Komunal në Obiliq	1
	Kuvendi Komunal në Podujevë	1
	Kuvendi Komunal në Suharekë	1
	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Kaçanik	1
	Shërbimi i Ofiqarisë në Podujevë	1
	Shkolla fillore “7 Marsi” në Suharekë	1
	Shtëpia e Shëndetit në Gjilan	1
	Zyra Kadastrale në Lipjan	1
	Zyra Kadastrale në Obiliq	1
	Zyra Kadastrale në Prizren	1
TË TJERA		
	Policia e Kosovës	20
	Korporata Energjetike e Kosovës	16
	Agjencia Kosovare e Pronës	13
	Agjencia Kosovare për Privatizim	10
	Universiteti i Prishtinës	7
	Palë private	3

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës	2
Këshilli Qendror Zgjedhor	2
Autoritetet e huaja	2
Shërbimi Doganor i Kosovës	2
Bordi i Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave	2
Kompania e Ujësjetës "Prishtina"	2
Kuvendi i Kosovës	2
Qendra Klinike Universitare e Kosovës	1
Arkivi i Kosovës	1
Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit	1
Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës	1
Policia e EULEX-it	1
Inspektorati Policor i Kosovës	1
Inspektorati Komunal i Punës në Prishtinë	1
Jugobanka	1
Komisioni i Pavarur për Media	1
Kompania e sigurimeve "Siguria"	1
Bordi i Menaxhmentit të Kombinatit Trepça	1
Aeroporti i Prishtinës	1
Oda e Avokateve të Kosovës	1
OSBE	1
Shoqata e Avokatëve Amerikanë	1
Njësia e Hetimeve Rajonale në Prishtinë	1

Tabela 9: Lëndët e rasteve të hetuara

E drejta për mjete juridike	99
Mbrojtja e pronës	73
E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm	68
E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit	65
Mbrojtja shëndetësore dhe sociale	36
Barazia para ligjit	28
Mbrojtja gjyqësore e të drejtave	10
Të drejtat e të akuzuarit	10



	Liria e lëvizjes	8
	Ndalimi i torturës, trajtimet mizor, çnjerëzor ose poshtërues	7
	E drejta e lirisë dhe sigurisë	7
	Përgjegjësia për mjedisin jetësor	7
	E drejta për jetën	5
	E drejta e privatësisë	5
	Liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë	5
	E drejta për arsimin	5
	Të drejtat e fëmijës	5
	E drejta e qasjes në dokumente publike	5
	Dinjiteti i njeriut	4
	E drejta e integritetit personal	3
	Konfesionet fetare	2
	Të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes	2
	Kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore	2
	Raste për ndërmjetësim	2
	Parimi i legalitetit dhe proporcionalitetit në rastet penale	1
	Liria e shprehjes	1
	Interpretimi i dispozitave për të drejtat e njeriut	1

Tabela 10: Dështimet e autoriteteve për t'u përgjigjur në letrat e IAP-së


SISTEMI GJYQËSOR DHE PROKURORIAL		
	Gjykata Komunale në Prishtinë	17
	Gjykata Komunale në Gjiilan	3
	Gjykata Supreme e Kosovës	3
	Prokuroria publike komunale në Prishtinë	3
	Gjykata e Qarkut në Prishtinë	2
	Prokuroria publike e Qarkut në Prishtinë	2
	Gjykata Komunale në Vushtrri	1
	Gjykata Komunale në Rahovec	1
	Gjykata Komunale në Suharekë	1
	Gjykata Komunale në Ferizaj	1
	Gjykata Komunale në Kamenicë	1
	Gjykata Komunale në Gjakovë	1

	Gjykata Komunale në Gjilan	1
	Gjykata e Qarkut në Prizren	1
	Njësia e Inspektimit Gjyqësor në Prishtinë	1
AUTORITETET QEVERTARE		
	Ministria e Shëndetësisë	5
	Agjencia Kadastrale e Kosovës	5
	Ministria e Punëve të Brendshme	2
	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	2
	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	2
	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	2
	Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale	1
	Administrata Pensionale e Kosovës	1
	Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës	1
	Agjencia Kosovare për Produkte Medicinale	1
PUSHTETI LOKAL		
	Kuvendi Komunal në Malishevë	2
	Kuvendi Komunal në Prishtinë	2
	Kuvendi Komunal në Gjilan	2
	Drejtoria e Arsimit në Gjilan	2
	Kuvendi Komunal në Junik	1
	Kuvendi Komunal në Mitrovicë	1
	Drejtoria për urbanizëm në Klinë	1
	Kuvendi Komunal në Skenderaj	1
	Kuvendi Komunal në Ferizaj	1
TË TJERA		
	Korporata Energjetike e Kosovës	3
	Agjencia Kosovare e Privatizimit	2
	Policia e Kosovës	2
	Fakulteti Ekonomik	1
	Universiteti i Prishtinës	1
	Këshilli i Pavarur për Shqyrtimin e Ankesave	1
	Agjencia Kosovare e Pronës	1
	Kombinati “Trepça”	1


Figura 1: Paraqitja grafike e statistikave 1 janar 2010 - 31 dhjetor 2010




Përkatësia etnike e ankuësve bazuar në rastet e hetuara



Palët përgjegjëse të rasteve të hetuara



Rastet e mbyllura



10. Struktura e personelit

Struktura dhe numri i personelit të IAP-it, të miratuar për 2010 përbëhet nga zyrtarët e zgjedhur publikë dhe shërbyesit civilë. Sipas strukturës së buxhetit për paga dhe mëditje, përveç Avokatit të Popullit, numri i përgjithshëm i paraparë i të punësuarve ka qenë 47, prej tyre 5 zyrtarë publikë të zgjedhur nga Kuvendi dhe 42 shërbyes civilë.

Gjendja e personelit të zyrtarëve të emëruar të IAP-së, për periudhën raportuese, nuk është zgjidhur plotësisht, si rezultat i vonesës së miratimit të Ligjit për Avokatin e Popullit dhe të procedurës ligjore për zgjedhjen e zëvendësve të Avokatit të Popullit. Gjatë këtij viti, Avokati i Popullit ka pasur vetëm një zëvendës, ushtrues detyre, të trashëguar nga legjislacioni i mëparshëm dhe me mandat të skaduar, i cili ka dhënë dorëheqje dhe është larguar nga IAP, në dhjetor 2010.

Me gjithë kërkesën buxhetore të IAP-së për personel të ri për vitin 2010, për 51 punësuar, kjo çuditërisht nuk është miratuar nga Qeveria e Kosovës, përkatësisht nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, edhe pse për këtë do të duhej të vendoste Kuvendi i Republikës së Kosovës! Me këtë numër dhe përbërje të personelit të aprovuar IAP ka pasur pengesa të theksuara në kryerjen e detyrave dhe realizimin e misionit të vet.

Në bazë të buxhetit të aprovuar për vitin 2010, 42 bashkëpunëtorë të IAP-së janë trajtuar si shërbyes civilë. Ky numër është i pamjaftueshëm dhe nuk mundëson funksionimin efikas dhe kryerjen me sukses të misionit kushtetues e ligjor të IAP-së. Mungesa e ndjeshme e personelit shprehet si në sektorin e shërbimit profesional, ashtu edhe në atë administrativ.

Nga vlerësimet e bëra të resurseve njerëzore ekzistuese, si dhe bazuar në shtimin e vëllimit të punëve dhe të përgjegjësive në punë, rezulton se numri i punëtorëve të paraparë me buxhetin e Kosovës për vitin 2010, gjithsej 47 punëtorë, është i pamjaftueshëm.

Kryerja e suksesshme e misionit të ngarkuar me Kushtetutë dhe ligj po vështirësohet dita-ditës, sidomos për shkak të mungesës së personelit për disa sektorë në IAP-së, si: zyra për marrëdhënie ndërkombëtare, juristë për disa sektorë të veçantë në kuadër të IAP-së, si dhe të disa funksione të rëndësishme në administratë.

Nevoja të mëdha, të vërejtura gjatë vitit 2010, janë konstatuar, sidomos, për katër juristë në selinë e IAP-së në Prishtinë, një juristi për Zyrën në Pejës, një juristi për Zyrën në Gjiilan dhe nga një juristi në Gjakovë, Ferizaj, Dragash dhe Shtërpcë. Po ashtu nevoja për hapjen e zyrave të reja në këto qendra po vjen duke u rritur.

Në shërbimin e administratës ekziston mungesë e nga një zyrtari për sektorin e personelit, për auditor të brendshëm, për lektor, për udhëheqës të zyrës për media dhe marrëdhënie me publikun, për dy zyrtarë të teknologjisë informative dhe për një arkivist.

Një ndër pengesat themelore në funksionimin dhe realizimin të obligimeve kryesore të IAP-së, vazhdon të shkaktojë lëvizja e madhe e personelit, përkatësisht e lëshimit të vendeve të punës, në njërën anë, si dhe procedurat ligjore të rekrutimit dhe themelimit të marrëdhënieve të reja të punës, në anën tjetër. E drejta ligjore për lëshimin e vendit të punës (një muaj), në njërën anë, dhe periudha minimale ligjore e rekrutimit për të njëjtin vend puna (tre muaj), janë në shpërputhje të madhe me

pasoja negative, e cila domosdoshmërisht duhet të rregullohet me ligjin përkatës që sanksionon rekrutimin e nëpunësve dhe shërbyesve civilë.

Gjatë kësaj periudhe raportimi, vullnetarisht kanë ndërprerë marrëdhënien e punës 8 punëtorë, ndërsa 7 punëtorë kanë krijuar marrëdhënie pune në IAP. Shkaqet kryesore për lëshimin vullnetar të marrëdhënies së punës, sipas dorëheqjeve të tyre me shkrim janë pozitave më të avancuara apo udhëheqëse, qoftë në institucionet ndërkombëtare apo vendore, brenda dhe jashtë Kosovës, ku të ardhurat personale janë më të larta dhe kushtet e punës shumë më të favorshme.

Tabela 11: Përbërja dhe struktura e personelit në institucion.

Vlerësimi i gjendjes dhe lëvizjes të personelit, për periudhën janar-dhjetor 2010

Nr.	Emërtimi pozitiv të personelit	Personeli i aprovuar për vitin 2010	Gjendja e personelit të punësuar në vitin 2010
I.	AVOKATI I POPULLIT	1	1
	Zëvendës të Avokatit të Popullit	4	1
	Asistent/e Ekzekutiv/e – për Avokatin e Popullit	1	1
II.	DREJTORI EKZEKUTIV	1	1
	Asistent/e Ekzekutiv/e	1	1
III.	DEPARTAMENTI I HETIMEVE		
	1. Drejtori i Departamentit	1	1
	1.1 Sektori – Juristë të Përgjithshëm të Hetimeve	5	5
	1.2 Sektori – Grupi për Diskriminim	3	3
	1.3 Sektori – Grupi për të Drejtat e Fëmijëve	1	1
	1.4 Sektori – Njësia për Barazi Gjinore	1	1
	1.5 Asistent Ligjor	2	2
	2. Zyret Regjionale		
	2.1 Zyra në Prizren	3	3
	2.2 Zyra në Gjiilan	3	3
	2.3 Zyra në Pejë	2	2
	2.4 Zyra në Mitrovicë	3	3
2.5 Zyra në Graçanicë	2	2	

IV.	DEPARTAMENTI ADMINISTRATËS 1. Drejtori i Departamentit të Administratës	1	1
	1.1 Zyrtari për Buxhet dhe Financa	1	1
	1.2 Sektori i Mediave	1	1
	1.3 Sektori i Logjistikës	1	1
	1.4 Sektori Përkthimit	2	2
	1.5 Zyrtar Certifikuese	1	1
	1.6 Zyrtari Pasurisë	1	1
	1.7 Zyrtari Pranimi/ Operatori	1	1
	1.8 Vozitës	2	2
	1.9 Shtëpiak	1	1
V	DEPARTAMENTI PROKURIMIT 1. Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit	1	1
	Gjithsej numri i personelit:	47	44

11. Shkurtesat

AKP	Agjencia Kosovare e Pronës
BE	Bashkimi Evropian
CEDAW	Convention on the Elimination of Discrimination Against Women (Konventa Ndërkombëtare mbi Eleminimin e Diskriminimit ndaj Gruas)
CLARD	Center for Legal Aid and Regional Development (Komisioni për Ndihmë Juridike Falas)
CMB	Ndërtimi i Komunitetit Mitrovicë
DPP	Departamenti i Punës dhe i Punësimit i MPMS
ENOC	European Network of Ombudspersons for Children (Rrjeti Evropian i Ombudsmanëve për Fëmijë)
EULEX	European Union Rule of Law Mission (Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit)
FIQ	Forumi për Iniciativë Qytetare
FSK	Forcat e Sigurisë së Kosovës
GDF	Grupi për të Drejtat e Fëmijëve
GJEDNJ	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GMD	Grupi për Mos-diskriminim
IAP	Institucioni i Avokatit të Popullit
IKS	Iniciativa Kosovare për Stabilitet
INPO	Inciative for Progress (Iniciativa për Progres)
IPOL	Instituti Ballkanik i Politikave
KDI	Instituti Demokratik i Kosovës
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KFOS	Kosovo Foundation for Open Society (Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur)
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KK	Kuvendi Komunal
KMDLNJ	Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut
KOJQ	Koalicioni i Organizatave Joqeveritare
KOS	Kisha Ortodokse Serbe
KPM	Komisioni i Pavarur për Media
KPMK	Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës
KPPK	Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës

KPPPK	Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale i Kosovës
KQZ	Komisioni Qendror Zgjedhor
KRK	Kushtetuta e Republikës së Kosovës
KVV	Këshillat e Vendvotimeve
LPJK	Ligji për Procedurën Jokontestimore
LPK	Ligji për Procedurën Kontestimore
MAP	Ministria e Administratës Publike
MARS	Ministria e Arsimit e Republikës së Serbisë
MASHT	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MKP	Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MT	Ministria e Transportit
NJBGJ	Njësia për Barazi Gjinore
OHCHR	Office of the High Commissioner for Human Rights (Zyra e Komisionarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut)
OJQ	Organizata Joqeveritare
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OPCAT	Optional Protocol to the Convention against Torture (Protokolli Opsional i Konventës së OKB kundër Torturës)
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PTK	Postë-Telekomi i Kosovës
QKRMT	Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës
QKRT	Qendra Kosovare për Rehabilitim të Torturës
QKSGJ	Qendra Kosovare për Studime Gjinore
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
QMGF	Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve
QPA	Qendra për Politika dhe Avokim
QPS	Qendra për Punë Sociale
QV	Qendrat e Votimeve
RTK	Radio Televizioni i Kosovës
TMK	Trupat Mbrojtës të Kosovës
UNDP	United Nations Development Programme (Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara)

UNHCR	United Nations High Commissioner for Refugees (Komisariati i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë)
UNICEF	United Nations International Children's Emergency Fund (Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët)
UNIFEM	United Nations Development Fund for Women (Fondi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara për Gratë)
UNMIK	United Nations Interim Administration Mission in Kosovo (Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë)
VV	Numri i Vendvotimeve
YIHR	Youth Initiative for Human Rights (Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut)

12. Shtojca 1: Kërkesat për Gjykatën Kushtetuese

Bazuar në kompetencat kushtetuese Avokati i Popullit ka të drejtë të referojë çështjen në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute.²⁰⁸

Në IAP, gjatë vitit 2010, janë pranuar 3 ankesa/kërkesa nga qytetarët dhe organizatat e ndryshme joqeveritare për ngritjen e çështjeve të ndryshme në Gjykatën Kushtetuese. Avokati i Popullit, pas analizës së kërkesave të parashtruara ka vendosur në kështu: një ankesë e ka shpallur si të papranueshme, ndërsa dy kërkesa janë proceduar në Gjykatën Kushtetuese. Për njëjën prej kërkesave, Gjykata Kushtetuese ka vendosur masën e përkohshme, ndërsa tjetra gjendet në procedurën e shqyrtimit.

Më 19 korrik 2010, 12 shoqata joqeveritare²⁰⁹ kanë paraqitur kërkesë te Avokati i Popullit që në Gjykatën Kushtetuese të paraqesë kërkesën për vlerësimin e pajtueshmërisë së Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.²¹⁰ Organizatat joqeveritare e kanë kundërshtuar të drejtën e pensionimit suplementar të deputetëve në moshën 55-vjeçare, edhe me vetëm gjysmë mandati shërbim, duke e bazuar atë në pagën e deputetit, e jo në pensionin mesatar në vend. Parashtruesit e kërkesës vlerësojnë që ky ligj është kundërkushtetues, sepse diskriminon kategoritë e tjera të të punësuarve në Kosovë, si edhe është kundër barazisë sociale në vend, pasi moshja e pensionimit në Republikën e Kosovës është 65 vjet dhe lartësia e pensionit përcaktohet sipas kontributeve të dhëna në Trustin Pensional gjatë karrierës së tyre.

Avokati i Popullit, pas analizës së kërkesës së shoqërisë civile, pas hetimeve dhe hulumtimeve të bëra, më 26 nëntor 2010, paraqiti çështjen në Gjykatën Kushtetuese për vlerësimin e pajtueshmërisë.²¹¹ Pas shqyrtimit të kërkesës së Avokatit të Popullit, më 22 dhjetor 2010, Gjykata Kushtetuese e njofton Avokatin e Popullit se ka marrë “Vendim për Masë të Përkohshme”, me të cilin pezullohet menjëherë zbatimi i Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit.²¹²

²⁰⁸ *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, Kapitulli XII, neni 135 dhe neni 113, pika 2.

²⁰⁹ Instituti Demokratik i Kosovës, Forumi për Iniciativë Qytetare, Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, Iniciativa Kosovare për Stabilitet, Iniciativa për Progres, Instituti Ballkanik i Politikave, KMLDNJ, Lëvizja Fol, Ndërtimi i Komunitetit Mitrovicë, Qendra për Politika dhe Evokim dhe Syri Vizion.

²¹⁰ Kërkesa për rishqyrtimin e nenit 14 pika 1.6, si dhe të neneve 22, 24, 25 dhe 27, të *Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Nr. 03/L-111, miratuar më 4. 06. 2010.

²¹¹ *Shih Avokati i Popullit*, kërkesë drejtuar Gjykatës Kushtetuese, 26. 11.2010, në <http://www>.

²¹² *Shih Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës*, Nr. Ref.: MP79/10, 22 dhjetor 2010.

KËRKESË

Drejtuar

Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës

- Në çështjen: E papajtueshmërisë së nenit 14 paragrafi 1.6, nenit 22, nenit 24, nenit 25 dhe nenit 27 të Ligjit për Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit Nr. 03/L-111, me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
- Palë përgjegjëse: Kuvendi i Republikës së Kosovës.
- Baza ligjore: Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 113, neni 135 paragrafi 4; Ligji për Avokatin e Popullit, neni 15 paragrafi 7; Ligji për Gjykatën Kushtetuese, neni 29.

26 nëntor 2010 Prishtinë

Përmbledhja e fakteve

Faktet në bazë të informatave që Institucioni i Avokatit të Popullit ka në dispozicion, mund të përmbliidhen si vijon:

1. Më 4 qershor 2010, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit me 74 (shtatëdhjetekatër) vota “për”, 2 (dy) “kundër” dhe 2 (dy) “abstenime”.

2. Më 21 qershor 2010, organizatat joqeveritare (OJQ): Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), Forumi për Iniciativë Qytetare (FIQ), Lëvizja Fol, Ndërtimi i Komunitetit Mitrovicë (CBM)²¹³, ishin drejtuar edhe Presidentit të Republikës së Kosovës me kërkesën që të mos e dekretonte Ligjin në fjalë..

3. Më 25 qershor 2010, z. Bahri Hyseni, Kryetar i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi në Kuvendin e Kosovës kishte kërkuar nga sekretaria e Kuvendit që të rregullohej një gabim teknik që ishte lëshuar në Ligjin për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, përkatësisht në nenin 22 të ligjit se mosha e pensionimit do të duhej të ishte 55 vjet, e jo ashtu siç ishte miratuar në seancën plenare të datës 4 qershor 2010, që mosha e pensionimit të ishte 50 vjet.²¹⁴

4. Më 25 qershor 2010, Kuvendi e miratoi kërkesën e z. Bahri Hyseni që të rregullohej gabimi teknik që ishte bërë në seancën e datës 4 qershor 2010. Kërkesa e z. Bahri Hyseni u miratua me 73 (shtatëdhjetetë) vota “për” dhe 2 (dy) vota “kundër”.

5. Më 5 korrik 2010, Ligji për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit është dekretuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës me dekretin DL-029-2010.

²¹³ Shih Web faqen zyrtare të Zyrës së Presidentit të Kosovës www.president-ksgov.net (linku <http://www.president-ksgov.net/?page=1,6&cdate=2010-06-21>)

²¹⁴ Shih Transkriptin e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës së mbajtur më 25 qershor 2010.

6. Më 19 korrik 2010, Institucioni i Avokatit të Popullit ka pranuar parashtresën e një numri OJQ-ve: Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), Forumi për Iniciativë Qytetare (FIQ), Iniciativa e të Rinjve për të Drejta të Njeriut (YIHR), Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS), Iniciativa për Progres (INOP), Instituti Ballkanik i Politikave (IPOL), Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMLDNJ), Lëvizja Fol, Ndërtimi i Komunitetit Mitrovicë (CBM), Qendra për Politika dhe Avokim (QPA) dhe Syri Vizion, të cilat me një kërkesë të përbashkët i janë drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit, që në bazë të detyrave dhe përgjegjësi të cilat i janë dhënë me Kushtetutë, që të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës shqyrtimin e kushtetutshmërisë së nenit 22 të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit.

7. OJQ-të e lartpërmendura konsiderojnë se ky nen është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe kërkojnë që zbatimi i këtij ligji të mos fillojë ashtu siç është paraparë, më 1 janar 2011, para se Gjykata Kushtetuese të marrë një vendim meritore për këtë.

8. Më 20 korrik 2010, Ligji për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr. 74, të datës 20 korrik 2010.

9. Më 21 korrik 2010, kërkesës së këtyre organizatave joqeveritare iu bashkua edhe Bashkimi i Pensionistëve të Kosovës – kryetar Ramë Alihajdaraj.

10. Nga OJQ-të e lartpërmendura është kontestuar neni 22, paragrafi 1 i Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit të cilin e konsiderojnë diskriminues në raport me pensionistët tjerë, me pretendimin se shkelë parimin e barazisë para ligjit.

Mekanizmat ligjorë të zbatueshëm në Republikën e Kosovës

11. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në kapitullin e parë “Dispozitat Themelore”, proklamon barazinë para ligjit dhe për vlerat mbi të cilat bazohet rendi kushtetues:

“Neni 3 [Barazia para Ligjit]

2. Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.”

“Neni 7 [Vlerat]

“1. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes së mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.”

12. Po ashtu, neni 24 i kapitullit të dytë “Të Drejtat dhe Liritë Themelore” i Kushtetutës së Republikës së Kosovës në mënyrë specifike garanton barazinë para ligjit dhe mosdiskriminimin:

“1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.

2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës,

gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.”

13. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut në nenin 14 shprehimisht ndalon diskriminimin.

Neni 14 - Ndalimi i diskriminimit

“Gëzimi i të drejtave dhe lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia një minoriteti kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”

14. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike në nenin 26 deklaronte se:

“Të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara ligjit dhe kanë të drejtë mbrojtjeje të barabartë para ligjit pa kurrfarë dallimi. Lidhur me këtë, ligji duhet të ndalojë çdo diskriminim dhe të garantojë për të gjithë, mbrojtje të barabartë e të efektshme kundër çdo diskriminimi, e veçanërisht për shkak të racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, fesë, opinionit politik dhe çdo opinionit tjetër, origjinës kombëtare apo shoqërore, pasurisë, lindjes ose çdo situatë tjetër.”

Analiza juridike

15. Avokati i Popullit vëren se, pensionet suplementare të përcaktuara sipas dispozitave të nenit 22 të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit janë në mënyrë të theksuar jo proporcionale me pensionet mesatare në vend dhe, si të tilla nuk janë në pajtueshmëri me vlerat e proklamuar me nenin 7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e cila rendin kushtetues e bazon mbi parimet e demokracisë, barazisë, mos diskriminimit dhe drejtësisë sociale.

16. Avokati i Popullit thekson se, parimi se të gjithë qytetarët janë të barabartë para ligjit, i garantuar edhe me preambulën e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe, zotimi për një shtet të mirëqenies ekonomike dhe drejtësisë sociale, janë ndër parimet themelore dhe më të rëndësishme të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

17. Avokati i Popullit vëren se, parimet e mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë kanë karakter imperativ dhe janë të zbatueshme në masë të njëjtë si për qytetarët, ashtu edhe për pushtetin shtetëror. Kuvendi si organ legjislativ i një shteti gjatë miratimit të ligjeve dhe akteve të tjera, duhet pasur kujdes që ato gjithnjë të jenë në përputhje me dispozitat dhe parimet e aktit më të lartë të shtetit – Kushtetutës.

18. Ligji për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit përmban dispozita të cilat anëtarëve të Kuvendit të Kosovës iu mundësojnë që të realizojnë pensione më të favorshme se të gjithë përfituesit tjerë të pensioneve dhe nuk është në përputhje me parimet kushtetuese të barazisë, sundimit e ligjit, mosdiskriminimit dhe drejtësisë sociale. Neni 22 i Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit thotë:

“1. Deputeti, pas përfundimit të mandatit, ka të drejtë për pension suplementar, nëse detyrën e deputetit e ka ushtruar së paku një mandat dhe e ka mbushur moshën pesëdhjetepesë (55) vjeç.

2. *Deputeti që i plotëson kushtet e caktuara me paragrafin 1 të këtij neni, e realizon pensionin suplementar në lartësi prej pesëdhjetë për qind (50 %) të pagës bazë të deputetit. Deputeti që ka shërbyer në dy (2) mandate në kushtet e përcaktuara nga paragrafi 1 i këtij neni, e realizon pensionin suplementar në vlerë prej gjashtëdhjetë për qind (60 %) të pagës bazë dhe ai që ka shërbyer në tri (3) e më shumë mandate në lartësi prej shtatëdhjetë për qind (70 %) të pagës bazë."*

19. Avokati i Popullit thekson se, parimi se të gjithë qytetarët janë të barabartë para ligjit i garantuar edhe me preambulën e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe, zotimi për një shtet të mirëqenies ekonomike dhe drejtësisë sociale, janë disa nga parimet themelore dhe më të rëndësishme të cilat janë mishëruar në këtë Kushtetutë.

20. Avokati i Popullit mendon se, e drejta për pension suplementar sipas Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit posa të arrijnë moshën 55 vjeçare, jo mbi bazë të kontributit të dhënë gjatë kohës sa janë në detyrë, por drejtpërdrejt nga buxheti i Republikës së Kosovës (neni 28), derisa me Ligj nuk është paraparë krijimi i ndonjë fondi të veçantë për këtë qëllim, përmban elemente diskriminuese.

21. Ligji Nr. 03/L-084 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2005/20 mbi Pensionet në Kosovë Neni 7, "arkëtimi i kontributeve për financimin e pensioneve të kursimeve individuale" thotë:

"Çdo punëdhënës është i obliguar që të kontribuojë në emër të punonjësve të vet në Fondin e kursimeve pensionale. Punonjësit obligohen që të kontribuojnë në emër të vet në kursimet pensionale. Obligimet e punëdhënësit dhe të punonjësit fillojnë në ditën e parë të punësimit të punëdhënësi për punonjësit që kanë arritur moshën tetëmbëdhjetëvjeçare (18) dhe përfundojnë kur punonjësi arrin moshën e pensionit."

22. Avokati i Popullit konsideron se privilegjet e parapara për deputetët e Kuvendit të Kosovës me Ligjin për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, janë diskriminues në raport me kategoritë tjera të pensionistëve, sepse moshja e pensionimit të deputetëve është për 10 (dhjetë) vite më e ulët, ndërsa shumica të cilën ata e përfitojnë nga ky pension është jo proporcionale me pensionet që përfitojnë kategoritë tjera të pensionistëve. Ky ligj mundëson që një deputet/e që shërben vetëm një mandat prej tre (3) vjet, të sigurojë një pension gati 8-10 (dhjetë) herë më të lartë se një qytetar/e, madje edhe mësimdhënës universitar, që ka shërbyer dhe ka kontribuar mbi 40 vjet në Kosovë dhe në fondin pensional. Sistemi pensional në Kosovë është gjithëpërfshirës dhe është evidente se pagesa është më ulëta, nëse krahasohet me vendet e rajonit.

23. Për më shumë, neni 38 i Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit i ofron mundësi deputetit që pas përfundimit të mandatit të kthehet në vendin e tij të punës nëse ka qenë i punësuar në sektorin publik, ose ndonjë institucion që financohet me mjete publike. Kjo iu ofron atyre siguri sa i përket punësimit, që do të thotë se ata nuk rrezikohen që të mbesin të pa punë nëse kanë qenë të punësuar më parë në sektorin publik. Po ashtu, ata mund të sigurojnë një vend tjetër të punës, kur dihet se moshja e përgjithshme e pensionimit është 65 vjet.

24. Sipas neneve të lartpërmendura, deputeti që ka përfunduar mandatin ndërmjet moshës 55 dhe 65 vjeçare mund të përftojë nga pensioni suplementar dhe në të njëjtën kohë të marrë pagë në bazë të funksionit që mban Të dyja këto nga buxheti i Kosovës. Ndërsa, me arritjen e moshës 65 vjeçare Ligji nuk e kufizon deputetin që krahas pensionit suplementar të realizojë të ardhura edhe nga pensioni i pleqërisë.

25. Avokati i Popullit konsideron se neni 22 i Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit i cili sfida, nuk do të ishte në kundërshtim me parimet kushtetuese të barazisë dhe sundimit të ligjit, po qe se do të kishte parashikuar kushte më të favorshme pensionimi për këtë kategori të personave. Mirëpo, Avokati i Popullit konsideron se të tilla kushte do të duhej të mbështeten në baza të arsyeshme. Ato duhet të jenë në një vijë me frymën e parimeve të përgjithshme nga kjo fushë dhe, njëkohësisht të mos kërcënojnë nenin 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (*shih paragrafin 10*), që në mënyrë indirekte mund të kenë efekt negativ në parimet tjera kushtetuese si sundimi i ligjit, drejtësia sociale dhe mosdiskriminimi.

26. Me miratimin e nenit 22 Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit Kuvendi i Kosovës bëri edhe një veprim tjetër diskriminues, duke siguruar trajtim më favorizues për deputetët e Kuvendi të Kosovës sesa për zyrtarët e tjerë publikë edhe pse ata janë në pozitë të njëjtë sociale.

27. Komiteti për të Drejta të Njeriut, në interpretimin që i bën nenit 26 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejta Civile dhe Politike, ndër të tjera vlerëson se neni 26 nuk u kërkon shteteve që të nxjerrin ligje që do të garantonin përkujdesjen sociale. Megjithatë, kur një ligj i tillë nxirret në përputhje me autorizimet e pushtetit shtetëror sovran, atëherë ai ligj duhet të jetë në pajtim me nenin 26 të Konventës.²¹⁵

28. Sipas hulumtimit të Bankës Botërore të publikuar në vitin 2007, vlerësohet se 45% e popullsisë janë të varfër, ndërsa 15% e popullsisë janë në varfëri të skajshme dhe me vështirësi plotësojnë nevojat elementare për ushqim. Ndërsa sipas raportit të fundit të Bankës Botërore, të publikuar më 10 qershor 2010 (Shih raportin nr. 53709-XX) :

“Kosova me një popullsi rreth 2.0 milion banorë dhe me një BPV për kokë banori prej 1,760, është një nga shtetet më të varfra në Evropë. Varfëria mbetet e përhapur dhe e qëndrueshme me 45 për qind të popullsisë nën kufirin kombëtar të varfërisë. Norma zyrtare e papunësisë është 48 për qind; më e keqja në Evropë.”

Sipas vlerësimit të Entit të Statistikave të Kosovës të publikuar në buletin tre mujor (tetor 2010), vlerësohet se paga mesatare në Kosovë në tremujorin e parë të vitit 2010 është 272 Euro.

29. Sipas informatave që disponon Avokati i Popullit, paga bazë e deputetit është 1,488 (njëmijë e katërqind e tetëdhjetë) Euro. Kjo do të thotë se deputeti i cili ka ushtruar detyrën e deputetit vetëm një mandat përfiton pensionin suplementar në lartësinë 50% të pagës bazë të deputetit (*shih paragrafin 18*), që është 744 (shtatëqind e dyzetekatër) Euro. Derisa shuma maksimale që përfiton një pensionist në Kosovë, me një përvojë pune 40 vjet, sipas skemës kontributpaguese është 80 (tetëdhjetë) euro, kurse sipas skemës së pensioneve bazë një pensionist përfiton vetëm 45 (dyzetepesë) euro.

30. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin *Stec and others v. The United Kingdom (Applications nos. 65731/01 and 65900/01)*, vlerëson se:

“...Trajtimi i ndryshëm është diskriminues në rast se nuk ka objektiv dhe justifikim të arsyeshëm, ose, me fjalë tjera, në rast se nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ka marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit dhe mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të realizohet. Shteti kontraktues gëzon një kufi të lirisë në rastet e vlerësimit nëse dhe në çfarë mase diferencat në

²¹⁵ Shih “Rastet Kryesore të Komitetit për të Drejta të Njeriut”, përmbledhur nga Raia Hanski dhe Martin Scheinin, faqe 377.

situata të ngjashme justifikojnë trajtimin e ndryshëm (Shiko Van Raalte v. the Netherlands, 21 Shkurt 1997, § 39, Raportet e Aktgjykimeve dhe Vendimeve 1997-I”).

31. Avokati i Popullit përfundimisht konstaton se, statusi më i privilegjuar për Deputetët e Kuvendit të Kosovës në sistemin juridik ekzistues të Republikës së Kosovës nuk paraqet bazë të mjaftueshme për të arsyetuar nivelin aq të lartë të devijimit nga parimet e përgjithshme në fushën e pensioneve.

Konkluzioni i Avokatit të Popullit

32. Në kuadër të sqarimit të rrethanave kushtetuese dhe ligjore, Avokati i Popullit, në cilësinë kërkuesit pranë Gjykatës Kushtetuese, duke iu referuar argumenteve të lartpërmendura vëren se, interesi i tij për të ndërhyrë me mjetet e njohura nga Kushtetuta dhe Ligji, është korrigjimi i përmbajtjes së dispozitave të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit.

33. Në këto kushte, në bazë të nenit 113 paragrafi 2.1, nenit 135 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 15 paragrafi 7 të Ligjit për Avokatin e Popullit dhe nenit 29 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, Avokati i Popullit kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës që të shfuqizojë si të papajtueshëm me Kushtetutën, nenet 14 paragrafi 1.6, nenin 22, nenin 24, nenin 25 dhe nenin 27 të Ligjit për Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit.

Me nderime,

Sami Kurteshi

Avokat i Popullit

12.1. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 22 dhjetor 2010
Nr. ref.: MP79/10

VENDIM PËR MASË TË PËRKOHSHME

në

Rastin nr. KO 119/10

Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës

Vlerësim i kushtetutshmërisë të nenit 14 paragrafi 1. 6, nenit 22, nenit 24,
nenit 25 dhe nenit 27 të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e
Deputetëve, Nr. 03/L-111 të datës 4 qershor 2010

Gjykata Kushtetuese e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare, dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi

1. Parashtrues është Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës.

Ligji i kontestuar

2. Parashtruesi kërkon anulimin e nenit 14 paragrafi 1. 6, si dhe neneve 22, 24, 25 dhe 27 të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetëve, Nr. 03/L-111 të datës 4 qershor 2010.

Objekti i çështjes

3. Vlerësimi i kushtetutshmërisë të nenit 14 paragrafi 1. 6, si dhe i neneve 22, 24, 25 dhe 27 të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetëve, Nr. 03/L-111 të datës 4 qershor 2010.

Baza juridike

4. Neni 113 paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("Kushtetuta") si dhe nenet 20 dhe 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës ("Ligji").

Përmbledhje e fakteve

5. Më 4 qershor 2010 Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi Ligjin për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetëve me 74 vota (shtatëdhjetë e katër) "për", 2 (dy) "kundër" dhe 2 (dy) "abstenime".
6. Organizatat e mëposhtme joqeveritare (OJQ-të): Instituti Demokratik i Kosovës (IDK), Forumi për Iniciativë Qytetare (FIQ), Lëvizja "Fol", Ndërtimi i Komunitetit Mitrovicë (CBM), iu drejtuan Kryetarit të Republikës së Kosovës më 21 qershor 2010 me kërkesë që të mos e shpallë Ligjin e lartpërmendur.
7. Më 25 qershor, z. Bahri Hyseni, kryesues i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi të Kuvendit të Kosovës, kërkoi nga Sekretaria e Kuvendit të korrigjonte një gabim teknik që ishte bërë në Ligjin për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetëve, përkatësisht nenin 22 të Ligjit, se mosha e pensionimit do të duhej të ishte 55 vjet dhe jo siç ishte miratuar në seancën plenare të datës 4 qershor që mosha e pensionimit të jetë 50 vjet.
8. Më 25 qershor 2010, Kuvendi e miratoi kërkesën e z. Bahri Hyseni për korrigjimin e gabimit teknik të bërë në seancën e datës 4 qershor 2010. Kërkesa e z. Bahri Hyseni u miratua me 73 (shtatëdhjetë e tri) vota "për" dhe 2 (dy) "kundër".
9. Më 5 korrik 2010, Ligji për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetëve u dekretua nga ana e Kryetarit të Republikës së Kosovës me dekretin DL-020-2010.
10. Më 19 korrik 2010, Institucioni e Avokatit të Popullit mori një parashtesë nga një numër i OJQ-ve: Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), Forumi për Iniciativë Qytetare (FIQ), Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (YIHR), Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS), Iniciativa për Progres (INPO), Instituti Ballkanik për Politika (IPOL), Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ), Lëvizja "FOL", Ndërtimi i Komunitetit Mitrovicë (CBM), Qendra për Politika dhe Avokim (QPA) dhe Syri Vision të cilat iu drejtuan Institucionit të Avokatit të Popullit me një kërkesë të përbashkët që Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në bazë të detyrave dhe përgjegjësisë që i janë dhënë me ligj, të vlerësojë kushtetutshmërinë e nenit 22 të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit.

11. OJQ-të e lartpërmendura konsiderojnë se ky nen përbën shkelje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe kërkojnë të ndalohet zbatimi i ligjit, ashtu siç është paraparë nga 1 janari 2011, deri sa Gjykata Kushtetuese të marrë një vendim meritor për këtë.
12. Më 20 korrik 2010, Ligji për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
13. Më 21 korrik 2010, kërkesës së OJQ-ve iu bashkua edhe Bashkimi i Pensionistëve të Kosovës.

Procedurat para Gjykatës

14. Më 26 nëntor parashtruesi e parashtrori kërkesën në Gjykatën Kushtetuese .
15. Kryetari i Gjykatës e caktoi gjyqtarin Robert Carolan si Gjyqtar Raportues si dhe anëtarin Kolegjin Shqyrtues në përbërje nga Ivan Čukalović, Kadri Kryeziu dhe Gjylieta Mushkolaj.
16. Më 17 dhjetor 2010, në një seance të mbyllur, Gjykata shqyrtoi raportin paraprak të Gjyqtarit Raportues në lidhje me miratimin e masës së përkohshme derisa të merret vendimi përfundimtar për kërkesën.

Pretendimet e parashtruesit

17. Parashtruesi konsideron *inter alia* se Ligji për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit përmban dispozita që “u mundësojnë deputetëve të Kuvendit të Kosovës të realizojnë pensione që janë më të favorshme se çdo përfitim tjetër pensional për qytetarët e tjerë, dhe se ato dispozita nuk janë në përputhje me parimet kushtetuese të barazisë, sundimit të ligjit, mos-diskriminimit dhe drejtësisë sociale”.
18. Avokati i Popullit, po ashtu, “vëren se pensionet suplementare të parapara me nenin 22 të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit janë qartësisht jo proporcionale me pensionet mesatare në vend, dhe si të tilla nuk janë në harmoni me vlerat e proklamuar me nenin 7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, rendi kushtetues i së cilës bazohet në parimet e demokracisë, barazisë, mos-diskriminimit dhe drejtësisë sociale”.
19. Për më tepër, neni 38 i Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit u ofron mundësinë deputetëve që të kthehen në vendet e tyre përkatëse të punës, nëse ai/ajo ka qenë i/e punësuar në sektorin publik apo në ndonjë institucion të financuar nga fondet publike para fillimit të mandatit. Kjo u jep atyre siguri sa i përket punësimit, pra ata nuk rrezikojnë të mbesin të papunë nëse kanë qenë pjesë e sektorit publik para fillimit të mandatit. Ata, gjithashtu, mund të gjejnë ndonjë vend tjetër të punës kur dihet se moshë e përgjithshme e pensionimit në Kosovë është 65 vjet.
20. Përfundimisht, sipas Avokatit të Popullit, “statusi i privilegjuar për deputetët e Kuvendit të Kosovës në rendin ekzistues juridik të Republikës së Kosovës nuk

paraqet arsyetim të mjaftueshëm për nivelin aq të lartë të devijimit nga parimet e përgjithshme në fushën e pensioneve”.

GJYKATA KUSHTETUESE

Pas dëgjimit të raportit të Gjyqtarit Raportues Robert Carolan dhe pas diskutimit të pikëpamjeve të parashtruesit të shprehura në parashtrësat e tij me shkrim, Gjykata mbajti këshillim më 17 dhjetor 2010. Duke mos paragjykuar rezultatin përfundimtar të kërkesës, Gjykata erdhi në përfundim se parashtruesi ka paraqitur argumente të mjaftueshme bindëse se zbatimi i dispozitave të kontestuarra të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetëve, Nr. 03/L-111 i datës 4 qershor 2010, mund të rezultojë me dëme të pariparueshme dhe se kjo masë e përkohshme është në interesin publik.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 116 paragrafi 2 i Kushtetutës dhe nenin 27 të Ligjit, Gjykata në mënyrë unanime:

VENDOS

- I. TË LEJOJË masë të përkohshme në kohëzgjatje prej jo më shumë se tre (3) muaj nga data e marrjes së këtij vendimi;
- II. TË PEZULLOJË MENJËHERË zbatimin e nenit 14 paragrafi 1. 6, si dhe të neneve 22, 24, 25 dhe 27 të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetëve, Nr. 03/L-111 të datës 4 qershor 2010 në kohëzgjatje të njëjtë;
- III. Ky vendim do t'u komunikohet palëve;
- IV. Ky vendim do të botohet në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20 paragrafi 4 të Ligjit dhe hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues



Robert Carolan



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. Dr. Enver Hasani

13. Shtojca 2: Baza ligjore dhe kompetencat e Avokatit të Popullit

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Kapitulli XII - Institucionet e Pavarura

Neni 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit]

1. Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.
2. Avokati i Popullit është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe nuk pranon udhëzime e ndërhyrje nga organet, institucionet ose autoritetet e tjera, të cilat ushtrojnë pushtetin në Republikën e Kosovës.
3. Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.

Neni 133 [Zyra e Avokatit të Popullit]

1. Zyra e Avokatit të Popullit është e pavarur, dhe propozon e administron buxhetin e vet, në pajtim me ligj.
2. Avokati i Popullit ka një (1) ose më shumë zëvendës. Numri, mënyra e përzgjedhjes dhe mandati i tyre, rregullohen me ligjin për Avokatin e Popullit. Të paktën një (1) nga zëvendësit e Avokatit të Popullit është pjesëtar i komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.

Neni 134 [Kualifikimi, Zgjedhja dhe Shkarkimi i Avokatit të Popullit]

1. Avokatin e Popullit e zgjedh Kuvendi i Kosovës, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të tij, për një mandat pesë (5) vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje.
2. Avokati i Popullit ka të drejtë të zgjidhet çdo shtetas i Republikës së Kosovës, me arsim të lartë, me karakter e moral të lartë, i ndershëm, me eksperiencë dhe njohuri të dalluara në fushën e të drejtave të njeriut.
3. Avokati i Popullit dhe zëvendësit e saj/tij nuk mund të jenë anëtarë të asnjë partie politike, as të ushtrojnë veprimtari politike, shtetërore a private profesionale dhe as të marrin pjesë në organizmat drejtues të organizatave civile, ekonomike dhe tregtare.
4. Avokati i Popullit gëzon imunitetin nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi për veprimet ose vendimet që janë brenda fushës së përgjegjësisë të Avokatit të Popullit.

5. Avokati i Popullit mund të shkarkohet vetëm me kërkesën e më shumë se një të tretës (1/3) së të gjithë deputetëve, dhe në këtë rast Kuvendi vendos me shumicën e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të tij.

Neni 135 [Raportimi i Avokatit të Popullit]

1. Avokati i Popullit paraqet raport vjetor para Kuvendit të Republikës së Kosovës.
2. Me kërkesën e Kuvendit, Avokati i Popullit duhet të dorëzojë raporte periodike ose tjera Kuvendit. Me kërkesën e Avokatit të Popullit, Kuvendi duhet t'ia lejojë që të dëgjohet.
3. Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.
4. Avokati i Popullit ka të drejtë të referojë çështje në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute.

Kapitulli VIII - Gjykata Kushtetuese

Neni 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara]

1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
2. Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim:
 - (1) çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekretëve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën;
 - (2) përputhshmëria e Statutit të Komunës me Kushtetutën.

13.1. Ligji për Avokatin e Popullit,

LIGJI Nr. 03/L-195

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR AVOKATIN E POPULLIT

KREU I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi i ligjit

Ky ligj ka për qëllim krijimin e mekanizmit ligjor për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizik dhe juridik nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, të organeve të tjera dhe të organizatave që ushtrojnë autorizime publike për llogari të tyre.

Neni 2 Fushëveprimi i ligjit

Me këtë ligj rregullohet organizimi dhe funksionimi i Institucionit të Avokatit të Popullit, duke përcaktuar procedurat për emërim dhe shkarkim, kompetencat dhe mënyrën e punës së Institucionit të Avokatit të Popullit si dhe rregullon procedurat për parashtrimin e ankesave dhe hetimin e tyre.

Neni 3 Parimet bazë të veprimitarisë së Avokatit të Popullit

1. Avokati i Popullit është institucion i pavarur që udhëhiqet nga parimet e paanësisë, konfidencialitetit dhe profesionalizmit.
2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të të gjithë personave në Republikën e Kosovës dhe jashtë saj nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme të organeve të autoriteteve publike të Republikës së Kosovës.

Neni 4 Gjuha e punës

Gjuhë e punës së Institucionit të Avokatit të Popullit janë gjuhët zyrtare të parapara me Kushtetutë dhe ligj.

Neni 5

Përbërja e Institucionit të Avokatit të Popullit

1. Institucioni i Avokatit të Popullit, përbëhet nga:

- 1.1. Avokati i Popullit;
- 1.2. pesë (5) zëvendës të Avokatit të Popullit;
- 1.3. personeli profesional dhe
- 1.4. administrata.

Neni 6

Kushtet për zgjedhjen e Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij

1. Avokati i Popullit dhe zëvendësit e tij zgjedhën personat që i plotësojnë këto kushte:

- 1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- 1.2. të ketë arsimim të lartë;
- 1.3. të ketë karakter, ndershmëri dhe moral të lartë;
- 1.4. të ketë eksperiencë dhe njohuri të dalluara në fushën e të drejtave të njeriut;
- 1.5. të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për veprë penale të dënueshme me legjislacionin e Republikës së Kosovës;
- 1.6. të mos ushtrojë funksion në parti politike, deputet në legjislaturën e Kuvendit të Republikës së Kosovës që e zgjedhë atë apo anëtar i kabinetit qeveritar.

Neni 7

Papajtueshmëria

1. Avokati i Popullit dhe Zëvendësit e tij nuk duhet të jenë anëtarë të asnjë partie politike e as të ushtrojnë veprimtari politike, shtetërore a private profesionale.

2. Avokati i Popullit dhe Zëvendësit e tij nuk marrin pjesë në organizmat drejtues të organizatave civile, ekonomike dhe tregtare;

2.1. përveç ndalesave të përcaktuara në nën-paragrafin 1.6. të nenit 6 të këtij ligji dhe paragrafin 1. dhe 2. të këtij neni, Avokati i popullit dhe zëvendësit e tij nuk kanë të drejtë të ushtrojnë ndonjë detyrë tjetër publike apo profesionale për të cilën shpërblehen me pagesë, përveç mësimdhënies në institucionet e arsimit të lartë.

3. Avokati i Popullit dhe zëvendësit e tij mund të merren me veprimtari shkencore, kulturore, akademike dhe veprimtari tjera, të cilat nuk bien në kundërshtim me funksionet e tyre dhe me legjislacionin në fuqi.

KREU II

PROPOZIMI, ZGJEDHJA DHE SHKARKIMI I AVOKATIT TË POPULLIT DHE ZËVENDËSVE TË TIJ

Neni 8

Procedura e propozimit

1. Procedura për zgjedhjen e Avokatit të Popullit, dhe zëvendësve të tij fillon gjashtë (6) muaj para skadimit të mandatit të tyre.

2. Gjatë procedurës së zgjedhjes së kandidatëve për Avokat të Popullit dhe të zëvendësve të tij, duhet të sigurohet përfaqësimi etnik dhe gjinor.
3. Propozimin e Avokatit të Popullit e bënë Komisioni përkatës i Kuvendit të Republikës së Kosovës i cili pasqyron përbërjen politike, etnike dhe gjinore të Kuvendit në pajtim me rregulloren e punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës.
4. Kuvendi i Kosovës e shpall konkursin për zgjedhjen e Avokatit të Popullit në media të shkruara dhe elektronike.
5. Në konkurs caktohen kushtet për zgjedhjen e Avokatit të Popullit të paraparë me Kushtetutë dhe me këtë ligj. Afati për paraqitjen e propozimit për kandidatin nuk mund të jetë më i shkurtër se pesëmbëdhjetë (15) e as më i gjatë se njëzetë (20) ditë.
6. Pas skadimit të afatit të paraparë në paragrafin 5. të këtij neni, Komisioni, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, vlerëson nëse kandidatët i plotësojnë kushtet për t'u zgjedhur Avokat i Popullit të paraparë me Kushtetutë dhe me këtë ligj, dhe hedhë poshtë kandidaturat që nuk plotësojnë këto kushte.
7. Komisioni zhvillon intervistë me secilin kandidat i cili plotëson kushtet për tu zgjedhur Avokat i Popullit dhe në bazë të të dhënave të paraqitura dhe rezultateve të intervistës, përgatitë listën e ngushtë të kandidatëve të kualifikuar për Avokat të Popullit.
8. Lista e ngushtë përmban tre (3) kandidatë.
9. Komisioni, bashkangjitur me listën e ngushtë, i dërgon Kuvendit të Republikës së Kosovës listën e të gjithë kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për t'u zgjedhur Avokat i Popullit.
10. Propozimi i Komisioni përmban arsyetim përse Komisioni ju ka dhënë përparësi disa kandidatëve në krahasim me kandidatët tjerë.
11. Propozimin e zëvendësve e bën Avokati i Popullit në bazë të konkurrencës së hapur dhe transparente, sipas konkursit të shpallur nga Kuvendi i Kosovës.
12. Propozimi i Avokatit të Popullit e përmban arsyetimin për kandidatët e propozuar.
13. Të paktën njëri nga zëvendësit e Avokatit të Popullit duhet të jetë pjesëtar i komunitetit serb të Kosovës dhe së paku një (1) duhet të jetë prej njërit nga komunitetet tjera jo shumicë në Kosovë.
14. Procedura e zgjedhjes dhe e shkarkimit të Avokatit të Popullit dhe Zëvendësve të Avokatit të Popullit, rregullohet me Rregullore të posaçme të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Neni 9

Zgjedhja e Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij

1. Avokatin e Popullit e zgjedh Kuvendi i Republikës së Kosovës, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të tij, për një mandat pesë (5) vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje.
2. Avokati i Popullit duhet të zgjidhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e propozimit të kandidatëve. Nëse ky afat nuk është arritur, Kuvendi i Republikës së Kosovës voton për zgjedhjen e Avokatit të Popullit në secilën seancë plenare për tridhjetë (30) ditë të tjera. Nëse Avokati i Popullit nuk zgjidhet brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve, Komisioni përkatës i Kuvendit përsëri do të shpallë konkurs për Avokat të Popullit.

3. Zëvendësit e Avokatit të Popullit zgjidhen njëherazi nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë.
4. Nëse Kuvendi nuk i zgjedh zëvendësit në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditëve, Kuvendi shpall konkurs të ri.
5. Avokati i Popullit, njërin nga zëvendësit e zgjedhur e cakton zëvendës kryesor të tij me rotacion për një mandat një (1) vjeçar.

Neni 10 **Marrja e detyrës dhe betimi**

1. Avokati i Popullit merr detyrën pasi ta kenë dhënë betimin para deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
2. Teksti i betimit është si në vijim: “Unë betohem dhe premtoj solemnisht se do t’i kryej me besnikëri në mënyrë të pavarur dhe të paanshme detyrat dhe funksionet që më janë besuar me Kushtetutë dhe me ligj, se do t’i mbroj dhe avancoj të drejtat dhe liritë e njeriut në Republikën e Kosovës”.

Neni 11 **Imuniteti**

1. Avokati i Popullit dhe zëvendësit e tij gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi për veprimtari ose vendimet që janë brenda fushës së përgjegjësisë të Institucionit të Avokatit të Popullit.
2. Zyrat e Institucionit të Avokatit të Popullit janë të pacenueshme. Arkivat, lëndët, komunikimet, prona, fondet dhe pasuritë e Institucionit të Avokatit të Popullit, kudo që janë apo nga kushdo që mbahen, janë të pacenueshme dhe gëzojnë imunitet nga kontrolli, marrja, nga kërkimi zyrtar i tyre, nga konfiskimi, nga shpronësimi apo nga çfarëdo ndërhyrje tjetër, qoftë përmes veprimit përmbarues, administrativ, gjyqësor apo legjislativ.

Neni 12 **Shkarkimi nga funksioni i Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij**

1. Avokati i Popullit, dhe zëvendësit e tij mund të shkarkohen për arsyet në vijim:
 - 1.1. paaftësia fizike apo mendore që shkakton pamundësinë e tij për kryerjen e funksioneve të tij.
 - 1.2. ka kryer veprë penale të dënueshme me legjislacionin e Republikës së Kosovës me gjashtë (6) ose më tepër muaj burgim në bazë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë;
 - 1.3. për shkak të sjelljes së tij personale që është në kundërshtim me ushtrimin e funksionit të tij;
 - 1.4. nëse kryen veprime në kundërshtim me nën-paragrafin 1.6 të nenit 6 dhe paragrafi 2. të nenit 7 të këtij ligji.

2. Avokati i Popullit kërkon që Kuvendi i Republikës së Kosovës të shkarkojë nga detyra një apo më shumë zëvendës të tij, për shkak të një apo më shumë arsyeve të parapara në këtë ligj.

Neni 13

Përfundimi i funksionit të Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij

1. Funksioni i Avokatit të Popullit dhe i zëvendësve të tij mbaron:

1.1. me vdekjen e tij;

1.2. kur jep dorëheqje;

1.3. kur mbaron afati 5 (pesë) vjeçar për Avokatin e Popullit, ndërsa 3 (tre) vjeçar për zëvendës të Avokatit të Popullit;

1.4. kur shkarkohet.

2. Në rast mungese, vdekje, paaftësie të përhershme ose të përkohshme, Avokati i Popullit, zëvendësohet nga zëvendësi kryesor. Nëse zëvendësi kryesor nuk mund të kryejë funksionin, atëherë Avokati i Popullit zëvendësohet nga zëvendësi më i vjetër sipas moshës.

3. Në rast skadimi të mandatit, Avokati i Popullit dhe zëvendësit e tij do ta ushtrojnë funksionin e tyre deri në zgjedhjen e Avokatit të ri të Popullit dhe zëvendësve të tij. 5

Neni 14

Sigurimi i Punës pas përfundimit të mandatit

1. Pas përfundimit të mandatit, Avokati i Popullit mund të kthehet në funksionin e tij ose punën publike që kishte para zgjedhjes si Avokat i Popullit. Kur kjo nuk është e mundur, atëherë punëdhënësi i mëhershëm duhet t'i sigurojë një punë të përshtatshme, varësisht nga aftësitë dhe profesioni i tij.

2. Avokatit të Popullit, të cilit i përfundon mandati, ose që për shkaqe të arsyeshme nuk mund ta vazhdojë punën e mëparshëm ose nuk mund të gjejë punë tjetër adekuate, e as që i ka plotësuar kushtet e përgjithshme të pensionimit, gëzon të drejtën e pagës në vlerën e njëjtë më atë që do të paguhej po të kishte punuar deri në pranimin në punë ose deri në plotësimin e kushteve të përgjithshme të pensionimit, por jo më gjatë se një (1) vit nga përfundimi i mandatit.

KREU III

KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSITË E AVOKATIT TË POPULLIT

Neni 15

Kompetencat

1. Avokati i Popullit ka kompetenca për t'i hetuar ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me standarde ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe konventave ndërkombëtare, veçanërisht me konventën evropiane për të drejtat e njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit.

2. Kompetencat e Avokatit të Popullit shtrihen në mbarë territorin e Republikës së Kosovës. Në ushtrimin e funksioneve të tij lidhur me rastet që paraqiten brenda territorit të Republikës së Kosovës, Avokati i Popullit mund t'u ofrojë shërbime të mira edhe qytetarëve të Republikës së Kosovës që përkohësisht ndodhen jashtë territorit të Republikës së Kosovës.
3. Avokati i Popullit ka kompetencë të bëjë hetime qoftë për t'u përgjigjur ankesës së parashtruar apo me iniciativën e vet (ex officio), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtrësë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e institucioneve të Republikës së Kosovës janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut.
4. Nëse Avokati i Popullit fillon procedurë me iniciativë të vetë ose ndonjë person tjetër në emër të të dëmtuarit i drejtohet me parashtrësë Avokatit të Popullit për ngritjen e procedurës, është i nevojshëm pëlqimi nga personi, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut.
5. Kur Avokati i Popullit fillon procedurë me iniciativë të vetë lidhur me shkeljen e të drejtave dhe lirive të një numri më të madh të qytetarëve, të fëmijëve apo personave me aftësi të humbura veprimi, nuk është i nevojshëm pëlqimi nga paragrafi 4. i këtij neni.
6. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe në procedura tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç në raste të zvarritjeve të paarsyeshme apo keqpërdorimit të dukshëm të pushtetit.
7. Avokati i Popullit mund të iniciojë çështje në Gjykatën Kushtetuese në pajtim me kushtetutën dhe ligjin për Gjykatë Kushtetuese;
8. Avokati i Popullit i ushtron kompetencat e veta edhe më anë të ndërmjetësimit dhe pajtimit.
9. Shërbimet e ofruara nga Institucioni i Avokatit të Popullit janë falas.

Neni 16 **Përgjegjësitë**

1. Avokati i Popullit ka këto përgjegjësi:
 - 1.1. të hetojë shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut dhe të angazhohet për zgjedhjen e tyre.
 - 1.2. të tërheqë vëmendjen për rastet kur institucionet e Republikës së Kosovës i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e institucioneve përkatëse në lidhje me rastet e tilla;
 - 1.3. të bëjë të njohura të drejtat e njeriut dhe përpjekjet për të luftuar të gjitha format e diskriminimit përmes ngritjes së vetëdijesimit, posaçërisht përmes informimit dhe edukimit edhe me anë të mediave;
 - 1.4. të njoftojë Qeverinë, Kuvendin dhe institucionet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut;
 - 1.5. t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta;
 - 1.6. të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës;

1.7. të përgatitë raporte vjetore, periodike dhe të tjera mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Republikën e Kosovë;

1.8. të rekomandojë harmonizimin e legjislacionit të Kuvendit me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv;

1.9. të bashkëpunojë, në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, me të gjitha organizatat dhe institucionet vendore dhe ndërkombëtare që merren me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut;

1.10. Avokati i Popullit, zëvendësit dhe personeli i tij duhet ruajtur fshehtësinë e të gjitha informatave dhe të të dhënave që i merr, duke i kushtuar kujdes të veçantë sigurisë së ankuesve, palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve, në pajtim me ligjin për mbrojtjen e të dhënave;

1.11. obligimi për ruajtjen e fshehtësisë zyrtare vlen edhe pas përfundimit të mandatit ose marrëdhënies së punës.

2. Avokati i Popullit mund t'i ofrojë këshilla dhe t'i japë rekomandime çdo personi fizik dhe juridik lidhur me pajtueshmërinë e ligjeve dhe akteve nënligjore me standardet e pranuar ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut.

3. Avokati i Popullit mund t'i këshillojë dhe t'u rekomandojë institucioneve të Republikës së Kosovës për programet dhe politikat e tyre për të siguruar mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Kosovës.

4. Avokati i Popullit i ndërmerr të gjitha masat dhe veprimet e nevojshme për t'i shqyrtuar ankesat e parashtruara sipas paragrafit 1. të nenit 15 të këtij ligji, duke përfshirë edhe intervenimin e drejtpërdrejtë tek autoritetet kompetente, nga të cilët do të kërkohet që të përgjigjen brenda kohës së arsyeshme të caktuar nga Avokati i Popullit. Nëse vazhdon dëmi i rëndë si pasojë e çështjes së ankesës sipas paragrafit 1. të nenit 15 të këtij ligji, nga autoritetet kompetente kërkohet të përgjigjen me nguti.

5. Nëse gjatë hetimeve, Avokati i Popullit konstaton se ekzekutimi i ndonjë vendimi administrativ mund të ketë pasoja të pariparueshme për personin fizik apo juridik, mund të rekomandojë që autoriteti kompetent ta pezullojë ekzekutimin e vendimit në fjalë deri në përfundimin e hetimeve lidhur me këtë çështje nga ana e Avokatit të Popullit.

6. Avokati i Popullit ka qasje në dosjet dhe në dokumentet e çdo institucioni të Republikës së Kosovës dhe mund t'i shqyrtojë ato lidhur me rastet që i ka në shqyrtim dhe sipas këtij ligji, mund të kërkojë nga çdo institucion i Republikës së Kosovës dhe nga personeli i tyre të bashkëpunojnë me Avokatin e Popullit, duke siguruar informacione relevante, duke përfshirë edhe kopjen e plotë apo të pjesshme të dosjes dhe dokumenteve tjera sipas kërkesës së Avokatit të Popullit.

7. Zyrtarët e Institucionit të Avokatit të Popullit në çdo kohë dhe pa paralajmërim mund të hyjnë dhe të inspektojnë çdo vend ku personat janë privuar nga liria si dhe në institucionet tjera me liri të lëvizjes së kufizuar dhe mund të jenë të pranishëm në mbledhje ose seanca dëgjimore ku përfshihen personat e tillë. Zyrtarët e Institucionit të Avokatit të Popullit mund të mbajnë edhe takime me personat e tillë pa praninë e zyrtarëve të institucionit përkatës. Çdo lloj korrespondence e këtyre personave me Institucionin e Avokatit të Popullit nuk pengohet apo kontrollohet.

8. Avokati i Popullit ose përfaqësuesit e tij mund të hyjnë në hapësirat zyrtare të të gjitha organeve të autoriteteve publike, organeve tjera dhe organizatave që ushtrojnë autorizime publike për llogari të tyre.

KREU IV PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË ANKESAVE

Neni 17 Fillimi i procedurës

Çdo person i cili pretendon se të drejtat apo liritë e tij janë shkelur me ndonjë ligj, veprim apo mosveprim, keqadministrim të organeve të autoriteteve publike, organeve tjera dhe organizatave që ushtrojnë autoritete publike për llogari të tyre, mund të kërkojë nga Institucioni i Avokatit të Popullit fillimin e procedurës.

Neni 18 Forma e paraqitjes së ankesës

1. Çdo ankesë që i parashtrohet Avokatit të Popullit duhet të jetë e nënshkruar dhe t'i ketë shënimet personale të paraqitësit të ankesës si dhe të përmbajë të gjitha rrethanat, faktet dhe dëshmitë në të cilat kjo ankesë bazohet. Paraqitësi i ankesës mund të deklarojë nëse mjetet juridike janë ushtruar apo jo, dhe nëse po cilat prej këtyre mjeteve janë zbatuar.

2. Çdo ankesë për fillimin e procedurës, si rregull paraqitet me shkrim. Kërkesa për fillimin e procedurës mund të paraqitet edhe gojarisht, në rast se nuk mund të bëhet me shkrim.

Neni 19 Procedura pas pranimit të ankesës

1. Pas pranimit të ankesës, Avokati i Popullit në afat prej tridhjetë (30) ditësh vendos për pranueshmërinë e çështjes si në vijim:

1.1. të shqyrtojë në procedurë të përshpejtuar rastin;

1.2. të fillojë hetimin e plotë;

1.3. të hedh poshtë ankesën për shkak se:

1.3.1. nuk është në kompetencën e Avokatit të Popullit sipas këtij ligji;

1.3.2. ankesa është parashtruar pas afatit të paraparë me këtë ligj;

1.3.3. ankesa është anonime;

1.3.4. ankesa paraqet keqpërdorim të së drejtës për paraqitjen e ankesës;

1.3.5. ankuesi ka dështuar të sigurojë informatat e kërkuara nga Avokati i Popullit.

1.4. të refuzojë ankesën si të pabazuar.

1.5. të ndërpretë hetimet kur konstaton se rasti është zgjidhur në ndonjë mënyrë tjetër në pajtim me kërkesën e ankuesit.

2. Në të gjitha rastet e mësipërme, Avokati i Popullit e njofton me shkrim palën brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të ankesës.

3. Vendimi i Avokatit të Popullit për të hedhur poshtë apo për të refuzuar ankesën është i formës së prerë.

Neni 20

Rastet e refuzimit të shqyrtimit të ankesës

1. Avokati i Popullit refuzon kërkesën për shkak të arsyeve si në vijim:

1.1. kur nga shënimet e paraqitura dhe nga rrethanat e rastit del se të drejtat dhe liritë e njeriut nuk janë shkelur apo nuk është kryer kurrfarë keqadministrimi;

1.2. kur kërkesa është jo e plotë dhe nuk është kompletuar edhe pas kërkesave të Avokatit të Popullit;

1.3. kur procedurat për një lëndë janë duke u zhvilluar në organet gjyqësore ose në organet tjera kompetente, përveç në rastet e specifikuara me këtë ligj.

1.4. kur të gjitha mjetet juridike të rregullta dhe të jashtëzakonshme nuk janë shterur, përpos nëse ai vlerëson se do të jetë e padobishme për paraqitësin e ankesës për të filluar apo vazhduar procedurën, apo nëse vlerëson se individët kanë pësuar dëm të madh apo mund të pësojnë dëm të madh dhe të pa kompenzueshëm në ndërkohë;.

Neni 21

Rastet e parashkrimit dhe përjashtimit

1. Avokati i Popullit nuk inicion procedurë për të hetuar shkeljen e të drejtave të njeriut nëse prej datës që pala e ka marrë vendimin e formës së prerë ose është njoftuar lidhur me të dhe deri në dorëzimin e ankesës në Institucionin e Avokatit të Popullit kanë kaluar më shumë se gjashtë (6) muaj.

2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, Avokati i Popullit mund të iniciojë procedurë edhe pas kalimit të afatit prej gjashtë (6) muaj në rast se vlerëson se paraqitësi i ankesës ka qenë i penguar apo në rast se vlerëson se çështja është e rëndësisë së veçantë.

Neni 22

Procedura pas fillimit të hetimit

1. Kur Avokati i Popullit vendos t'i fillojë hetimet në pajtim me nenin 19 të këtij ligji, vendimin e vet do t'ua komunikojë paraqitësit të ankesës dhe organit kundër të cilit është paraqitur ankesa. Avokati i Popullit mund të kërkojë informata shtesë lidhur me rastin.

2. Avokati i Popullit cakton afatin brenda të cilit organi duhet t'ia dorëzojë të gjitha informatat e kërkuara në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni. Afati nuk mund të jetë më i shkurtër se tetë (8) ditë dhe as më i gjatë se tridhjetë (30) ditë. Kur organi nuk arrin t'i dorëzojë në afatin e paraparë informatat e kërkuara nga Avokati i Popullit, ai pa vonesë duhet t'i paraqesë me shkrim arsyet e vonesës në ofrimin e informatës së kërkuar.

3. Në rast se Avokati i Popullit i vlerëson të pamjaftueshme përgjigjet ose masat e ndërmarra nga organi, ai ka të drejtë ta procedojë çështjen tek organi më i lartë kompetent, ose t'i paraqesë raport të veçantë Kuvendit, duke i propozuar edhe masa konkrete për vënien në vend të së drejtës së shkelur.

4. Refuzimi apo dështimi për t'iu përgjigjur kërkesave të Avokatit të Popullit konsiderohet pengim i punës së Avokatit të Popullit. Kjo nuk e pengon Avokatin e Popullit për të nxjerrë konkludimet dhe rekomandimet e tij.

5. Avokati i Popullit mund të raportojë veprimet e parapara në paragrafin 4. të këtij neni në raportet e tij.

Neni 23

Detyrimi i bashkëpunimit dhe pasojat e refuzimit

1. Të gjitha organet e pushtetit shtetëror kanë për obligim ta ndihmojnë Avokatin e Popullit në zhvillimin e hetimeve, si dhe t'i ofrojnë ndihmë adekuate sipas kërkesës së tij.

2. Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose nga autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga organi kompetent fillimin e procedurës administrative duke përfshirë marrjen e masave disiplinore, deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil.

Neni 24

Thirrja e dëshmitarëve dhe ekspertëve

Avokati i Popullit mund t'i dërgojë thirrje çdo dëshmitari ose eksperti për ta intervistuar lidhur me rastin që e shqyrton. Personi i thirrur e që punon në institucionet publike është i obliguar t'i përgjigjet thirrjes.

Neni 25

Marrja e vendimit

Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit në pajtim me kompetencat dhe përgjegjësitë e tij, nxjerrë vendim në të cilin paraqiten konstatimet dhe rekomandimet e tij. Vendimi i tij i dërgohet parashtruesit të ankesës dhe autoriteteve publike përgjegjëse.

Neni 26

Përgjigjja në kërkesat e Avokatit të Popullit

Organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për masa disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Neni 27

Raporti i Avokatit të Popullit

1. Avokati i Popullit i paraqet Kuvendit të Republikës së Kosovës raportin vjetor.

2. Avokati i Popullit ia paraqet Kuvendit të Kosovës raportin për vitin paraprak deri më 31 mars të vitit vijues. Avokati i Popullit e paraqet raportin në seancë plenare, në të cilën diskutohet.

Neni 28

Publikimi i raporteve të veçanta

Avokati i Popullit mund të publikojë raporte të veçanta edhe përmes mediave për shkeljet e bëra nga organi, nëse ky i fundit, pas kërkesave të përsëritura nuk i është përgjigjur në mënyrë përkatëse propozimeve dhe rekomandimeve të tij.

KREU V

ZYRA, OBJEKTI, PERSONELI DHE BUXHETI I INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT

Neni 29

Selia e Institucionit, paprekshmëria e selisë dhe zyrave të Avokatit të Popullit

1. Selia e Institucionit të Avokatit të Popullit është në Prishtinë.
2. Institucionit të Avokatit të Popullit i sigurohen objekte të duhura për punë dhe pajisje të tjera në mënyrë që t'i mundësohet kryerja efektive e funksioneve dhe e përgjegjësisë të tij.
3. Avokati i Popullit sipas nevojës mund të hapë zyra tjera brenda territorit të Republikës së Kosovës.
4. Në kuadër të Institucionit të Avokatit të Popullit do të funksionojnë njësi të veçanta për mbrojtjen e kategorive të posaçme të drejtave të njeriut.

Neni 30

Personeli Profesional

Personeli i Institucionit të Avokatit të Popullit përzgjidhet nga radhët e qytetarëve të Republikës së Kosovës në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës.

Neni 31

Rregullorja e Institucionit

1. Institucioni i Avokatit të Popullit nxjerrë Rregulloren e punës së tij.
2. Rregullorja e punës publikohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës" si dhe në web faqe të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Neni 32 Pagat

1. Niveli i pagës së Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij caktohet në pajtim me Ligjin për Pagat e zyrtarëve të Lartë Publik
2. Niveli i pagës së personelit tjetër të Avokatit të Popullit përcaktohet në pajtim me Ligjin për Pagat e nëpunësve civil.

Neni 33 Angazhimi i këshilltarëve dhe ekspertëve të jashtëm

Avokati i Popullit, në marrëveshje me punëdhënësin mund të angazhojë, sipas nevojës, këshilltarë dhe ekspertë të jashtëm, për t'i shërbyer për një periudhë të caktuar.

Neni 34 Financimi

1. Institucioni i Avokatit të Popullit financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës.
2. Pavarësisht nga dispozitat e ligjeve të tjera, Institucioni i Avokatit të Popullit përgatit propozimin e buxhetit të tij vjetor dhe ia dërgon atë për miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Institucioni i Avokatit të Popullit menaxhon në mënyrë të pavarur me buxhetin e tij dhe i nënshtrohet auditimit të brendshëm si dhe auditimit të jashtëm nga Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës.

Neni 35 Pranimi i donacioneve

Institucioni i Avokatit të Popullit mund të pranojë donacione shtesë nga donatorët vendorë dhe ndërkombëtarë, për të cilat njoftohet Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe të cilat nuk ndikojnë në pavarësinë financiare të Institucionit të Avokatit të Popullit dhe nuk janë në kundërshtim me ligjin dhe që nuk ndikojnë në pavarësinë e Institucionit të Avokatit të Popullit ose në të drejtat e tij prej Buxhetit të Republikës së Kosovës.

KREU VI DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 36

1. Brenda gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, zgjedhën zëvendësit e Avokatit të Popullit në pajtim me këtë ligj.
2. Mandati aktual i Avokatit të Popullit vazhdon deri në përfundimin e mandatit të tij.
3. Mandati aktual i zëvendësit të Avokatit të Popullit vazhdon deri në zgjedhjen e zëvendësve tjerë.

4. Avokati i Popullit ka kompetenca edhe për rastet që paraqiten para hyrjes në fuqi të këtij ligji kur nga faktet rezulton vazhdimi i shkeljes së një ose më shumë standardeve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut ose përbëjnë keqpërdorim të vazhdueshëm të pushtetit.

Neni 37
Dispozitat Kalimtare

Brenda tre (3) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Institucioni i Avokatit të Popullit nxjerrë Rregulloren e punës.

Neni 38
Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2000/38 mbi themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë të datës 30 qershor 2000, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/6 mbi Institucionin e Avokatit të Popullit të Kosovës e datës 16 shkurt 2006 dhe Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2007/15 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/6 mbi Institucionin e Avokatit të Popullit në Kosovë të datës 19 mars 2007 si dhe të gjitha dispozitat tjera që bien në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 39
Hyrja në Fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-195

22 korrik 2010

Shpallur me dekretin Nr. DL-046-2010, datë 09.08.2010 nga Presidenti i Republikës së Kosovës,
Dr. Fatmir Sejdiu

13.2. Kompetencat e Avokatit të Popullit në ligjet e tjera

Ligji nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike

Neni 3, paragrafi 1.5.

“Avokati i Popullit-institucion i pavarur, i themeluar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.”

Neni 10 Mos përgjigja e Institucionit Publik

“Refuzimi i kërkesës së kërkuarit, si dhe mos përgjigja e institucionit publik brenda afatit të caktuar konsiderohet si përgjigje negative dhe i jep të drejtë kërkuarit që të fillojë procedurën para Institucioni të Avokatit të Popullit, institucioneve të tjera publike, gjykatës kompetente, në përputhje me ligjin në fuqi.”

Neni 17 Institucioni i Avokatit të Popullit

“Institucioni i Avokatit të Popullit është organ i pavarur, i cili ndihmon qytetarët për realizimin e së drejtës për qasje në dokumentet e nevojshme të cilat u janë refuzuar.

Detyrë e Institucionit të Avokatit të Popullit është që të kujdeset për realizimin e papengueshëm të së drejtës për qasje në dokumente publike, e sidomos:

të ndërmerri masat e nevojshme për të promovuar dhe përkrahur të drejtat themelore për qasje në dokumente, dhe t’ia paraqesë Kuvendit raportet e rregullta për zbatimin e së drejtës për qasje në dokumente zyrtare, nga institucionet publike.

Institucioni i Avokatit të Popullit shërbimet për qytetarët i kryen pa pagesë.

Pala e pakënaqur në procedurën e realizimit të së drejtës në qasje në dokumente publike, mund të drejtohet me ankesë edhe institucioneve të tjera publike.”

Ligji nr. 03/L-202, Për Konfliktin Administrativ

Neni 10, paragrafi 2

“Organi i administratës, Avokati i Popullit, shoqatat dhe organizatat e tjera, të cilat veprojnë në mbrojtje të interesave publike mund të fillojnë konfliktin administrativë.”

Neni 18

“Paditës në Konfliktin administrativ mund të jetë personi fizik, personi juridik, Avokati i Popullit, shoqatat dhe organizatat tjera, të cilat veprojnë në mbrojtje të interesit publik, që konsideron se me aktin administrativ i është shkelur ndonjë e drejtë apo interes i drejtpërdrejtë ose i tërthortë, i bazuar në ligj.”

Ligji nr. 03/L-121, Për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës

Neni 6, paragrafi 2, pika 2.4.

“Avokati i Popullit është anëtar i komisionit për shqyrtimin e kandidatëve për emërim në Gjykatën Kushtetuese.”

Neni 6, paragrafi 1

”Kërkesa e ngritura në pajtim me nenin 113 paragrafi 2 të Kushtetutës do të parashtrohen nga një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria ose nga ana e Avokatit të Popullit.”

Ligji nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore

Neni 460

“Kur prokurori publik apo Ombudspersoni marrin pjesë në procesin kontestimor si palë ndërgjyqëse, atyre u takon e drejta në shpenzimet procedurale sipas dispozitave të këtij ligji, por jo edhe e drejta e shpërblimit për punën e kryer.”

Ligji 03/L-063 për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë

Neni 7

”Rregulloren mbi mekanizmin e ankesave, që do të zhvillohen në konsultim me institucionin e Ombudspersonit në Kosovë dhe do të vendoset në domenin publik.”

Neni 10

“Inspektori i përgjithshëm është përgjegjes për të mbështetur hetimet e Ombudspersonit të Kosovës.”

Neni 39.2.

”Ankesat mund t’i drejtohen Institucionit të Ombudspersonit të Kosovës (IOK).”

Neni 39.3.

”Cilado ankesë e paraqitur në IOK-së nuk e çënon të drejtën e një individi, institucioni apo pale të tretë të kërkojnë shqyrtim nga një gjykatë.”

Ligji 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat

Neni 84, paragrafi 2, Konfidencialiteti Informatave,

Zyrtari tatimor mund të zbulojë informata për tatimpaguesin si në vijim:

Nënparagrafi 2.4.

”Institucionin e Ombudspersonit të themeluar sipas legjisllacionit dhe rregulloreve ne fuqi lidhur me Themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, për përdorim në zgjidhjen e ankesave të tatimpaguesit”

Ligji nr. 02/L-28, për Procedurën Administrative

Neni 35.3.

”Në mënyrë që të mbrohen interesat publike,të cilat mund të preken nga një procedim administrativ,e drejta për të filluar një procedim administrativ ose për të marrë pjesë në të, u njihet edhe subjekteve të mëposhtme: *pika c*) Ombudspersonit (Avokatit të Popullit).”

Neni 47.1.

”Në ato raste kur vërtetohen kushtet e parashikuar nga Paragrafet 3 dhe 4 të nenit 35 të këtij Ligji, procedimi administrativ mund te fillohet nga publiku ose Ombudspersoni.”

Neni 47.2.

”Në ato raste kur procedimin administrativ e fillon publiku ose Ombudspersoni,organi i administratës publike merr të gjitha masat që i quan të nevojshme për përgatitjen e çështjes, duke përfshirë edhe probleme që nuk përfshihen në kërkesën e dorëzuar në qoftë se gjykon se kjo është në interesin e publikut.”

Ligji nr. 03/L-047, për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës

Neni 13.4.

”Komunitetet dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë të: *pika b*) të parashitrojnë ankesë në Zyrën e Ombudspersonit të Republikës së Kosovës dhe në organet e tjera të specializuara, përfshirë komisionin e pavarur të mediave, dhe komisionin e gjuhëve.”

Ligji Nr 2004/2, për Barazi Gjinore, neni (b) i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/18 mbi shpalljen e Ligjit për Barazi Gjinore në Kosovë

Neni (b) i Rregullores thotë: Neni 6 i Ligjit për Barazi Gjinore fshihet tërësisht dhe zëvendësohet me nenin e ri 6 në të cilin thuhet:

”Çështjet e diskriminimit që lidhen drejtpërdrejt me gjininë trajtohen nga njësia për barazi gjinore në kuadër të institucionit të Ombudspersonit të themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/38,e cila po ashtu ka përgjegjësi të rishikojë projektligjet, të japë komente lidhur me zbatimin e këtij ligji dhe me legjisllacionin ekzistues kur ka të bëjë me çështjet gjinore. Zyra për barazi gjinore në kuadër të institucionit të Ombudspersonit financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.”

Ligji nr. 2004/32, Kundër Diskriminimit

Neni 10

“Organ i autorizuar për pranimin dhe hetimin e ankesave që kanë të bëjnë me shkeljen e të drejtave në baza diskriminuuese është Ombudspersoni i Kosovës, i cili do t’i shqyrtojë rastet në përputhje me autorizimet dhe përgjegjësitë që ka sipas legjislacionit në fuqi.”

Ligji Nr. 02/L-65, Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes

Neni 9

“Deklaratat e dhëna nuk bartin përgjegjësi në bazë të këtij Ligji nëse i padituri dëshmon se ato janë bërë në cilën do nga rrethanat në vijim: *pika d*) çdo deklaratë e bërë para Avokatit të Popullit.”

Ligji Nr. 03/L-31 mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale

Neni 61, paragrafi 8

“Letrat dhe dërgesat tjera postare nga personi i dënuar që i dërgohen Zyrës së Ombudspersonit të Kosovës nuk duhet të kontrollohen në asnjë mënyrë.”

Neni 215, paragrafi 7

“Dispozitat e këtij neni nuk e cenojnë autorizimin që e kanë Ombudspersoni i Kosovës, gjykatësit dhe zyrtarët tjerë të drejtësisë në bazë të ligjit në fuqi për qasje në dokumentet, zyrtare dhe Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.”

Kodi i Përkohshëm i procedurës Penale i Kosovës, 6 korrik 2003

Neni 294, paragrafi 3

“Ombudspersoni i Kosovës ose zëvendësi i tij mund të vizitojë të paraburgosurit dhe të korrespondojë me ta pa paralajmërim paraprak ose pa mbikëqyrjen e gjyqtarit të procedurës paraprake apo personave të tjerë të emëruar nga gjyqtari i tillë. Letrat e të paraburgosurit dërguar Zyrës së Ombudspersonit të Kosovës nuk mund të kontrollohen. Ombudspersoni i Kosovës dhe zëvendësi i tij mund të komunikojnë gojarisht ose me shkrim në mënyrë konfidenciale me të paraburgosurit. Komunikimi ndërmjet të pandehurit dhe Ombudspersonit ose zëvendësit të tij mund të shikohet nga oficeri policor, por jo të dëgjohet.”

Neni 295, paragrafi 3

“Kufizimi ose ndalimi i vizitës a i korrespondencës nuk zbatohet ndaj vizitave ose korrespondencave me mbrojtësin, mjekët, Ombudspersonin e Kosovës, përfaqësuesit e zyrës së ndërlidhjes ose të misionit diplomatik të shtetit, shtetas i të cilit është i paraburgosuri ose, në rastin e refugjatit ose të personit i cili në ndonjë mënyrë tjetër është nën mbrojtjen e ndonjë organizate ndërkombëtare dhe ndaj përfaqësuesve të organizatës kompetente.”

Neni 321, paragrafi 7

“Me kërkesë të Ombudspersonit të Kosovës, Ombudspersoni gjithashtu njoftohet për shqyrtimin gjyqësor me qëllim të monitorimit të procedurës penale në kufijtë e autorizimeve të tij.”

Rregullorja nr. 2006/12, Mbi Themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut

Neni 13 Pjesëmarrja e një Amicus Curiae dhe e Avokatit të Popullit

Paragrafi 13.1.

”Paneli këshillëdhënës, kur është në interes të drejtësisë, mund të ftojë

(b) Avokatin e Popullit që të parashtrojë komentet me shkrim nëse ai është duke u marrë me këtë çështje”.

Paragrafi 13.2.

”Parashtrësat me shkrim nga avokati i popullit do të jenë pa paragjykimë mbi autorizimet, përgjegjësitë dhe obligimet e avokatit të popullit sipas ligjit në fuqi.”